

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Analizë e atraktivitetit të Investimeve të huaja dhe roli i tyre në Ekonomi

Demir LIMA

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(Shkenca Ekonomike), me profil (Menaxhim), për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof Dr. Arben Malaj

Numri i fjalëve: 56, 880

Tiranë, Maj 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë deklaroj me përgjegjesi dhe dijeni të pasojave ligjore që ka një deklaram i rremë se i gjithë dokumentacioni akademik është krijimtari e imja dhe nuk është plagjiaturë as kopje e ndonjë autori tjetër.

Deklaroj se procesi i mbledhjes, regjistrimit dhe përpunimit të të dhënave si parësore ashtu edhe dytësore është pronësi e imja dhe me burime të dokumentuara.

Përmbajtja

MIRËNJOHJE	11
ABSTRAKT	12
ABSTRACT.....	14
KAPITULLI I.....	16
1.1 HYRJE pse ky studim?	16
1.2 QËLLIMI I STUDIMIT	19
1.3 OBJEKTIVAT E PUNIMIT	21
1.4 PYETJET KËRKIMORE	22
1.5 HIPOTEZAT E NGRITURA	22
1.6 METODOLOGJIA E PERDORUR.....	23
1.7 MUNDËSITË DHE KUFIZIMET	23
KAPITULLI II.....	25
2.1 Shqyrtimi i literaturës mbi IHD-të dhe roli i tyre në ekonomi.....	25
2.2. Përkufizimi mbi Investimet e Huaja Direkte dhe tendenca e fundit	27
Këndvështrimi makroekonomik dhe mikroekonomik	41
2.3. Teoritë mbi Investimet e Huaja Direkte.....	44
Shkolla neoliberales dhe keynesiane	44
2.4. Krijimi i kushteve për tërheqjen e IHD-ve.....	50
2.5 Investimet e Huaja Direkte në Evropën Juglindore	53
IHD-të në bazë të të dhënave të vitit 2009.....	64
2.6 Investimet e Huaja Direkte dhe kriza globale ekonomike në Ballkanin Perëndimor	70
Maqedonia, pesë herë më pak investime se Shqipëria	77
2.7 Përmbledhje e kapitullit të dytë	83
KAPITULLI III	86
Investimet e Huaja Direkte në Kosovë dhe sfidat me të cilat ato përballen.....	86
3.1. Sfidat me të cilat do të ballafaqohet Kosova.....	86
3.2. Stabiliteti makroekonomik.....	87
3.3 Procesi i privatizimit në Kosovë	91
Bilanci tregtar i Kosovës, 2011-2013	94
3.4 Përparësitë e Kosovës për Investime të Huaja Direkte	99
3.5 Angazhimi i institucioneve të Kosovës në përmbushje të standardeve të nevojshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian.....	100

3.6 Dinamika e IHD-ve në Kosovë.....	100
Ecuria e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë.....	107
3.7 Pozicioni ndërkombëtar i investimeve.....	113
Llojet e IHD-ve dhe klasifikimi i tyre.....	115
3.8 IHD-të në kontekstin e Kosovës	116
3.9 Struktura e tregut të punës	117
3.10 Llogaria kapitale dhe financiare.....	122
3.11 Kuadri ligjor dhe institucional në Kosovë	123
3.12 Format e të bërit biznes në Republikën e Kosovës	124
Ndikimi i Raportit të të Bërit Biznes	127
3.13 Ndikimi i TBB-së në investime, praktika nga vendet e tjera	129
3.14 Ambienti afarist si faktor në investime	132
Roli dhe zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në Kosovë	133
3.15 Ligji mbi Investimet e Huaja nr. 2013/04-L-220	136
3.16 Indikatorët e përgjithshëm që duhet të merren në konsideratë për IHD-të	140
3.17 Indeksi i perceptimit të korrupsionit	143
3.18 Raporti global i konkurrencës	145
3.19 Raporti i qeverisjes për Kosovën, 1996-2013 Banka Botrore.....	146
3.20 Praktikrat e mira ndërkombëtare dhe incentivave; format dhe objektivat e incentivave të investimeve	149
3.21 Sfidat kryesore të zhvillimit dhe strategjia qeveritare.....	156
3.22 Indeksi i lirisë ekonomike	158
3.23 Indeksi i transformimit i Fondacionit Bertelsmann	159
3.24 Analiza e faktorëve që merren në konsideratë në Investimet e Huaja Direkte në Kosovë	160
3.25 Përmbledhje e kapitullit të tretë	161
KAPITULLI I IV	164
METODOLOGJIA KËRKIMORE.....	164
4.1 Grumbullimi i të dhënave	165
4.2 Mostra (kampioni i përzgjedhur)	170
4.3 Pyetësori.....	170
4.4 Përpunimi i të dhënave (Paraqitja e tyre).....	173
4.5 Përgjigjet e pyetjeve të kërkimit dhe rezultatet.....	179
4.5.1 Atraktiviteti i Kosovës për investime të huaja – Testet statistikore.....	180

4.5.2 Analizë ekonometrike mbi IHD-të në Kosovë.....	184
Të dhënat per VECM.....	184
4.5.3 Ndikimi i IHD-ve në rritjen ekonomike.....	185
4.6 Përfundime.....	197
KAPITULLI V	201
5.1 Përmbledhje dhe gjetje empirike.....	201
5.2 REKOMANDIME TË NEVOJSHME.....	203
5.3 SUGJERIMET PËR KËRKIME NË TË ARDHMEN	205
6.ANEKSET	206
Pyetësi, Testi i Kruskal-Wallis dhe Testi Wilcoxon, grafikët e rezultateve të pyetësorit dhe grafikët e indikatorëve të qeverisjes botërore për Kosovën (WGI).....	206
Kufizimet e modelit – Arsyeimi për modelin OLS.....	223
Analiza ekonometrike – Modeli OLS	227
7.BIBLIOGRAFIA	241

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKEVE

Grafiku 2.1: Flukset hyrëse të IHD-ve në nivel botëror (1998-2013)	34
Grafiku 2.2. IHD-të sipas grupit të ekonomive, 1995 - 2012	35
(Grafiku 2.3)	36
Grafiku 2.4. Fluksi IHD-ve në nivel global dhe sipas grupimeve ekonomike, 1995-2013 dhe parashikimet, 2014-2016 (miliarda dollarë)	38
Grafiku 2.5. IHD-të në nivel botëror 2000-2013 në miliarda \$	59
Grafiku 2.6 Flukset hyrëse të IHD-ve në Evropën Juglindore në vitet 2002 dhe 2005.	61
Grafiku 2.7 IHD-të në Evropën Juglindore në vitin 2006-2007 dhe 2008 (në mil. €).....	62
Tabela 2.1 Flukset e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore 2000-2013	66
Grafiku 2.8 Paraqitja e flukseve të IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore në vitet 2000-2013	67
Grafiku 2.9 Flukset e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore në vitet 2011-2013	67
Grafiku 2.10 Raporti i IHD-ve në mes të Shqipërisë dhe Maqedonisë në vitet 2008-2013	77
Tabela 2.2 Rritja reale e PBB-së dhe parashikimi deri në vitin 2020 në vendet EJT në përqindje	79
Grafiku 2.11 Rritja reale e PBB-së në % sipas shteteve ndër vite deri më 2020.....	80
Tabela 2.3. Investimet e Huaja Direkte neto në % ndaj PBB-së në vendet e EJT-së, EU11 dhe EU15, 2009-2013	80
Grafiku 2.12. Flukset e IHD-ve si % e PBB-së	81
Tabela 3.1 shkëmbimi tregtar i Kosovës, 2001-2014	94
Grafiku 3.1. Shkëmbimi tregtar i Kosovës, 2001-2014	94
Grafiku 3.2. Importet-eksportet, 2011-2013	95
Tabela 3.3. Vendet me pjesëmarrjen më të madhe në importet e përgjithshme në vitin 2013 (në %).....	95
Grafiku 3.3. Vendet me pjesëmarrje më të madhe në importet e përgjithshme në vitin 2013 (në %).....	96
Tabela 3.4. Vendet me pjesëmarrje më të madhe në eksportet e përgjithshme të Kosovës në vitin 2013 (në %).....	96
Grafiku 3.4. Vendet me pjesëmarrje më të madhe në eksportet e përgjithshme të Kosovës në vitin 2013 (në %).....	97
Tabela: 3.5. Importet.....	97
Tabela: 3.6. Exportet.....	97

Tabela 3.7 tregon një pasqyrë të importeve dhe eksporteve me vendet e CEFTA-s gjatë periudhës 2011-2013	98
Grafiku 3.5. Importet dhe eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s gjatë periudhës 2011-2013	98
Grafiku 3.6 Investimet e Huaja Direkte në Kosovë gjatë periudhës 2007-2014	102
Tabela 3.8. Investimet e Huaja Direkte sipas shteteve (vitet 2007- 2014 euro mil.).....	103
Grafik 3.7. Investimet e Huaja Direkte sipas shteteve (vitet 2007- 2014, në mil. euro).....	103
Tabela 3.9. Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik (vitet 2007- 2014 në mil. euro	104
Grafiku 3.8. Sipas aktivitetit ekonomik në vitet 2007-2014 (në mil. euro)	105
Tabela 3.10. Shpërndarja e kompanive të huaja investuese sipas sektorëve të ekonomisë-2014	106
Grafiku 3.9. Shpërndarja e kompanive të huaja investuese sipas sektorëve të ekonomisë-2014	106
Tabela 3.11 Pjesëmarrja e IHD-ve në BPV të Kosovës në periudhën 2007-2014 (përfshinë TM1, TM2 dhe TM3)	107
Grafiku 3.10. Paraqitja grafike e IHD-ve si % e BPV-së, 2007-2014	107
Grafiku 3.11. Investimet e Huaja Direkte dhe deficitit i llogarisë rrjedhëse	108
Tabela 3.12. Investimet e Huaja Direkte sipas sektorëve ekonomikë 2007-2014 shprehur në përqindje	110
Grafiku 3.12. Investimet e Huaja Direkte sipas sektorëve ekonomikë gjatë viteve 2007-2014 shprehur në përqindje (%).....	110
Grafiku 3.13. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve	113
Grafiku 3.14. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve sipas sektorëve institucionalë	115
Tabela 3.12. Krahësimi i statistikave kyçe të punësimit mes vendeve	118
Grafiku 3.11. Krahësimi i statistikave kyçe mes vendeve të EJT-së, EU-s dhe Kosovës 2012-2013.....	118
Tabela 3.13. Përmbledhja e tregut të punës 2012-2013.....	120
Tabela 3.14. Renditja e Kosovës në lehtësirat e të bërit biznes 2013-2014.....	128
Grafiku 3.12 Raporti i BEEPS 2010 për Kosovën.....	129
Tabela 3.15. Renditja e ekonomive të të bërit biznes për vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2013.....	130
Tabela 3.16. Krahësimi TBB - IHD, Kosovë, <i>Banka Botërore, tetor 2011</i>	141
Tabela 3.17. Krahësimi TBB - IHD, Maqedoni.....	142
Grafiku 3.13. Indeksi i perceptimit të korrupsionit.....	145

Tabela 4.1 Taksat e vendeve të rajonit.....	177
Grafiku 4.1 Përmbledhja e rezultateve të pyetësorit.....	179
Tabela 4.2: Statistikat e testit Kruskall Wallis.....	181
Tabela 4.3: Testi i Wilcoxon mbi Kostot e punës dhe faktorëve të tjerë.....	182
Tabela 4.4: Testi i Wilcoxon për krahasimet midis faktorëve	183
Tabela 4.5: Testi i Wilcoxon për krahasimet midis faktorëve	183
Tabela 1. Testi ADF për normën e rritjes ekonomike	186
Tabela 2. Testi ADF për serinë e IHD-ve	188
Tabela 3. Kriteri i selektimit të Lag-ut.....	190
Tabela 4. Testi Granger i shkakësisë	191
Tabela 5. Rezultatet e testit Engel-Granger	192
Tabela 6. Rezultatet e testit Johansen	193
Tabela 7. Vlerësimi i modelit VECM për ta parë ndikimin e IHD-ve tek rritja ekonomike	195

LISTA E SHKURTIMEVE

ACIT Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare

AKI Agjencia e Kosovës për Investime

AKP Agjencia Kosovare e Privatizimit

AKPI Agjencia Kosovare për Promovimin e Investimeve

ANI Agjencitë e Nxitjes së Investimeve

ARBK Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

ASK Agjencia e Statistikave të Kosovës

BB Banka Botërore

BE Bashkimi Evropian

BERZH Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BPV Bruto Prodhimi Vendor

BQK Banka Qendrore e Kosovës

CEAC Kompani Alumini e Evropës Qendrore

CEB Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës

CEFTA Marrëveshje e Tregtisë së Lirë midis vendeve të Evropës Juglindore

FMN Fondi Monetar Ndërkombëtar

GDP Bruto Produkti i Vendit

IEG Grupi i Vlerësimit të Pavarur

IFI Incentivat Financiare të Investimeve

IHD Investimet e Huaja Direkte

INDEP Institute for Development Policy

INSTAT Instituti i Statistikave

LE Liria Ekonomike

MESH Memorandumi Ekonomik i Shtetit

METE Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

MNC Multinational Cooperation

MPMS Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSA Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

MTI Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MTL Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë
NVM Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OBT Organizata Botërore e Tregtisë
OEA Oda Ekonomike Amerikane
OECD Organization for Economic Co-Operation and Development
OEK Oda Ekonomike e Kosovës
PBB Prodhimi i Brendshëm Bruto
QKR Qendra Kombëtare e Regjistrimit
SEZ Zonat Speciale Ekonomike
TBB Të Bërit Biznes
TKPK Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TNC Kompani Shumëkombëshe
TVSH Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNCTAD United Nation Conference on Trade and Development
USAID United States Agency for International Development
WIR World Investment Report

MIRËNJOHJE

Do të ishte e pasinqertë po qe se në këtë punim mos të shprehja mirënjohje për udhëheqësin tim shkencor, Prof. Dr. Arben Malaj, i cili vazhdimisht më ka dhënë mbështetje gjatë hartimit të punimit të disertacionit. Konsultimet dhe këshillimet e shpeshta të dhëna nga ai kanë ndikuar në formimin tim profesional për ta përgatitur sa më mirë këtë punim.

Gjithashtu, dua t'i falënderoj të gjithë profesorët dhe kolegët e mi të nderuar, veçanërisht Universitetin Evropian të Tiranës, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Tiranës, Odën Ekonomike Amerikane, Odën Ekonomike të Kosovës dhe universitetet e tjera me renome botërore, të cilat kanë qenë për mua thesare, do të jenë edhe për të tjerët, për të gjithë brezat në trojet tona, ekonomistë të devotshëm, simbole pikënisje për suksese.

Falënderim të veçantë shpreh edhe për familjen time, e cila më ka mbështetur gjithmonë për t'i realizuar synimet e mia. Veçant falënderoj fëmijët e mi, të cilëve, kur u duhesha, isha duke e përgatitur disertacionin.

ABSTRAKT

Ekonomia e Kosovës ka nevojë për ritëm të rritjes dhe të zhvillimit më të lartë, më të qëndrueshëm, me më efekte konkrete për rritjen e punësimit, zbutjen e varfërisë dhe minimizimin e pabarazisë. Pjesë e kësaj strategjie, të rritjes dhe zhvillimit të Kosovës, duhet të jenë edhe IHD-të. Ndërkaq, faktorët që ndikojnë në përmasat, strukturën, përfitimet dhe kostot e IHD-ve në ekonominë e Kosovës do të jenë objekte analize në këtë punim.

Roli i IHD-ve në ekonominë e një vendi është shumë i rëndësishëm. Rëndësia dhe pozicionimi i tyre në vende të ndryshme varet nga stadi i zhvillimit që ka vendi pritës. Niveli i investimeve të huaja në Ballkan po vjen duke u rritur. Këto kompani e zhvillojnë këtë proces nëpërmjet produktivitetit, formimit të kapitalit, krijimit të vendeve të punës, reduktimit të deficitit në bilancin e pagesave, forcimin e integritetit rajonal dhe ndërkombëtar etj.

Investimet e Huaja Direkte kanë disa veçori që i dallojnë ato për sa i përket krahasimit me format e tjera të investimeve. Pikërisht këto veçori i shtojnë këto ekonomi investuese ta nisin hapin për të investuar në ekonominë e shteteve të tjera. Si në çdo investim, pjesë e shpresës për të fituar të ardhura ekonomike është edhe frika e humbjeve ekonomike.

Në këtë studim do të bëhet analiza e IHD-ve për vendet e Evropës Juglindore. Situata politike dhe gjendja ekonomike e këtyre vendeve të dala nga ekonominë komuniste mund të themi se nuk ka qenë aspak e favorshme për ekonominë investuese, pasi nuk kishin njohuri të mjaftueshme të marrëdhënieve me kompanitë e huaja dhe për menaxhimin e tregut kapitalist.

Në fokus të këtij punimi do të jetë ekonomia e Kosovës, e cila është ende e brishtë, ndërsa fluksi i IHD-ve më i ulët se në vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu, do t'i krahasojmë flukset e IHD-ve ndër vite në vendet e rajonit dhe në Kosovë, ndikimet e tyre në PBB dhe efektet

në rritjen ekonomike të Kosovës. Po ashtu, do t'i trajtojmë faktorët problematikë të të bërit biznes në EJK dhe në Kosovë.

Rezultatet e hulumtimit me kompanitë e huaja përmes pyetësorëve që kanë investuar në Kosovë, të gjeturat nga ky hulumtim, do të nxirren si rekomandime për nxitjen e IHD-ve. Po ashtu, do të bëhet analiza ekonometrike, e cila do t'i testojë hipotezat e ngritura si të vërteta ose të hidhen poshtë.

ABSTRACT

Kosovo's economy needs growth rhythm and higher development, more stable, with concrete effects on employment growth, reducing poverty and minimizing inequality. Part of this strategy, the growth and development of Kosovo should be the FDI. However, the factors that affect the structure, benefits and costs of FDI in Kosovo's economy will be subject of analysis in this study.

The role of FDI in the economy of a country is very important. The importance and their positioning in different countries depends on the stage of development of the host country. The level of foreign investment in the Balkans is growing. These companies develop this process through productivity, capital creation, job opportunities, reducing the deficit in the balance of payments , strengthen regional and international integration etc.

FDI have some features that distinguish them in terms of comparison with other forms of investment. These features push these economies to begin step to invest in the economies of other countries. As in any investment, part of hope to gain economic income is the fear of economic losses .

In this study will be an analysis of FDI for countries of Eastern Europe. The political and economic situation of these countries emerged from communist economies we can say that it was not at all conducive to investment economies since they had sufficient knowledge of the relations with foreign companies about the management of the capitalist market.

The focus of this study will be the economy of Kosovo, which is still fragile, while FDI flow is lower than in other regional countries. Also, we compare FDI flows over the years in the region and in Kosovo, their effects on GDP and the impacts on economic growth in Kosovo. Also, we will treat problematic factors for doing business in South East Europe and in Kosovo.

Results of research in foreign companies through questionnaires that have invested in Kosovo, the findings from this research will be issued as recommendations for promoting FDI. Also, econometric analysis will be conducted, which will test the hypotheses raised as true or discarded.

KAPITULLI I

1.1 HYRJJE - pse ky studim?

Qëllimi i këtij punimi është studimi i efekteve që sjellin IHD-të në një shtet pritës të IHD-ve. Debatet përtej kufijve që po bëhen rreth IHD-ve, në botën akademike dhe në debatet e ndryshme publike, e lidhin këtë element të ekonomisë me një seri benefitesh për shtetin pritës. Nga analizat e ndryshme që do të shihen gjatë punimit të këtij studimi, mund të themi me siguri se IHD-të janë shumë të preferuara sidomos nga shtetet në zhvillim, duke qenë se në disa prej tyre IHD-të kanë rezultuar me një faktor të rritjes ekonomike, duke iu shtuar kështu investimeve vendore.

Një analizë e qartë e këtyre efekteve në ekonominë e vendeve të Evropës Juglindore do të bëhet në kapitujt në vijim të këtij punimi. Do të shohim se si hendeku i teknologjisë dhe nevoja për rikonstruktim i detyronte këto vende të bënin përpjekje për t'i zëvendësuar strukturat e vjetra. Duke e filluar kështu periudhën e tranzicionit, me një boshllëk të madh drejt teknologjisë globale, lindi nevoja për inovacion. Shkaku i vetëm që këto vende të riintegroheshin dhe të ecnin me hapin e shteteve të tjera ishte adoptimi i këtyre teknologjive në një mënyrë ose në një tjetër. Për shkak të investimeve të pakta financiare, ky transferim i teknologjisë ishte i kushtueshëm. Rruga më e mundshme për këto vende do të ishte nëpërmjet tregtisë ndërkombëtare dhe IHD-ve. Interesimin në rritje të këtyre vendeve drejt IHD-ve e shohim gjatë studimit, duke parë statistikën gjithnjë në rritje të fluksit të IHD-ve.

Duke bërë analiza në plane të ndryshme, mund të thuhet se shtetet e zhvilluara janë ato që kanë një nivel të lartë të IHD-ve. Sigurisht këto rezultate duhen analizuar edhe më tej; dhe analiza kryesore për sa iu përket IHD-ve duhet të bazohet në formën dhe në lidhjet e IHD-ve.

Në kapitullin e dytë të këtij punimi do të trajtohen niveli dhe llojet e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore. Disa analiza do të na bëjnë të mundur të kuptojmë se si ndikojnë IHD-të në ekonominë vendëse, si duhen trajtuar IHD-të nga vetë politika shtetërore nëpërmjet strategjive dhe politikave të ndryshme fiskale që duhet t'i ndërmarrin shtetet në mënyrë që IHD-të ta arrijnë qëllimin e tyre.

Analiza e efektit të IHD-ve ka ngrehur shumë pyetje për shumë shtete. Një prej tyre është edhe kjo: efektet e IHD-ve në këto vende, a i justifikojnë subvencionet dhe stimujt e taksave të zbatuara nga vendet më të zhvilluara për t'i tërhequr investitorët e huaj? Pa dyshim se ndikojnë pozitivisht.

Vendet e Evropës Juglindore kanë përdorur masa të shumta për t'i tërhequr investitorët e huaj, duke i parë IHD-të si zgjidhje e përgjithshme dhe një mrekulli për problemet e tranzicionit. Në këtë mënyrë i përkrahin ato vazhdimisht. Nëse hedhim një vështrim në vitin 2007, shohim se ekonominë në tranzicion ishin destinacioni i dytë më i rëndësishëm pas Azisë.

Sipas raporteve që Banka Botërore jepte në vitin 2010, flukset e IHD-ve në Evropën juglindore kanë çuar drejt ndryshimeve teknologjike shumë domethënëse e shumë pozitive në menaxhim, detaje këto të cilat kanë ndikuar në mënyrë shumë të dukshme në ekonominë vendëse. Hulumtime të ndryshme e konsiderojnë transformimin e teknologjisë dhe fluksin e kapitalit si kanalin kryesor nëpërmjet të cilit IHD-të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomive të shteteve pritëse (Keller, 2009, Lipsey, 2004; DeMello, 1997, Campos and Kinoshita, 2002, Bloningen and Wang, 2004).

Ndër të tjera, gjatë punimit do të fokusohemi edhe në efektet që IHD-të kanë dhënë në ekonominë vendëse, ndikimi e tyre në rritjen e PBB-së që ato kanë sjellë në shtetet e Evropës Juglindore dhe arsyet ku ato kanë qenë jofunksionale.

Nuk ka asnjë autor që del kundër vlerave që sjellin IHD-të në ekonomitë e shteteve pritëse, por ne nuk mund të qëndrojmë indiferentë ndaj efekteve anësore që mund të shfaqen gjatë këtij procesi. Autorë të ndryshëm kanë vlerësime të ndryshme për llojin dhe shkallën e përfitimeve nga IHD-të.

Marrë parasysh këto që u thanë më sipër, kemi vendosur të bëjmë një studim me analiza sasiore dhe cilësore, mbi efektet teknologjike dhe ekonomike që përcaktojnë kushtet dhe që mund t'i drejtojnë shtetet (IHD) drejt rezultateve pozitive.

Ky punim është i ndarë në pesë kapituj.

Në kapitullin e parë

Hyrje, Qellimi, objektivat , Hipotezat dhe metodat e përdorura ne analizë .

Në kapitullin e dytë

Rishikimi i literatura mbi fenomenin e IHD-së, teoritë e zhvilluara që shpjegojnë natyrën e këtij fenomeni dhe përcaktojnë faktorët që e shkaktojnë atë, ndikimin e tij në vendet pritëse. Në këtë kapitull jepet një vështrim sipërfaqësor rreth ecurisë së IHD-ve në arenën botërore.

Gjithashtu shqyrtimi i literatures mbi IHD-të në EJT, trajtohen efektet e IHD-ve në këto vende, bëhet krahasimi i flukseve të IHD-ve në këto vende gjatë një periudhe 10-vjeçare. Sektorët të cilët më së shumti kanë thithur investime të huaja, politikat strategjike të këtyre vendeve për tërheqje të IHD-ve, gjithashtu edhe problemet që kanë hasur investitorët në vendet pritëse (EJT)

Në kapitullin e tretë Investimet e huaja direkte ne Kosove dhe sfidat me te cilat ato perballen trajtohen IHD-të në Kosovë dhe efektet në ekonominë e saj, ndikimi i IHD-ve në PBB gjatë periudhës 2004-2013, sektorët që kanë thithur më së shumti investime, vështirësitë e Kosovës për tërheqjen e IHD-ve, politikat strategjike jo të favorshme për tërheqje të IHD-ve,

lëvizjet e hyrjeve të IHD-ve ndër vite, duke pasqyruar ngritjet dhe rëniet e IHD-ve përmes treguesve të ndryshëm ndërkombëtarë. Po ashtu, bëhet edhe krahasim me vendet e rajonit, duke i paraqitur dobësitë që IHD-të të janë në nivel të dëshiruar.

Në këtë kapitull do ta trajtojmë edhe hulumtimin e bërë me kompanitë e huaja përmes pyetësorëve.

Në **kapitullin e katërt** paraqitet analiza e testeve statistikore Kruskall Wallis dhe Wilcoxon si dhe analiza ekonometrike sipas modelit VECM mbi IHD-të në Kosovë, një përshkrim i literaturës për modelet që janë përdorur për t'i testuar hipotezat e ngritura, ku gjatë këtij studimi si variabla të varura janë IHD-të; mundësitë dhe kufizimet dhe metodologjia e përdorur.

Në **kapitullin e pestë** trajtohen Përmbledhje dhe gjetjet empirike, rekomandimet e nevojshme dhe sugjerime për kërkime nga studiues të ndryshëm në të ardhmen. bibliografia dhe anekset.

1.2 QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i këtij studimi është t'i argumentojë domosdoshmërinë dhe dobishmërinë për investimet e huaja në Kosovë, për krijimin e parakushteve ligjore dhe institucionale që lehtësojnë dhe nxisin investimet private, përfshirë këtu edhe IHD-të.

Nëpërmjet punimit me titull *“Efektet e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Kosovë – Analizë e atraktivitetit të investimeve të huaja dhe roli i tyre në ekonomi”* do ta analizohet roli e liberalizimit të tregtisë, hapja e tregjeve në kuadër të procesit të globalizimit si tërësi, synimi i zbutjes së raportit import/eksport, mbrojtja e investimeve vendëse, eliminimi i barrierave tarifore dhe jotarifore si dhe integrimi ekonomik në tregjet rajonale e globale.

Në cilësinë e kërkuesit kam identifikuar disa prioritete për aktorët të cilët kanë influencë në menaxhimin e sektorëve të ekonomisë, veçant Ministrinë e Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, të cilat duhet të kenë qëllim përmirësimin e shërbimeve nëpërmjet politikave të mirëfillta ekonomike në harmoni me politikat e Bashkimit Evropian. Drejtuesit me kompetencat që bartin duhet t'i planifikojnë nevojat për trajnim, edukim dhe zhvillim të vazhdueshëm në fushën e investimeve.

Të gjithë këta drejtues (drejtorët, menaxherët, zyrtarët e zyrave të personelit për planifikime strategjike) duhet ta krijojnë kornizën strategjike në të cilën do të ishin përcaktuar qartë të gjitha kriteret, që nga aplikimi i procedurave, rregulloreve, ligjeve e deri tek përzgjedhja e personelit adekuat për t'i mbështetur Investimet e Huaja Direkte në vend.

Sugjerohet që në të ardhmen të organizohen punëtori, konferenca, tryeza dhe sesione të ndryshme që kanë për qëllim trajnimin dhe vetëdijësimin e vlerësuesve për rëndësinë e investimeve të huaja si dhe rëndësinë e vlerësimit të vlerave dhe kontributit që ata japin dhe të jenë shtytës drejt një të ardhme më të suksesshme të institucionit ku ata i zhvillojnë aktivitetet.

Studiuesit gjejnë se IHD-të kanë ndikim në rritjen ekonomike të vendeve. P.sh. Balasubramanyam et al. (1996), analizon se si IHD-të ndikojnë në rritjen ekonomike të vendeve në zhvillim.

Gjatë studimit do të trajtohen roli dhe rritja e investimeve si një nga operacionet më të avancuara ndërkombëtare të biznesit dhe bashkëpunimit ekonomik mes vendeve. Sipas gjetjeve të Choes (2003), shkakësia midis rritjes ekonomike dhe IHD-ve është e dyanshme, por duke anuar më shumë nga lidhja rritja => IHD; ka pak evidenca që IHD-të të sjellin rritje të vendit pritës. Rritja e shpejtë ekonomike mund të rezultojë në rritje të flukseve të IHD-ve.

Kosova dhe vendet e tjera në zhvillim, ashtu sikurse edhe ato të zhvilluara, janë të orientuara drejt draftimit dhe implementimit të politikave të cilat do ta inkurajojnë tërheqjen e investimeve të huaja direkte me qëllim - tërheqjen e kapitalit privat në ekonomi dhe arritjen e objektivave të rëndësishme makroekonomike. Theks i veçantë do të vihet në analizën e efekteve të ekonomisë liberale në tregun e Kosovës dhe përfitimet e mundshme nga ky zhvillim i ri ekonomik. Gjithashtu, do të ketë një përpjekje për të dëshmuar që marrëveshja e CEFTA-s mund të jetë edhe një test paraprak për ekonominë dhe ndërmarrjet Kosovare se si dhe çfarë do të jetë terreni i veprimit afarist në një treg rajonal e global dhe cilat janë sfidat që priten për to.

Qëllimi i studimit është analiza e efekteve të deritashme të IHD-ve në dhe roli i tyre në ekonominë e Kosovës, duke filluar nga periudha e viteve 2000-2014, krahasueshmëria e flukseve të IHD-ve gjatë kësaj periudhe, ndikimi i tyre reale në PBB, si dhe arsyet e lëvizjeve të IHD-ve në rënie dhe ngritje. Në fund do të analizohen politikat në Kosovë që i inkurajojnë politikat e IHD-ve dhe do të ofrohen ide për orientimin e Kosovës në të ardhmen dhe sfidat e saj në ekonominë e tregut.

1.3 OBJEKTIVAT E PUNIMIT

Qëllimi i këtij studimi është analiza e efekteve pozitive të investimeve të huaja në ekonominë e Evropës Juglindore dhe problemet që hasin investitorët e huaj duke kaluar më pas tek efektet që ia kanë sjellë Kosovës këto investime dhe problemet që kanë pasur investitorët. Gjithashtu, do të analizohen edhe faktorët që e bëjnë Kosovën vend tërheqës ose jo për investitorët e huaj. Do të analizohet në mënyrë të detajuar rritja ekonomike që i ka sjellë IHD-të në Evropën Juglindore dhe në Kosovë, si dhe pse shumica e IHD-ve në disa periudha të ndryshme kohore nuk kanë sjellë efektet e dëshiruara në ekonominë e vendeve pritëse; si kanë

ndikuar politikat shtetërore, ato afatgjata, afatmesme dhe afatshkurta, por edhe politikat e ndryshme fiskale për tërheqjen e IHD-ve; problemet që e pengojnë zhvillimin e IHD-ve në këto vende, në veçanti në Kosovë.

1.4 PYETJET KËRKIMORE

- 1. Cilët janë faktorët që ndikojnë në nxitjen e investimeve të huaja direkte?*
- 2. Cili është ndikimi i IHD-ve në rritjen ekonomike të Kosovës?*
- 3. A janë institucionet dhe politikat e klimës së biznesit elementet më të rëndësishme në nxitjen e IHD-ve?*

1.5 HIPOTEZAT E NGRITURA

Hipotezat të cilat do të testohen/vërtetohen ose do të hidhen si jo të vërteta:

H1 - Hapja tregtare nxit IHD-të, të cilat çojnë në rritjen e produktit të brendshëm bruto.

H2 - Madhësia e tregut pritës është një element i rëndësishëm në vendimmarrjen e IHD-ve, pasi përfaqëson kushtet ekonomike të vendit dhe kërkesën potenciale për prodhim.

H3 - Përmirësimi i klimës së biznesit në drejtim të politikave favorizuese të taksave, procedurave burokratike lehtësuese dhe infrastrukturës çon në rritjen e IHD-ve, e treguar nga niveli i investimeve private/PBB-së.

1.6 METODOLOGJIA E PERDORUR

Nëpërmjet metodologjisë kemi bërë testimin e hipotezave të ngritura në këtë studim dhe kemi dhënë përgjigjet pas analizave kërkimore, duke bërë analizë specifike dhe me fakte (Palys, 1997, f. 3-4). Sipas Bulmerit (1984, f. 4), metodologjia kërkimore tregon “studimin sistematik dhe logjik të principeve që qeverisin analizën, përmban pyetjet se si kërkuesi përcakton njohurinë sociale dhe si ai apo ajo mund t’i bindë të tjerët që njohuria e tij apo e saj është e duhur”. Eshte përdorur analiza joparametrike e testeve statistikore e Kruskall Wallis dhe Wilcoxon, përmes këtyre testeve është analizuar se si investitoret e huaj e shohin Kosoven në lidhje me variablat që kemi shqyrtuar.

1.7 MUNDËSITË DHE KUFIZIMET

Kosova, sikurse edhe vendet e tjera në zhvillim, edhe pse ka mekanizma të përshtatshëm për mbledhje statistikash, ka vështirësi. Vështirësitë më të mëdha janë paraqitur gjatë mbledhjes së të dhënave statistikore për IHD-të. Shumë institucione të ndryshme kanë edhe standarde të ndryshme të kontabilitetit. Ato kanë bërë edhe përkufizime jo të unifikuara. Vështirësi të mëdha kanë qenë edhe mosmundësia për të pasur qasje në institucionet zyrtare nga ana e sektorëve përgjegjës që i përcjellin flukset e IHD-ve.

IHD-të kanë efekte të shumta në treguesit makro dhe mikro, të cilët nuk mund të përmbliidhen në një punim të vetëm.

Statusi i Kosovës, jo si një shtetet anëtar i Kombeve të Bashkuara, e ka lënë Kosovën jashtë disa indekseve ndërkombëtare të cilat kanë vështirësuar mbledhjen e të dhënave në seri të gjata kohore, që mund ta ndihmonin dhe plotësonin studimin tonë. Studimet specifike për IHD-të

në Kosovë gjithashtu janë të limituara. Më tepër ka hulumtime përmes raporteve të ndryshme të OJQ-ve, odave ekonomike ose instituteve të ndryshme që merren me hulumtime. Për më tepër, ka më shumë publikime e analiza të pavarura dhe komentime nëpër debate të ndryshme e tryeza që organizohen në kuadër të zhvillimeve ekonomike në vend. Megjithatë, japin ndihmesë në këtë punim indekset ndërkombëtare bërë për Kosovën, për progresin e arritur në të gjitha fushat e saj, duke përfshirë edhe indekset e flukseve të IHD-ve. Po këtyre, ndihmesë për këtë punim, nëpërmjet raporteve dhe analizave, kanë dhënë edhe Zyra e FMN-së në Kosovë, raportet e Bankës Botërore dhe shumë institucione të tjera ndërkombëtare që paraqesin trendin e zhvillimit ekonomik në Kosovë; përparësitë, dobësitë, mundësitë, shkaqet dhe pasojat.

KAPITULLI II

2.1 Shqyrtimi i literaturës mbi IHD-të dhe roli i tyre në ekonomi

Disa studiues argumentojnë se IHD-të kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. Për shembull, Balasubramanyam et al. (1996) analizojnë se si IHD-të ndikojnë në rritjen ekonomike në vendet në zhvillim. Duke përdorur të dhëna *cross-section* dhe regresione, ata gjejnë se IHD-të kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike në vendet pritëse, duke përdorur një strategji që nxit eksportet, por jo në vendet që përdorin strategjinë e zëvendësimit të importeve. Analiza e Olofsdotterit (1998) është mjaft e ngjashme. Duke përdorur të dhëna *cross-section*, ai gjen se një rritje e stokut të IHD-ve është e lidhur pozitivisht me rritjen dhe efekti është më i fortë për vendet pritëse, të cilat kanë një nivel më të lartë të aftësive institucionale, matur nga niveli i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë dhe eficienta burokratike. De Mello (1999) gjen lidhje të dobët pozitive midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike, megjithëse përdor vlerësime me seri kohore dhe të dhëna panel me efekte fikse për një zgjedhje prej 32-vendesh të zhvilluara dhe në zhvillim. Nga ana tjetër, Zhang (2001) dhe Choe (2003) analizojnë shkaqet midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike. Zhangu përdor të dhëna për 11 vende në zhvillim në Azinë Lindore dhe në Amerikën Latine. Duke përdorur testet e kointegrimit dhe të shkakësisë Granger, Zhangu (2001) gjen se në pesë raste rritja ekonomike mbështetet nga IHD-të, por kushtet e vendit pritës, të tilla si regjimi tregtar dhe stabiliteti makroekonomik - janë të rëndësishëm. Sipas gjetjeve të Choes (2003), shkaku midis rritjes ekonomike dhe IHD-ve është e dyanshme, por duke anuar më shumë nga lidhja/rritja => IHD. Rritja e shpejtë ekonomike mund të rezultojë në rritje të flukseve të IHD-ve.

Një studim tjetër i bërë nga Chowdhury dhe Mavrotas (2003) përdor një metodologji ekonometrike inovative për ta studiuar drejtimin e shkakësisë midis dy variablave. Studimi përfshin seri kohore për periudhën 1969-2000 për tri vende në zhvillim: Kili, Malajzia dhe Tajlanda. Të gjitha këto vende i tërheqin shumë IHD-të. Gjetjet empirike të tyre sugjerojnë se PBB-ja shkakton IHD-të jo për Kilin, ndërsa për Malajzinë dhe Tajlandën ka një evidencë të fortë të shkakësisë së dyanshme midis dy variablave. Më tutje, Frimpongu dhe Abayie (2008) studiojnë lidhjen shkakësore midis IHD-ve dhe rritjes për Ghanën për periudhën para dhe pas programit të përshtatjeve strukturore (SAP). Studimi gjen se nuk ka shkakësi midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike për periudhën e zgjedhur dhe asaj para programit SAP. Megjithatë, IHD-të shkaktojnë rritje të PBB-së gjatë periudhës pas SAP.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) kryesisht shfaqen në këto tri forma: tregti ndërkombëtare, investime të huaja direkte dhe integrim të tregjeve të kapitalit (Banka Botërore, 2002). Duke u bazuar në këto tri forma kryesore të aktivitetit total të ekonomisë globale, ajo ç'është me interes për ne janë Investimet e Huaja Direkte si një nga format bazë të këtij procesi gjigand në ditët e sotme që burojnë nga globalizimi, koncepti dhe matja e të cilit ka ndryshuar dhe ajo që matet nga balanca e fluksit të pagesave nga njëra anë dhe gjendjes së stokut nga ana tjetër është krejtësisht e ndryshme nga ajo që nënkuptojnë teoritë e IHD-ve.

Fluksi i IHD-ve është rritur shumë krahasuar me format e tjera të kapitaleve të huaja ndërkombëtare. Prodhimi në nivel botëror është rritur 8 % në fund të shekullit XX krahasuar me nivelin e përgjithshëm të prodhimit botëror. Gjatë dy dekadave të fundit shumë vende në mbarë botën kanë përjetuar rritje të konsiderueshme në ekonomitë e tyre' rritje edhe më të shpejtë në transaksionet ndërkombëtare, veçanërisht në formën e investimeve të huaja direkte (IHD). Sasia e IHD-ve neto në GDP-në botërore është rritur pesëfish në vitet e tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta,

duke u bërë kështu shkak dhe pasojë e investimeve të huaja direkte dhe rritjeve ekonomike të vazhdueshme.

Nëpërmjet këtij punimi synojmë të japim një kontribut në këtë kontekst, duke analizuar ekzistencën e një lidhje të dukshme midis investimeve të huaja direkte dhe rritjes ekonomike. Gjithashtu, do të japim përkufizime të ndryshme të investimeve të huaja direkte nga autorë të ndryshëm, të bëjmë përpjekje për t'i përcaktuar Investimet e Huaja Direkte në një kuptim më të gjerë. Përveç këtyre, do ta trajtojmë një sfond historik global mbi IHD-të, teoritë dhe shkollat pro dhe kundër IHD-ve, tendencat aktuale që kanë IHD-të dhe vullneti që kanë korporatat e mëdha për të qenë iniciatore të IHD-ve, kushtet e nevojshme që duhet t'i kenë vendet pritëse për t'i tërhequr IHD-të, efektet e IHD-ve dhe gjetjet mbi IHD-të.

2.2. Përkufizimi mbi Investimet e Huaja Direkte dhe tendenca e fundit

Investimet janë faktorë të rëndësishëm për mbajtjen, ngritjen dhe zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Një shtet që ka një nivel të ulët investimesh mund të themi se ka zhvillim të ekonomisë me ritëm shumë të ngadaltë, se ka probleme të ndryshme shoqërore dhe politike.

Po çfarë kuptojmë me konceptin investim?

Me fjalën investim kuptojmë mjetet në para që angazhohen në objekte të reja ekonomike, në rikonstruktim të objekteve ekzistuese, në modernizim, në adaptim etj. R.Halili dhe F.Gogiqi, (2013). Investimet mund të bëhen edhe në objekte joekonomike, të cilat u shërbejnë nevojave të bashkësisë së gjerë. “Ndërmarrjet apo korporatat investojnë me qëllim të rritjes së profitit” M.Mustafa, (2005). Në esencë, nocioni investim do të thotë dhënie të kapitalit për një punë të qëllimtë S. Xhaferi dhe D. Nikollovski, (2007). Termi investim ose proces investues është shumë i gjerë. Është me rëndësi të kuptojmë se si do të fitohet një pasqyrë complete në vendin e

shpenzimeve për investime në shkallën e zhvillimit të sotshëm. Në kuptimin e gjerë të fjalës, me termin investime nënkuptojmë të hyrat nga shitja ose fitimi mbi baza të mjeteve të harxhuara individuale dhe kolektive nga organizata e punës, kolektivi politiko-shoqëror dhe organet e saj, organizatat shoqërore dhe persona të tjerë juridikë të cilët i shfrytëzojnë mjetet shoqërore A. Antic (1979)

Sipas Fjalorit shpjegues elektronik, me investime nënkuptojmë një shumë parash ose kapital që investohet për diçka. Investime themelore (kapitale) janë tërësia e shpenzimeve që bëhen gjatë një periudhe të caktuar për të krijuar fonde themelore të reja prodhuese (ndërtesa prodhimi, makineri etj.) dhe joprodhuese (ndërtesa me karakter social, kulturor etj), ose për përtëritjen dhe zgjerimin e tyre. Investimet kanë rëndësi imanente në ekonomi. Ato paraqesin faktorin më të rëndësishëm në ekonominë e tregut. Në lidhje me këtë çështje duhet të theksojmë se investimet dallojnë në masë nga një sistem ekonomik në tjetrin. Ato nuk janë të njëjta si në ekonominë e tregut ashtu edhe në ekonominë centraliste. IHD-të në këto dy sisteme ekonomike dallojnë nga njëra-tjetra. Edhe perceptimi i tyre i drejtë ekonomik është i vështirë. Kjo ndodh për arsye se në shekullin që po jetojmë depërtimi i shpejtë i logjikës ekspansioniste po mbisundon.

Enciklopedia britanike për investimet jep këtë përkufizim: Investimet janë proces i zëvendësimit ose shndërrimit të të hyrave me mjete, nga të cilat presim të na sjellin më shumë fitime në një periudhë të caktuar, Britanica - Shkup (2005). Duke u nisur nga fakti se kujt i shërbejnë investimet, ato mund t'i klasifikojmë :

- Investimet në ekonomi (investime kapitale)
- Investime joekonomike (për standardin shoqëror).

Investimet në ekonomi përfshijnë deponimet në mjete të cilat u shërbejnë veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve siç janë: ndërtesat afariste, pajisjet teknike (makinat), stabilimentet,

mjetet e transportit etj. Investimet joekonomike të ndërmarrjeve përfshijnë ato objekte të cilat kryesisht hyjnë në mjetet e konsumit të përbashkët siç janë: objektet e kulturës, sportit, shëndetësisë, kujdesit social, ndërtesa për banim etj, R.Halili dhe F.Gogiqi, (2013)

Në përpjekjet për harmonizim, FMN dhe OECD kanë dhënë një përkufizim të përbashkët: *“...investimi i huaj direkt reflekton qëllimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm nga një njësi rezidente e një ekonomie (investitor direkt) në një njësi rezidente të një tjetër ekonomie (ndërmarrje e investimit direkt)...”*.

Investimi i huaj direkt përfshin së bashku transaksionin fillestar për vendosjen e marrëdhënies ndërmjet investitorit dhe ndërmarrjes dhe të gjitha transaksionet kapitale pasuese ndërmjet tyre dhe ndërmjet filialeve, pavarësisht formës ligjore në të cilën janë regjistruar - si persona juridikë apo persona fizikë.

Niveli dhe përbërja e IHD-ve ka ndryshuar dukshëm me kalimin e kohës. Kjo pjesë paraqet të dhënat e IHD-ve në një perspektivë historike. Një histori e shkurtër e IHD-ve dhe rëndësia e tyre në rrjedhjen e kapitalit të IHD-ve mendohet ndonjëherë që e ka origjinën nga kompanitë amerikane dhe disa nga karakteristikat e tyre që ne i vëmë re sot janë të zhvilluara më së shumti në kompanitë amerikane. Studiues të ndryshëm të kësaj fushe janë munduar ta gjejnë zanafillën e IHD-ve. Një ndër këta studiues ishte M. Wilkins. Sipas saj, “...rreth viteve 2500 p. e. r tregtarët sumerianë zbuluan se gjatë zhvillimit të tregtisë në vende të tjera e panë të nevojshme të kishin të stacionuar në këto vende një përfaqësues të tyre, i cili do ta merrte mallin, ta ruante dhe ta shiste...”M.Wilkins (1970).

Kompania East India (Londër) më 1600 vendosi filiale jashtë vendit. Në mesin e shekullit XVII familjet tregtare të Anglisë, të Francës dhe të Holandës dërguan të afërmit e tyre në Amerikë dhe në Indinë Perëndimore për t’i përfaqësuar kompanitë e tyre. Gjithashtu, kolonistët

amerikanë në tregtinë e tyre të jashtme e panë shumë me vend të kenë korrespondentë, agjendë, filiale për t'i magazinuar dhe për t'i shitur mallrat e eksportit amerikan. Wilkins mendon se në vitet 1875 deri më 1914 ishte një rritje e madhe e IHD-ve në sektorin privat M.Wilkins (1970). Ai i ndanë IHD-të në dy tipa: njëri përfshin investimet që përmbajnë potencialin e kontrollit, por që ndonjëherë kanë të ashtuquajturat 'zyra shtëpi', me një kapacitet shumë të dobët, për të mos thënë joekzistent. Këto kompani nuk kanë përvojë për të punuar jashtë vendit. Tipi i dytë i IHD-ve është i ngjashëm me kompanitë e sotme shumëkombëshe. Kemi të bëjmë me ato kompani shumë të fuqishme dhe me shumë përvojë që hapin filialet e tyre në shtete të ndryshme të botës, duke çuar bashkë me kompaninë njerëz të kualifikuar, teknologji, menaxhim dhe përvojë marketingu, M.Wilkins (1970).

Në funksion të analizës që po bëjmë rreth kompanive shumëkombëshe dhe investimeve të huaja direkte, para vitit 1913 ka shumë pak përshkrime mbi IHD-të, e kjo bie në kontradiktë me faktet se fluksi i IHD-ve gjatë kësaj periudhe ka lulëzuar për sa i përket prodhimit dhe investimeve kapitale. Rreth lëvizjeve të kapitalit ka shkruar edhe Iverseni C, (1936), i cili ose s'i përmend fare IHD-të, ose i trajton si forma të vogla të investimeve ndërkombëtare. Hobsoni C.K (1914) e përshkruan si "...një rritje të madhe në rëndësinë e kompanisë ndërkombëtare, në hekurudhat, minierat, ujit, gazit, energjisë elektrike, bankave, sigurimeve, financave e, tokës, madje edhe prodhim", por nuk ishte ndonjë përkufizim i padëgjuar. Ky koncept është përmbledhur edhe nga Arthur Bloomfieldi. Sipas tij, "investimet e portofolit ishin një komponentë shumë e rëndësishme në lëvizjet e kapitalit afatgjatë të IHD-ve para vitit 1914". Ai vuri në dukje këtë përjashtim: Kina, në mesin e përfituesve të vendeve në zhvillim të investimeve dhe Shtetet e Bashkuara në mesin e vendeve të zhvilluara investitore. Një përjashtim tjetër ishte Japonia, homologe e Kinës si shtet pritës, siç tregohet në një numër të madh burimesh të cituara

nga Wilkinsi. Bloomfieldi sugjeroi se para vitit 1914 “koncepti i investimeve direkte (në kuptimin e saj të sotëm) nuk ishte qartësisht i ndarë nga investimet e tjera të kapitalit neto në ndërmarrjet e huaja private”. Bloomfield, A (1914)

Svedberg P. (1987) ka theksuar faktin se IHD-të ishin të papërfillshme para vitit 1914. Ai pohoi se ky ishte një iluzion që rrjedh nga metoda tipike e parashikimit të flukseve dhe stoqeve të IHD-ve. IHD-të kanë qenë një burim shumë i rëndësishëm i financimit nga jashtë për shtetet në zhvillim për rreth 25 vjet pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitet e fundit, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka publikuar vlerësimet gjithëpërfshirëse në mbarë botën të flukseve bruto dhe neto të IHD-ve nga viti 1970; flukset e rënda të portofolios dhe investimet e tjera që nga viti 1980 dhe flukset neto që nga viti 1970. Investim portofoli përfshin letrat me vlerë të kapitalit, letrat me vlerë të borxhit në formën e bonove, instrumentet e tregut të parasë dhe derivatet financiare, të gjithë, me përjashtim të ndonjërit prej tyre, të përfshira në investime direkte ose asete të ruajtura. Kategoria e “investimeve të tjera” përfshin kreditin tregtar, kreditë, qiratë financiare.

Të dhënat mbi flukset e investimeve ndërkombëtare tregojnë se IHD-të ka qenë në rritje nga totali i flukseve të investimeve që prej viteve 1970 dhe fillim të viteve 1980. Ato ishin më pak se 15 %. Në gjysmën e parë të viteve 1990 ato përbënin 30 % të totalit të daljeve dhe qëndruan në atë nivel deri në gjysmën e dytë të dekadës. Burimi më i madh i fluksit të IHD-ve bruto që nga 1980 ka qenë në Evropë, e ndjekur nga Shtetet e Bashkuara. Japonia ishte burim tjetër i madh i IHD-ve deri në vitet 1990, thekson Lipsey. Në vitin 1999, sipas tij, një pjesë e madhe e të dalave ka qëndruar brenda Evropës. Hyrjet në Evropë ishin më shumë se gjysma e daljeve në vitet 1970 dhe 1980 Lipsey, Robert E. (1988)

Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjithashtu kanë qenë një marrës i madh i flukseve hyrëse të IHD-ve. Pozicioni i saj i mëparshëm, si një ofrues i madh neto i investimeve të drejtpërdrejta me vendet e tjera, pothuajse është zhdukur. Në vitet 1980 Shtetet e Bashkuara ishin përfitues neto të investimeve të drejtpërdrejta nga jashtë. Në fillim të viteve 1990 u kthyen për të qenë një furnizues neto dhe përsëri u bënë marrës neto në gjysmën e dytë të viteve 1990. Evropa dhe Japonia kanë qenë më të qëndrueshme. Të dyja kanë qenë furnizuesit neto, ndërsa Azia në zhvillim dhe Amerika Latine kanë qenë marrësit e qëndrueshëm neto. Lipsey, Robert E. (1988)

Kështu, një pjesë e madhe e flukseve bruto të investimeve të drejtpërdrejta janë midis vendeve të zhvilluara.


Është e vështirë t'i krahasosh flukset bruto apo neto të investimeve të drejtpërdrejta me shpenzimet kapitale fikse për botën në tërësi, por një krahasim mund të bëhet për vendet e OECD-së. Midis 22 vende, nga vitet 1970 - 1995 raportet mesatare të brendshme të flukseve bruto të IHD-së ishin nën 10 % në 20 vende dhe ato ishin mbi 5 % në shumicën e vendeve. Kur hyrjet bruto në një periudhë pesëvjeçare kishin të bëjnë me formimin e kapitalit fiks në periudhat e mëvonshme pesëvjeçare, koeficienti ishte negativ, megjithëse ky fakt ishte statistikisht jo i rëndësishëm. Pra, me sa duket, IHD-të nuk ishin një burim kryesor i financimit për formimin e kapitalit në këto vende. Daljet bruto ishin negative dhe në mënyrë të konsiderueshme ishin të lidhura me formimin e kapitalit në periudhën e ardhshme, por flukset neto nuk ishin të lidhura me formimin e kapitalit në tërësi (Lipsey, 2001).

Një tjetër mënyrë për ta gjykuar rëndësinë e IHD-ve në ekonominë botërore është të pyesni se sa % të prodhimit botëror dhe punësimit kontabilizohen nga operacionet e huaja që janë rezultat i IHD-ve ose “prodhim i ndërkombëtarizuar”. Në fund të viteve 1950, kur një pjesë e madhe e stokut të jashtëm të IHD-ve është në pronësi të firmave amerikane, prodhimi i

ndërkombëtarizuar mund të ketë përfaqësuar rreth 2 % të prodhimit botëror. Gjatë viteve 1970 rolit global të IHD-ve i kishte rënë rëndësia. Gjatë viteve 1980 IHD-ve vazhdoi t'u binte rëndësia për nga volumi. IHD-të për shtetet në zhvillim (këtu përfshihen Amerika Latine, Azia dhe Evropa Qendrore dhe Perëndimore) bënë një kthim mbrapa rreth vitit 1994. Krugman, P. R., Obstfeld, M. (1997). Arsyeja e lehtësimit të kufizimeve në IHD kishte pakësuar huadhënien e bankave të nivelit të dytë për ekonomitë në zhvillim. Përbërja e kapitalit të jashtëm ka pësuar transformim dramatik gjatë kësaj periudhe për shkak të krizës financiare dhe ekonomike aziatike dhe ruse. Flukset zyrtare të kapitalit në këto vende ose ngecën ose ishin në rënie. Në vend të tyre, flukset e kapitalit privat u bënë burimi kryesor i financimit të jashtëm për një numër të mirë të ekonomive në zhvillim. IHD-të përbënin vetëm rreth 30 % në fillim të viteve '80, por ato shënuan më shumë se 60 % të rrjedhës së kapitalit privat në vitet 2000 dhe në vitet në vijim Carkovic M. and Levine R. (2002). Pamja ndryshon edhe më tutje, midis një krize financiare dhe një ekonomie shumë delikate. Fluksi i IHD-ve globale bëri edhe një rënie të konsiderueshme. Kjo rënie ishte nga 1979 bilionë \$ në 2007-n, drejt 1697 bilionë \$ në 2008-n. Pra, ka rënie 14 %. Kjo ulje vazhdoi edhe në vitin 2009. Të dhënat paraprake tregojnë se IHD-të ranë 44 % krahasuar me nivelin e 2008-s, World Investment Report (2009). Ka një shans të mirë që IHD-të do të rriten shumë shpejt me shenjat e para të stabilitetit ekonomik.

Më poshtë do t'i paraqesim grafikisht flukset e IHD-ve duke i parë në këndvështrim botëror sipas formave përcaktuese që u përkasin këtyre llojeve të investimeve. Grafiku i parë ka marrë si indikator për nivelin botëror flukset hyrëse të IHD-ve në varësi të periudhave kohore. Një grafik tjetër që është pasqyruar nga UNCTAD-i ka marrë si element fluksin e IHD-ve në varësi të llojit të ekonomisë së vendit, të tilla si vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim.

Grafiku 2.1: Flukset hyrëse të IHD-ve në nivel botëror (1998-2013)




Burimi: OECD Investimet direkte nderkombetare databasa 2013

Në këtë grafik, i nxjerrë nga OCED për flukset hyrëse të IHD-ve ndër vite, nga viti 1998 deri në vitin 2013, ajo që vëmë re është fakti se këto flukse në botë kanë pësuar variacione, duke pësuar rritje dhe ulje në varësi të periudhave vjetore. Këto flukse hyrëse të IHD-ve në nivelin botëror kanë kapur shifrën më të lartë në \$ në vitin 2007.

Një kulminacion tjetër, jo në këto shifra, por në shifra më të ulëta se në vitin 2007, e kemi në vitet 2000 dhe 2011. Periudha vjetore e IHD-ve me fluksin më të ulët të hyrjeve në bazë të kësaj figure na paraqitet në vitet 2002, 2003, 2005, 2009. Pavarësisht se flukset hyrëse të IHD-ve u rritën në 2011-n në bazë të statistikave të OECD-s, në vitin 2012 pati sërish ulje të nivelit të përgjithshëm botëror të IHD-ve. Në 2013-n IHD-të nuk kanë vazhduar me ulje të pasuara nga viti 2012, por janë rimëkëmbur pasi vija e kurbës është përmirësuar duke u rritur. Në bazë të këtij

grafiku kemi të pasqyruar edhe situatën e fluksit hyrës të IHD-ve në EU. Kjo kurbë është e njëjtë në shumë vite me kurbën e flukseve hyrëse të IHD-ve në botë, por me disa ndryshime të vogla. Në vitin 2004 kemi një thellim të kurbës me rënie të këtyre flukseve në EU në ndryshim me flukset botërore të IHD-ve. Po në vitin 2004 kurba ka pësuar rritje. Një rënie tjetër e vërejmë në flukset hyrëse të IHD-ve në EU në vitin 2006. Kurba e flukseve është konstante me flukset e 2005-s. Flukset më të ulëta hyrëse në \$ të IHD-ve gjatë kësaj periudhe i kemi në vendet e Evropës, që nëse do ta shikojmë në aspektin krahasimtar me llojet e investimeve të tjera, janë shumë të ulëta nga viti 2001 deri në vitin 2004 dhe nga viti 2008 deri në vitin 2013. Në segmentin e fundit kohor shikojmë një rritje të vogël në 2011-n. Maksimumin në vlerën e IHD-ve e konvertuar në \$ në vendet e EU-s e hasim në vitin 2000 dhe në 2007-n, ndërsa në 2011-n, nëse e krahasojmë me IHD-të e vendeve të tjera që kanë pasur një rritje shumë të mirë në vendet e EU-s, kjo rritje është e ulët e konvertuar në \$. Thellimin më të lartë e hasim në vitet 2004 dhe 2012. Në këto vite EU shikohet si një terren që ka marrë më pak investime të huaja direkte.




Burimi: UNCTAD, Raport 2013

Në bazë të grafikut të nxjerrë nga UNCTAD-i, lidhur me fluksin e IHD-ve sipas grupit të ekonomive nga viti 1995-2012 për vendet me ekonomi të zhvilluar, për vendet me ekonomi në zhvillim dhe për vendet në tranzicion, vërejmë faktin se edhe në këtë grafik flukset më të larta në nivel botëror i kemi në vitin 2007 me shumë totale 2 000 bilionë \$, pavarësisht shtesës në lidhje me vitet që janë marrë për analizë.

Gjatë pasqyrës teorike në lidhje me IHD-të theksuam faktin se këto të fundit shërbejnë si faktorë shumë të rëndësishëm për t'i dhënë shtytje rritjes ekonomike në vendet në zhvillim. Këtë fakt e vëmë re nga flukset e investimeve të thithura. Në vendet në zhvillim janë 52 % të flukseve totale të IHD-ve me shumën totale në botë të këtyre flukseve. Kjo shifër është 10 % më e madhe se flukset totale të IHD-ve të kryera në vendet e zhvilluara, pasi në këto vende është 42 %. Ndërsa flukset e investimeve të kryera në vendet në tranzicion janë të papërcaktuara, por nga përlogaritja totale e këtyre flukseve për këto vende flukset e IHD-ve janë në nivelin 6 %.

(Grafiku 2.3 Flukset dalese të IHD-ve për shtetet në zhvillim dhe shtetet e zhvilluara 2002-2012)



Burimi: UNCTAD, Raport 2013

Në bazë të këtij grafiku të paraqitur nga UNCTAD-i, i shohim flukset dalëse të IHD-ve të marra për dy grupe shtetesh, për shtetet në zhvillim dhe për shtetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore 2000-2012.

Çfarë vëmë re në këtë?


Gjatë viteve 2000 flukset dalëse të IHD-ve për vendet e zhvilluara kanë qenë në shifrën 88 %, shifër kjo shumë e lartë në krahasim me vendet në zhvillim që i përkasin një shifre prej 12 %. Nëse e analizojmë grafikun, këto flukse dalëse për vendet në zhvillim kanë pësuar ulje në vitin 2002, duke arritur në nivelin 10 %. Elementi pozitiv i këtij grafiku është fakti se me kalimin e viteve flukset dalëse të IHD-ve në vendet në zhvillim janë rritur duke rënë në vendet e zhvilluara. Pra, vendet në zhvillim, në bazë të këtij grafiku, në vitin 2012 janë rritur për 23 % në total. Në këtë vit ka arritur në nivelin 35 % fluksi i daljeve të IHD-ve në vendet në zhvillim, ndërsa për vendet e zhvilluara kemi ulje 23 %. Në vitin 2012 shuma totale e flukseve dalëse të IHD-ve është në nivelin 65 %. Ky fakt tregon se vendet në zhvillim me kalimin e viteve e shikojnë IHD-në si një aktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë për këto vende.

Fluksi i IHD-ve u kthye në një tendencë rritëse. Hyrjet IHD u rritën 9 për qind në 1.45 trilion \$ në vitin 2013. IHD-të janë rritur në të gjitha grupimet e mëdha ekonomike: ekonomitë e zhvilluara, në zhvillim dhe në tranzicion. Aksionet globale të IHD-ve u rritën 9 për qind duke arritur në \$ 25.5 trilionë. UNCTAD-i projekton se flukset e IHD-ve globale mund të rriten në 1.6 trilion \$ në 2014-n, 1.75 trilion \$ në 2015-n dhe 1.85 trilion \$ në 2016-n.

Rritja do të jetë nxitur kryesisht nga investimet në ekonomitë e zhvilluara. Shërimi ekonomik i tyre fillon të marrë, të mbajë dhe të përhapet më gjerë. Brishtësia në disa tregje në zhvillim dhe rreziqet që lidhen me pasiguri politike dhe konfliktet rajonale ende mund t'i prishin përmirësimet e pritshme në rrjedhat e IHD-ve. Si rezultat i rritjes më të lartë të pritshme të IHD-

ve në vendet e zhvilluara, shpërndarja rajonale e IHD-ve mund të kthehet përsëri drejt “modelit tradicional” të një pjesë më të lartë të vendeve të zhvilluara në hyrjet globale. Megjithatë, flukset e IHD-ve në ekonomitë në zhvillim do të mbeten në një nivel të lartë në vitet e ardhshme.

Grafiku 2.4. Fluksi IHD-ve në nivel global dhe sipas grupimeve ekonomike, 1995-2013 dhe parashikimet, 2014-2016 (miliarda dollarë)



Burimi: (UNCTAD/WIR/2014)

Me standardet e FMN-së Investimet e Huaja Direkte konsistojnë në shumën e:

1. Të drejtave të pronësisë të blera apo të siguruara nga kompanitë mëmë në firmat jashtë me qëllim kontrolli (duke përfshirë edhe ngritjen e filialeve të tjera)
2. Riinvestimin e firmave nga kompanitë e kontrolluara
3. Huat midis kompanisë mëmë dhe kompanive nën kontroll.

IHD është një term i përdorur për ta paraqitur blerjen e aktiviteteve fizike jashtë kufijve si impiante dhe pajisje nën kontrollin e kompanisë mëmë.

Kjo mund t'i përfshijë disa lloje:

- a. Ngritjen e një dege apo filiali të ri
- b. Blerjen e një aktiviteti apo biznesi të huaj.

Një tjetër përkufizim që nënvizon rëndësinë e nocionit të pjesëmarrjes në administrim është ai nga Rugman & Hodgetts, (1995). “Investim i huaj direkt është pronësia dhe kontrolli i aseteve të huaja, që nënkupton pronësinë e plotë ose të pjesshme të një kompanie në një vend të huaj”. Botimi i pestë i manualit të statistikave të Bilancit të Pagesave (FMN 1995) përcakton si investitor direkt zotëruesin e 0 % ose të më shumë aksioneve të zakonshme ose të fuqisë votuese të një kompanie në një vend, duke qenë rezident në një ekonomi tjetër. Gjithsesi, ky përcaktim nuk e bën të qartë dallimin mes Investimit të Huaj Direkt e Investimit të Huaj të Portofolit. “Një nga shkaqet kryesore të shumëllojshmërisë së përkufizimeve të IHD-së vjen nga ndryshimet në rëndësinë që u atribuohet karakteristikave të kompanive që operojnë në arenën ndërkombëtare” (Hood dhe Young, 1979). Hood N and Young. S (1979)

Në këtë kuadër, Moosa (2002) argumenton se “karakteristika e përbashkët e përkufizimeve të IHD-së qëndron në termat si ‘kontroll’ dhe ‘fuqi vendosëse’, të cilat përfaqësojnë tiparin kryesor që i dallon IHD-të nga investimet e portofolit, meqë investitori portofol nuk kërkon kontroll mbi ndërmarrjen”. Përgjithësisht, një minimum prej 10 % i mbajtjes së aksioneve konsiderohet t'i lejojë aksionarët e huaj të ushtrojnë një influencë të konsiderueshme mbi ndërmarrjen, nëse do të zgjidhnin ta bënin.

Në kuadrin e ndryshimit të modelit dhe rolit të IHD-së në ekonominë botërore, një grup ekspertësh nga FMN-ja dhe OECD-ja arritën në përfundim, se është koha e duhur të rishikohet përkufizimi i tyre, i përmendur më sipër. Në vitin 2003 u krijua një grup i përbashkët FMN/OECD (Direct Investment technical expert Group DIteG) për t'i koordinuar shtjellimet metodologjike dhe për ta siguruar harmonizimin mes rekomandimeve të tyre. Një ndërmarrje e tillë do të kërkojë disa vjet, kryesisht do t'i rishikojë konceptet e përkufizimit ekzistuese nën dritën e analizave dhe përvojave të tyre praktike në vendet anëtare të OECD-së, si dhe do të përfshijë koncepte e përkufizime të reja, të cilat kanë marrë rëndësi për aktivitetet e IHD-së që nga rishikimi i fundit. Për shembull, një nga rekomandimet që doli nga takimi i diskutimit i OECD-së mbi statistikën e investimeve ndërkombëtare (WIIIs) mbajtur në tetor 2004 dhe prill 2005, ishte ndryshimi nga 10 në 20 për qind i kufirit të përdorur në përcaktimin e IHD-së (OECD, 2005).

Më lart paraqitëm disa definicione që ekzistojnë për IHD-të, por definicioni më i pranuar është ai i dhënë nga Organizata Botërore e Tregtisë, sipas së cilës, investim i huaj i drejtpërdrejtë konsiderohet çdo investim ku investuesi nga një vend investon në një vend të huaj për krijimin e aktivitetit (pasurisë) të ndërmarrjes me të drejtë të kontrollit të afarizmit të saj.

Një nga kriteret kryesore për t'u konsideruar një investim si investim i huaj i drejtpërdrejtë është e drejta e pjesëmarrjes së subjektit të huaj në kontrollin e ndërmarrjes. E drejta e pjesëmarrjes në kontrollin e ndërmarrjes është karakteristika kryesore që i dallon investimet e huaja të tërthorta nga investimet e huaja të drejtpërdrejta, Kukaj H. (2014). Sipas FMN-së, për t'u konsideruar një investim si IHD është e nevojshme që vlera e investimit të jetë së paku 10 % e vlerës së përgjithshme të pasurisë së ndërmarrjes, dmth. minimumi 10 % e vlerës së

zakonshme, Charles W. L. Hill (2007). Pjesëmarrja prej së paku 10 % konsiderohet se është e mjaftueshme për t'ia siguruar investuesit të huaj mundësinë në kontrollin e ndërmarrjes.

Këndvështrimi makroekonomik dhe mikroekonomik

Termi Investime të Huaja Direkte ose IHD përfshin dy grupe ose aktivitete të lidhura, por të ndryshme të trajtuara nga teori të ndryshme ose degë të ndryshme të ekonomisë. Këndvështrimi i parë është i bazuar në financat ndërkombëtare, të quajtura ndryshe makroekonomi. Këndvështrimi i dytë është i lidhur me organizimin industrial, e quajtur ndryshe mikroekonomi.

Këndvështrimi makroekonomik i shikon IHD-të si një formë e veçantë e rrjedhjes së kapitalit nëpërmjet kufijve kombëtarë, pra nga vendet e origjinës në vendet pritëse, i matur nga statistikat e nxjerra nga bilanci i pagesave. Këto kapitale rrisin një formë të veçantë stoku në vendet pritëse, domethënë rrisin vlerën e investimeve hyrëse në këto shtete, konkretisht korporatat e kontrolluara nga një pronar vendës ose korporata ku pronari vendës ka një nivel të caktuar aksionesh. Variablat e interesit janë rrjedha e kapitalit financiar, vlera e stokut të kapitalit që është akumuluar nga firmat investuese dhe flukset e ardhura nga këto investime.

Këndvështrim mikroekonomik përpiket t'i shpjegojë motivet për t'i kontrolluar operacionet e investimeve të huaja nga pikëpamja e investitorit. Gjithashtu, shqyrton pasojat që rrjedhin nga ky investim për investuesin, për vendet dhe shtetet pritëse; shqyrton gjithashtu pasojat që vijnë nga këto operacione të kompanive shumëkombëshe apo të filialeve të krijuara nga këto kompani në vend që ta analizojë masën e fluksit ose vlerës së stokut të investimeve apo gjendjen e këtyre investimeve. Këto pasoja lindin nga mënyra se si realizohet tregtia e tyre nga punësimi, prodhimi, fluksi i investimeve dhe stoku i kapitalit intelektual, i cili analizohet më vete, pra i ndarë nga analiza e balancës së pagesave dhe stokut. Këto motive dhe pasoja thelbësisht me

kontrollin që kanë firmat shumëkombëshe të filialet e tyre dhe aftësinë që kanë këto kompani investuese ose ndërkombëtare për t'i koordinuar aktivitetet me filialet e tyre.

Këndvështrimi mikro është më i vjetri. Ky lloj këndvështrimi i paraprin interesit të investimeve direkte si një formë e fluksit të kapitalit. Teori dhe studiues të ndryshëm ndër vite kanë paraqitur shqetësimet e tyre për sa iu përket këtyre investimeve dhe kanë analizuar pasojat që sjell kontrolli i ekonomive të huaja për ekonominë pritëse. Këto teori janë pasqyruar në kërkimet e studimeve të zhvilluara në SHBA mbi investimet direkte, të cilat synojnë t'i shpjegojnë motivet e padukshme që lidhen me zgjerimin e firmave në vendet e huaja. Southard, Frank, A. (1931)

Çfarë kuptojmë me subjekt të Investimeve të Huaja Direkte (FMN - OECD)?

Kompanitë dhe individët kanë shumë mënyra të ndryshme të mundshme të mbajtjes së aseteve në vendet e huaja. Përcaktimi se cilat nga këto konsiderohen investime të drejtpërdrejta individuale dhe cilat kompani konsiderohen ndërmarrje shumëkombëshe, varet nga përkufizimi i dhënë për një “subjekt të investimeve të huaja direkte”. Një njësi ekonomike, bërthamë e investimeve të huaja direkte, është e përkufizuar në mënyra të ndryshme nga vende të ndryshme dhe përkufizimi ka ndryshuar me kalimin e kohës. Përkufizimi i investimeve të huaja direkte si një rrjedhë e kapitalit dhe e stokut të tij ka pësuar ndryshime si më poshtë. Përkufizimi dominues aktual i një njësie ekonomike të investimeve direkte, i përshkruar për bilancin e pagesave, i përpiluar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (1993) dhe i miratuar nga OECD (1996), shmang nocionin e kontrollit nga ana e investitorit, në favor të një koncepti shumë më të paqartë.

Investimet e Huaja Direkte janë kategori e investimeve ndërkombëtare që pasqyrojnë objektivin e një njësie rezidente në një ekonomi (investitori direkt) merr një interes të

qëndrueshëm në një ndërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër (ndërmarrja investuese direkte). Interesi i qëndrueshëm nënkupton ekzistencën e një marrëdhënie afatgjatë mes investitorit direkt dhe ndërmarrjes së investimit direkt dhe një shkallë të konsiderueshme të ndikimit nga ana e investitorit në menaxhimin e ndërmarrjes.

Investimet direkte përfshijnë jo vetëm dy transaksionet fillestare për vendosjen e marrëdhënieve në mes të investitorit dhe ndërmarrjes, por edhe të gjitha transaksionet e mëvonshme mes tyre dhe në mesin e ndërmarrjeve të lidhura, si të inkuorporuara dhe të painkuorporuara. Një marrëdhënie investimi direkt është themeluar kur investitori direkt ka fituar 10 % ose më shumë të aksioneve të zakonshme ose të fuqisë votuese të një ndërmarrje jashtë vendit IMF, (1993).

Përveç përkufizimit të investimeve të huaja direkte, një përkufizim tjetër është bërë nga (OECD, f. 8, 1996) për sa i përket konceptit për investitorin e huaj direkt në bazë të të cilit thuhet se “investitor i huaj direkt është një individ, ndërmarrje publike ose private, e inkuorporuar ose e painkuorporuar, është një qeveri, një grup individësh apo ndërmarrjesh të cilat kanë një investim direkt, qeveri ose agjenci të ndryshme qeveritare”, (BPM5 2009) i cili është një degë, filial që operon në një shtet i cili është i ndryshëm nga shteti rezident i investuesit ose investuesve.

Përveç përkufizimit të dhënë nga OECD, kemi edhe përkufizimin tjetër që jep FMN-ja, e cila konsideron investitor direkt pronarin e 10 për qind ose më shumë të kapitalit të një ndërmarrjeje. Kjo përqindje përdoret si kufi ndarjeje ndërmjet investimit direkt dhe investimit të portofolit si pjesëmarrje në aksione. Kështu, kur një jorezident, i cili nuk ka pjesëmarrje të mëparshme në kapitalin e një ndërmarrjeje rezidente, blen 10 për qind ose më shumë aksione të kësaj ndërmarrjeje, çmimi i aksioneve të siguruara duhet të regjistrohet si investim direkt. Nga ky

moment transaksionet e kapitalit të mëpasshëm ndërmjet këtyre dy ndërmarrjeve duhet të regjistrohen si investim direkt. Kryesisht mbartësit kryesorë të IHD-ve janë kompanitë shumëkombëshe (MNCs - multinational corporations). Kjo korporatë kompaninë mëmë e ka të vendosur në vendin mëmë, kurse rrjetin e filialeve të veta e ka të shpërndarë në vende të ndryshme të botës, të cilat kompania mëmë i kontrollon dhe i drejton me një model të integruar sipas oportuniteteve të përshtatshmërisë globale. Nëpërmjet filialeve të veta korporata shumëkombëshe zhvillon operacione biznesore të kombinuara nëpër vende të ndryshme të botës. Këto korporata zhvillojnë ndërmjet njëra-tjetrës një lloj tregtie që quhet tregtia e brendshme e korporatës Kukaj H. (2014). Pra, kompania shumëkombëshe njësinë amë e ka të vendosur në vendin e origjinës, kurse filialet i ka të shpërndara nëpër vende të ndryshme, por të gjitha ato janë të kontrolluara nga kompania amë.

2.3. Teoritë mbi Investimet e Huaja Direkte **Shkolla neoliberale dhe keynesiane**

Siç është parë dhe vërtetuar, ekziston një mundësi e mirë që efektet e aktiviteteve të investimeve direkte do të jenë shumë të ndryshme (në varësi nga vendet dhe kompanitë e përfshira), e jo gjithmonë pozitive për të dyja palët si për investitorët (kryesorë) ashtu edhe për shtetet pritëse. Teoria ofron parashikime kontradiktore në lidhje me efektet e investimeve të huaja direkte. Kemi dy shkolla më të njohura për sa i përket këndvështrimit teorik mbi IHD-të dhe efekteve të tyre të cilat janë si më poshtë:

Neoliberalët - Parashetrojnë një numër argumentesh për mbrojtjen e IHD-ve dhe shpjegojnë se ato janë të dobishme dhe kontribuojnë në zhvillimin e një vendi. Ata përkrahin lëvizjen e lirë të kapitalit duke argumentuar se ajo siguron efikasitetin ekonomik; lejon kapitalin të lëvizë në

mënyrë të lirshme përtej kufijve; realizon në mënyrë të shpejtë rritjen ekonomike si rrjedhja e lirë e kapitalit; zvogëlon rrezikun e investitorëve duke u lejuar atyre për t'i diversifikuar investimet e tyre më mirë. Ekonomistët pro IHD-ve pohojnë se rezultati i IHD-ve është aftësia e kufizuar e qeverive të vendeve pritëse për zbatimin e politikave të këqija nëse këto qeveri kanë tendencë për të bërë këtë. Për më tepër, që rrjedha e huaj e kapitalit mund t'i përhapë praktikatat më të mira të drejtimit të korporatave, të rregullave të kontabilitetit dhe traditat ligjore më të mira për vendet më pak të zhvilluara (LDCs) Ciburiene, J. & Zaharieva, G. (2006).

Disa argumente shumë të përdorura nga përkrahësit e IHD-ve janë ato që, së pari, ta mundësojnë transferimin e teknologjisë në formën e inputeve kapitale, të cilat nuk do të mund të arriheshin vetëm nga tregtia Brock, G. & Urbonavicius, S. (2008). Së dyti, nëpërmjet investimeve të huaja direkte një konkurrent hyn në tregun e vendeve pritëse dhe në këtë formë rritet cilësia e prodhimit. Së treti, FDI kontribuon në zhvillimin e kapitalit njerëzor sepse kompanitë e huaja angazhohen në trajnimin e punonjësve duke sjellë praktika të reja të zhvillimit të punëve të ndryshme nga praktikatat e vendit pritës. Përveç kësaj, fitimet nga taksat e korporatave të këtyre kompanive mund të përdoren për ta inkurajuar zhvillimin e vendit pritës duke investuar për shembull në infrastrukturë etj. Përveç këtyre, ndonjëherë investimet nga një vend tjetër i inkurajojnë investimet e brendshme për të ardhmen. Bernatonyte, D., & Normantiene, A. (2009)

Në raportin botëror të investimeve, World Investment Report (1999). FMN-ja shprehet se mund të gjenden disa mënyra nëpërmjet të cilave IHD-të shërbejnë si nxitëse të zhvillimit të vendit. Përveç atyre çfarë përmendëm më lart, IHD-të sjellin burime financiare të cilat janë të pakta në vendet pritëse, krijojnë vende të reja pune, rrisin eksportin nëpërmjet rritjes së efikasitetit dhe nëpërmjet përmirësimit të marketingut, rrisin disponueshmërinë për t'i reduktuar

kostot e shërbimeve publike dhe konsumit të të mirave. Kemi edhe një argument tjetër që është në favor të IHD-ve, i cili ka disa arsye praktike. IHD-të kanë një avantazh ndaj investimeve të tjera, të tilla si investimet e portofolit apo kreditë, duke qenë se është provuar se IHD-të janë më të qëndrueshme në periudhat e krizave ekonomike.

Gjatë krizës financiare të 1997-1998-s ky lloj investimi ishte i qëndrueshëm në krahasim me llojet e tjera të investimeve, veçanërisht atyre afatshkurtra, të cilat ishin objekt i humbjeve të mëdha. E njëjta gjë ishte e dukshme gjatë krizës së Meksikës dhe Amerikës Latine në vitin 1980, Loungani, P. Razin, A. (2001). Në anën tjetër, ngjarjet e fundit tregojnë se gjatë krizës së fundit disa kompani të mëdha shumëkombëshe, për shembull, prodhuesit amerikanë të makinave, të cilët ishin të vendosur në BE (Spanjë, Poloni, Angli), gjatë kësaj periudhe i mbyllën kompanitë e tyre duke u kushtuar shumë pak vëmendje pasojave ekonomike dhe sociale që do t'i sillte ky largim i tyre. Ndërsa duke pretenduar se përfitimet e IHD-ve që marrin vendet pritëse inkurajojnë rritjen dhe zhvillimin, neoliberalët do të thoshin se vendet duhet të jenë të hapura dhe ta lejojnë tregun të punojë lirshëm dhe të gjitha përpjekjet duhet të jenë të përqendruara në tërheqjen e IHD-ve, sepse kjo do të thotë zhvillim i vendit. Çdo shtet duhet t'i mirëpresë IHD-të sepse do t'i përmirësojnë kushtet ekonomike dhe do ta rrisin potencialin e zhvillimit të vendit pritës, Saboniere, A. (2009).

Pra, siç shpjeguar më lart, politikat neoliberale janë pro politikave të IHD-ve si një faktor shumë i rëndësishëm i zhvillimit të vendeve pritëse të këtyre investimeve. Ndërsa duke pranuar se përfitimet e përmendura më lart mund të sigurohen nga IHD-të, shumë ekonomistë kanë dyshime të arsyeshme nëse kjo ndodh çdoherë në çdo vend. Shumë shkencëtarë nuk pajtohen fuqimisht me faktin se një masë u përshtatet të gjithëve. Pra, ky rregull nuk vlen për të gjithë.

Ekonomistët liberalë theksojnë se frytshmëria botërore dhe shtimi i pasurisë rrjedhin prej aftësisë së korporatave shumëkombëshe për të investuar lirisht në shkallë ndërkombëtare. Vendimet për investime duhet të bëhen vetëm duke u mbështetur në argumente ekonomike (shkalla e fitimit, frytshmëria), e jo në argumente nacionaliste. Liberalët vënë në dukje mungesën e habitshme të koherencës në shqetësimin e publikut amerikan për investimet e Japonisë në SHBA në fund të viteve 1980; më se gjysma e të gjitha investimeve të huaja në SHBA ishin prej Evropës Perëndimore (sidomos prej Britanisë e Holandës). Vetëm një e treta e tyre vinte prej Japonisë. Megjithatë, kishte pak notë protestë ndaj Evropës për humbje të sovranitetit të SHBA-së. Ndoshta kjo pasqyron ose racizmin, ose një paragjykim të vazhdueshëm të Luftës së Dytë Botërore në përjetimet e publikut amerikan për investimet e huaja. Në çdo rast gjërat ndryshuan në fund të viteve 1990, kur kriza financiare në Japoni i bëri amerikanët të shqetësohen se investitorët japonezë do të largoheshin prej SHBA-së.

Në këndvështrimin e ekonomistëve liberalë, investimet e huaja në SHBA më shumë e ndihmojnë sesa e dëmtojnë ekonominë amerikane. Shumë prej përfitimeve prej një fabrike japoneze fitimprurëse në SHBA, për shembull, u shkonin punëtorëve amerikanë në uzinë dhe përdoruesve amerikanë të prodhimeve të saj, qoftë edhe sikur disa prej fitimeve të shkonin përsëri në të mirë të Japonisë (madje edhe ato fitime mund të riinvestoheshin në SHBA). Gjithashtu, korporatat shumëkombëshe amerikane kanë më shumë se një trilion dollarë investime të huaja të drejtpërdrejta jashtë SHBA-së. Joshua S. G, (2001).

Shkolla keynesiane - Argumenton se, nëse IHD-të sjellin përfitime në një vend, kjo nuk do të thotë se e njëjta gjë do të ndodhë në një shtet tjetër. Shumë gjëra varen nga kushtet e pranimi të vendit pritës. Kjo do të thotë se efektet duhet të ndryshojnë jo vetëm ndërmjet vendeve, por edhe

në vende e në kohë të ndryshme, në varësi të ndryshimit të kushteve. (Lipsey, Pourvis dhe Courant, (1994); Epstein, (1999); Sims dhe Liqeni, (2000); Han X.Vo, (2004), duke Buoziute-Rafanaviciene, Pundziene, Turauskas, L. (2009). Përkrahësit e kësaj shkolle besojnë se nuk ekzistojnë dështimet e tregut, çfarë do të thotë se tregu i lirë në vetvete nuk mund ta sigurojë efikasitetin.

Së pari, informacioni nuk është gjithmonë i përsosur. Informacioni i pamjaftueshëm apo i gabuar mund të çojë në tërheqjen e investimeve të gabuara. Së dyti, ndonjëherë interesat e investitorëve ndryshojnë në varësi të interesave të shtetit pritës. Kjo është arsyeja pse politikatat ekonomike duhet të jenë të përshtatura me kushtet reale të vendit. Rritja e konkurrencës mund të jetë e dobishme për ekonominë e shtetit pritës. Megjithatë, ky rregull nuk vlen gjithmonë. Ardhja e kompanive shumëkombëshe të fuqishme mund t'i nxjerrë jashtë tregut bizneset lokale potenciale, meqenëse këto të fundit e kanë të pamundur të konkurrojnë me kompanitë e mëdha. Në këtë rast, shumë vende pune mund të mbyllën në vend që të hapen vende të reja pune.

Sipas Lounganit, Razinit (2001), Kazlauskaites dhe Bucunienes (2008), është shumë e nevojshme që qeveritë ta gjejnë mënyrën t'i mbrojnë bizneset lokale. Kur tërheqin IHD-të, qeveritë mund t'i përdorin shkurtime të taksave, subvencionet dhe shumë mjete të tjera për kompanitë vendore. Kur ato vendosin ta ulin volumin e kompanive të huaja, zakonisht qeveritë përdorin barriera institucionale për IHD të tilla si: kufizime mbi pronësinë, në kërkesat e aprovimit të projektit, kufizime financiare qeveritare etj. Qeveria e Kinës ka treguar se është shumë racionale në marrjen e vendimeve për tërheqjen e IHD-ve kur në bazë të analizës ekonomike kanë dalë në konkluzionin që ata duhet t'i kufizojnë IHD-të kur efektet ekonomike kanë arritur kulmin e vendosur prej tyre, Blackman, A. & Wu, X. (1999). Megjithatë, shpesh është e vështirë që qeveritë e vendeve në zhvillim t'i menaxhojnë investimet e huaja në favor të

tyre, duke qenë se ekziston një asimetri e fuqisë midis vendeve investuese në njërin anë dhe qeverisë pritëse nga ana tjetër, sidomos ato qeveri të vendeve të varfra që kanë burime të pakta natyrore. Han X. Vo (2004).

Epstein G. (1999) pohon se vendet, duke u përpjekur për t'i tërhequr investimet me subvencione dhe heqjen e taksave, mund të çojnë në ulje të konsiderueshme të të ardhurave të qeverisë, të cilat mund të përdorëshin shumë mirë për të investuar në arsim dhe infrastrukturë dhe mund të krijojnë ambient atraktiv për IHD-të në vetvete. Gjithashtu, ato mund ta përshpejtojnë rritjen ekonomike dhe mund ta rrisin mirëqenien në total. Një mjedis i tillë mund të jetë edhe më i rëndësishëm se heqja e taksave dhe vendi pritës e gjen veten në një situatë ku nuk është më një vend tërheqës për IHD-të. Autorët të cilët argumentojnë se vendet në zhvillim duhet të përpiqen për t'i tërhequr IHD-të, bien dakord se në vend se t'u japin kompanive të huaja “karamelle” në formën e subvencioneve dhe heqjes së taksave, qeveritë e vendeve në zhvillim duhet t'i mobilizojnë burimet për zhvillimin e “infrastrukturës dhe resurseve të punës”, që do t'i plotësojnë strukturat ekonomike dhe nevojat e veçanta të vendit në zhvillim. Ata duhet të bëjnë përpjekje për ta informuar botën e këtyre burimeve dhe mundësive për t'i tërhequr investitorët e ndryshëm, vendës dhe të huaj.

Qeveria duhet të negociojë me kompanitë shumëkombëshe për të siguruar që këto investime të kontribuojnë në afat të gjatë dhe të kenë përfitime dinamike për vendet në zhvillim. Së fundi, jo të gjitha llojet e IHD-ve kontribuojnë në mënyrë të barabartë në zhvillimin e ekonomisë lokale. Përfaqësuesit e kësaj qasjeje argumentojnë se me IHD-të përfitojnë ekonomitë e vendeve të zhvilluara në kurriz të vendeve të pazhvilluara. Si rezultat, IHD-të mund të kontribuojnë në rritjen e pabarazisë në botë në vend se të japin fryte pozitive. Sipas kësaj shkolle, IHD-të tentojnë ta pengojnë rritjen ekonomike dhe zhvillimin e ekonomive pritëse. Megjithatë, në vendet e

pazhvilluara mungojnë kapitali dhe teknologjia industriale. Ato shpesh janë të pasura me burime natyrore si dhe me fuqi punëtore të lirë. Ndërkohë të ardhurat ose pasuria janë krijuar në vendin pritës, por kjo nuk do të çojë në një grumbullim të pasurisë që do të ndikojë në ekonominë pritëse. Kjo pasuri është transferuar në vendet investitore. Si pasojë, thelbi qëndron te përfitimi nga kjo ndarje në dy pjesë bazë të ekonomisë strukturore, sepse sektori i huaj (dmth. sektori i lidhur me IHD-të) nuk përfiton asgjë tjetër nga shteti pritës për shkak të mungesës së integritit.

Disa autorë (Lipsey, Purvis dhe Courant, 1994; Krugman, Obstfeld, 1997) argumentojnë se një veçori dalluese e investimeve të huaja direkte është se ajo përfshin jo vetëm një transferim të burimeve, por edhe blerjen e kontrollit. Në disa raste zgjerimi i kontrollit është qëllimi thelbësor i hyrjeve të kapitalit të huaj. Të gjitha rastet e përmendura më sipër argumentojnë se të hyrat e IHD-ve kanë nevojë për ekzaminim më të plotë dhe vendimmarrja në lidhje me politikat ndaj IHD-ve nuk duhet të jetë thjesht e drejtpërdrejtë, por duhet t'u nënshtrohet analizave. Ideja e tërheqjes së investorëve të huaj direktë si një përpjekje e veçantë qëndron pas arsyes ekonomike.

2.4. Krijimi i kushteve për tërheqjen e IHD-ve

Për tërheqjen e IHD-ve është shumë i rëndësishëm krijimi i kushteve të përshtatshme për rritjen e përfitimeve të saj. Për ta nxitur zhvillimin e vendeve të tyre qeveritë e vendeve përthithëse të IHD-ve duhet ta maksimizojnë kontributin pozitiv dhe t'i minimizojnë të gjitha efektet negative që mund të kenë. IHD-ja është përshkruar si të pasurit e një efekti pozitiv në ekonominë e shteteve në tranzicion në fushën e transferimit të teknologjisë për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin industrial Campos, N. and Konishita, Y. (2002),. Ndikimi i IHD-ve në ekonominë pritëse mund të njihet në një nga këto tri mënyra:

- a. Duke stimuluar zhvillimin në vend nëpërmjet rritjes së GDP-së; rritja e kapacitetit të eksportit dhe rritja e stokut të kapitalit;
- b. Duke dhënë kontributin e tyre në përmirësimin dhe transferimin e njohurive teknike në vendin pritës;
- c. Zhvillimi i infrastrukturës në përputhje me standardet e mjedisit, Grigorova, V. (2007).

Paqja dhe siguria janë kushte të nevojshme, por jo të mjaftueshme për t'i tërhequr investimet e huaja. Kjo është e qartë pasi Investimet e Huaja Direkte (IHD) kanë qenë nën parashikimet në vitin 2010.

Cilat janë arsyet që flukset e investimeve të huaja janë të ngadalta? Cilat janë kushtet e tjera që duhet të plotësohen për t'i tërhequr IHD-të?

Ka shumë kushte që duhet të vihen në vend për t'i tërhequr Investimet e Huaja Direkte. Investitorët investojnë mjetet e tyre në vendet që ofrojnë kushte më të favorshme për investime dhe aty ku u ofrohet kthim më i lartë nga mjetet e investuara. Politikat në përputhje makroekonomike, qeverisja e mirë, stabiliteti ekonomik, garantimi i të drejtave pronësore, sundimi i ligjit dhe vendi pa korrupsion janë në mesin e kushteve të kërkuara për t'i tërhequr Investimet e Huaja Direkte.

Një kusht shumë i rëndësishëm për tërheqjen e IHD-ve nga vendi pritës është ulja e taksave për këto kompani, që quhen kompani shumëkombëshe, që janë përfaqësuese të IHD-ve, reduktimi i licensave apo kushteve të regjistrimit të biznesit, kushte këto që, edhe pse konsiderohen mjaft të rëndësishme, nuk mjaftojnë për ta rritur nivelin e IHD-ve në vendin pritës pasi, përveç këtyre kushteve, një faktor thelbësor është përputhshmëria ndërmjet politikave ekonomike. Stabiliteti politik është një kusht i domosdoshëm për t'i tërhequr IHD-të si një

element bazë për ta shfrytëzuar potencialin dhe fokusimi i drejtpërdrejtë në sektorët që i ka më të zhvilluara vendi pritës.

Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës është një ndër themelet kryesore për ta shndërruar një vend në vend të përzgjedhur nga investorët për të investuar sa më shumë. Për të krijuar një ambient biznesor atraktiv dhe të favorshëm është e nevojshme përkrahja e investorëve nga ana e qeverisë së vendit përkatës. Qeveritë e vendit përkatës duhet të punojnë më fuqishëm për një treg të lirë, të mbrojtur nga konkurrenca jolojale, treg të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në të, kryerjen e të gjitha shërbimeve të bizneseve në një vend, të krijojë lehtësi në taksa dhe tatime qeveritare, duke përfshirë edhe ofrimin e greis periudhave për bizneset e sapokrijuara, të veprojnë në drejtim të stimulimit ekonomik edhe përmes granteve dhe subvencioneve qeveritare.

Për t'ua mundësuar aktivitetin normal biznesor kompanive investuese duhet t'u krijohet një sistem gjyqësor efikas, i drejtë, i pakorruptuar dhe i barabartë për të gjithë. Gjithashtu, për të ofruar një forcë punëtore të kualifikuar në treg, kompanitë investuese duhet të punojnë më tepër për krijimin dhe përkrahjen e arsimimit shkollor profesional, përkatësisht kryerjen e praktikës së zanatit, apo kurseve të tjera për shkollat profesionale. Këto janë kushte të rëndësishme për të siguruar një klimë të përshtatshme tërheqëse për investime të huaja direkte.

Interesi për fenomenin e IHD-së ka motivuar përpjekjet e vazhdueshme për të nxjerrë teori që shpjegojnë shkaqet e pasojat e tij. Sipas profesorit I. A. Moosa (2002), u atribuohet arsyeve të ndryshme si më poshtë:

- a. *Arsyeja e parë* është rritja e shpejtë e flukseve të IHD-ve dhe modeleve të tyre, sidomos pas viteve 1980. Moosa sjell fakte që tregojnë se flukset e IHD-ve vazhdojnë të rriten

edhe kur tregtia botërore ngadalësohet. Për shembull, kur rritja e tregtisë frenohet nga pengesa të tregtisë, IHD-të mund të rriten si një përpjekje e kompanive për t'i shmangur këto pengesa.

- b. *Arsyeja e dytë* e interesit rreth IHD-ve është shqetësimi që ngrihet për shkaqet dhe pasojat e pronësisë së huaj.
- c. *Arsyeja e tretë* për t'i studiuar IHD-të rrjedh për faktin pasi ofrojnë mundësinë e kanalizimit të burimeve drejt vendeve në zhvillim. Duke ndjekur këtë arsyetim, IHD-të bëhen burim i rëndësishëm fondesh në një kohë kur mundësia e gjetjes së mënyrave të tjera të financimit vjen gjithmonë duke u zvogëluar dhe;
- d. *Arsyeja e katërt* lidhur me qëllimin kryesor të këtij materiali është që IHD-të mendohet se luajnë rol shumë të rëndësishëm në transformimin e vendeve ish-komuniste, sepse IHD-të, bashkë me kursimet e brendshme, kontribuojnë në investimet totale të ekonomisë pritëse. Gjithashtu, IHD-të sjellin me vete teknologjinë e përparuar, aftësitë administruese dhe hyrjen në tregjet e eksportit.

2.5 Investimet e Huaja Direkte në Evropën Juglindore

Para se të fillojmë t'i analizojmë Investimet e Huaja Direkte në Evropën Juglindore, është me interes t'i japim disa informacione pasqyruese për sa i përket Evropës Juglindore, eksplorimit dhe determinimit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) brenda tetë ekonomive në tranzicion të Evropës Juglindore (EJL) dhe Kroacisë. Në vendet e Ballkanit Perëndimor kemi Kroacinë që është bërë pjesë e BE-së më 1 qershor 2013. Vendet e këtij rajoni bëjnë pjesë në ekonominë në tranzicion, pasi vendet në tranzicion ndahen në dy grupe: a) vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore si dhe b) vendet e Evropës Juglindore.

Termi EJT në gjuhën politike, sidomos në fushën e studimeve politike e historike, përdoret njëherësh në dy nocionet e tij, politikisht dhe gjeografikisht. Nocioni gjeografik lidhet me shpjegimin formal të hartës evropiane, “perëndim”, “lindje” dhe më tej - “juglindje”. Gjithashtu, për sa iu përket këtyre vendeve, deri në rënien e sistemit, janë emërtuar sipas nocionit politik. Sipas Fjalorit të politikave moderne (Robertson, 1993), deri në rënien e pushtetit sovjetik Evropa Lindore përkufizohej politikisht, e jo gjeografikisht. Nocioni politik përfshinë modelet politike “joperëndimore” dhe ish-komuniste që u vendosën pas Luftës së Dytë Botërore.

Rasti gjerman (para 1989-s një shtet gjerman perëndimor dhe një lindor dhe, pas vitit 1989, një shtet gjerman perëndimor) është provë e këtij koncepti ideologjik në klasifikimin dhe ndarjen e dy pjesëve evropiane. Pas vitit 1945 koncepti i Evropës Lindore fitoi konotacion ideologjik si pjesë e sferës dominuese dhe satelite sovjetike. Vendet e Evropës Juglindore kanë qenë në procesin e demokratizimit politik dhe liberalizmit ekonomik në periudhën kohore pas viteve ‘90. Këto vende janë përballur me probleme dhe ndryshime ekonomike, politike, sociale, kulturore etj. Në periudhën kohore, kur këto vende ishin të njohura nën emërtimin politik, ne jemi dëshmitarë të historisë për rolin dominues të pronës shtetërore dhe shoqërore. Shërbejnë pikërisht momentet e periudhës kohore pas këtyre viteve për ta realizuar transformimin e sjell si rezultat i këtyre ndryshimeve të sistemit ekonomik, e cila kishte qëllim bazë sendërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut, WFD, (2013)

Hellman Joel (1996) shikon aspektin pozitiv të këtij sistemi, duke theksuar se vendet postkomuniste me shpërndarje më të madhe të pushtetit politik dhe të aktorëve me veto në procesin e vendimmarrjes politike kanë arritur të krijojnë më shpejt një sistem të stabilizuar dhe efektiv sesa vendet në të cilat pushteti politik është më i përqendruar, Joel. H (1996). Pas përmbyesjes së sistemit ekonomik, në të cilat gjendeshin këto shtete, niveli i zhvillimit ekonomik

është i ndryshëm. Rothschild J. (1974), thekson se Shqipëria, Bullgaria dhe Maqedonia patën tregues ekonomikë më të ulët sesa Kroacia, Sllovenia apo Hungaria. Transformimi sistematik nga socializmi autoritar tek kapitalizmi demokratik dhe modernizimi i shoqërive postindustriale, sipas studiuesve gjermanë, Segert, Dieter; Stöss, Richard und Niedermayer, Oskar (1997), u shoqërua me konfliktet e modernizimit, të cilat bazohen në përvoja dhe tradita historike specifike dhe në norma kushtetuese e ligjore të ndryshme.

Studiues të tjerë e lidhin atë me aspektin gjeografik, sipas të cilit, vendet që ndodhen gjeografikisht më afër Perëndimit të zhvilluar do të shënojnë hapa më të shpejtë drejt demokratizimit, Kopstein, J. & Reilly, D. (2000). Huntingtoni S. (2011), e shpjegon konfliktin politik në botë me përplasjen e qytetërimeve, duke paralajmëruar se vendet lindore, të cilat janë më të lidhura me Perëndimin në fushën e historisë dhe të fesë, do të kenë më shumë sukses në vendosjen dhe zhvillimin e regjimeve demokratike. Huntington, S. (2011). Këto janë vetëm disa këndvështrime të iniciuara nga rëndësia që i japin një elementi. Po ashtu, nëse bazohemi në një analizë konkrete, këto vende janë shumë të pasura me një mori mundësish potenciale për sa i përket tërheqjes së IHD-ve si një burim shumë i rëndësishëm i flukseve të kapitalit dhe zhvillimit të një ekonomie për vendet në tranzicion.

Ekonomitë në rajon filluan procesin e tranzicionit nga një gjendje tejet e vështirë; pasiguria politike ishte në nivel të lartë, institucionet ishin mjaft të dobëta dhe shoqëritë civile të copëtuara. Ecuria makroekonomike ishte mjaft e paqëndrueshme, ndikuar thellë nga konfliktet dhe luftërat civile gjatë pjesës më të madhe të periudhës së tranzicionit. Ky rajon konsiderohet si një nga rajonet me nivel më të ulët ekonomik. Duke qenë në këto kushte, ka mjaft autorë që e lidhin valën e demokratizimit me nivelet ekonomike shoqërore. Kundrejt tyre ka të tjerë që e mbrojnë tezën, Vanhanen, T. & Kimber, R. (1994), se “procesi i demokratizimit mund të

zhvillohet si në kushtet e një niveli të lartë, ashtu dhe në kushtet e një niveli të ulët të zhvillimit ekonomik, që është në kundërshtim me mendimin e doktrinave më të hershme, sipas të cilave, demokracia mund të vendoset vetëm në vendet e pasura. E rëndësishme është shpërndarja e burimeve të pushtetit. Sa më të shpërndara të jenë ato, aq më të mëdha janë mundësitë e demokratizimit”.

Hunya G, (2004) shpjegon se vendet e Evropës Juglindore janë vende me një ekonomi të lëkundur dhe paqëndrueshmëri të lartë politike. Disa nga këto vende në tranzicion kanë probleme thelbësore konstitucionale, probleme që drejtpërdrejt ose tërthorazi ndikojnë në zhvillimin e tyre. Këto vende kanë marrëdhënie më pak të ngushta me BE-në dhe mbeten prapa vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore për sa i përket progresit të arritur gjatë fazës së tranzicionit. Duhet theksuar faktin se këto vende kanë një sektor privat në nivelet minimale të zhvillimit, nga ana tjetër një sektor publik jo të reformuar sa duhet në stabilitetin e brendshëm të organizimit.

Një problem tjetër në të cilin hasin këto vende është përhapja në një shkallë të gjerë e ekonomisë informate, por edhe ekzekutimi dhe zbatimi i ligjit në terren. Zhvillimet në dekadën e fundit kanë treguar se vendet më demokrate e më të liberalizuara kanë ecur më mirë se vendet e SEE-së, të cilat ende kanë probleme në të dyja drejtimet (Hunya, G. 2004). Ky rajon llogaritet në pak më shumë se dy për qind të prodhimit botëror të brendshëm bruto, sipas paritetit të fuqisë blerëse e, pothuaj, me po të njëjtën përqindje në popullsinë botërore. Megjithatë, pavarësisht nga ngadalësimi i përgjithshëm botëror, ky rajon mbetet një nga rajonet me rritjen më të konsiderueshme të PBB-së, duke lënë pas rritjen botërore dhe të BE-së nga viti 1999 deri në vitin 2004.

Në rajonin e Evropës Juglindore, Shqipëria, e cila ngrihet prej nivelit më të ulët, pati normën më të lartë të rritjes, e ndjekur nga Rumania, Bullgaria e Kroacia për hyrje në Bashkimin

Evropian. Duke i marrë këto pikëpamje si plotësuese të njëra-tjetrës dhe si ide përfaqësuese në botën akademike, krahasimi i tyre me realitetet politike në shoqëritë ish-komuniste të Evropës Juglindore krijon një fushë të zgjeruar studimi, me dallime midis vendeve të ndryshme. Ideja se ndryshimi demokratik i vitit 1990 ishte i barabartë me demokracinë rezultoi të ishte utopike. Në praktikë, dallimi midis Lindjes dhe Perëndimit nuk është vetëm në këndvështrimin politik. Ky dallim ekziston në këndvështrimin ekonomik, social, strukturor dhe në mënyrën e mendimit dhe sjelljes politike. Ky është edhe shkaku që kjo periudhë transitore ka sjellë shpeshherë kriza politike, të panjohura prej kohësh në pjesën perëndimore.

Luftërat etnike në Jugosllavi, krizat politike dhe ekonomike në Shqipëri, Bullgari, Maqedoni apo edhe Rumani, problemet e mëdha të rotacionit normal politik në këto vende si dhe në Kroaci, Serbi etj. janë tiparet lindore që këto vende janë duke i përjetuar pas viteve '90. Këto tipare që vendet lindore i kalojnë sot, shtetet perëndimore i kanë tejkaluar pas Luftës së Dytë Botërore. Vendet e Ballkanit perëndimor kanë shumë karakteristika të përbashkëta si rezultat i një historie të përbashkët dhe përvojave të ngjashme në tranzicion. Shumica e vendeve të Evropës Juglindore kanë përjetuar paqëndrueshmëri të lartë politike dhe ekonomike në vitet 1990, ndërsa reformat ekonomike të rimëkëmbjes ekonomike dhe të vendeve në tranzicion kanë qenë përgjithësisht më të ngadalshme se në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL).

Investimet e Huaja Direkte janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme si një nga format bazë në rritjen financiare dhe investimin në vendet pritëse. IHD-të konsiderohen të dëshirueshme për disa arsye, ndër të tjera, për faktin se ai është një mjet shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. P.sh., nëpërmjet ndikimeve pozitive në bilancin e pagesave, promovimin e eksporteve, duke rritur numrin e të punësuarve dhe transferimin e një grupi të madh të burimeve financiare, teknologjike, organizative etj., një promotor i stabilitetit ekonomik. Duke u dhënë rëndësi të

madhe investimeve të huaja direkte, vendet e EJL-së hyjnë në një konkurs për t'i tërhequr këto investime.


Siç theksuam dhe më lart, vendet e EJL-së, të cilat, deri në fillim të viteve 1990 ishin të mbyllura për IHD-të, tani janë ndër ekonomitë më proaktive në zhvillim për sa iu përket politikave të formave të ndryshme për tërheqjen e IHD-ve dhe po e shfaqin veten si lojtarë të rëndësishëm në “garën” e Unionit Evropian për IHD-të.

Rëndësia e Investimeve të Huaja Direkte (FDI) për zhvillimin ekonomik është gjerësisht e pranuar (Mudambi, 2001, OECD, 2001). Në krahasim me format e tjera të flukseve të kapitalit, IHD-të janë të preferuara, sepse më shumë se të qenit mjet për transferimin e kapitalit, zakonisht lehtësojnë transferimin e teknologjisë, promovojnë praktikën e qeverisjes korporative, nxisin zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe janë më të qëndrueshme se flukset e tjera të kapitalit (OECD, 2001). Stabiliteti relativ i tyre, sidomos në periudhat e krizave që ndikojnë në ekonominë në zhvillim, Antoine van A. (1981), rezulton në atë që quhet “kolesteroli i mirë” Hausmann dhe Fernández-Arias, (2000). Në këtë kuadër, vendndodhja e investimeve të huaja direkte dhe faktorët që ndikojnë në vendimet për IHD-të bëhen çështje të rëndësishme.

Fillimi i viteve 1990 solli një numër të ngjarjeve të rëndësishme që ndikojnë në tregun botëror, të tilla si rënia e Perdes së Hekurt, hapja ekonomike e Kinës dhe ndryshime të mëdha në regjimet ekonomike dhe politike në disa vende të Amerikës Latine. Riintegrimi i këtyre vendeve në zhvillim në ekonominë botërore, së bashku me përparimin e rëndësishëm në teknologjinë e komunikimit dhe transportit, reduktimi i barrierave tregtare dhe kufizimet në flukset e kapitalit ndërkombëtar dhe globalizimi i prodhimit kanë zmadhuar në mënyrë të konsiderueshme rëndësinë e IHD-ve. Aksionet e IHD-ve në nivelin botëror në vitin 2006 ishin pothuajse 14 miliardë \$ në krahasim me vetëm 1.5 miliard \$ në vitin 1989. Brenda kësaj periudhe pesha e

vendeve në zhvillim dhe vendeve në tranzicion në nivelin global e rezervat e IHD-ve janë rritur (nga 20.5 % në 1990-n, në 30 % në vitin 2006-n) (UNCTAD, 2007).

Grafiku 2.5. IHD-të në nivel botëror 2000-2013 në miliarda \$



<http://knoema.com/UNCTADFDI2014/inward-and-outward-foreign-direct-investment-flows-and-stock-annual-1970-2013-august-2014>


Sipas të dhënave të UNCTAD-it, hyrjet më të mëdha të IHD-ve ishin në vitin 2000, të pasuara me rënie të vazhdueshme në vitin 2001 deri në vitin 2004. Në vitin 2005 filloi rritja e IHD-ve në nivel botëror dhe arriti shifrën në rreth 10 miliardë \$, për t'u rritur në rreth 15 miliardë në vitin 2006 dhe për ta arritur rritjen më të madhe të dekadës në vitin 2007, në rreth 20 miliardë \$. Pastaj filloi një rënie e lehtë në vitin 2008, në rreth 18 miliardë \$, në vitin 2009 në 12 miliardë \$, në vitin 2010 në 14 miliardë \$, në vitin 2011 në 17 miliardë \$, në vitin 2012 prapë pati një rënie në 13 miliardë dhe në vitin 2013 një rritje e lehtë në 14 miliardë \$.

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2012 kishte zhvillime pozitive, por të kufizuara si rezultat i zhvillimeve të ngadalshme në eurozonë. Gjatë vitit 2012 ekonomia e SHBA-ve u karakterizua me performancë pozitive dhe me rritje më të lartë se në vitin 2011. Në anën tjetër, ekonomia e eurozonës gjatë kësaj periudhe u ballafaqua me recesion prej 0.6-përqindësh si pasojë e dobësimit të konsumit të brendshëm dhe investimeve, shtrëngimit të

politikave fiskale dhe papunësisë në rritje. Rrjedhimisht, rritja ekonomike në nivel global gjatë vitit 2012 ishte 3.2 për qind, rritje kjo e nxitur kryesisht nga vendet në zhvillim dhe SHBA-të. Këto zhvillime u reflektuan edhe në vendet e EJT-së, duke ndikuar në tkurrje të kërkesës së brendshme si dhe rënie të eksporteve. Përveç këtyre, rajoni gjatë vitit 2012 u ballafaqua me rënie substanciale të Investimeve të Huaja Direkte (IHD), por edhe zvogëlim të dërgesave të emigrantëve. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, por edhe kujdesit të shtuar të bankave në kreditim, aktiviteti ekonomik në EJT shënoi rënie prej 0.2 përqindësh. Banka Qendërore e Kosovës, (2012)

Gjatë viteve 1990 - 2004 vendet e Evropës Juglindore kanë tërhequr shumë më pak IHD sesa vendet në tranzicion të Evropës Qendrore. Diferenca midis dy grupeve bëhet e qartë kur krahason nivelin e stokut të IHD-së në fund të vitit 2004. Edhe brenda grupit të vendeve të SEE ka diferencime të konsiderueshme, me Rumaninë dhe Kroacinë që tërheqin pjesën më të madhe të IHD-ve. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë pothuajse në të njëjtin nivel me ecurinë më të dobët në rajon për sa i përket IHD-së. Megjithatë, duket se vendet e Evropës Juglindore po u afrohen niveleve të fqinjëve të tyre. Flukset hyrëse të IHD-ve në Evropën Juglindore filluan të rriten pas vitit 2002. Ndikuar nga procesi i privatizimit, këto flukse hyrëse pothuajse u trefishuan, duke arritur në vitin 2005, në 4.6 miliardë USD.


Grafiku 2.6 Flukset hyrëse të IHD-ve në Evropën Juglindore në vitet 2002 dhe 2005.



Source: UNCTAD, FDI/TNC database (www.unctad.org/fdistatistics).

Kjo rritje e fluksit të IHD-ve nuk mund të mbetet pa u analizuar nga specialistët e fushës. Kjo rritje konsiston në analizën që këta individë ua kanë bërë efekteve pozitive dhe negative të procesit të globalizimit, rrjedhimisht IHD-ve, Fischerit F. (2003). Mbështetësit e IHD-ve e shikojnë këtë proces si një instrument për ta ulur varfërinë dhe për ta rritur efikasitetin e ekonomisë globale. Në të njëjtën kohë, ish-ekonomitë e planifikuara, përfshirë këtu Evropën Qendrore dhe Lindore të kësaj periudhe, të gjendura në ekonominë e tranzicionit, në rrugën drejt ekonomisë së tregut. Lehtësimi i mundësisë së investimit në këto vende u dha ndërmarrjeve shumëkombëshe qasje në tregje të reja dhe mundësi të lira të prodhimit. Si pasojë, flukset e IHD-ve në këtë rajon kanë qenë vazhdimisht në rritje. Pikërisht flukset e këtyre investimeve kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për një tranzicion të suksesshëm. Megjithatë, në vitet e fundit një numër në rritje i investitorëve fillestarë po largohen nga rajoni për shkak se është rritur kostoja e prodhimit. Anë pse po ndodh kjo, prapë shuma e përgjithshme e IHD-ve ende është në rritje. Frankfurter Allgemeine Zeitung (2002) & The Economist (2003).

Grafiku 2.7 IHD-të në Evropën Juglindore në vitin 2006-2007 dhe 2008 (në mil. €)



Source: UNCTAD, FDI/TNC database (www.unctad.org/fdistatistics)

Investimet e Huaja Direkte (IHD) japin mundësi shumë të mira për shtrirjen e veprimtarisë së kompanive shumëkombëshe në Evropën Juglindore. Gjithashtu, janë shansi më i mirë për rritjen e prodhimit, punësimit, eksportit dhe standardit të jetesës në plan afatgjatë. IHD-të janë një formë shumë e mirë e lëvizjes së kapitalit ndërkombëtar me anë të të cilit mund të ndihmohen kompanitë shumëkombëshe për ta nxitur konkurrencën vendore ndërkombëtare të produkteve të tyre në rajonin e Evropës Juglindore, si dhe një formë shumë e mirë për rritjen e produktit të brendshëm bruto (GDP), ndërtimin e infrastrukturës dhe për t'i tërhequr teknologjitë e përparuara.

Në pjesën më të madhe të rasteve, vendet e Evropës Juglindore kanë shpenzime të larta publike, administratë shtetërore joefikase, investime të dobëta në punët kërkimore dhe të zhvillimit dhe probleme serioze në lidhje me cilësinë e arsimit. Një shkak që ka ndikuar në uljen e prodhimit të brendshëm bruto (GDP-së), në rritjen e nivelit të papunësisë, rritjen e deficitit, mungesës së likuiditetit në sektorin real në të gjithë Ballkanin Perëndimor, është si pasojë e krizës globale ekonomike. Nëse do ta shikojmë një nga vendet e këtij rajoni, ta zëmë Malin e Zi, ka rezultuar se rënia e prodhimit industrial në nivel global ka prekur veçanërisht këtë vend. Kjo

qëndron edhe për faktin se eksporti i Malit të Zi i bazon flukset e veta kryesisht në eksportin e aluminit, pasi eksporti i Malit të Zi është i bazuar kryesisht në eksportin e aluminit. Në përgjithësi këto vende e kanë humbur tashmë mundësinë që iu dha atyre me anë të Investimeve të Huaja Direkte në periudhën para krizës globale. Kjo është një çështje e hapur se si këto vende të vogla, të cilat varen nga përfitimet e integritimeve evropiane dhe të eksportit, do të shërohen nga kriza, fundi i së cilës vështirë se mund të parashikohet.

Investimet e Huaja Direkte janë forma kryesore e lëvizjes së kapitalit ndërkombëtar dhe lloji më tërheqës i bashkëpunimit ndërkombëtar për arritjen e qëllimeve strategjike. Për analizën e IHD-ve duhet analizuar edhe konceptin e financave ndërkombëtare në aspektin më të gjerë dhe të ngushtë të tyre.

- a) **Financat ndërkombëtare në kuptim e ngushtë** do të thotë një kredi e mallrave dhe shërbimeve, reagim dhe transaksion financiar të njëkohshëm ose të eksportit dhe importit të kapitalit.
- b) **Financat ndërkombëtare në kuptim më të gjerë** përfshijnë bartjen e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe parave nga një vend në një tjetër në formën e ndihmës ekonomike, riparimit dhe dhuratat. Dunning, J. (1992),

Lëvizja ndërkombëtare e kapitalit i përgjigjet drejtpërdrejt diversifikimit ndërkombëtar të aktiviteteve të biznesit dhe në mënyrë të tërthortë, rekrutimit dhe bërjes së produkteve globale konkurruese. Kjo lëvizje ndërkombëtare e kapitalit u përgjigjet rritjeve ekonomike, ndryshimeve në strukturën ekonomike, bilancit të pagesave, punësimit dhe stabilitetit të një vendi. Lëvizja e kapitalit ndërkombëtar është një gjenerator autentik dhe përshpejtues i globalizimit, Veselin, D. (2002).

IHD-ja në një këndvështrim është hedhja e një kapitali privat afatgjatë jashtë vendit në mënyrë që të arrihet kontrolli i duhur në një kompani të huaj. IHD-ja fillon kur një kompani investon direkt në formën e kapacitetit. Kjo formë e lëvizjes së kapitalit ndërkombëtar përfshin një marrëdhënie afatgjatë në mes të një investitori të drejtpërdrejtë dhe një kompanie të huaj, si dhe ndikim të rëndësishëm nga investitori direkt me menaxhimin e një investitori të huaj.

IHD-ja është më shumë se lëvizja e kapitalit ndërkombëtar dhe më shumë se elementi i kontrollit në kompani. Dinamika e IHD-ve u atribuohet aktiviteteve të kompanive transnacionale që janë mbajtëse të investimeve të huaja direkte, si dhe ndikimit që kanë ndryshimet që pëndodhin në mjedisin e biznesit global. Për më tepër, investorët e huaj duhet të blejnë të paktën dhjetë për qind të kapitalit fillestar të shoqërisë, më pas ta marrin kontrollin e pronësisë së kompanisë.

Një nga analizat që do të bëjmë në këtë kapitull të punimit është se si kriza ekonomike globale ka kërcënuar seriozisht shtetet e Evropës Juglindore. Ajo ka përkeqësuar krizën aktuale lokale në Evropën Juglindore në përgjithësi. Vendet e Evropës Juglindore kanë këtë problem të përbashkët: Rritja ekonomike dhe kriza ekonomike globale e tyre nuk është e bazuar në Investimet e Huaja Direkte, në prodhimin e Evropës Juglindore, në eksportin e tyre dhe konkurrencën e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Rritja ekonomike e vendeve të Ballkanit Perëndimor është në radhë të parë në bazë të Investimeve të Huaja Direkte.

IHD-të në bazë të të dhënave të vitit 2009

Flukset globale të IHD-ve në të gjithë rajonin janë prekur nga kriza ekonomike dhe financiare. Hyrjet priteshin të binin nga 1.7 trilion \$, nën 1.2 trilion \$ në vitin 2009, me një shërim të ngadaltë në vitin 2010, në një nivel deri në 1.4 trilion \$.World. B (2009a) Ka tre komponentë kryesorë të flukseve hyrëse të Investimeve të Huaja Direkte:

- a. Investimet e kapitalit
- b. Kapitale të tjera (kryesisht kredi brenda kompanisë) dhe
- c. Fitimi i riinvestuar.

Bazuar në këtë raport, në fund të viteve 2008 dhe muajt e parë të viteve 2009 u regjistruan rënie të konsiderueshme në të tre komponentët e IHD-ve. Për shembull, fitimet më të ulëta nga filialet e huaja e ulen nivelin e fitimit të riinvestuar, duke kontribuar në rënie me 46 % të flukseve dalëse të IHD-ve nga vendet e zhvilluara në tremujorin e parë të vitit 2009. World. B (2009b) Që nga mesi i vitit 2008 investimet e riatdhesuara, kreditë brenda kompanisë dhe pagesa e borxhit ndaj kompanive të origjinës kanë tejkaluar flukset bruto të IHD-ve në një numër të madh vendesh. Në vitin 2008 flukset e IHD-ve në Evropën Juglindore dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura (CIS) (Commonwealth of Independent States) arriti një rekord të ri të lartë, pavarësisht krizës globale financiare ekonomike dhe konflikteve të armatosura brenda dhe midis vendeve në disa pjesë të rajonit.

Fluksi i IHD-ve filloi të ngadalësohet në gjysmën e dytë të vitit 2008 dhe vazhdoi të tregonte shenja të një ulje të madhe në gjysmën e parë të vitit 2009. Në vitin 2010 Investimet e Huaja Direkte në Evropën Qendrore dhe Lindore do të binin në nivelin e viteve 2001 dhe 2002, Instituti i Vjenës për Studimet Ndërkombëtare Ekonomike (2009). Ulja e investimeve midis 20 % dhe 80 % është raportuar në këtë rajon në tremujorin e parë të vitit 2010. Kriza në Evropën Lindore ende nuk ka kaluar, edhe pse ulja e prodhimit industrial është aktualisht më e ulët se në periudhën e kaluar. IHD-të në Evropën Qendrore dhe Lindore janë ulur vitin e kaluar, kështu që ata ranë me nëntë për qind në vit ose 44.86 miliardë euro në dhjetë vendet e reja të BE-së. IHD-të pësuan rënie në Evropën Juglindore nga më shumë se një e pesta, duke arritur shifrën prej 7.4 miliardë eurosh.

Tabela 2.1 Flukset e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore 2000-2013


	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Kosova	-	-	-	-	53.5	133.8	369.8	440.7	369.9	295.5	368.5	384.4	229.1	280.2
Shqipëria	144.3	206.4	135.0	178.0	345.7	264.3	324.4	658.5	974.3	995.9	1 050.7	876.3	855.4	1 225.5
Bosnja dhe Hercegovina	146.1	118.9	265.2	381.1	511.2	351.2	554.7	1 819.2	1 001.6	249.9	406.0	493.3	366.3	331.7
Mali i Zi	-	-	71.9	49.4	65.4	500.6	622.0	934.4	960.4	1 527.3	760.4	558.1	619.8	447.4
Serbia	51.8	177.4	490.6	1 467.0	958.5	1 577.0	255.7	3 438.9	2 955.3	1 958.8	1 328.6	2 709.3	1 365.1	1 033.7
Maqedonia	215.1	447.1	105.6	113.3	323.7	96.0	432.6	692.5	585.8	201.4	211.9	468.2	92.6	333.9
Kroacia	1 050.9	1 313.2	1 070.9	1 989.1	1 179.1	1 825.4	3 231.1	4 927.7	5 938.1	3 346.4	490.0	1 516.8	1 355.5	580.1

Source: UNCTAD, FDI/TNC database (www.unctad.org/fdistatistics).

Në këtë tabelë shihet se fluksi më i madh i hyrjeve të IHD-ve në vitin 2005 ka qenë në Kroaci me 1 825 4 mil. €, pastaj në Serbi me 1 577 0 mil €, vijnë Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria. Kosova është e pesta me fluks të IHD-ve prej 133.8 mil €.


Kroacia ka pasur fluks më të mirë edhe në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009, ndërsa në vitin 2010 ka pasur rënie të madhe në 490 milionë € si pasojë e krizës ekonomike globale. Gjithashtu, Serbia ka pasur nivel të lartë të investimeve gjatë viteve 2006-2011, kurse rënie në vitin 2012 për shkak të problemeve të brendshme, për të pasur prapë rritje në vitin 2013 në 1 033 7 mil. €. Edhe Shqipëria është karakterizuar me rritje nga viti 2006 deri në vitin 2010, për të pësuar rënie të lehtë në vitet 2011 dhe 2012, ndërsa në vitin 2013 arrin rritjen prej 1225.5 €. Kosova ka pasur rritje të lehtë nga viti 2006 deri në vitin 2010 në 368.5 mil. €, pastaj pati rënie në vitin 2011 në 384.4 mil. €, në vitin 2012 në 229.1 mil. €, në vitin 2013 në 280.2 mil. €. Sipas statistikave të BQK-së, në vitin 2014 ka pasur rënien më të madhe, në 151.2 mil. €.

Grafiku 2.8 Paraqitja e flukseve të IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore në vitet 2000-2013



Source: UNCTAD, FDI/TNC database (www.unctad.org/fdistatistics) dhe përpunimi i autorit

Grafiku 2.9 Flukset e IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore në vitet 2011-2013



Source: UNCTAD, FDI/TNC database (www.unctad.org/fdistatistics) dhe përpunimi i autorit

Nëse bëjmë krahasim mes viteve 2011-2013, shohim se rritjen më të madhe e ka pasur Serbia në vitin 2011. Kroacia ka pasur rënie në vitin 2012, kurse më dobët gjenden Maqedonia, B&H dhe Kosova. IHD-të në vendet në tranzicion sjellin kapital, teknologji, mirëmbajtje dhe zhvillim të konkurrencës në nivel ndërkombëtar. Në kushtet e sotme të biznesit është e nevojshme mbështetja tek Investimet e Huaja Direkte që do të kontribuojnë në ristrukturimin drejt prodhimit të produkteve që janë konkurruese në tregun ndërkombëtar.

Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis rrjedhjes së kapitalit, rritjes më të shpejtë të prodhimit të brendshëm bruto dhe strategjive të eksportit të vendeve. Kjo është arsyeja pse

strategjia e konkurrencës së eksportit duhet të koordinohet saktësisht me strategjinë për tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte. Të gjitha këto vende, me përjashtim të Serbisë, regjistruan rënie të IHD-ve në tremujorin e parë të vitit 2009. Situata më e keqe është gjetur në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku flukset hyrëse të IHD-ve kanë rënë 75 %. Në anën tjetër, në Bosnje-Hercegovinë procesi i privatizimit të IHD-ve, me transaksionet jashtëzakonisht të mëdha në vitet 2006 dhe 2007, por disa edhe në vitin 2008, çuan në një nivel më të ulët të hyrjeve në vitin 2008.

Daljet e IHD-ve në këtë periudhë u rritën vetëm në Mal të Zi. Struktura e IHD-ve dominohet ende nga investimet në ndërmjetësimin financiar. Është e sigurt se bilanci i deficitit të pagesave të këtij viti do të jetë i mbuluar me Investimet e Huaja Direkte dhe një rënie të mëtejshme në Investimet e Huaja Direkte gjatë vitit 2009 u shkaktua, ndër të tjera, nga kriza ekonomike globale. Ndërkohë, liberalizimi i importit të kapitalit, mallrave dhe shërbimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor, duhet të jetë i thellë dhe racional në mënyrë që të prodhojë një efekt maksimal dhe të ulen efektet negative të krizës ekonomike globale. Shteti duhet ta ketë rolin e vet në këtë proces. Ai duhet të ketë një strategji të rafinuar dhe shumë të kujdesshme për t'u mundësuar vetë kompanive për të hyrë në tregjet ndërkombëtare dhe për ta përmirësuar pozitën e tyre konkurruese.

Për sa iu përket vendeve të Evropës Qendrore, supozohet se nuk kanë pasur kompani as të mira as të këqija në kushtet e tranzicionit. Ato hapën dyert për Investimet e Huaja Direkte. Shumica e vendeve që kanë mbështetur dhe përkrahur Investimet e Huaja Direkte nëpërmjet strategjive dhe planeve afatgjata. Me fjalë të tjera, vendet e Evropës Qendrore kishin një strategji për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Një shembull i mirë është Ukraina, e cila kishte planifikuar për t'i tërhequr Investimet e Huaja Direkte. Megjithatë, pyetja e hapur është se si vendi mund të përmirësohet duke përdorur IHD-të. Ukraina ka dhjetë vjet radhazi në rënie të

prodhimit të regjistruar. Në vitin 2000 shënohet rritje për herë të parë. Vetëm pesë vjet pas kohës së dhënë, Investimet e Huaja Direkte në Ukrainë arritën në 6.6 miliardë euro.

Në Evropën Qendrore ka tri faza të fluksit të investimeve të huaja direkte.

1. Në **fazën e parë** investitorët ishin më të interesuar për privatizimin e pronës shtetërore.
2. **Faza e dytë** dallohet për shitjen e ndërmarrjeve shtetërore. Ajo shërbeu si shtysë për një valë të investimeve në Greenfield, të cilat kanë qenë të orientuara nga eksporti.
3. **Faza e tretë** është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Kjo fazë është e lidhur kryesisht me riinvestimin e fitimeve.

Evropa Qendrore ka arritur fazën e tretë, por në krizën globale ekziston rreziku që vendet e Evropës Qendrore do të mbeten të mbërthyera në fazën e tretë. Ndryshe nga vendet e Evropës Qendrore, IHD-të në Evropën Juglindore kanë stagnuar në fazën e parë, e karakterizuar nga privatizimi. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë marrë sasi relativisht të vogla të IHD-ve. Rritja e investimeve ishte e theksueshme, por hyrjet ende të zbehta ishin të rezervuara nga Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia, ndërsa rënia e konsiderueshme i goditi Kroacinë dhe Serbinë. Këto zhvillime korrespondojnë me paraqitjen e marrëveshjeve të privatizimit. As Mali i Zi e as vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor nuk menduan dhe nuk bënë plane afatgjata. Ato besojnë se zgjidhja është për të gjetur ndonjë lloj investitori. Do të ishte e vështirë për të krijuar vende të reja pune me investime direkte nëpërmjet privatizimit sepse, pas shitjes së ndërmarrjeve vendëse, ka një teprice të punëtorëve. Megjithatë, në Evropën Juglindore çështja kryesore nuk është “sa investime”, por “se sa efektive janë IHD-të dhe cili është kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik të vendit?” Investitorët e huaj kërkuan të përfitonin nga proceset e privatizimit të ish-ndërmarrjeve shtetërore në Evropën Juglindore. Më shumë të justifikuara ekonomikisht janë ato

projekte të IHD-ve që kanë çuar në përmirësime të rëndësishme të konkurrencës së produkteve dhe shërbimeve, duke rritur efikasitetin dhe orientimin e eksportit të ekonomisë pritëse.

Investimi Greenfield (fushor) duhet të luajë rol kyç në këtë proces më shumë sesa investimet përmes privatizimit. Nëse disa investitorë donin të krijojnë një kompani të re ose do të dëshironin për të blerë një sipërfaqe toke për të ndërtuar një fabrikë të re dhe një objekt, ky investim do të quhet një investim fushor (greenfield). Ky lloj i investimit të huaj direkt mundëson punësimin e shumë punëtorëve të rinj dhe sjell produkte të reja. Teorikisht, investimi fushor ekziston në industri por, praktikisht, zgjerohet në shumë fusha, duke përfshirë shërbimet.

2.6 Investimet e Huaja Direkte dhe kriza globale ekonomike në Ballkanin Perëndimor

Nëse ekziston mundësia për blerjen e një sipërfaqe toke me një objekt atëherë kjo quhet një investim Brownfield. Nëse një kompani dëshiron të blejë një strukturë ekzistuese jashtë vendit, mund të bëhet në dy mënyra: formën e bashkimit ose blerjes. Prandaj, çështja kryesore për vendet e Evropës Juglindore është një mungesë e strategjisë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Ata nuk do të shkojnë më tej se faza e parë në qoftë se nuk e marrin parasysh arsyeshmërinë ekonomike të investimeve, motivet e vërteta për ardhjen e investitorëve të huaj dhe origjinën e kapitalit të tyre. IHD-të nuk do të jenë në funksion të rritjes së aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të tyre; konkurrenca ndërkombëtare e produkteve të tyre, rritja e punësimit dhe arritja e standardit më të mirë të jetesës. Për shembull, ka shumë pak investime në bujqësi në Mal të Zi. Investimi më i madh fushor është operatori celular “Promonte”. Investime të tjera Greenfield janë të lidhura zakonisht me sektorin e shërbimeve, të tilla si “Hotel Splendid”, sektorin financiar, të tilla si “Hypo Alpe Adria Bank” dhe “LB Leasing”. Investimet

në prodhim ishin të dobëta. Një nga shembujt e rrallë është fabrika për shishet “Coca Cola”, në të cilën janë investuar 2 000 000 €.

“Promonte” ka qenë pjesë e familjes “Telenor” nga dita e parë dhe që nga 11 gushti 2004 ajo ka qenë në pronësi 100 % nga “Telenori”. Me seli në Norvegji, “Telenori” është operatori celular, i shtati në botë më i madhi, me afër 150 milionë abonentë, me 12 operatorë celularë në Evropë dhe Azi. “Telenori” po shfaqet si një nga rritjet më të shpejta të ofruesve të shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme në mbarë botën.

“Promonte” ka 300 të punësuar, prej të cilëve më shumë se gjysma janë me diplomë universitare. Nga numri i përgjithshëm i stafit, 45 % janë gra dhe janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë në menaxhimin e kompanisë. Në Mal të Zi gjithsej IHD-të në vitin 2008 arritën në 685 000 000 euro dhe ishin pak më shumë se në 2007-n kur arriti në 678 000 000 euro, Agjencia për promovimin e investimeve malazeze, (2009). Megjithatë, në strukturën e fluksit IHD-të kishin pjesën më të madhe të investmentit në pasuritë e patundshme, e cila, sipas Bankës Qendrore të Malit të Zi, ishte edhe 51 % ose më shumë se gjysma e një miliard eurove në vitin 2007.

Në vitin 2008 pothuajse 40 % e IHD-ve u investuan në pasuri të patundshme dhe 30 % në kompanitë dhe bankat lokale apo borxhet ndërmjet kompanive sipas Raportit të Progresit në Mal të Zi (2008). Këto të dhëna janë seriozisht shqetësuese. Praktika ka dëshmuar se Investimet e Huaja Direkte në Malin e Zi nuk e kanë rritur prodhimin apo nuk kanë futur në treg produkte të reja, ndërkombëtarisht konkurruese, por janë përdorur kryesisht për konsum personal. IHD-të në Malin e Zi janë përdorur për blerjet tërheqëse në bregdetin e Malit të Zi dhe të burimeve të tjera të cilat nuk janë drejtpërdrejt në funksion të krijimit të prodhimit të brendshëm bruto dhe rritjes së efikasitetit të ekonomisë lokale.

IHD-të duhet të kontribuojnë në zhvillimin e ndërmarrjeve dhe janë shans i mirë për një rritje afatgjatë në prodhimin, punësimin, në eksporte, në rritjen e nivelit të konkurrencës dhe nivelit të jetesës. IHD-të në Mal të Zi janë në funksion të konsumit, i cili është një anomali ekonomike. Të dhënat statistikore për vitin 2009 janë pak më ndryshe. Në dy tremujorët e parë të vitit 2009 llogaria kapitale dhe financiare regjistroi një suficit prej 290 900 000 eurosh, e cila është shumë më pak se ajo që ishte shënuar në periudhën krahasuese të vitit 2008 (698 400 000 euro). Fluksi neto i investimeve të huaja direkte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 arriti në 323 500 000 euro, që është 1.1 % më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2008.

Fluksi total i IHD-ve në raportimin e Investimeve të Huaja Direkte dhe krizës ekonomike globale në Evropën Juglindore në këtë periudhë arriti në 396 200 000 euro. Struktura e IHD-ve ka ndryshuar shumë në krahasim me vitet e mëparshme, kur investimet në pasuri të patundshme ishin të përhapura. Investimi në kompanitë vendëse dhe bankat është rritur në gjysmën e parë të këtij viti, në shumën 231 400 000 euro ose 38.9 % më shumë se në periudhën krahasuese të vitit 2008, ku 83 100 000 euro (21 %) ishte në formën e borxhit ndërmjet kompanive, ndërsa investimet në pasuri të patundshme arritën në 81 400 000 euro (20.6 %), ose 52.5 % më pak se në periudhën krahasuese, Raporti Vjetor i Ekonomik (2009a). Shumica e investimeve në periudhën raportuese erdhën nga Italia, Britania e Madhe dhe Austria. Rikapitalizimi i ardhshëm i EPCG-së (kompania e energjisë elektrike të Malit të Zi) dhe investimet kapitale të shpallura krijuan kushte reale për një fluks të kapitalit të freskët dhe efekte pozitive të shumëfishimit të ekonomisë.

Në terma strukturorë, situata në Serbi është e ngjashme. Privatizimi serb është pothuajse i përfunduar, por efekti i pritur nuk ka arritur të marrë formë: kompanitë lokale janë bërë mjaft konkurruese në tregun ndërkombëtar dhe kanë filluar të krijojnë vende të reja pune në sektorin i

cili duhet të jetë i orientuar drejt eksportit. Dikush mund të thotë se struktura ekonomike e Serbisë është pasojë e rënies ekonomike në fund të shekullit 20, privatizimit dhe politikave ekonomike të 2001-2008.

Privatizimi serb është zbatuar në mënyrën e mëposhtme. Kompanitë janë shitur shpeshherë tek pronarët e dyshuar të kapitalit. IHD-ja përmes privatizimit do të thotë shitje e pronës. Pronarët përdorin asetet për t'i maksimizuar objektivat afatshkurtra, e jo për ta rritur punësimin dhe aktivitetin ekonomik në afat të gjatë. Vende të reja pune janë krijuar kryesisht në sektorët që janë në gjendje të eksportojnë.

Modeli i zhvillimit në Serbi është kryesisht i bazuar në bankat, qendrat tregtare, dyqanet e basteve dhe ndërtimin e banesave luksoze dhe objekteve të biznesit. Në këtë mënyrë Serbia nuk mund të ndërtojë një industri të rëndësishme të eksportit të aftë për ta mbështetur ekonominë e vendit. Nëse shikojmë në strukturën e vlerës së shtuar bruto (prodhimin e brendshëm bruto, pa taksat dhe subvencionet) për vitin 2009, 60 % e GDP-së vjen nga shërbimet, vetëm 29 % nga industria dhe ndërtimi. Raporti Statistikor Vjetor i Serbisë (2008:134).

Shqipëria ka të njëjtën qasje në tërheqjen e investimeve të huaja direkte, edhe pse të dhënat tregojnë se Investimet e Huaja Direkte janë rritur shumë në vitin 2009. Në nëntë muajt e parë të vitit 2009 Shqipëria ka tërhequr 565 000 000 euro të investimeve të huaja direkte, e cila është 214 000 000 më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2008. Investimet janë rezultat i reformave qeveritare dhe privatizimit të vazhdueshëm të ndërmarrjeve shtetërore, Raporti Mujor Statistikor i Shqipërisë (2009).

Struktura e investimeve të huaja direkte në Kroaci ende dominohet nga investimet në ndërmjetësimin financiar. Shuma më e madhe e investimeve të përgjithshme të drejtpërdrejta erdhi nga Austria (325 milionë euro) dhe që nga viti 1993 investimet me vlerë 6.1 bilionë euro

janë derdhur nga Austria në Kroaci, e cila është një e treta e investimeve totale. Bilanci i deficitit të pagesave në Kroaci në vitin 2009 do të jetë i mbuluar me IHD-të dhe rënia e tyre më tej gjatë vitit 2009 ishte, ndër të tjera, për shkak të krizës globale ekonomike Raporti Botëror Investimeve (2009c: 75). Është e qartë se të gjitha këto vende kanë të njëjtin problem. Nuk përdorin investime të huaja direkte për projekte të prodhimit ose të eksportit. Në këtë mënyrë, kriza në të cilën Evropa Juglindore ka qenë për një kohë të gjatë, po thellohej.

Një problem tjetër i Evropës Juglindore është ky i mëposhtmi: një model i rritjes ekonomike të të gjitha vendeve është i bazuar ekskluzivisht në IHD-të. Nëse janë të varura vetëm nga IHD-të dhe nuk mendojnë për prodhimin, eksportin, konkurrencën dhe cilësinë më të mirë të jetës, janë të detyruar për të dështuar në afat të gjatë. IHD-ja duhet të jetë vlerë e përhershme, e jo parametri në të cilën modeli i rritjes ekonomike është i bazuar aktualisht. Në lidhje me prodhimin industrial, Mali i Zi ka shënuar rënie të madhe prej 32.2 %. Për më tepër, Mali i Zi është përballur me problemin e përpunimit industrial të pazhvilluar.

Në anën tjetër, Mali i Zi ka një sektor shumë të zhvilluar të shërbimeve, i cili është rezultat i shpenzimeve të fundit që dalin prej investimeve të huaja direkte. Sektori i shërbimeve duhet të jetë në përputhje me sektorin e prodhimit në çdo ekonomi. Për shembull, në industrinë e drurit, e cila ka potencial për eksport, pikat më të rëndësishme të eksportit trajtohen thjesht si dru apo dru i papërpunuar. Ky produkt eksporti i Malit të Zi ka një shkallë të ulët të përpunimit, vlerë të shtuar të ulët dhe shpesh bazohet në përdorimin produktiv të pamjaftueshëm të resurseve ekzistuese natyrore. Në këtë drejtim, eksporti i Malit të Zi ka karakteristikat e eksportit të vendeve të “botës së tretë”. Produkti kryesor i eksportit të Malit të Zi është alumini. Është e vërtetë se në krizën ekonomike globale, ekonomi të orientuara nga eksporti do të preken nga Investimet e Huaja Direkte dhe kriza ekonomike globale në ngushtimin e Ballkanit Perëndimor

të mundësive të tregut global. Në disa sektorë, sidomos në prodhimin dhe përpunimin e metaleve, nuk duhet të priten dështime dramatike. Në rastin e një ekonomie të vogël të shtetit, të tilla si Mali i Zi, rënia e një kompanie të madhe (Aluminium Smeltery) mund të ketë pasoja katastrofale. (Aluminium Smeltery) (KAP) u shit për CEAC-n ruse (kompani alumini e Evropës Qendrore) dhe llogarive KAP për 40 % të GDP-së. Marrim shembullin e Serbisë.

Kriza globale ka mbajtur një pjesë të hyrjeve të kapitalit nga jashtë dhe ka treguar se Serbia nuk ka strukturë ekonomike të aftë për punësimin produktiv të qytetarëve, për t'i kthyer borxhet dhe për ta ruajtur stabilitetin makroekonomik. Me gjithë zhvillimin e ekonomisë serbe 2001-2008 dhe para shpërthimit të krizës globale, prodhimi industrial serb është zvogëluar përgjysmë në krahasim me të vitit 1990. Për shembull, vlera e përgjithshme e punës në ndërtim e kryer nga punëtorët nga Serbia në tremujorin e parë të vitit 2009, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, është ulur për 11 % në çmimet aktuale dhe 17 % për çmimet konstante. Vlera e kontratave në tremujorin e parë të vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 me çmime aktuale është ulur për 45.5 % dhe numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara është ulur për 16.7 %. Macroeconomic trends and Conjuncture barometer (2009:1). Për më tepër, çfarë do të ndodhë kur Mali i Zi (dhe vende të tjera) do t'i privatizojnë të gjitha ndërmarrjet shtetërore dhe do t'i realizojnë IHD-të nëpërmjet privatizimit? Në bazë të cilave kritere do ta ndërtojnë modelin e vet të rritjes ekonomike?

Procesi i privatizimit është iniciuar me programet e miratuara të ristrukturimit për kompanitë “Zeljeznice Crne Gore”, “Montenegro Airlines” dhe “Posta Crne Gore”. Përgatitja dhe realizimi i procedurave publike për përzgjedhjen e investitorëve për zbatimin e projekteve të vlerësimit ka të bëjë me vende ekskluzive turistike: “Ada Bojana”, “Velika Plaza”, “Njivice”, “Utjeha”, “Buljarica” dhe “Jaz”. Mali i Zi pret shumë nga ndërtimi i autostradës Bar - Boljari. Ajo mbetet


një pyetje e hapur se si do ta ndihmojë investimin afatgjatë në Mal të Zi, i cili nuk ka një industri të ndërtimit të zhvilluar mirë, industri metalike ose industri të drurit. Mbetet të shpresojmë se këto investime do t'i rrisin punësimin dhe zhvillimin e shërbimeve edhe më tej.

Në përgjithësi, Evropa Juglindore, në vend të kërkimit të një modeli të ri më të përshtatshëm të rritjes, është fshehur vazhdimisht pas krizës ekonomike globale. Kriza lokale në Evropën Juglindore është ende shumë e rëndësishme, por është analizuar në kontekstin e krizës globale, e cila është e papranueshme. Ne kemi nevojë për të parë saktësisht se cilat janë efektet globale dhe cilat janë efektet lokale të krizës. Në përgjithësi, të gjitha vendet e Evropës Juglindore kanë shpenzime të larta publike, administratë joefikase, investime të dobëta në problemet e kërkimit dhe zhvillimit dhe probleme serioze në lidhje me cilësinë e arsimit. Kriza globale ekonomike ka rezultuar vetëm në ulje të mëtejshme të prodhimit të brendshëm bruto (GDP-së), rritjen e deficitit, papunësisë, mungesën e likuiditetit në sektorin real në të gjithë Evropën Juglindore. Shembulli më dramatik është Kroacia, e cila ka pasur problemin e borxhit të jashtëm për vite me radhë. Në 2009-n GDP-ja kroate arriti rreth 39 miliardë euro, The Central Bureau of Statistics (2009). Borxhi i jashtëm në fund të vitit 2008 arriti në 39.1 bilionë euro dhe për herë të parë në histori ishte më i madh se GDP-ja vjetore, Report of Croatian National Bank (2009). Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nevojë urgjente për një tranzicion. Tranzicioni i mëparshëm i ka shtyrë vendet në probleme shumë më të mëdha sesa ato që kishin më parë. Tani është e nevojshme për të krijuar një strategji serioze të zhvillimit ekonomik dhe kushte të favorshme ligjore dhe ekonomike për investime në sektorë të orientuar nga eksporti, që kanë për qëllim zhvillimin afatgjatë të infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe normave relativisht të larta të rritjes ekonomike.

Në fund të vitit 2009 pesha e investimeve të huaja direkte (IHD) ndaj produktit të brendshëm bruto (PBB) në Shqipëri ka qenë më e larta në rajon (8.1 %), e ndjekur nga Kroacia (4.61 %), Serbia (4.5 %), Maqedonia (2.7 %) dhe Bosnja dhe Hercegovina (1.4 %). Vihet re se rritja e IHD-ve gjatë tre vjetëve të fundit në Shqipëri është shoqëruar me uljen e IHD-ve për vendet e tjera të rajonit. Gjatë kësaj periudhe përlllogaritja që është marrë në shqyrtim, vlerën maksimale të IHD-ve ndaj PBB-së e ka arritur Serbia në vitin 2006 me shifrën 17 %. Po ky vend ka arritur vlerën minimale të IHD-ve ndaj PBB-së në vitin 2000 me shifrën 0.85 %. Investimet e Huaja Direkte janë një nga treguesit më të rëndësishëm për ta treguar vlerën e besimit të investitorit të huaj kundrejt vendit pritës dhe janë në raport të drejtë të uljes në kushtet e krizave ekonomike dhe politike si dhe rritjen në kushtet e përmirësimit të ambientit ekonomik dhe politik Penev, S. & Rojevc, M. (2009)

Maqedonia, pesë herë më pak investime se Shqipëria

Grafiku 2.10 Raporti i IHD-ve në mes të Shqipërisë dhe Maqedonisë në vitet 2008-2013



Source: UNCTAD, FDI/TNC database (www.unctad.org/fdistatistics) dhe përpunimi i autorit

Investimet në Maqedoni janë zvogëluar dhe as në vitet e ardhshme nuk mund të paralajmërohet ndonjë rritje ekonomike. Vetëm pritët të ketë trend të rënies. Ky përfundim është nxjerrë nga ekspertët e ekonomisë duke u bazuar në mosinteresimin e vendit për të tërhequr

investitorë të huaj, edhe pse në vend ka një numër të madh të zonave industriale. Sipas tyre, Investimet e Huaja Direkte në vend, por edhe më gjerë, bazohen në “përmirësimin e mjedisit të biznesit, krijimin e sigurisë në shtet dhe privatizimin e kompanive të mëdha që më parë ishin në pronësi të shtetit”. Të dhënat tregojnë se investimet në Maqedoni llogariten më të varfrat dhe më të paktat në krahasim me vendet e rajonit për arsyen se në vitin 2009 në Maqedoni janë investuar vetëm 201.4 milionë euro, UNCTAD (2009), në Shqipëri rreth 995.9 milionë euro, në po të njëjtin vit në Kosovë janë investuar 295.5 milionë euro.

Në Shqipëri gjatë vitit 2009 Investimet e Huaja Direkte (IHD) u rritën për 3 % në krahasim me vitin 2008, kurse vetëm në gjysmën e parë të vitit 2009 në Shqipëri janë investuar 565 milionë euro nga 351 milionë euro që ishin një vit më parë (2008). Edhe në Kosovë situata qëndron shumë më mirë se në Maqedoni, pasi investimet gjatë vitit 2009 ishin rreth 295.5 milionë euro, edhe pse një vit më parë (2008) ishin 20 % më të larta, që do të thotë rreth 369.9 milionë euro.

Kemi lënë mbrapa vitin 2013 me probleme të theksuara ekonomike. Për qëllim të këtij punimi do ta trajtojmë gjendjen e investimeve të huaja direkte në vendet e Evropës Juglindore. Vendet e Evropës Juglindore kanë qenë jo vetëm të prekura nga krizat e ndryshme politike, ekonomike dhe sociale, por edhe ndajnë ndërmjet vete karakteristika të tjera të përbashkëta të ekonomive në tranzicion të tilla si, niveli dhe ritmet e zhvillimit dhe shtrebbërimi i ekonomisë së tregut. Kushtet ekonomike që ka tani Evropa po pengojnë përsëri aktivitetin ekonomik dhe po kufizojnë të ardhurat e qeverive në këto vende.

Vendet e Evropës Juglindore shënuan rritje ekonomike prej 2.2 milionë eurosh në vitin 2011. Sipas analizave ekonomike të vazhdueshme, shenjat tregojnë se rritja ekonomike në këto vende është ngadalësuar në mënyrë drastike; u prit një rritje shumë e vogël në vitet në vijim. Në


Raportin e Rregullt Ekonomik për Evropën Juglindore të Bankës Botërore u pohua se ekonomia e Evropës Juglindore filloi të rimëkëmbej nga recesioni i 2012-s duke u rritur mesatarisht në 2.2 % në 2013-n. Ky raport u shpreh edhe për parashikimet në të ardhmen, duke thënë se ekonomia do të rritet 1.9 % në 2014-n dhe 2.6 % në 2015-n falë rritjes së kërkesës së jashtme. Përmbytjet e fundit që ndodhën në rajon e zbehën paksa shpresën për këtë rritje ekonomike. Përmbytjet që ndodhën në Bosnje dhe në Serbi në maj të 2014-s shkaktuan krizë humanitare e dhjetëra të vdekur. Padyshim kjo situatë, humbjet në njerëz dhe dëmet ekonomike, e ngadalësuan ritmin e rritjes ekonomike. Në vitin 2013 secili prej shteteve të Evropës Juglindore shënoi rritje pozitive. Rritje në nivelin 3 % ose më shumë u shënuar në Kosovë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Malin e Zi. Viti i mbarë bujqësor dhe rritja e industrisë kanë mbështetur aktivitetin ekonomik të rajonit në të gjitha shtetet.

Tabela 2.2 Rritja reale e PBB-së dhe parashikimi deri në vitin 2020 në vendet EJL në përqindje

Vendet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Kosova	3.3	3.2	2.7	3.0	3.5	3.5	3.5	3.5	3.5	4.0	4.0
Shqipëria	3.7	2.5	1.6	1.4	2.1	3.0	4.0	4.5	4.5	4.5	4.5
Maqedoni	3.4	2.3	(0.5)	2.7	3.8	3.8	3.9	4.0	4.0	4.0	4.0
Serbia	0.6	1.4	(1.0)	2.6	(1.8)	0.5	1.5	2.0	3.5	3.5	4.0
Mali i Zi	2.5	3.2	(2.5)	3.3	1.1	4.7	3.5	2.7	1.6	2.6	3.3
B & H	0.8	1.0	(1.2)	2.5	0.8	2.3	3.1	3.6	3.8	3.9	4.0
Kroacia	(1.7)	(0.3)	(2.2)	(0.9)	(0.4)	0.5	1.0	1.7	2.1	2.0	2.0

Burimi: <http://knoema.com/IMFWEO2015Apr/imf-world-economic-outlook-weo-april-2015>, BQK dhe autori 2015

Shih grafikun 2.11 Rritja reale e PBB-së në % sipas shteteve ndër vite deri më 2020



Burimi: <http://knoema.com/IMFWEO2015Apr/imf-world-economic-outlook-weo-april-2015> dhe BQK dhe përpunimi i autorit


Shtetet e Evropës Juglindore gjenden përballë disa fakteve. Niveli i borxhit publik shumë i lartë, presionet e financimit, të dyja këto fakte shpijnë në një drejtim. Evropa duhet të adoptojë programe të gjëra të konsolidimit fiskal për ta ndryshuar situatën me borxhet. Faktor tjetër që ndikon në nivelin ekonomik të këtyre vendeve është kriza ekonomike në Greqi. Sigurisht kjo lloj krize do të bëjë që autoritetet t'u kërkojnë bankave t'i rrisin rezervat e tyre dhe ta bëjnë sektorin më rezistent.

Tabela 2.3. Investimet e Huaja Direkte neto në % ndaj PBB-së në vendet e EJT-së, EU11 dhe EU15, 2009-2013

	2009	2010	2011	2012	2013
EJT6	3.8	3	2.8	2.8	2.8
EU11	8	8.2	11.5	11	2.5
EU15	13	13.5	20.5	14.5	13

<http://unctadstat.unctad.org/wds/TableViewer/downloadPrompt.aspx>

Grafiku 2.12. Flukset e IHD-ve si % e PBB-së



<http://unctadstat.unctad.org/> dhe përpunimi i autorit

Siç shihet në tabelë, vendet e EU15 gjatë viteve 2009-2013 kanë pasur flukset më të mëdha hyrëse të IHD-ve, të ndjekura nga vendet e EU11, ndërsa më dobët qëndrojnë vendet e EUL-së. Në vitin 2013 Evropa Juglindore filloi të rimëkëmbej nga recesioni. Rritja ekonomike u bë e mundur falë kërkesës në rritje për eksportet e rajonit nga shtetet me të ardhura të larta, veçanërisht nga shtetet e Bashkimit Evropian (BE), Goldstein, E. (2013). Sipas raportit, eksportet janë rritur rreth 17 % në vitin 2013, të prira nga një rritje e shpejtë në eksportet serbe. Rritja kryesore në vitin 2013 ka ardhur nga eksportimi i makinerive dhe i pajisjeve të transportit, kryesisht në Serbi dhe në Maqedoni. Ndërsa mineralet e djegshme të eksportuara në Shqipëri dhe Mali të Zi ishin shumë domethënëse për këto dy vende, ndërsa metalet bazë zunë rreth çerekun e eksporteve nga Kosova në vitin 2013. Në kontrast, kërkesa e brendshme e rajonit u tkurr në vitin 2013. Një problem tjetër në këtë drejtim është që niveli i papunësisë dhe varfërisë janë më të larta në Evropën Juglindore se në çdo vend tjetër të Evropës. Kërkesa e brendshme është vënë më shumë nën tryzni nga ulja e remitencave në rajon në vitin 2013, duke reflektuar një rimëkëmbje ekonomike ende të plogësht dhe mbizotërim të papunësisë së lartë në shtetet e BE-së. Më pak vende të reja pune të hapura, ulje të remitancave dhe kreditim të kufizuar në

ekonomi, të ardhurat e familjeve dhe fitimet e kompanive nuk ishin në gjendje ta nxisin konsumin e brendshëm ose investimet në rajon. “Në tërësi, përderisa rimëkëmbja ka sjellë rritje, shtetet në rajon kanë qasje të kufizuar në përkthimin e rimëkëmbjes ekonomike në vende të reja pune”. Thotë: Gallina A Vincelette, ekonomiste kryesore dhe një ndër autoret e RRE-së/EJL-së “Papunësia ka qenë shumë e lartë në rajon, me nivel mesatar më shumë se 24 për qind në vitin 2013. Nivelet e vazhdueshme të larta të papunësisë dhe papunësia kronike kanë mbizotëruar ndërmjet grupeve të cënueshme, të tillë si të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të ulëta”. Sipas raportit, sfidat janë ende të pranishme dhe kërkojnë veprime në sektorët financiarë dhe fiskalë.

Zbutja e huave të këqija të larta dhe në rritje, rifillimi i rritjes së kreditimit për bizneset huamarrëse, vendosmëria për përpjekje konsoliduese për ta ruajtur bilancin fiskal dhe ulja e borxhit publik do të çonin në përsheptimin e aktivitetit ekonomik. Për ta mbështetur rritjen në rajon, vendet duhet t’i forcojnë më tej themelet e brendshme makro-ekonomike që ndihmojnë prodhimin dhe rrisin rezistencën ndaj trazirave të jashtme. Për më tepër, rimëkëmbja ekonomike kohët e fundit përbën një mundësi për t’i rinisur reformat strukturore të nevojshme prej shumë kohe. Përparësitë për rritje për hapjen e vendeve të reja të punës përfshijnë stabilizim makro-ekonomik dhe fiskal, përmirësim të konkurrueshmërisë dhe të konektivitetit, rritje të aftësive dhe të produktivitetit të punës dhe forcim të qeverisjes dhe të antikorrupsionit. Paralelisht me rimëkëmbjen, ka ardhur koha që vëmendja të përqendrohet në krijimin e një klime investimesh nxitëse të rritjes së mbështetur në eksporte dhe konektivitetit.

2.7 Përmbledhje e kapitullit të dytë

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u trajtuan në kapitullin e dytë, mund të nxjerrim një përfundim për IHD-të, duke i paraqitur disa të gjetura nga interesi i tyre. Ndër arsytet më kryesore janë këto:

Arsyeja ekonomike për të ofruar stimuj të veçantë për t'i tërhequr IHD-të buron nga besimi, se ato do ta lehtësojnë rritjen më të shpejtë ekonomike sepse: krijojnë mundësi në formën e punësimit më të madh, përfitimit nga transferimi i teknologjisë, rritje të aftësive në industrinë lokale, rritje të produktivitetit ose plotësimit të boshllëqeve në ide midis vendeve të pasura dhe të varfra.

Ndikimi ekonomik i investimeve të huaja direkte nuk është gjithmonë pozitiv. Ky lloj ndikimi i IHD-ve varet nga forma që ai merr. Analiza për efektet e IHD-ve përfshinë disa lloje elementesh të cilat janë: lloji i IHD-ve, sektorit, shkallës, kohëzgjatjes, vendndodhjen e biznesit, dendësinë e firmave vendore në sektorin dhe shumë efekte të tjera dytësore.

Një aspekt i rëndësishëm është se IHD-të mund të shërbejnë jo vetëm si një mënyrë për të bërë para, por edhe një mënyrë për të fituar një lloj pushteti dhe kontrolli ekonomik dhe politik në vendin pritës.

Ekzistojnë dështime të tregut, informacion jo i plotë dhe kushte të ndryshme në vendet pritëse, nevoja të ndryshme dhe niveli i zhvillimit të cilat gjithnjë duhen marrë parasysh përpara se të vendosin një strategji të përshtatshme në lidhje me IHD-të. Një masë nuk u bënë të gjithëve.

Vendi i madh është në gjendje të ndikojë në akumulimin e kapitalit tek partnerët investues dhe kështu që mund të ndryshojë të ardhmen e kushteve të tregut. Një rrezik në tërheqjen e IHD-ve

është që lëvizjet e kapitalit mund të rregullohen nëpërmjet diskriminimit pozitiv për ta maksimizuar mirëqenien e vendit.

Duhet të krijohet një strategji individuale në bazë të së cilës do të sigurohej që Investimet e Huaja Direkte do të japin këto përfitime dhe ekonomia lokale do të jetë në gjendje për t'i përthithur ato siç duhet.

Ka raste kur kapitalet e huaja hyrëse mund të kenë ndikim pozitiv në kompani të tjera të vendit, jo vetëm ata që marrin një kapital nga jashtë. Nga ana tjetër, nuk ka prova të qarta se IHD-të gjithmonë kanë një avantazh ndaj llojeve të tjera të investimeve, si kredi për zhvillimin e bizneseve lokale.

Përdorimi i stimujve të investimeve, duke u fokusuar në firmat e huaja, nuk është një strategji e rekomandueshme. Argumenti kryesor në mbështetje të kësaj është se motivi më i fortë teorik për subvencione financiare ndaj IHD-ve ka tendencë të jetë i bazuar në efektet e jashtme, të tilla si efektet e teknologjisë dhe kapitalit njerëzor, të cilat nuk ndiqen automatikisht nga Investimet e Huaja Direkte.

Duhet të nxitet dhe të bëhet motivim i veprimtarisë ekonomike, duke ndjekur të njëjtën logjikë, të përqendrohet në ato aktivitete që krijojnë potencial të fortë për efektet, duke përfshirë lidhjet në mes të firmave në pronësi të huaja dhe vendëse, arsimim, trajnim. Në vend se duke propozuar politika të lidhura ngushtë me IHD-të, kushtet tërheqëse për investitorët duhet të shihen si pjesë e politikës së përgjithshme industriale të vendit dhe të jenë në dispozicion në kushte të barabarta për të gjithë investitorët e huaj dhe vendës.

Në pjesën më të madhe të rasteve pamë se vendet e Evropës Juglindore kanë shpenzime të larta publike (borxhi publik), administratë shtetërore joefikase, investime të dobëta në punët

kërkimore dhe të zhvillimit, probleme serioze në lidhje me cilësinë e arsimit. Një shkak që ka ndikuar në uljen e prodhimit të brendshëm bruto (GDP-së), në rritjen e nivelit të papunësisë, rritjen e deficitit, mungesës së likuiditetit në sektorin real në të gjithë Ballkanin Perëndimor, është si pasojë e krizës globale ekonomike. IHD-të tregojnë se më së shumti ndodhen në sektorët e bujqësisë (përjashto Malin e Zi), në patundshmëri, shërbime financiare, ndërtim, më së paku, në industri dhe në prodhimtari. Tani është e nevojshme për të krijuar një strategji serioze të zhvillimit ekonomik dhe kushte të favorshme ligjore dhe ekonomike për investime në sektorë të orientuar nga eksporti, që kanë për qëllim zhvillimin afatgjatë të infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe normave relativisht të larta të rritjes ekonomike. Për më tepër, qeveritë e këtyre vendeve duhet të ofrojnë procese të besueshme dhe të harmonizuara të cilat garantojnë respektimin e standardeve të sigurisë së BE-së për firmat eksportuese, në veçanti për eksportuesit bujqësorë. Përmirësimet në standardet e qeverisjes, duke përfshirë dhe shtetin e së drejtës, lidhen ngushtë me procesin e integritit të BE-së. Por, reformat që kërkohen nga BE-ja do të ndihmojnë për inkurajimin e rritjes ekonomike në shtetet e EJT-së. Reformat janë të domosdoshme për rritjen e kërkesës për punë, uljen e papunësisë e cila është më e ulëta në raport me vendet e BE-së, si dhe reformat në sistemin arsimor.

KAPITULLI III

3. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë dhe sfidat me të cilat ato përballen

Kosova është një vend pa dalje në det, por e pozicionuar në zemër të Ballkanit. Kosova është shtet demokratik, e qeverisur si republikë parlamentare, e bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit dhe sistemit të balancimit. Shteti më i ri në Evropë që shpalli pavarësinë në vitin 2008, është shtet fqinj me Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Sipas regjistrimit të vitit 2011, popullata e Kosovës është 1 820 631, prej tyre 50.4 % janë meshkuj. Kosova krenohet me popullsinë më të re në Evropë, siç dëshmohet nga Zyra e Regjistrimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (census.gov/prod/2011pubs). Vendndodhja strategjike e Kosovës dhe zhvillimi i infrastrukturës janë ndër arsytet më tërheqëse për të investuar në këtë shtet.

Prishtina ndodhet vetëm një orë vozitje me veturë larg secilit shtet fqinj. Projektet momentale të infrastrukturës moderne përfshijnë lidhjet autostradë me Shqipërinë, Serbinë dhe Maqedoninë. Koha për të arritur me veturë deri në Portin Detar të Shqipërisë, Durrës, është tri orë, kurse në portin detar të Selanikut, katër orë. Së këndejmi, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ofron lidhje të përditshme me shumë qytete të mëdha evropiane.

3.1. Sfidat me të cilat do të ballafaqohet Kosova

Edhe pse mbetin sfida të rëndësishme për përmirësim të mëtejshëm të mjedisit të të bërit biznes, Kosova u ofron investitorëve të huaj shumë potenciale të cilat ia vlejnë të eksplorojnë. Fuqi punëtore të re dhe të motivuar, regjime të ulëta tatimore, sistem të shëndoshë financiar, qasje në një treg për më shumë se 500 milionë konsumatorë (përmes disa marrëveshjeve për

tregti të lirë prej të cilave përfiton Kosova) janë vetëm disa nga përfitimet nga të cilat investitorët e huaj mund t'i bazojnë investimet e tyre.

Siç kemi parë tashmë në këtë punim, kompanitë që veprojnë në Kosovë ishin të afta të rriten si nga aspekti i qarkullimit vjetor, ashtu edhe nga numri i të punësuarve. Por, barra fiskale e tyre ka mbetur e njëjtë. Kjo rritje është dëshmuar përmes rritjes prej 29 % të qarkullimit mesatar vjetor që kompanitë kanë pasur në vitin 2011, nëse krahasohet me vitin 2009. Gjithashtu, fakti se pagesat tatimore si përqindje e qarkullimit total vjetor mbeten në një nivel shumë të ulët prej 3 deri 4 % në vit tregon se barra tatimore në Kosovë është në nivelet minimale. Në aspektin e mundësive investuese, vlen të shqyrtohen këto industri vijuese: bujqësi, kopshtari, nënkontraktim i proceseve afariste, energji dhe minierë, turizëm etj, OEA (2012)

3.2. Stabiliteti makroekonomik

Ekonomia e Kosovës vazhdimisht ka pasur norma pozitive të rritjes ekonomike, të cilat ishin më të larta se mesatarja rajonale. Pavarësisht normave relativisht të larta të rritjes (rreth 4-5 % në pesë vjetët e fundit), sfiduese për ekonominë e Kosovës vazhdimisht është norma e lartë e papunësisë, pasi ekonomia e Kosovës kryesisht është e bazuar në aktivitetin tregtar, sektor ky i cili ka kapacitete më të limituara për krijimin e vlerës së shtuar në ekonomi, por edhe për krijimin e vendeve të reja të punës. Sidoqoftë, rol të madh në neutralizimin e efektit të papunësisë në ekonomi vazhdojnë të luajnë dërgesat e emigrantëve (remitencat), të cilat në vitet e fundit arrijnë vlerën rreth 600 milionë euro.

Rritja ekonomike në vitet e fundit ishte ndërmjet 4-5 %, rritje kjo e cila në periudhën 2005-2008 ishte e nxitur nga sektori privat, ndërsa që nga viti 2009 është sektori publik ai i cili ka

marrë primatin në këtë rritje, duke reflektuar sjellje kundër ciklike të shpenzimeve qeveritare. Edhe sektori privat vazhdon të mbajë rol pozitiv në rritje, por se efekti i këtij sektori është reduktuar duke reflektuar ambientin e përgjithshëm makroekonomik në rajon. Në anën tjetër, me ndikim negativ në rritjen ekonomike vazhdon të jetë deficitit tregtar i cili karakterizohet me nivel të lartë të importeve të cilat kanë mbulueshmëri prej vetëm 10 % me eksporte.

Ky nivel i lartë i deficitit tregtar reflekton në deficit të llogarisë rrjedhëse, i cili karakterizon ekonominë e vendit që nga periudha e pasluftës. Mirëpo, me ndikim në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë kategoritë si tregtia në shërbime, në të cilën Kosova ka bilanc pozitiv, bilanci i të ardhurave si dhe transferet rrjedhëse të cilat dominohen nga dërgesat e emigrantëve. Në anën e financimit (llogarisë kapitale dhe financiare) janë Investimet e Huaja Direkte (IHD) ato që kanë ndikim pozitiv në financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse si dhe investimet e tjera. Investimet e Huaja Direkte vazhdimisht janë karakterizuar me luhatshmëri si rezultat i zhvillimeve në vitet e fundit në vendet e eurozonës që, njëkohësisht, paraqesin burimin kryesor të IHD-ve. Gjatë vitit 2012 ishte edhe ngadalësimi në procesin e privatizimit që ndikoi në fluksin më të ulët të IHD-ve në vend (rënie për afër 40 % në krahasim me vitin 2011), BQK, 2015).

Sa iu përket investimeve të tjera, kjo kategori më së shumti përmban kreditë tregtare ndërmjet kompanive vendëse dhe kompanive jashtë ekonomisë së Kosovës. Kjo kategori në masë të madhe përbëhet nga kreditë në mallra që kompanitë vendëse marrin nga kompanitë jashtë vendit. Përveç këtyre dy kategorive, kategori të rëndësishme janë edhe investimet portofoli, të cilat kanë vetëm fluks dalës si rezultat i mungesës së instrumenteve për investime në Kosovë. Rrjedhimisht, kjo kategori dominohet nga mjetet e Trustit, të cilat investohen në instrumente financiare ndërkombëtare.

Ekzistojnë teori që përkrahin dhe përshkruajnë efektet e globalizimit edhe në ekonominë e Kosovës. Këto teori argumentojnë efektet pozitive të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në zhvillimin ekonomik të vendit dhe vlerësojnë shumë lart të mirat që sjellin për ndërmarrjet kosovare qarkullimi i lirë i kapitalit dhe ekonomia e tregut në përgjithësi.

IHD-ja u shërben ndërmarrjeve shumëkombëshe për t'i shfrytëzuar resurset natyrore dhe njerëzore të vendeve në zhvillim, pra edhe të Kosovës. Prandaj, hapja ndaj IHD-ve reflekton të jenë faktor i rëndësishëm i sektorëve kryesorë të ekonomisë së Kosovës, kurse rritja e tregtisë ndërkombëtare do t'i paralizojë aktivitetet afariste të ndërmarrjeve vendore për shkak të mungesës së kapacitetit (njerëzor dhe financiar) për t'u përballur me konkurrencën e shumëfishtë më të fuqishme të ndërmarrjeve të vendeve të zhvilluara.

Në këtë punim do të përpiqem t'i ballafaqoj mendimet e ekspertëve kosovarë në një anë dhe atyre ndërkombëtarë, por dhe të argumentoj se procesi i IHD-ve është një zhvillim i pashmangshëm global për efektet e tij në ekonominë e Kosovës; t'i identifikoj sfidat dhe mundësitë që sjell ky zhvillim për ekonominë dhe ndërmarrjet në Kosovë.

Veprimi i lirë i korporatave shumëkombëshe jashtë kufijve shtetërorë, fuqia e tyre e madhe financiare dhe teknologjike sigurisht se do t'i detyrojë ndërmarrjet që veprojnë kryesisht brenda kufijve nacionalë, t'i modifikojnë strategjitë e tyre duke iu përshtatur zhvillimeve të reja globale.

Gjatë punimit është vënë në pah se duhet një analizë e detajuar për efektin e IHD-së në zhvillimin ekonomik të vendeve në zhvillim, në rastin konkret të Kosovës. Sa është kontributi real i këtyre investimeve në rritjen ekonomike dhe mirëqenies sociale në Kosovë, duke marrë parasysh edhe sfidat, rreziqet dhe mundësitë që sjellin këto investime për operatorët ekonomikë dhe socialë në vend. Cilat janë përparësitë dhe të metat e të qenit e Kosovës në një treg global

përballë alternativës së një tregu të segmentuar në variablën gjeografike nacionale, do të jetë, po ashtu, një paraqitje e problemit.

Në fund do të analizohen politikat në Kosovë që inkurajojnë politikat e IHD-ve dhe që ofrohen ide për orientimin e Kosovës në të ardhmen dhe sfidat e saj në ekonominë e tregut. Fakti se shumë autorë me famë botërore, të të gjitha teorive dhe pikëpamjeve, kanë shkruar dhe debatuar mbi efektet e ekonomisë botërore nga qasja e globalizimit, në veçanti për rolin e IHD-ve, e bëjnë edhe më të rëndësishëm përdorimin e kësaj literature.

Një ndër çështjet e tjera që trajtohet në këtë punim është fakti se ku është Kosova në gjithë këtë dinamikë të zhvillimeve aktuale ekonomike dhe sa është efekti i procesit të IHD-ve në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Një gjë është e sigurt, se roli i IHD-ve dhe efektet e tij në ekonominë e Kosovës janë të pashmangshme. Gjithashtu, sfida është se sa ekonomia dhe ndërmarrjet kosovare janë të përgatitura të inkorporohen suksesshëm në një treg të hapur me përmasa botërore dhe sa janë të përgatitura t'i shfrytëzojnë shanset dhe mundësitë që ofron ky proces, si dhe sa e kanë kapacitetin financiar dhe njerëzor për t'i përcjellë zhvillimet bashkëkohore teknologjike dhe cili është kontributi i IHD-ve në rritjen e dinamikës së zhvillimeve, si në ekonominë e Kosovës, po ashtu edhe të bizneseve të saj; sa këto investime mund të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së prodhimit ose shërbimit të ndërmarrjet kosovare dhe sa duhet të jetë imperativ për to përsosmëria e teknologjisë dhe e afarizmit modern. Gjithashtu, është koha të fillohet të analizohet edhe te ne, së paku teorikisht, roli i liberalizimit të tregtisë, hapjes së tregjeve, eliminimi i barrierave tarifore dhe jotarifore si dhe integrimi ekonomik në zhvillimin ekonomik të vendeve, ku një nga gjeneratorët kryesorë është rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD-ve), si një nga operacionet më të avancuara ndërkombëtare të biznesit dhe bashkëpunimit ekonomik mes vendeve.

Kosova dhe vendet e tjera në zhvillim, ashtu sikurse edhe ato të zhvilluara, janë fuqishëm të orientuara drejt draftimit dhe implementimit të politikave të cilat do ta inkurajojnë tërheqjen e investimeve të huaja direkte me qëllim të tërheqjes së kapitalit privat në ekonomi dhe arritjes së objektivave të rëndësishme makroekonomike. Theksi i veçantë duhet të jetë në analizën e efekteve të ekonomisë liberale në tregun e Kosovës dhe përfitimet e mundshme nga ky zhvillim i ri ekonomik. Patjetër duhet marrë parasysh edhe problemet, defektet, impaktet dhe hezitimet aktuale të vendeve të zhvilluara dhe të korporatave shumëkombëshe të përmendura më lart për zgjerimin e investimeve të tyre në vende të tjera dhe çfarë do të jetë ky efekt në ekonominë e ardhshme të Kosovës.

Marrëveshja e CEFTA-s, p.sh., mund të jetë edhe një test paraprak për ekonominë dhe ndërmarrjet kosovare se si dhe çfarë do të jetë terreni i veprimit afarist në një treg global dhe cilat janë sfidat që priten për to. Në vazhdim do të shihet dallimi i flukseve të IHD-ve që ka ndodhur pas periudhës së luftës në Kosovë (periudha e UNMIK-ut) dhe pas pavarësisë.

3.3 Procesi i privatizimit në Kosovë

Kosova ka një ekonomi të re dhe dinamike. Ka 1.8 milion banorë. Ka sipërfaqe 10 887 km². GDP-ja është 5.02 miliardë € (2012 vl). GDP-ja e rritjes ekonomike 2.9 % (2012 vl). GDP-ja për kokë banori 2.750 € (2012 vl). GDP-ja sipas ndarjes së sektorëve: bujqësia 20 %, industria 20 %, shërbimet 60 %. Shkalla e papunësisë arrin 30.9 %, shkalla e inflacionit 2.5 %, vlerësuar në 2012-n, IHD-të 232 milionë euro. Kosova është e pasur me burime natyrore si me: linjit, zink, plumb, ferronikel dhe toka pjellore bujqësore. Valuta që përdorur është euro. MPJ, (2014). Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste e dirigjuar, në një ekonomi të hapur të

tregut, e cila transformimin e saj të thellë e ka përjetuar pas vitit 1999 me çlirimin e Kosovës nga Serbia. Një ndër sfidat me të cilat ajo u përballë gjatë dekadës së fundit është edhe procesi i privatizimit. Ky studim, në bazë të intervistave të bëra me investitorët e huaj në Kosovë, nxjerrë rezultate mbi qëndrueshmërinë, stabilitetin dhe atraktivitetin e këtyre faktorëve në lidhje me ambientin investiv në Kosovë, me theks të veçantë rreth Investimeve të Huaja Direkte. Duhet përmendur faktin se në lidhje me këtë çështje janë bërë analiza dhe hulumtime të ndryshme në vend si nga institucionet shtetërore, po ashtu edhe nga agjencitë dhe organizatat e pavarura.

Nga raportet e tyre dalin përfundime të dallueshme për shumë nga faktorët e përmendur më sipër si faktorë të rëndësishëm për atraktivitet të investimeve ose jo. Së bashku me këto rezultate të këtij studimi dhe duke bërë krahasimin do të përpiqem të vij në një përfundim në lidhje me efektin e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë. Në përpjekje për të krijuar një mjedis sa më të përshtatshëm për investitorët, AKP-ja vazhdon me një program të përshpejtuar të privatizimit të ndërmarrjeve dhe aseteve përmes një procesi të tenderimit transparent dhe konkurrues, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Mirëpo, praktika ka treguar se nga qëllimet e këtij procesi të përshkruara më lart nuk janë arritur të priturat.

Nga intervistat me biznese dhe nga perceptimet e aktorëve të përfshirë në këtë proces, del se privatizimi në Kosovë nuk ka rezultuar me rigjenerim të bizneseve dhe të aseteve të tyre të trashëguara nga sistemi i kaluar. Procesi është përcjell me jotransparencë dhe me mungesë të zbatimit të kontratave të bëra në mes të AKP/AKM dhe operatorëve ekonomikë, përfitues të aseteve të privatizuara dhe është karakterizuar me shumë afera korruptive që janë edhe sot e kësaj dite pjesë e proceseve gjyqësore. Në një ambient të tillë, procesi i privatizimit nuk ka treguar ndonjë moment atraktiv për investitorë të huaj. “Ferronikeli New Co” dhe fabrika e çimentos “Sharrcem” janë shenjat e vetme që deri-diku mund të thuhet se janë tregime të

suksesit në këtë proces. Në rrethana normale ky proces është atraktiv për investitorët sepse i mundëson pronarit të ri të bëjë investime të menjëhershme si dhe ta bëjë përzgjedhjen e fuqisë së re punëtore, duke ofruar pronësi të pastër pa ndonjë borxh të trashëguar, pa ndërhyrje të kreditorëve dhe pretendentëve të mundshëm.

E ndodhur në Evropën Juglindore, ekonomia e Kosovës është bërë pjesë e integritimeve ekonomike të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaft të gjerë. Qëllim në vete duhet të jetë konkurrueshmëria e kësaj ekonomie duke rritur kapacitetin e saj eksportues për ta zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht ka. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron një sërë përparësish krahasuese si: popullsinë e re dhe mjaft mirë të kualifikuar, ku mosha mesatare e saj është mjaft e re, resurse natyrore, kushte të volitshme klimatike, infrastrukturë të re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozitë gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-s dhe në atë të Bashkimit Evropian.

Kosova, përveçse është anëtare e CEFTA-s, është anëtarësuar edhe në FMN (Fondin Monetar Ndërkombëtar) dhe BB (Bankën Botërore). Synon të anëtarësohet edhe në mekanizma të tjerë të fuqishëm ekonomiko-financiarë si në: BERZH, Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës. Kosova gjatë muajit qershor 2013 është pranuar si anëtare e plotë në CEB. Kjo bankë është degë autonome e Këshillit të Evropës. Po ashtu, synon të anëtarësohet në mekanizma të tjerë të fuqishëm ekonomiko-financiarë si në: Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) etj. Një faktor i rëndësishëm për investitorët e huaj është edhe shkëmbimi tregtar i Kosovës me vendet e tjera.

Tabela 3.1 Shkëmbimi tregtar i Kosovës, periudha 2001-2014


(000€)

Periudha	Eksportet	Importet	Bilanci tregtar	Përqindja mbulimit ^e
1	2	3	4=2-3	5=2/3
2001	10,559	684,500	-673,941	1.5
2002	27,599	854,758	-827,159	3.2
2003	35,621	973,265	-937,644	3.7
2004	56,567	1,063,347	-1,006,780	5.3
2005	56,283	1,157,492	-1,101,209	4.9
2006	110,774	1,305,879	-1,195,105	8.5
2007	165,112	1,576,186	-1,411,074	10.5
2008	198,463	1,928,236	-1,729,773	10.3
2009	165,328	1,935,541	-1,770,213	8.5
2010	295,957	2,157,725	-1,861,768	13.7
2011	319,165	2,492,348	-2,173,183	12.8
2012	276,100	2,507,609	-2,231,509	11.0
2013	293,842	2,449,064	-2,155,222	12.0
2014	324,554	2,538,232	-2,213,678	12.8

Burimi: <https://ask.rks-gov.net/dmdocuments/Statistikat%20e%20Tregtise%20se%20Jashtme%2002%20>

Shkurt%20 2015.

Grafiku 3.1. Shkëmbimi tregtar i Kosovës, 2001-2014

Burimi: <https://ask.rks-gov.net/dmdocuments/Statistikat%20e%20Tregtise%20se%20Jashtme%2002%20>


Shkurt%20 2015.dhe përpunimi i autorit

Bilanci tregtar i Kosovës, 2011-2013

Bilanci tregtar i Kosovës (në 000 euro) sipas tabelës 3.2. për periudhën 2011-2012-2013 tregon për një mosharmonizim ndërmjet importeve dhe eksporteve të Kosovës, ASK, MTI dhe llogaritjet e autorit, (2015).

	2011	2012	2013
Eksporti	319,165	276,100	293,842
Importi	2,492,348	2,507,609	2,449,064
Bilanci tregtar	-2,173,184	-2,231,509	-2,155,221

Grafiku 3.2. Importet-eksportet, 2011-2013




Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përpunimi i autorit

Tabela 3.3. Vendet me pjesëmarrjen më të madhe në importet e përgjithshme në vitin 2013 (në %)

Vendet	Pjesëmarrja në %
Serbia	11.6
Gjermania	10.3
Italia	9.3
Turqia	8.4
Maqedonia	7.6
Kina	7.3
Greqia	6.0
Shqipëria	4.5
Bosnja dhe Hercegovina	3.4
Kroacia	3.0

Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përpunimi i autorit

Grafiku 3.3. Vendet me pjesëmarrje më të madhe në importet e përgjithshme në vitin 2013 (në %)




Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përpunimi i autorit

Tabela 3.4. Vendet me pjesëmarrje më të madhe në eksportet e përgjithshme të Kosovës në vitin 2013 (në %)

Vendet	Pjesëmarrja në %
Italia	25.3
Shqipëria	14.9
India	9.9
Maqedonia	8.9
Mali i Zi	5.9
Serbia	4.9
Gjermania	3.7
Turqia	2.6
Zvicra	2.5
Austria	2.2

Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përpunimi i autorit

Grafiku 3.4. Vendet me pjesëmarrje më të madhe në eksportet e përgjithshme të Kosovës në vitin 2013 (në %)



Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përpunimi i autorit

Importet-eksportet e Kosovës me vendet e tjera të mbetura të botës në periudhën 2011-2012-2013 (në mil. euro)

Tabela: 3.5. Importet

Viti/ Vendi	2011	2012	2013
Turqia	184,452	200,193	204,691
Zvicra	22,194	22,664	20,909
Kina	170,285	159,904	179,589
SHBA	42,847	50,192	52,142
Brazili	40,925	41,789	45,777

Tabela: 3.6 Eksportet

Viti/ Vendi	2011	2012	2013
Turqia	7,831	11,380	7,393
Zvicra	17,611	15,132	7,209
Kina	28,268	3,266	1,290
India	15,482	22,889	28,953

Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përpunimi i autorit

Tregtia me vendet e rajonit (anëtarë në CEFTA) dhe Bashkimin Evropian përbën pjesën dërrmuese të tregtisë së jashtme të Kosovës. Bashkimi Evropian është grupimi i parë më i rëndësishëm tregtar i Kosovës, duke qenë në shifra të përafërta në shkëmbime tregtare si me grupimin e CEFTA-s. Për sa iu përket eksporteve të Kosovës me vendet ballkanike, Shqipëria


merr pjesë me 14.9 %, Maqedonia me 8.9 %, Serbia me 4.9 % në raport me totalin e vitit 2013, ndërsa pjesëmarrjen më të madhe të importeve në Kosovë nga vendet ballkanike e kanë Serbia me 11.6 %, Gjermania me 10.3 % dhe Shqipëria me 4.5 % të totalit të përgjithshëm në vitin 2013.

Tabela 3.7 tregon një pasqyrë të importeve dhe eksporteve me vendet e CEFTA-s gjatë periudhës 2011-2013

CEFTA	Importet			Eksportet		
	2011 €	2012 €	2013 €	2011 €	2012 €	2013 €
Shqipëria	96,400,074	110,527,930	110,597,375	34,566,119	40,180,432	43,774,413
Bosnja dhe Hercegovina	79,835,425	85,308,988	83,530,800	612,071	1,974,263	2,812,032
Kroacia	64,062,989	72,012,144	73,331,168	2,793,626	2,359,168	2,593,718
Moldavia	558,925	182,803	429,635	10,001	11,417	4,267
Mali i Zi	12,232,207	10,510,468	11,386,944	6,987,555	16,758,828	17,310,034
Maqedonia	365,960,511	287,738,514	185,019,550	30,949,033	26,375,555	26,139,232
Serbia	254,916,680	278,387,936	285,355,644	7,198,356	14,967,694	14,463,381
TOTAL	873,966,810	844,668,785	749,651,116	83,116,760	102,627,356	107,097,077

Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe llogaritjet e autorit

Grafiku 3.5. Importet dhe eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s gjatë periudhës 2011-2013



Burimi: ASK, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përpunimi i autorit

3.4 Përparësitë e Kosovës për Investime të Huaja Direkte

Institucionet e Kosovës vazhdimisht përpiqen t'i promovojnë anët pozitive dhe atraktive të investimeve në vend. Është kjo një shtytje për themelimin e Agjencisë Kosovare për Promovimin e Investimeve (AKPI) dhe ka për qëllim mbështetjen e investimeve të huaja në Kosovë. AKPI ofron një spektër të gjerë të programeve mbështetëse për t'i ndihmuar bizneset ndërkombëtare t'i arrijnë qëllimet e tyre të zhvendosjes. Gjithashtu, Agjencia është e ngarkuar me promovimin e eksporteve. AKPI (2014). Sipas institucioneve shtetërore që promovojnë vlerat dhe të arriturat e Kosovës në bërjen e një ambienti atraktiv për investitorë të huaj, disa nga përfitimet të cilat cilësohen fitimprurëse për investitorë në Kosovë janë :

- Taksat në Kosovë janë shumë të ulëta krahasuar me shtetet fqinje
- Sistemi tatimor është mbajtur jashtëzakonisht i thjeshtë
- Fuqi të re dhe e motivuar punëtore me shpirt dhe aftësi të forta ndërmarrëse, gjithashtu njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve evropiane
- Resurse të lakmueshme natyrore: linjit, zink, plumb, ferronikel dhe toka pjellore bujqësore
- Qasje të lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinje
- Institucione moderne në përkrahjen e bizneseve
- Procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë për regjistrimin e bizneseve (brenda tri ditëve)
- Sistem të sigurt bankar
- Strukturë moderne ligjore dhe në pajtim me BE-në dhe
- Monedha zyrtare në Kosovë është euro, që eliminon rrezikun e eurozonave.

Pas pavarësimit Kosova ka arritur progres të madh në shumë fusha të zhvillimit të saj si në: rritjen e stabilitetit politik, ngritjen e nivelit të sigurisë, ekonomi stabile me rritje të

vazhdueshme, plotësim të legjislacionit etj. Është bërë pjesë e rëndësishme e iniciativave të bashkëpunimit regional, përmes të cilave është arritur krijimi i tregut të përbashkët rajonal, eliminimi i tarifave doganore, eliminimi i barrierave tregtare, si dhe hapja e perspektivave të reja.

3.5 Angazhimi i institucioneve të Kosovës në përmbushje të standardeve të nevojshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian

Kosova sot ka stabilitet makroekonomik, sistem të qëndrueshëm financiar, janë bërë reforma në politikën fiskale në aplikimin e normave më të ulëta tatimore në rajon. Ndër objektivat kryesore është rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë së vendit në tregun rajonal. Marrë parasysh klimën e biznesit, ambientin makroekonomik dhe mundësitë reale investuese në të gjithë sektorët e ndryshëm të biznesit, Kosova është duke u bërë një vend gjithnjë e më kompleks për të bërë biznes. Si rezultat i këtyre, interesi i investitorëve të huaj është vazhdimisht në rënie vitet e fundit. Në fakt, Kosova ka tërhequr më shumë se një miliard Investime të Huaja Direkte (IHD) në tre vjetët e fundit. Pas një kulminacioni në vitin 2007, me 440 milionë euro të IHD-ve, një rënie e vogël është parë në vitet 2008 dhe 2009 për shkak të ndikimit të krizës globale financiare.

3.6 Dinamika e IHD-ve në Kosovë

Dinamika dhe volumi i IHD-ve ka pësuar ulje dhe ngritje në periudha të ndryshme. Kjo është theksuar pas krizës financiar më 2008. Vende të ndryshme në botë kanë pësuar ose përfiturar në renditjen e përfituesve të IHD-ve në periudhat e para dhe pas krizës së fundit. Me krizën globale të vitit 2008 hyrjet nga investimet ranë në 1.7 trilion dollarë ose për 20 %, ndërsa në vitin 2009 në 1.1 trilion dollarë për shkak të rënies së profitit, kushteve më të këqija kreditore dhe reduktimit të vlerës së aseteve të ndërmarrjeve. Viti 2010 manifestoi një rritje të IHD-ve për 5 %

ose 1.2 trilion dollarë dhe më 2011 u rrit për 2 %, që kthehu optimizëm. Në fakt, IHD-të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik edhe të vendeve në tranzicion siç është Kosova.

Është vlerësuar se vendi ynë mund të përfitojë nga këto investime nëse:

1. IHD-të bëjnë të mundur investime në projekte që mundësojnë rritjen ekonomike në vend
2. Zvogëlojnë koston në shkëmbimin e të mirave materiale me karakter ndërkombëtar
3. Stimulojnë konkurrencën në mes të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare
4. Nuk përkeqësojnë gjendjen e papunësisë, sidomos të shtresat e pakualifikuara të popullsisë.


Pas përfundimit të luftës shumë investitorë erdhën në Kosovë për ta analizuar mundësinë e investimeve të tyre në vend. Investitorët e huaj u interesuan për kushtet e investimeve në një treg që, për shumicën e tyre, deri atëherë ishte krejtësisht i panjohur. Kosova ishte ende e papërgatitur për t'iu përgjigjur këtij interesimi. Mungesa e institucioneve, mungesa e infrastrukturës ligjore dhe e autoriteteve për komunikim në administratën publike, vështirësitë e mëdha në shërbimet publike, mungesa e sistemit financiar në atë kohë, sidomos mosekzistenca e bankave të qëndrueshme, kanë pasur ndikim të shprehur dekurajues. Megjithatë, në vitet në vazhdim ka pasur një dinamikë të zhvillimeve ekonomike në Kosovë, edhe pse rrjedha e zhvillimeve nuk ka arritur pritshmëritë e aktorëve ekonomikë në vend.

Zhvillimi më i vërejtur ka qenë në sektorin bankar, ku edhe janë vërejtur dukshëm këto zhvillime, sidomos të tilla si Investime të Huaja Direkte. Zhvillimi i këtij sektori ka mundësuar qëndrueshmëri duke përbërë një faktor pozitiv për ta rritur atraktivitetin e IHD-ve në Kosovë. Megjithatë, janë identifikuar edhe faktorë të tjerë të rëndësishëm të cilat e bëjnë një vend atraktiv ose jo për investitorët e huaj, sidomos nëse bëhet fjalë për investimet e tyre direkte.

Kriza globale e vitit 2008 ndikoi që IHD-të, në sektorët kryesorë të ekonomisë së Kosovës, të kishin rënie të theksuar. Gjatë vitit 2010-2011 vlera IHD filloi të rritet me një ritëm të ngadalshëm. Kështu nuk ndodhi edhe gjatë vitit 2012. Në Kosovë gjatë vitit 2012 rrjedha e IHD-ve përkeqësohet dukshëm. Kjo situatë dëshmon për ndjeshmërinë që kanë IHD-të ndaj zhvillimeve në ekonomitë e vendeve të Eurozonës, të cilat vende njëkohësisht paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë (Raporti i BQK-së, 2012). Megjithatë, ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar me normë pozitive të rritjes. Rritja ekonomike pozitive gjatë vitit 2012 është mbështetur edhe nga pozicioni stabil fiskal, BQK, (2013).

Rrjedha e IHD-ve në Kosovë gjatë vitit 2012 ishte 232.0 milionë euro, ose 41.2 për qind më e ulët se në vitin 2011. Vendet e BE-së vazhdojnë ta paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë, BQK, (2012). Sidoqoftë, kontribuuesi kryesor në kuadër të bilancit pozitiv të llogarisë financiare vazhdon të jetë kategoria e investimeve të huaja direkte që, pavarësisht rënies, konsiderohet komponenti kryesor në financim të llogarisë rrjedhëse, BQK, (2013)

Grafiku 3.6 Investimet e Huaja Direkte në Kosovë gjatë periudhës 2007-2014



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, shkurt 2015 dhe përpunimi i autorit

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për vëllimin dhe origjinën e Investimeve të Huaja Direkte për vitet 2007-2014.


Tabela 3.8. Investimet e Huaja Direkte sipas shteteve (vitet 2007- 2014 euro mil.)

Vitet	Gjithsejtë	Sllovenia	Gjermania	Austria	Zvicra	UK	Turqia	Holanda	Shqipëria	SHBA-ja	Franca	Të tjera
2007	440.7	56.2	48.1	35.4	9.7	116.2	5.4	41.2	3.4	8.8	8.6	107.7
2008	369.9	44.3	44.0	51.3	32.1	36.6	23.8	25.9	21.9	4.8	3.6	81.6
2009	295.5	50.8	75.2	15.5	22.7	6.2	14.5	23.1	23.3	11.8	6.0	46.4
2010	368.5	34.0	91.6	21.1	35.1	38.8	4.9	17.2	20.3	12.6	3.8	89.1
2011	384.4	16.2	66.6	19.6	30.9	80.1	34.7	4.7	11.2	14.3	0.2	105.9
2012	229.1	9.3	49.5	0.4	43.8	14.3	65.6	(25.6)	4.7	10.8	6.3	20.0
2013	280.2	7.0	21.7	10.7	41.7	10.7	88.6	(0.1)	19.3	12.7	3.8	64.1
2014	151.3	(9.4)	29.4	30.1	38.2	(39.5)	20.2	(7.8)	20.4	14.6	3.0	59.0

Burimi: BQK, buletini mujor statistikor, shkurt 2015 dhe llogaritjet e autorit

Sipas tabelës nr. 3.8, nga flukset e IHD-ve në Kosovë sipas shteteve shohim se kryeson Gjermania, e pasuar nga Anglia, Turqia, Zvicra, Sllovenia, Austria, Shqipëria dhe të tjera, për dallim nga viti 2011, kur pjesa më e madhe e IHD-ve ishte nga Britania e Madhe (20.3 % e gjithsej IHD-ve). Në vitin 2012 Turqia paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD-të në Kosovë (28.3 % të gjithsej IHD-ve). Gjermania është e dyta me (21.60 %), Zvicra e treta për nga shuma e IHD-ve (18.9 %). Shumica e vendeve të BE-së kanë pasur rënie të IHD-ve, mirëpo për shkak se rënia e IHD-ve nga Britania e Madhe ishte mjaft e madhe, tek disa prej vendeve të tjera vërehet rritje e pjesëmarrjes në strukturën e IHD-ve. BQK, (2012)

Grafik 3.7. Investimet e Huaja Direkte sipas shteteve (vitet 2007- 2014, në mil. euro)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës dhe përpunimi i autorit


Tabela 3.9. Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik (vitet 2007- 2014 në mil. euro)

Pershkrimi	Gjithsej	Bujqësia	Minierat	Industria	Energjetika	Ndërtimi	Shërbimet tregtare	Hotele dhe restorante	Transporti dhe komunikimi	Patundshmeri, qiradhënies financiare	qiradhënie dhe aktivitetë tjera biznesore	Shërbime tjera	Aktivitetë të tjera të paklasifikuara diku tjetër
2007	440.7	7.9	41.5	74.8	2.5	5.2	12.7	12.7	129.2	102.0	30.9	4.5	16.9
2008	369.9	8.5	17.4	53.7	16.7	13.5	10.1	2.1	51.0	109.6	62.2	2.1	23.0
2009	295.5	13.1	7.0	57.6	8.7	35.5	16.2	2.4	21.9	75.3	43.9	2.7	11.3
2010	368.5	0.9	17.7	101.1	00	54.2	6.8	00	-15.9	39.4	75.5	1.3	87.6
2011	384.4	0.6	-5.2	46.9	0.2	133.1	11.6	0.2	29.0	33.0	60.5	11.3	63.2
2012	229.1	0.3	-25.0	27.4	2.2	31.1	9.3	0.5	32.4	22.4	115.7	1.8	11.0
2013	280.2	0.4	-14.1	11.5	48.8	17.3	14.6	0.8	51.0	4.4	136.1	3.3	6.2
2014	151.3	0.1	4.2	-34.1	13.4	-19.9	8.1	0.4	-9.1	43.1	142.3	1.8	1.1

Burimi: BQK, Buletini Mujo Statistikor, shkurt 2015 dhe llogaritjet e autorit

Duke marrë për bazë tre vjetët e fundit (2012-2014), shohim se IHD-të më së shumti ishin të fokusuara në patundshmëri, ndërtime, shërbime financiare, duke u shoqëruar me prodhim, transport, telekomunikacion dhe shërbime të tjera. Ndërsa në vitet 2007 dhe 2008 koncentrimi më i madh i IHD-ve ishte në shërbime financiare, pastaj transport dhe komunikim, patundshmëri, qiradhënie dhe aktivitetë të tjera biznesore.

Grafiku 3.8. Sipas aktivitetit ekonomik në vitet 2007-2014 (në mil. euro)



Burimi: BQK, Buletini Mujo Statistikor, shkurt 2015 dhe llogaritjet e autorit

Kosova nuk është e kufizuar në fushat e përmendura, por ofron mundësi të mëdha për investime edhe në sektorë të tjerë si në: bujqësi, energji, vreshtari, turizëm, nxjerrje dhe përpunim të metaleve etj. Gjithashtu, sistemi i regjistrimit të biznesit në Kosovë përbën një faktor tjetër nxitës në rritjen e investimeve, me proceduara të thjeshtuara dhe me shpejtësi të regjistrimit të bizneseve të reja për një kohë të shkurtë. Të gjitha këto e veçojnë Kosovën si një vend me mundësi të paqarta investimi për secilin investitor të sektorëve të ndryshëm si në privatizim dhe dhënie në koncesion kompanive të mëdha publike si: Posta dhe Telekom i Kosovës dhe sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike, po ashtu edhe investimi në fushat e gjelbra, në të cilat mundësi mjaft të favorshme në ofrimin e infrastrukturës fizike ofrojnë parqet industriale (siç është Parku Industrial i Drenasit).


Kosova duhet të punojë për krijimin e tregut të kapitalit financiar, në të cilin do të gjenin terren investorët të cilët duan të investojnë në aksione të kompanive të ndryshme.

Tabela 3.10. Shpërndarja e kompanive të huaja investuese sipas sektorëve të ekonomisë-2014

	Spektori	Nr. i kompanive	Pjesëmarrja në %
1	Tregti	1952	38.9
2	Prodhim	791	15.8
3	Aktivitet shërbyese	764	15.2
4	Ndërtim	607	12.1
5	Turizëm dhe hoteleri	350	7.0
6	Transport	181	3.6
7	Shërbime financiare	141	2.8
8	Telekomunikim	121	2.4
9	Shëndetësi	68	1.4
10	Edukim	43	0.9
	Totali	5018	100.0

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Grafiku 3.9. Shpërndarja e kompanive të huaja investuese sipas sektorëve të ekonomisë-2014



Burimi: BQK, Buletini Muor Statistikor, shkurt 2015 dhe përpunimi i autorit

Grafiku tregon se 39 % e kompanive kanë qenë të orientuara në shërbime tregtare, 16 % në prodhim, 15 % në aktivitete shërbyese, 12 % në ndërtim, pjesa tjetër në transport dhe komunikim, shërbime financiare dhe shëndetësi.

Ecuria e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë


Tabela 3.11 Pjesëmarrja e IHD-ve në BPV të Kosovës në periudhën 2007-2014 (përfshinë TM1, TM2 dhe TM3)

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
IHD	440.7	369.9	295.5	368.5	384.1	229.1	280.2	151.2
BPV	3,393.7	3,851.4	3,912.4	4,215.6	4,772.8	4,916.0	5,326.0	4,061.3
IHD si % e BPV-së	12.99	9.60	7.55	8.74	8.05	4.66	5.26	3.72

Burimi: BQK-ASK dhe llogaritjet e autorit 2015

Shihet se në vitin 2007 IHD-të kanë marrë pjesë në BPV me 12.99 %, duke shënuar rënie të vazhdueshme ndër vite, ndërsa rënia më e madhe shihet në vitin 2012 me 4.66 %, në vitin 2013 kemi ngritje të lehtë në 5.26 % ose 0.6 %, në vitin 2014 (TM1, TM2 dhe TM3) pjesëmarrja e IHD-ve është 3.72 %. Shkaqet ose arsyet e rënies ndër vite janë evidentuar sipas studimit në pasigurinë politike. Korrupsioni i lartë, mungesa e vullnetit të qeverisë për ta krijuar ambientin e përshtatshëm dhe incentivat për investitorët e huaj dhe shumë faktorë të tjerë. Kjo rënie padyshim se interferon edhe në rënien e BPV për kokë banori.

Grafiku 3.10. Paraqitja grafike e IHD-ve si % e BPV-së, 2007-2014




Burimi: BQK-ASK dhe përpunimi i autorit 2015

Investimet e Huaja Direkte (Raporti vjetor i BQK-së, 2013)

IHD-të në Kosovë gjatë vitit 2013 ishin 258.9 milionë euro ose 13.1 për qind më të larta se në vitin 2012. Investimet e rezidentëve të Kosovës në vende të tjera shënuan rritje prej 13.2-përqindësh dhe arritën vlerën prej 17.9 milionë eurosh. Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e pasurive të patundshme.

Si rezultat i krizës globale financiare, IHD-të në raport me PBB-në kanë shënuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2008, ndërkohë që në vitin 2013 është shënuar përmirësim i ndjeshëm i këtij treguesi, nga 4.7 për qind, në 5.0 për qind të PBB-së. Rritja e IHD-ve paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm edhe në kuptim të qëndrueshmërisë së financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Këtë e ilustron edhe grafiku i mëposhtëm.



Burimi: BQK, 2014

Siç shohim në këtë grafik në kudër të IHD-ve, rritje ka shënuar kategoria e kredive ndërmjet ndërmarrjeve dhe fitimi i riinvestuar (64.4, përkatësisht 26 milionë euro më shumë se në vitin 2012), ndërsa kapitali aksionar ishte 60.4 milionë euro më i ulët se në vitin 2012.

Investimet e Huaja Direkte sipas sektorëve ekonomikë gjatë viteve 2007-2014 të shprehura në %


Në vitet 2007-2008 sektorët me përqindje më të madhe në IHD-në e përgjithshme kanë qenë transporti dhe komunikimi me 29.32 % dhe 13.79 %, shërbimet financiare me 23.14 % dhe 29.63 %, industria me 16.97 % dhe 14.52 %, pastaj minierat me 9.42 % dhe 4.7 % dhe patundshmëritë me 7.01 % dhe 16.82 %. Kurse në vitet 2013-2014 sektorët me (%) më të madhe në pjesëmarrjen e përgjithshme të IHD-ve kanë qenë: patundshmëritë me 48.57 % dhe 94.05 %, shërbimet financiare me 28.49 % në vitin 2014, pastaj energjetika me 17.42 % dhe 8.86 % dhe shërbimet tregtare me 5.21 % dhe 5.35 %. Shihet rënie në industri nga 16.97 % në vitin 2007, në -22.54 % në vitin 2014. Ndoshta për shkak të rënies së përgjithshme të IHD-ve në nivel vendi!

Tabela 3.12. Investimet e Huaja Direkte sipas sektorëve ekonomikë 2007-2014 shprehur në përqindje

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
Shërbime financiare	23.14	29.63	25.48	10.69	8.58	9.78	1.57	28.49
Patundshmëri	7.01	16.82	14.86	20.49	15.74	50.5	48.57	94.05
Transport dhe komunikacion	29.32	13.79	7.41	-4.31	7.54	14.14	18.2	-6.1
Elektricitet	0.57	4.51	2.94	0	0.5	0.96	17.42	8.86
Miniera	9.42	4.7	2.37	4.8	-1.35	-10.91	-5.03	2.78
Ndërtim	1.18	3.65	12.01	14.71	34.63	13.57	6.17	-13.15
Industri përpunuese	16.97	14.52	19.49	27.44	12.20	11.96	4.10	-22.54
Bujqësi	1.79	2.30	4.43	0.24	0.16	0.13	0.14	0.07
Shërbime tregtare	2.88	2.73	5.48	1.85	3.02	4.06	5.21	5.35
Hotele dhe restorante	2.88	0.57	0.81	0	0.05	0.22	0.29	0.26
Aktivitete dhe shërbime të tjera	1.02	0.57	0.91	0.35	2.94	0.79	1.18	1.19
Aktivitete të tjera të paklasifikuara diku tjetër	3.83	6.22	3.82	23.77	16.44	4.80	2.21	0.73

Burimi: BQK dhe llogaritjet e autorit shkurt 2015

Grafiku 3.12. Investimet e Huaja Direkte sipas sektorëve ekonomikë gjatë viteve 2007-2014 shprehur në përqindje (%)



Burimi: BQK dhe përpunimi autorit shkurt 2015

Sipas tabelës 3.18 dhe grafikut 3.12, shihet se nga viti 2007 deri në vitin 2010 sektorët ekonomikë që kanë thithur më së shumti investime të huaja direkte kanë qenë shërbimet financiare, transporti dhe komunikacioni dhe industria përpunuese, ndërsa fare pak është investuar në bujqësi, energji dhe shërbime të tjera. Ndërsa në vitin 2011-2012 është investuar në sektorin e ndërtimit, industrinë përpunuese dhe patundshmëri. Në vitin 2013 në përgjithësi ka pasur rënie të IHD-ve. Edhe ato që kanë qenë, kanë qenë të orientuara në patundshmëri 48.57 %, energji elektrike 17.42 %, ndërtim 6.17 % dhe shërbime tregtare 5.21 %. Ndërsa në vitin 2014, kryesisht në patundshmëri 94.05 %, shërbime financiare 28.49 %, elektricitet 8.86 %, kurse ka pasur rënie tepër të madhe në sektorët e industrisë përpunuese (-22.54 %), në ndërtim (-13.15 %) dhe në transport e komunikacion (-6.1 %). Kjo rënie është për shkak të jostabilitetit politik (pasiviteti i qeverisë gjatë periudhës gjashtëmujore qershor-dhjetor 2014), korrupsioni i lartë në nivel të lartë shtetëror dhe pasiguria për t'i mbrojtur investimet. Në disa prej sektorëve vërehet mungesë investimi ndër vite. Këta sektorë janë: energjia, minierat dhe industria.

Faktorët problematikë që kanë ndikuar që investitorët të mos investojnë në energji

- Ngritja e paparashikueshme e çmimeve të karburanteve të lëngëta që importohen dhe ndërprerja e paparashikueshme e furnizimit me prodhime të importuara të naftës
- Krizat e mundshme financiare globale, me ndikim negativ në investimet nga jashtë
- Vazhdimi i obstrukcioneve nga Serbia në sektorin e energjisë
- Rritje të çmimeve të energjisë elektrike dhe rritje të kërkesës për import deri në ngritjen e kapaciteteve të reja prodhuese
- Eficienca e ulët në procesin e prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë
- Ndotja e mjedisit nga minierat e linjitit dhe nga prodhimi i energjisë
- Mungesa e rezervave shtetërore të karburanteve të lëngshme

- Pamundësia e qasjes për menaxhimin e sektorit të energjisë në pjesën veriore të Kosovës
- Mungesa e vëmendjes së edukimit të brezit të ri me kujdesin institucional në zhvillimin e profileve që sektori kërkon.

Faktorë problematikë që kanë ndikuar që investorët të mos investojnë në sektorin e minierave janë:


- Kriza financiare globale
- Ndryshimet globale në tregun e mineraleve
- Jostabiliteti i mundshëm rajonal
- Ndërtimi i pakontrolluar në zonat me interes të veçantë
- Dëmet mjedisore të bëra në të kaluarën, të pazgjidhura
- Mungesa e politikave të qarta qeveritare për IHD-të
- Jostabiliteti politik (më shumë se një vit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka qenë pa bord mbikëqyrës. (Mbi 120 aplikacione për kërkime minerare kanë mbetur pa përgjigje).

Faktorë problematikë që kanë ndikuar që investorët të mos investojnë në sektorin e industrisë përpunuese janë:

- Furnizimi i dobët me energji elektrike;
- Korrupsioni i lartë;
- Kushtet e papërshtatshme të mjedisit;
- Vjedhjet dhe krimi;
- Sistemi i komplikuar i procedurave administrative;
- Tarifat e larta të importit të makinerisë dhe lëndës së parë.

3.7 Pozicioni ndërkombëtar i investimeve

Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI) neto në fund të shtatorit 2013 ishte pozitiv me vlerë prej 387.0 milionë eurosh. Bilanci pozitiv i PNI-së ka ndjekur trendin e rënies deri në vitin 2011, ku si përqindje e PBB-së kishte arritur në 2.8 për qind, ndërsa ka filluar të rritet përsëri dhe ka arritur në 7.5 për qind të PBB-së në vitin 2013. Në këtë kontekst, investimet portofoli neto dhe investimet e tjera ndikuan në përmirësimin e bilancit të PNI-së, duke shënuar rritje prej 20.2, përkatësisht 23.8 për qind në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012. Në anën tjetër, bilanci i investimeve direkte vazhdoi të jetë negativ dhe shënoi rritje prej 9.6-përqindësh në vitin 2013. Sektori bankar ka pasur vazhdimisht bilanc pozitiv (1.5 miliard, përkatësisht 539.6 milionë euro në vitin 2013), ndërsa sektorë të tjerë dhe qeveria bilanc negativ (1.3 miliard, përkatësisht 321.8 milionë euro).




Burimi: BQK, 2014

Portofoli i investimeve, investimet e tjera dhe asetet rezervë

Bilanci i investimeve portofoli gjatë vitit 2013 ishte -133.8 milionë euro (-184.9 milionë euro në vitin 2012). Investimet portofoli jashtë vendit, kryesisht në letra me vlerë të borxhit, shënuan vlerën prej 132.8 milionë eurosh (185.7 milionë euro në 2012). Pjesa më e madhe e investimeve portofoli përbëhet nga investimet e fondeve pensionale në instrumente të ndryshme financiare jashtë vendit, ndërsa pjesa tjetër i takon Bankës Qendrore dhe bankave komerciale. Kategoria e investimeve të tjera kishte një bilanc prej vetëm 5.1 milionë eurosh në vitin 2013 (369.2 milionë euro në 2012-n). Ajo ç'është është me rëndësi të ceket në bazë të këtyre rezultateve, është se ky bilanc, që është më i ulëti i investimeve të tjera krahasuar me vitin paraardhës, ishte për shkak të rritjes së aseteve, kryesisht në depozita dhe kredi, për 70.4 milionë euro dhe rritjes së detyrimeve për 75.5 milionë euro për dallim nga viti i mëparshëm, ku asetet ishin zvogëluar për 146.3 milionë euro, ndërsa detyrimet patën shënuar rritje për 222.9 milionë euro. Kurse në vitin 2012 asetet u ulen kryesisht për shkak të zvogëlimit të depozitave jashtë vendit si dhe rritjes së kredive tregtare. Ndërsa në vitin 2013 depozitat e investuara jashtë u rritën për 47.3 milionë euro, ndërsa kreditë tregtare u zvogëluar nga 100.3 milionë euro në vitin 2012, në 19.1 milionë euro në vitin 2013, që lidhet edhe me nivelin më të ulët të importeve. Asetet rezervë, të cilat janë të investuara kryesisht në instrumente të tregut të parasë dhe në depozita, gjatë vitit 2013 janë zvogëluar për 21 milionë euro.

Grafiku 3.14. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve sipas sektorëve institucionale



Burimi: BQK, 2014

Llojet e IHD-ve dhe klasifikimi i tyre

Nga këndvështrimi i investitorit IHD-të klasifikohen në:

- IHD-të horizontale, prodhohen jashtë (në vendin pritës). Ajo që prodhohet edhe në kompaninë mëmë;
- IHD-të vertikale, transferohet jashtë në një nga fazat e procesit prodhues;
- IHD-të konglomerat, përzierje e investimeve horizontale dhe vertikale, të cilat përfshijnë edhe investimin në një industri të një natyre tjetër në vendin e punës.

Nga këndvështrimi i vendit pritës IHD-të klasifikohen në:

- Zëvendësuese të importit;
- Rritëse të eksportit;
- Të iniciuara nga qeveritë.

Ndërsa nga drejtimi i investimit, IHD-të ndahen në dy tipa:

- Të brendshme dhe
- Të jashtme.

Format e IHD-ve janë:

- Marrja (përfitimi) ose shkrirja me një ndërmarrje në një vend tjetër;
- Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me një ndërmarrje tjetër;
- Krijimi i një ndërmarrje të re (investim në fushë të gjelbër, green field);
- Investim shtesë ose riinvestim në një projekt ekzistues.

Tendencat politike të investimeve

- Politika qeveritare për t'i lehtësuar investimet;
- Përpilimi i politikave për sektorë strategjikë;
- Rritja e numrit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

3.8 IHD-të në kontekstin e Kosovës

Janë një numër pikash si atraksione kryesore për investitorët e huaj potencialë (APIK, 2012) si:

- Monedha euro, kosto të ulëta transaksioni brenda Eurozonës;
- Krah i punës i ulët, rreth 250 euro paga mujore;
- Qasje të lirë në një treg prej 520 milionë konsumatorësh nëpërmjet regjimit të preferencave tregtare autonome të BE-së dhe marrëveshjes me CEFTA-në;

- Popullsia më e re në Evropë;
- Nivel të njohjes së gjuhëve të huaja;
- Fuqi punëtore të disponueshme, të motivuar dhe të arsimuar;
- Taksa të ulëta, shkalla e tatimit të korporatës është përgjysmuar në vitin 2009 nga 20, në 10 %;
- Norma tatimore të ulëta për të ardhurat personale (0 deri në 10 %);
- Normë TVSH-je prej 16 %;
- Kontribute të ulëta shoqërore për pagat;
- Mbështetje institucionale për IHD-të me nisje të shpejtë operacionesh;
- Sistem ligjor modern të pajtueshëm me atë të BE-së;
- Sistem të shëndetshëm bankar, sistem me dy nivele me Bankën Qendrore të Kosovës dhe tetë banka private.

3.9 Struktura e tregut të punës

Statistikat e tregut të punës të vitit 2013 tregojnë se tregu i punës në Kosovë është në gjendjen më të rëndë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në Kosovë është 40.5 %, ndërkohë që në vendet e Ballkanit Perëndimor sillet nga 43 %, në 68 % dhe 71.8 % në vendet e Bashkimit Evropian. ASK, (2014)

Tabela 3.12. Krahasimi i statistikave kyçe të punësimit mes vendeve


	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore		Raporti i punësimit ndaj popullsisë		Shkalla e papunësisë	
	Të gjithë	Femrat	Të gjithë	Femrat	Të gjithë	Femrat
Kosova	40.5	21.1	28.4	12.9	30.0	38.8
EU 28	71.8	65.6	64.1	58.5	10.5	10.5
Shqipëria	61.3	50.1	50.5	42.7	17.7	14.7
Maqedonia	63.9	50.8	44	35.3	31.2	30.5
Serbia	60.4	50.7	46.4	38.3	23.1	24.3
Mali i Zi	59	52.1	47.4	41.5	19.7	20.4
B&H	43.6	32.5	31.6	23.0	27.5	29.0

Burimi: ASK, 2014

Një pjesë e këtyre dallimeve është për faktin se Kosova ka një popullsi të re dhe shumë prej këtyre të rinjve janë ende në shkollim (dhe për rrjedhojë klasifikohen si joaktivë). Shqetësimi është se me kalimin e kohës mundësia që popullata joaktive të rritet mbetet e lartë, pasi çdo vit afërsisht 36 000 të rinj i shtohen popullsisë në moshë pune (dmth. 14-vjeçarët do të bëhen 15-vjeçarë), ndërkohë që vetëm rreth 10 000 do të hiqen nga popullsia në moshë pune (dmth. 64-vjeçarët bëhen 65-vjeçarë).

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të femrave është shumë më e ulët në Kosovë se në vendet fqinje. Vetëm 28.4 % e popullsisë në moshë pune në Kosovë janë të punësuar në krahasim me një shkallë mesatare të punësimit prej 44 % për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe 64.1 % për vendet e Bashkimit Evropian. Pas Maqedonisë, shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Shkalla e papunësisë tek femrat në Kosovë është më e larta në mesin e vendeve të Bashkimit Evropian dhe të Ballkanit Perëndimor.

Grafiku 3.11. Krahasimi i statistikave kyçe mes vendeve të EJT-së, EU-s dhe Kosovës 2012-2013



Burimi: ASK, 2014

Statistikat kyçe të Kosovës gjatë viteve 2012-2013, sipas të dhënave të AFP-së (Anketa e Fuqisë Punëtore) të vitit 2012 dhe AFP-së të vitit 2013, janë drejtpërdrejt të krahasueshme dhe tabela 3.13 përmbledh treguesit kryesorë të tregut të punës për këta dy vjet:

Tabela 3.13. Përmbledhja e tregut të punës 2012-2013

	Kosovë 2012	Kosovë 2013
Shkalla e joaktivitetit (%)	63.1	59.5
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (%)	36.9	40.51
Meshkuj	55.4	60.2
Femra	17.8	21.1
Shkalla e punësimit	25.6	28.4
Meshkuj	39.9	44
Femra	10.7	12.9
Me orar të pjesshëm (si % e të punësuarve)	11.1	11.9
Meshkuj	11.3	11.1
Femra	10.3	14.3
Me orar të përkohshëm (si % e të punësuarve)	73.0	68.8
Meshkuj	73.2	68.9
Femra	72.5	68.7
Të vetëpunësuar (si % e të punësuarve)	19.8	22.9
Meshkuj	22.7	26.0
Femra	8.3	12.8
Shkalla e papunësisë (%)	30.9	30.0
Meshkuj	28.1	26.9
Femra	40.1	38.8
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (% e grupmoshës 15-24)	55.3	55.9
Meshkuj	52.0	50.4
Femra	63.8	68.4
Papunësia afatgjatë (12+ muaj të të pa punëve)	59.8	8.9
Meshkuj	59.1	71.8
Femra	61.3	69.0

Burimi: https://ask.rks-gov.net/dmdocuments/LFS_ALB%202014.pdf

Tabela 3.13 tregon se shumica e indikatorëve të tregut të punës kanë mbetur të ngjashëm me të dy vjetëve të shkuar. Kjo nuk është e befasishme duke pasur parasysh mungesën e ndryshimeve të mëdha në ekonominë e Kosovës nga viti 2012 në vitin 2013 dhe shkallën modeste të rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe. Shkalla e papunësisë ka rënë vetëm pak, nga 30.9 %, në 30.0 %. Ndryshimi më i theksuar ka ndodhur në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, e cila është rritur nga 36.9 %, në 40.5 %. Nga viti 2012 në 2013-n popullsia në moshë pune është rritur për vetëm 2 611 persona, por numri i shënuar si ekonomikisht aktiv është rritur për rreth 45 000. Numri i personave të shënuar si të punësuar është rritur për rreth 35 000, duke rritur shkallën e punësimit (ose raportin për punësim ndaj popullsisë) për rreth tri pikë përqindjeje, nga 25.6 %, në 28.4 %. Është e mundur që rritjet e pjesëmarrjes së fuqinë punëtore dhe punësimi në vitin 2013 janë të mbivlerësuara. Këta indikatorë duket të mos jenë raportuar plotësisht në AFP-në e vitit 2012, ndërkohë që AFP-ja e vitit 2013 ka qenë më përfshirëse në kuptimin e regjistrimit të punëve të vogla, përfshirë punën familjare të papaguar. Prandaj, disa nga rritjet e dukshme në vitin 2013 me gjasë mund t'i atribuohen përmirësimit të metodologjisë së anketës. Megjithatë, ka mundësi që një pjesë e rritjes, si punësimi, ka ndodhur për shkak të rritjes së vërtetë të vendeve të punës, mbështetur nga rritja e regjistrimeve për bizneset e reja në vitin 2013.

Të dhënat e AFP-së tregojnë se një pjesë e mirë e rritjes në punësim vjen nga punësimi i cilësisë më të ulët. P.sh., përqindja e personave të punësuar me orar të pjesshëm është rritur nga 11.1 %, në 11.9 %. Pothuajse gjysma e rritjes në punësim ka ndodhur në vetëpunësim, duke rritur kështu përqindjen e personave të vetëpunësuar (si përqindje e personave të punësuar) nga 19.8 %, në 22.9 %. Përveç kësaj, përqindja e personave të punësuar në vende pune të paqëndrueshme (personat e vetëpunësuar pa punonjës dhe ata që punojnë pa pagesë në një biznes

familjar) është rritur nga 16.8 % në vitin 2012, në 23.6 % në vitin 2013. Kjo është në përputhje me atë që u theksua më lart, se një pjesë e rritjes së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe punësim mund të jetë si rezultat i regjistrimit më të mirë të punëve të vogla.

Së fundi, rritja e përgjithshme në punësim ka pasur pak ose fare ndikim në situatën e punësimit të femrave, të të rinjve, ose të papunëve për një kohë të gjatë. Pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore dhe punësimi i tyre është rritur në vitin 2013, por me një shkallë më të ngadalshme se për meshkujt. Vetëm 40 % e rritjes së punësimit ishte në mesin e femrave krahasuar me 60 % në mesin e meshkujve, duke rritur kështu diferencën gjinore në punësim. Papunësia tek të rinjtë praktikisht nuk ka ndryshuar, me një rritje të vogël nga 55.3 %, në 55.9 %. Në fakt, ka pasur rritje të shprehur në shkallën e papunësisë afatgjatë: përqindja e personave të papunë, të cilët kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj, është rritur nga 59.8 % në vitin 2012, në 68.9 % në vitin 2013.

3.10 Llogaria kapitale dhe financiare

Në kuadër të bilancit të pagesave, pjesë e rëndësishme është edhe llogaria kapitale dhe financiare. Në Kosovë ishin pikërisht flukset hyrëse në këtë llogari ato që ndikuan në mbajtjen e nivelit relativisht të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Sipas të dhënave të BQK-së, deri në shtator 2012 bilanci i llogarisë kapitale dhe financiare ishte 63.5 milionë euro. Ky nivel njëherësh paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2008. Faktorët që më së shumti ndikuan që kjo llogari të ketë rënie relativisht të lartë ishin: niveli i ulët i granteve për investime kapitale, rënia e investimeve të huaja direkte si dhe rënia e financimit nëpërmjet investimeve të tjera si dhe rritja më e shpejtë e investimeve portofoli të cilat paraqesin fluks dalës për ekonominë e Kosovës.

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë paraqesin njërën ndër komponentët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe për burime të reja financimi. Gjatë këtyre viteve ekonomia e Kosovës ka pasur nivel të kënaqshëm të fluksit hyrës të IHD-ve, të cilat mesatarisht kanë pasur një pjesëmarrje rreth 7.6 % të BPV-së. Të dhënat e paraqitura në grafik për vitin 2012 janë vetëm deri në shtator 2012. Mirëpo gjatë viteve paraprake Kosova mesatarisht ka tërhequr IHD-të në vlerë prej 370 milionë eurosh në vit (përfshirë vitin 2012). Investimet e Huaja Direkte, sipas të dhënave të BQK-së, i takojnë kryesisht formës së investimeve kapitale gjatë vitit 2012, ndërsa në bazë sektoriale IHD-të kishin ndryshime të vazhdueshme në pjesëmarrje (BQK, 2013).

Siç edhe është paraqitur, IHD-të gjatë vitit 2012 kanë shënuar rritje në sektorin e pasurive të patundshme, ndërtimit dhe prodhimit. Sektorët e tjerë ekonomikë si: sektori financiar, i transportit dhe i telekomunikacionit kanë shënuar rënie në vitet e fundit. Në kontekst të shteteve, IHD-të në Kosovë kryesisht vijnë nga vendet e Bashkimit Evropian, ndërsa në vitet e fundit është rritur pjesëmarrja e IHD-ve nga Turqia.

3.11 Kuadri ligjor dhe institucional në Kosovë

Në Kosovë kuadri ligjor në fushën ekonomike dhe financiare është i shpërndarë në disa akte ligjore, duke përfshirë:

- Ligjin për Auditim të Brendshëm
- Ligjin për Bankën Qendrore
- Ligjin për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar
- Ligjin për Borxhet Publike
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi

- Ligjin për Investimet e Huaja
- Ligjin për Tregti me Jashtë
- Ligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare etj.

Politikat tregtare, që hyjnë në kornizën e kompetencave të MTI-së, ndikojnë në bilancin e pagesave. Në anën tjetër, përgjegjës për përpilimin e statistikave të bilancit të pagesave është BQK-ja, e cila, përveç publikimit të rregullt të serive kohore mbi statistikave të bilancit të pagesave, në baza të rregullta publikon raporte me analiza për të gjithë sektorët e ekonomisë si dhe në çdo vit publikon Raportin e Bilancit të Pagesave, Tryeza tematike për ekonomi, financa dhe statistika, Prishtinë, (2013).

3.12 Format e të bërit biznes në Republikën e Kosovës

Raporti i të Bërit Biznes (TBB) është studim i Bankës Botërore që bën njehsimin e indikatorëve kyçë të të bërit biznes të një vendi. Raporti TBB shërben si një instrument monitorues i progresit dhe regresit vjetor të 185 shteteve të përfshira në raport. I publikuar që nga viti 2003, ky raport bën vlerësimin e faktorëve mikroekonomikë që ndikojnë në mjedisin e të bërit biznes në shtetet e botës. Ambienti i të bërit biznes është një nga treguesit e gjendjes ekonomike të një vendi. Procedurat e hapjes së një biznesi, regjistrimi i pronësisë, marrja e lejes së ndërtimit, zbatimi i kontratave e mbrojtja e investitorëve janë disa nga aspektet që e përcaktojnë cilësinë e ambientit të të bërit biznes. TBB-ja paraqet një mundësi të vlefshme për çdo vend për ta identifikuar trendin e lëvizjes në treguesit e ndryshëm që përfshihen në raport.

Origjina e Raportit TBB vjen nga një publikim mbi rregullat dhe procedurat në fushën e hapjes së një biznesi e që nga raporti i parë - metodologjia dhe indikatorët pësojnë ndryshime nga viti në vit. Faktorët kryesorë që vlerësohen nga TBB për secilin indikator janë numri i procedurave të nevojshme, koha, kostoja dhe mbrojtja ligjore. Kjo do të thotë se Raporti i të Bërit Biznes bazohet në aspektin rregullativ dhe përmirësimet në renditje bëhen nga reformat në kornizën ligjore të një vendi.

Për Kosovën, Banka Botërore publikoi raportin e parë TBB në vitin 2011, në të cilin Kosova u rendit në vendin e 117 në botë. Kjo renditje ishte e njëjtë edhe në raportin e vitit 2012, përderisa mesatarja e shteteve të rajonit është vendi i 77.

1. Renditja e tillë është cilësuar alarmuese për Qeverinë e Kosovës. Përmirësimi i vendit në Raportin e TBB-së është caktuar si një ndër objektivat ekonomike të vendit. Në Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës për vitet 2011-2014, i njohur edhe si “Plani i Banksos”, parashihet që me reformat e ndërmarra Kosova të renditet në top 40 shtetet reformuese në Raportin e të Bërit Biznes deri në vitin 2014, edhe pse një kategori e tillë ekziston në raport.
2. Ky plan i veprimit, i cili parasheh aktivitete për zhvillimin ekonomik të Kosovës deri në vitin 2014, në masë të madhe cilëson përmirësimin në treguesit e raportit TBB si indikator të suksesit për aktivitete të parapara, Banka Botërore, (2011).

Një ndër karakteristikat e raportit TBB është nxitja e reformave rregullative në ekonominë botërore që janë në zhvillim. Vetë Banka Botërore e cilëson këtë raport si shtysë të nevojshme për fillimin e reformave në sferën e të bërit biznes. Historikisht, shtetet në zhvillim kanë fokusuar politikat e tyre në përmirësimin e treguesve të këtij raporti.

Gjeorgjia dhe Maqedonia janë dy shtetet të cilat merren shembuj për përmirësimin e renditjes në raportin e TBB-së brenda një kohe të shkurtër. Këto dy shtete u kanë dhënë prioritet politikave të ndërlidhura me raportin TBB, që ka rezultuar në renditjen e tyre në top 10-she, respektivisht top 30 shteteve në botë në këtë raport. Sidoqoftë, përmirësimi i renditjes në TBB nuk ka pasur rezultate pozitive në zhvillimin e këtyre vendeve. Implementimi i politikave me fokus jo vetëm të kufizuar, por edhe të varur nga një raport si ky i TBB-së, ka rezultuar në mungesë të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik dhe tërheqjes efektive të investimeve të huaja. ZKM, (2011)

Ky punim synon t'i analizojë rëndësinë dhe ndikimin e Raportit të të Bërit Biznes në politikat e Qeverisë së Kosovës drejt përmirësimit të ambientit biznesor. Për më tepër, studimi i përfshinë edhe përvojat e qasjen e shteteve të tjera që e bazuan politikbërjen e tyre në TBB.

INDEP po ashtu tenton të prezantojë një pasqyrë më të qartë të fushave të tjera ekonomike që duhen marrë parasysh në përpilimin e politikave për zhvillim ekonomik. Për më tepër, në këtë analizë konsiderohen raportet e tjera me interes në zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investitorëve. Pasi Kosova po e përdor TBB-në si një njehsues rreth suksesit në përmirësimin e gjendjes së të bërit biznes, analiza gjithashtu është fokusuar në suksesin e TBB-së si një vlerësim i ambientit të ndërmarrësisë së një shteti.

Duke përdorur metoda hulumtuese kualitative dhe analiza të të dhënave, ky punim do ta qartësojë fokusin e ngushtë të raportit TBB. Prizmi i limituar i TBB-së rrjedhimisht rezulton në politika që kanë për qëllim përmirësimin e renditjes në këtë raport e jo zhvillimit ekonomik. Fokus i veçantë u është kushtuar indikatorëve të cilët edhe vetë Qeveria e Kosovës i ka vënë si prioritet për përmirësim. Në anën tjetër, INDEP ka llogaritur korrelacionin mes renditjes në raportin e TBB-së dhe Investimeve të Huaja Direkte (IHD) për ta analizuar ndikimin e renditjes

në këtë raport për tërheqjen e investimeve. INDEP gjithashtu ka përdorur dhe analizuar katër raportet e tjera kryesore në përcaktimin e gjendjes ekonomike në një shtet. Analiza e këtyre raporteve shërben për t'i identifikuar çështjet e rëndësishme ekonomike që duhen adresuar për ta përmirësuar fillimisht stabilitetin ekonomik në Kosovë dhe imazhin e ekonomisë kosovare.

Fokusi i kufizuar i politikave ekonomike të një shteti në përmirësimin e suksesit në indikatorët e një raporti, që edhe vetë është i mangët, rezulton për shkak të mungesës zhvillimit ekonomik. Hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore ka nevojë për përfshirje të një numri më të madh të faktorëve që ndikojnë në zhvillim dhe qëndrueshmëri ekonomike të një vendi. Politikat zhvillimore të një vendi duhet të jenë të bazuara në zhvillim dhe qëndrueshmëri ekonomike sipas analizave shkencore, e jo për të konkurruar për një rangim apo tjetrin, Dobranja, D. dhe Canhasi, D. me kontribut të Bodnarova, B. (2011).

Ndikimi i Raportit të të Bërit Biznes

Renditja e vendit në raportin e TBB-së çdo ditë e më shumë po ndikon në politikëbërjen e këtyre vendeve, posaçërisht atyre në tranzicion. Ekziston një keqinterpretim nga politikbërësit e shumë vendeve në tranzicion, i cili dikton që, nëse politikat publike fokusohen në përmirësimin e renditjes në raport, do ta përmirësojnë edhe mjedisin për zhvillimin e biznesit dhe të sektorit privat në përgjithësi.

Politikbërësit mendojnë se raporti shërben si udhëzues për investitorët potencialë dhe sa më pozitiv të jetë ai, aq më shumë ka gjasa për rritjen e investimeve të huaja. Sipas Grupit të Vlerësimit të Pavarur (IEG), 85 % e politikbërësve e marrin parasysh radhitjen e shtetit të tyre në raportin e të bërit biznes si shtysë për reforma, mirëpo shumica e tyre nuk e cilësojnë si

udhërrëfyes për të vepruar. Nga kjo shihet se ndikimi i Raportit të të Bërit Biznes është shumë më i madh në politikbërësit e një vendi sesa në investitorët potencialë.

Sipas Raportit të të Bërit Biznes 2013-2014 (raporti përmbledhë treguesit dhe rendit ekonomitë e 189 të vendeve të botës në lehtësitë e të bërit biznes), Kosova renditet në vendin e 81-të, përkatësisht 75-të. Pra, në vitin 2014 ka ngritje për gjashtë vende (nga 81, në 75).


Tabela 3.14. Renditja e Kosovës në lehtësirat e të bërit biznes 2013-2014

	DB 2014 Renditja	DB 2013 Renditja	në renditje
Kosova	75	81	6
Fillimi i biznesit	42	100	58
Pajisja me licencë për ndërtim	135	148	13
Furnizimi me energji elektrike	112	105	-7
Regjistrimi i pronës	34	35	1
Marrja e kredive	23	19	-4
Mbrojtja e investitorëve	62	61	-1
Pagesa e taksave	63	58	-5
Tregtia ndërkufitare	118	117	-1
Zbatimi i kontratave	138	143	5
Zgjidhja e paafëtisë pague	164	166	2

Burimi: <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/Kosovo-dhe-llogaritje-te-autorit>

Grafiku 3.12 Raporti i BEEPS 2010 për Kosovën tregon dhjetë grupe të pengesave ndaj të bërit biznes

Pengesat kryesore të raportuara nga firmat për bërje të biznesit të shprehura në %



Burimi: Beeps (2010)

Problem kryesor, me përqindje prej 30 %, paraqitet furnizimi me energji elektrike, korrupsioni në nivel të lartë me rreth 28 %, konkurrenca joformale me 22 %, krimi dhe vjedhja me 21 %, jostabiliteti politik me 20 % e kështu me radhë. Ky trend vazhdon edhe gjatë viteve në vijim, vetëm se faktorë problematikë kanë ndryshuar në pozicionim. P.sh., energjia është përmirësuar, korrupsioni është rritur, po ashtu edhe konkurrenca jolojale dhe stabiliteti politik dhe gjyqësori janë në nivelin më të lartë sipas raporteve të ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

3.13 Ndikimi i TBB-së në investime, praktika nga vendet e tjera

Një ndër forcat shtytëse për përmirësimin e renditjes në Raportin e të Bërit Biznes është tërheqja e investimeve të huaja direkte. Në ekonominë në tranzicion si Kosova, Investimet e Huaja Direkte janë të rëndësishme për përparimin e ekonomisë dhe stabilizimin e saj. Qeveria e Kosovës, posaçërisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duhet punuar në drejtim të përmirësimit

të renditjes së Kosovës në këtë raport. Megjithatë, siç është përmendur më lart, përmirësimi i renditjes nuk do të thotë se do të ketë rritje të IHD-ve. Në vitet e fundit të treguesve të TBB-së, në Evropën Lindore ka pasur dy shtete që janë përkushtuar në masë më të madhe në reforma për përmirësimin e renditjes, Maqedonia dhe Gjeorgjia. Të dy këto shtete kanë qenë ndër reformuesit kryesorë dhe kanë arritur që brenda një kohe të shkurtër ta përmirësojnë renditjen e tyre në këtë raport. Sot Gjeorgjia qëndron në vendin e nëntë, ndërsa Maqedonia në vendin e 23-të. Sidoqoftë, Investimet e Huaja Direkte jo vetëm se nuk kanë rritur proporcionalisht përmirësimin e renditjes në raportin e të bërit biznes, por ka pasur raste kur ato edhe kanë pësuar rënie.






Ekonomitë renditen në lehtësimin e tyre të të bërit biznes nga 1-189. Lehtësia e lartë e rangut të të bërit biznes do të thotë mjedis rregullator dhe që është më e favorshme për fillimin dhe operimin e një firme lokale. Renditjet janë të përcaktuara nga zgjidhja e distancës agregate në pikët kufitare në 10 tema, secila e përbërë nga disa tregues, duke i dhënë peshë të barabartë për çdo temë. Renditjet për ekonomitë krahasohen deri në qershor 2014.

Tabela 3.15. Renditja e ekonomive të të bërit biznes për vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2013

	Renditja e lehtësirave të të bërit biznes 2013-2014	Fillimi i biznesit	Pajisja me licencë për ndërtim	Furnizimi me energji elektrike	Regjistrimi i pronës	Marrja e kredive	Mbrojtja e investitorëve	Pagesa e taksave	Tregtia ndërkufitare	Zbatimi i kontratave	Zgjidhja e paafëtisë paguese
Kosova	75	42	135	112	34	23	62	63	118	138	164
Shqipëria	68	41	157	152	118	36	7	131	95	102	44
Maqedoni	30	3	89	88	74	36	21	7	85	87	35
Kroacia	65	88	178	59	92	61	62	36	86	54	56
Mali i Zi	36	56	138	63	87	4	43	98	52	136	33
B&H	107	147	182	163	88	36	83	151	104	95	34
Serbia	91	66	186	84	72	52	32	165	96	96	48

Burimi: <http://www.doingbusiness.org/rankings>

Faktorët problematikë të të bërit biznes në vendet e EJT-së



Burimi: <http://www.doingbusiness.org/rankings> dhe përpunimi i autorit 2015

Sipas renditjes, para Kosovës qëndrojnë Maqedonia në vendin e 30, Mali i Zi në vendin e 36, Kroacia në vendin e 65-të dhe Shqipëria në vendin e 68. Ndërkaq, për fillimin e një biznesi

Kosova gjendet para Kroacisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Kosova qëndron në pozitë më të mirë me “regjistrimin e pronës”, në vendin e 34-të, me “marrje të kredive” në vendin e 23-të, ndërsa ka pozitë mesatare për “mbrojtjen e investimeve”, në vendin e 62-të dhe pagesën e taksave në vendin e 63-të. Por, më së keqi qëndron me “tregtinë ndërkufitare”, në vendin 118. Për zbatimin e kontratave zë vendin e 138, kurse për “zgjidhjen e paaftësisë paguese” vendin e 164-t.

3.14 Ambienti afarist si faktor në investime

Për investitorë të huaj ambienti afarist në një vend është faktori vendimtar për të investuar. Edhe pse në letër, si në aspektin legjislativ ashtu edhe në procedurat e të bërit biznes të prezantuara nga institucionet shtetërore dhe agjencitë shtetërore për promovimin e investimeve të huaja, duket se në Kosovë ekziston një ambient i përshtatshëm afarist. Në realitet ky ambient lë për të dëshiruar. Në fakt, statistikatat tregojnë se mbi 90 % e ndërmarrjeve në Kosovë i takojnë madhësisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kjo le të kuptohet se ambienti aktual afarist është i përshtatshëm për ndërmarrje të vogla dhe nënkupton se edhe vëllimi i investimeve është i tillë.

Bilanci tregtar i Kosovës tregon një pasqyrë të këtij ambienti afarist. Me më shumë se 90 % import dhe me më pak se 10 % eksport, është e qartë se vendi karakterizohet shumë më shumë me konsum sesa me prodhim dhe se sektori i tregtisë është dukshëm më aktiv në raport me sektorët e tjerë.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2013 tregojnë se Bilanci Tregtar i Kosovës ka rënie në krahasim me vitin 2012. Në vitin 2013 importet e Kosovës ishin 2 449 064 milionë €, kurse në të njëjtën periudhë të vitit 2012 importet e Kosovës ishin 2 507 609 milionë

€. Pra, bilanci tregtar i Kosovës në vitin 2013 ishte -2 155 221 mil. euro, kurse në vitin 2012 -2 234 509 (shih tabelën 3.2.).

Sipas të dhënave nga ASK-ja për eksport, 59.9 % e përbëjnë metalet bazë, 7.9 % produktet minerale, 6.8 % plastika dhe goma, 6.4 % ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 5.1 % tekstili, 3.9 % makineritë dhe pajisjet elektrike, 3.5 % produktet bimore. Ndërsa importet, 18.5 % i përbëjnë produktet minerale, 12 % ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 10.4 % metalet bazë, 10.2 % makineritë, 10.1 % produktet e industrisë kimike, 6.3 % plastika dhe goma, 6 % produktet bimore. I tëri ky aktivitet afarist zhvillohet në shkëmbimet tregtare në mes të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Roli dhe zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në Kosovë

NVM-të përbëjnë bazën e ekonomisë së Kosovës. Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në fund të 2011-s NVM-të (përfshirë ndërmarrjet mikro) përbënin rreth 99.97 % të të gjitha bizneseve që veprojnë në vend. Nga viti 2007 deri në vitin 2011 numri i NVM-ve është rritur me një normë prej rreth 20 % çdo vit, ndërsa rritja e përgjithshme gjatë këtyre pesë vjetëve ishte rreth 35 %, por nuk ka të dhëna në dispozicion mbi numrin e NVM-ve që janë mbyllur dhe kanë bankrotuar. Nga ana tjetër, të dhënat e ARBK-së tregojnë se nga fundi i vitit 2011 NVM-të kanë marrë pjesë në punësim me gjithsej 232 411 të punësuar, ose rreth 63 % të numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në ndërmarrje, por ende nuk ka të dhëna në dispozicion në lidhje me numrin e njerëzve të punësuar nga NVM-të çdo vit.

Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, më shumë se 90 % të ndërmarrjeve punësojnë më pak se katër persona. Për më tepër, vlerësohet se të gjitha ndërmarrjet kanë gjeneruar 47.6 % të

shumës së përgjithshme të eksportit të vendit në vitin 2011. Dhe sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës të vitit 2010, NVM-të kanë marrë pjesë me 43.3 % në PBB të vendit. Në anën tjetër, marrë parasysh numrin e personave që hyjnë rishtazi në tregun e punës çdo vit, Kosova ka nevojë për rritje ekonomike prej 7 %.

Një krahasim bazë i të dhënave të ofruara në fund të vitit 2011 me ato të ofruara në shtator të vitit 2012 tregon se nuk kishte pothuajse asnjë ndryshim në numrin e të punësuarve nga NVM-të (një rritje për vetëm gjashtë të punësuar), ndërsa numri i njerëzve të punësuar nga ndërmarrjet e mëdha duket se kanë rënë për 81 438 (nga 137 096, në 55 658). Në terma relativë, në fund të vitit 2011 NVM-të kanë punësuar rreth 63 % të të gjithë të punësuarve në të gjitha ndërmarrjet (me gjithë pjesën tjetër të personave të punësuar në ndërmarrjet e mëdha), ndërsa në shtator të vitit 2012 pjesa e të punësuarve në NVM u rrit në 81 % (nga të cilët, pjesa tjetër prej 19 % ishin të punësuar në ndërmarrjet e mëdha).

Së pari, duke pasur parasysh shtrirjen e sektorit të NVM-ve në ekonominë e vendit, Qeveria e Kosovës pranon rëndësinë e NVM-ve për zhvillimin ekonomik të vendit. Megjithatë, një numër i sfidave duhet të adresohen. Procesi dhe metodologjia e mbledhjes dhe e përpunimit të të dhënave e përdorur nga ARBK-ja është e standardizuar dhe e rregulluar.

Së dyti, kjo metodologji duhet të harmonizohet me ato që përdoren nga institucionet e tjera relevante (siç janë Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale etj.) në mënyrë që të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara të jenë të krahasueshme. Kjo do të mundësonte interpretim të unifikuar të trendëve të zhvillimit të NVM-ve dhe kontributit të tyre në punësim, PBB, eksport dhe import, buxhetin e shtetit si dhe në zhvillimin ekonomik në përgjithësi (përfshirë aspekte të ndryshme që ndërlidhen me investime të huaja direkte).

Së treti, i gjithë procesi dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit të tyre duhet të jetë më transparente, pasi kjo është themelore për vlerësim të pavarur të të gjitha aspekteve të tilla të zhvillimit të NVM-ve, ndërsa koha e publikimit të tyre të jetë e standardizuar.

Së katërti, ky proces duhet të përmirësohet ndjeshëm në aspektin e cilësisë (përfshirë aspektet e arsimit dhe kualifikimit profesional), me synimin për të mundësuar një krahasim të lehtë mes sektorëve të ndryshëm të aktivitetit të NVM-ve. Kjo do ta mundësonte identifikimin më të lehtë të avantazheve krahasuese të sektorëve të biznesit dhe përdorimin më të mirë të të dhënave të tilla kualitative për zhvillimin e politikave dhe instrumenteve për mbështetjen e NVM-ve dhe zhvillimin e sektorit privat.

Për më tepër, i gjithë sistemi i mbledhjes së të dhënave duhet të mundësojë një analizë më të saktë dhe më objektive të madhësisë së ekonomisë gri, gjë që, nga ana tjetër, është faktor kyç për luftimin në mënyrë efektive të ekonomisë joformale. Kjo për shkak se, sipas BE-së, ekonomia joformale në Kosovë konsiderohet të jetë e madhe dhe ushqehet nga dobësitë në sistemin tatimor, politikat e shpenzimeve dhe në zbatimin e ligjit, përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe, si e tillë, e zvogëlon bazën tatimore dhe efikasitetin e politikave ekonomike.

Përfundimisht, adresimi i mangësive të tilla do të kontribuonte në krijimin e kushteve të qëndrueshme, transparente dhe të parashikueshme për investitorët e huaj. Kjo do të çonte në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga procesi i integritetit në BE. Përveç përmirësimit të mjedisit rregullativ dhe të infrastrukturës dhe një rritjeje të përdorimit të politikave të kërkimeve dhe inovacionit, përpjekjet në një nivel “mikro” duhet të fokusohen në përmirësimin e aftësive menaxheriale të ndërmarrjeve. Më gjerësisht, sipas vlerësimit më të fundit të BE-së, mungesa e

të dhënave të përditësuara mbi çështjet që kanë të bëjnë me NVM-të paraqet pengesë për NVM-të ekzistuese, ndërsa mbështetja për biznese fillestare është veçanërisht e pazhvilluar.

Nga ana tjetër, vështirësitë në lidhje me zbatimin ligjor të kontratave e furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike janë pengesa serioze për NVM-të dhe zhvillimin e sektorit privat. Në këtë drejtim, Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK) është përgjegjëse për mbështetjen e investimeve të huaja në Kosovë (përfshirë promovimin e eksporteve). Për këtë qëllim, kjo Agjenci ofron një gamë të gjerë të programeve mbështetëse.

3.15 Ligji mbi Investimet e Huaja nr. 2013/04-L-220

e ngarkon APIK-un me përgjegjësitë në vijim:

- Dhënie ndihmë investitorëve të huaj për t'i njoftuar ata me të drejtat, garancitë dhe privilegjet e parapara me këtë ligj në lidhje me krijimin, implementimin, veprimin dhe likuidimin e ndonjë investimi në Kosovë
- Ofrim të këshillave publike në lidhje me obligimet dhe çështjet e tjera të ndërlidhura me investimet e jashtme
- Pranimin, në emër të Kosovës, të pëlqimeve të investitorëve të huaj për arbitrazh
- Dhënie të rekomandimeve institucioneve në lidhje me politikat, me qëllim të promovimit të krijimit të një klime të përshtatshme për investime në vend
- Përmirësim të imazhit të Kosovës si një vend atraktiv për investime (përmes fushatave të marketingut dhe aktiviteteve të ndryshme që ndërlidhen me marrëdhëniet me publikun, siç janë, p.sh.: ekspozitat, forumet e investitorëve dhe seminarët) dhe ofrim të informatave dhe bashkëpunim me mediet publike

- Ofrim të mbështetjes iniciativave që synojnë përmirësimin e kualitetit dhe klimës për investime siç janë: hulumtimet e tregut, studimet dhe hulumtimet e fizibilitetit dhe pjesëmarrja në grupe punuese qeveritare dhe joqeveritare si dhe në task force relevante
- Ofrim të informatave dhe udhëzimeve me qëllim të lehtësimit të marrjes së vendimeve në fushën e investimeve, krijim të bizneseve dhe kontratave afariste dhe
- Promovim të eksporteve të Kosovës, pos të tjerash, përmes hulumtimeve dhe identifikimit të mundësive për eksport, reklamimit të produkteve vendore, sigurimit të asistencës teknike ndaj organizatave të eksportit, si dhe përmes mbledhjes, procesimit dhe shpërndarjes së të dhënave që ndërlidhen me eksportin brenda dhe jashtë Kosovës.

Liberalizimi i tregtisë së jashtme në Kosovë ka rritur konkurrencën nga jashtë të ndërmarrjeve vendëse. Çrregullimet e tregut u krijuan për shkak të raporteve fiskale asimetrike me vendet fqinje që u reflektuan negativisht në aftësinë konkurruese të Kosovës si në tregun e jashtëm ashtu edhe në atë vendës. Statusi i Kosovës krijon vështirësi për krijimin e një rrethine për mbështetjen e IHD-ve. Për shkak të kësaj çështje, nuk mund të nënshkruhen marrëveshje bilaterale me disa vende dhe institucione ndërkombëtare financiare dhe jofinanciare.

Sistemi modern fiskal dhe i tatimeve është duke u përshtatur. Megjithatë, vërejtjet kryesore të ndërmarrjeve janë drejtuar kundër tarifave dhe TVSH-së për mallrat prodhuese, që janë bërë pengesë për shpejtimin e investimeve. Evazioni fiskal është pengesë për politikën moderne të tatimeve dhe konkurrencën lojale.

Një pjesë e konsiderueshme e ligjeve komerciale të aprovuara dhe Ligji mbi Investimet e Huaja i plotësojnë standardet e ekonomisë së tregut. Mirëpo, paketa e ligjeve tregtare dhe ligjeve të tjera ende nuk është kompletuar dhe, për pasojë, nuk janë implementuar. Prandaj, mungesa e

efekteve sinergjike ende nuk është duke i vërejtur sa duhet përparësitë e sistemit ligjor të Kosovës.

Në promovimin e IHD-ve janë të angazhuar disa aktorë: Qeveria, Oda Ekonomike e Kosovës, USAID-KBS, Euro Info Qendra, Swisscontact dhe zyrat përfaqësuese të shteteve të huaja. Por, aktualisht mungon koordinimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm, mungon organizimi për koordinim dhe strategjia e promovimit. Është e nevojshme të adresohet kjo situatë në të ardhmen e afërt krahas promovimit të përparësive që i ka Kosova dhe krijimi i një imazhi të mirë për Kosovën. Duhet të nisë një fushatë institucionale për t'i theksuar përparësitë e Kosovës në krahasim me destinacionet alternative në Ballkan dhe Evropën Qendrore siç janë:

- Pozita qendrore gjeografike
- Disponimi me pasuri natyrore me çmime konkurruese
- Territori në brendësi të Evropës
- Lidhjet me shumë vende të Evropës dhe SHBA-ve nëpërmjet diasporës
- Popullsia e re dhe relativisht e arsimuar
- Motivimi i fuqisë punëtore
- Fuqia e lirë punëtore
- Aftësitë e mira teknike
- Niveli i ulët i tatimeve të brendshme
- Valuta stabile (euro) dhe inflacioni i ulët
- Eksporti i liruar nga TVSH-ja dhe tarifatat doganore.

Duke pasur parasysh këto fakte, është e qartë se Kosova ballafaqohet me burime të reduktura për financimin e investimeve, në kushtet kur domosdo përballet me presionin dhe nevojën

urgjente për ta zgjidhur problemin e papunësisë (norma e vlerësuar e papunësisë 45-50 %) dhe përmirësuar infrastrukturën publike.

Aktiviteti investues i bizneseve private në periudhën e pasluftës ka gjeneruar rritje të konsiderueshme ekonomike dhe të punësimit, por tani vërehen shenja të recesionit në kuptim të rënies së vëllimit të qarkullimit mesatar për një ndërmarrje dhe rritje të punësimit. Në këto kushte, krijuesit e politikave ekonomike sfidohen me nevojën e nxitjes së investimeve të reja. Prandaj, krijimi i një ambienti miqësor afarist dhe ambientit adekuat institucional për tërheqjen e IHD-ve imponohet si një nga prioritetet më të rëndësishme të politikave ekonomike dhe reformës ekonomike. Është e kuptueshme se vetëm IHD-ve nuk mund t'i shpejtojnë aktivitetet më se të domosdoshme investuese. Synimi duhet të jetë që ato të bëhen një burim i rëndësishëm dhe komplementar me burimet e tjera të financimit.

Përvoja e zhvillimit ekonomik në dekadat e fundit, sidomos kur është fjala për vendet në zhvillim, ka vënë në pah se IHD-të konsiderohen të rëndësishme për shkak të efekteve të tyre të shumanshme pozitive. Është konstatuar një lidhje pozitive midis IHD-ve dhe rritjes së GDP-së (Bruto Produktit të Vendit), në sajë të rritjes së mundësive eksportuese dhe efekteve stimuluese në bizneset lokale dhe përmirësim të konkurrencës.

IHD-të sigurojnë efekte më të mira për zhvillim të qëndrueshëm sesa huat në formë të kredive për shkak të përfshirjes direkt të investuesit në menaxhment dhe reduktimit të ngarkesës me borxhe, nxitjes së zhvillimit social dhe zhvillimit të kapitalit human në saje të transferit teknologjik, dijeve të reja dhe trajnimit, efekteve pozitive në buxhet, rritjes së të ardhurave buxhetore që vijnë si rezultat i rritjes së taksave dhe zvogëlimit të nevojës së subvencioneve për shërbimet publike. Është e qartë se për të gjitha këto arsye në Kosovë nevojitet një politikë aktive që do ta përmirësonte promovimin e mundësive të bashkëpunimit me investitorët e

jashtëm, rritjen e aftësive konkurruese në tregun e IHD-ve dhe rritjen e aftësive absorbuese për partneritet dhe investime të përbashkëta.

Hulumtimet kanë provuar ekzistencën e shumë pengesave institucionale dhe administrative për një klimë të favorshme investuese. Për ta identifikuar intensitetin e pengesave të veçanta nga aspekti i investorëve të jashtëm në anketën e përmendur me ndërmarrje, të anketuarit është dashur ta përcaktojnë intensitetin në listën e pengesave. Është e qartë se një mori e pengesave të karakterit të përgjithshëm ka ndikim më specifik në gatishmërinë e investorëve potencialë të huaj që një pjesë të kapitalit të vet ta orientojnë në projekte prodhuese dhe produktive në Kosovë. Është i pranishëm një rangim tjetër i pengesave në krahasim me rezultatet e anketimit të ndërmarrjeve të tjera private të vendit. Kështu, në anketën e ndërmarrjeve si pengesë numër një është identifikuar mungesa e ligjeve dhe konkurrenca jolojale. Në rastin e ndërmarrjeve të formuara me investime të huaja në vend të parë janë identifikuar korrupsioni dhe mungesa e garantimit të investimeve.

3.16 Indikatorët e përgjithshëm që duhet të merren në konsideratë për IHD-të

Në këtë studim kemi identifikuar disa faktorë të rëndësishëm që, sipas hulumtimit të bërë, janë identifikuar si faktorë shumë të rëndësishëm për bizneset e huaja, që potencialisht mund të bëjnë investime direkte në Kosovë. Këta faktorë kanë të bëjnë me stabilitetin politik, stabilitetin ekonomik, legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Investimet e Huaja Direkte si: qartësia e legjislacionit, Ligji mbi mbrojtjen e investorëve të huaj, atraktiviteti i legjislacionit për investime dhe mbrojtja e investorëve nga ligji aktual, atraktiviteti i legjislacionit për investime, procedurat për regjistrimin e bizneseve dhe marrjen e licencave, legjislacioni tatimor dhe doganor, Ligji i punës dhe ekzistenca e fuqisë punëtore të kualifikuar, baza normative dhe ligjore

që ka të bëjë me investimet e huaja, sektorët atraktivë për investitorë dhe disa faktorë të tjerë mund të jenë të rëndësishëm për disa investitorë në sektorë specifikë.

Përveç faktorëve të përmendur më lart (faktorët ekonomikë, politikë, legjislativë, teknologjikë etj.), për atraktivitetin e një ambienti biznesi, në rastin tonë atë të Kosovës, duhet dhënë një pasqyrë mbi faktorët e përgjithshëm determinues që ndikojnë në një mjedis afarist të të bërit biznes: korrupsioni, konkurrenca, liria ekonomike dhe perceptimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare. Përveç statistikave që tregojnë se renditja pozitive në TBB nuk garanton tërheqje të investimeve, një krahasim i investimeve të huaja direkte në Kosovë dhe në Maqedoni, duke pasur parasysh edhe renditjen e këtyre dy vendeve në TBB, mund të na japë një pamje më të qartë.

Tabela 3.16. Krahasimi TBB - IHD, Kosovë, *Banka Botërore, tetor 2011*

KOSOVA							
TBB				IHD (USD)			
2006	N/A			2006	369,808,407.38		
2007	N/A			2007	603,224,093.07	1.63118	63%
2008	N/A			2008	536,790,831.64	0.88987	-11%
2009	107*			2009	408,068,782.77	0.760201	-24%
2010	113*	0.946903	-5%	2010	457,269,392.08	1.120569	12%
2011	117	0.965812	-3%	2011	546,217,228.95	1.19452	19%
2012	117	1	0%	2012			

Burimi: Politikëbërja e limituar e të bërit biznes (f. 14)

Në raportet e të bërit biznes të viteve 2010 dhe 2011 renditja e Kosovës në vitin paraprak përfshihet në tabelë të vitit 2010, respektivisht të vitit 2011 dhe shërben si krahasim.

Tabela 3.17. Krahasimi TBB - IHD, Maqedoni

MAQEDONIA							
TBB				IHD (USD)			
2006	94			2006	424,155,269.27		
2007	92	1.02	2%	2007	699,092,642.00	1.65	65%
2008	75	1.23	23%	2008	586,953,718.61	0.84	-16%
2009	71	1.06	6%	2009	197,089,613.49	0.34	-66%
2010	32	2.22	122%	2010	207,463,067.12	1.05	5%
2011	38	0.84	-16%	2011	409,958,903.23	1.98	98%
2012	22	1.73	73%	2012			

Burimi: Politikëbërja e limituar e të bërit biznes (f. 13)

Nëse i krahasojmë IHD-të me renditjen në TBB në mes të Kosovës dhe Maqedonisë shohim se në vitin 2010 Kosova kishte 220 % të IHD-ve të totalit të Maqedonisë, duke qenë në vendin e 113, ndërsa Maqedonia në vendin e 32-të. Në vitin 2011 Kosova ishte në vendin e 117, Maqedonia në vendin e 38, ndërsa Kosova këtë vit mori 133 % të investimeve totale që i mori Maqedonia. Kjo shpjegohet se, edhe nëse ka përmirësime në renditjen e një vendi në Raportin e të Bërit Biznes, korrelacioni i investimeve të huaja direkte me këtë renditje nuk është aq i lartë. Kjo na lë të kuptojmë se, edhe po t'i lëmë anash të gjitha mangësitë e raportit, përfshirë këtu edhe mungesën e adresimit të shumë faktorëve të rëndësishëm ekonomikë, ky raport nuk mund të përdoret si forcë kryesore nxitëse për politikëbërje në një shtet.

Hartimi i planeve të zhvillimit ekonomik nga qeveria duhet të përfshijë një spektër të gjerë të indikatorëve të cilët mbulojnë pjesën më të madhe të sektorëve në një vend. Një platformë e tillë e politikave publike që adreson numër të madh të çështjeve garanton stimulimin e zhvillimit ekonomik. Në anën tjetër, investitorët potencialë i bazojnë vendimet e tyre në indikatorë dhe analiza sa më gjithëpërfshirëse. Fokusi i politikëbërjes në një raport të vetëm

ndikon negativisht jo vetëm në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, por edhe në tërheqjen e investimeve të huaja. Banka Botërore, (2011).

Raportet ekonomike në vazhdim përfshijnë një tërësi treguesish ekonomike që ndikojnë në perceptimin e investitorëve potencialë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të një vendi. Banka Botërore, (2012).

Raporti i Bankës Botërore për lehtësirat e të bërit biznes fokusohet në masë të madhe në rregulloret dhe kornizat legjislative që rregullojnë secilin nga indikatorët e matur në këtë raport. Kosova deri më tani ka shfaqur gatishmëri të madhe për amendamentimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për t'i harmonizuar ato me direktivat evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Sidoqoftë, problemi madhor i Kosovës nuk është mungesa e ligjeve të përditësuara me legjislacionin ndërkombëtar, por zbatimi i tyre në praktikë. Si rezultat, përmirësimi i Kosovës në renditjen e Raportit të të Bërit Biznes është drejtpërdrejt i ndërlidhur me përmbajtjen e ligjeve dhe atë se çka ato tentojnë të rregullojnë, e jo me zbatimin e tyre. Kjo do të thotë se përmirësimi i renditjes në raportin TBB nuk paraqet pasqyrë të qartë të zhvillimeve reale në vend.

3.17 Indeksi i perceptimit të korrupsionit

Transparency International publikon çdo vit indeksin e perceptimit të korrupsionit për 183 shtete në botë, përfshirë këtu edhe Kosovën. Ky indeks e mat perceptimin për nivelin e korrupsionit të sektorit publik në një shtet dhe i radhit shtetet bazuar në indeksin prej 0 deri në 10, ku 0 do të thotë se një shtet perceptohet të ketë nivel shumë të lartë të korrupsionit, ndërsa 10 do të thotë se shteti perceptohet pa korrupsion. Renditja e një shteti në këtë listë tregon

pozicionin e atij shteti në krahasim me shtetet e tjera të përfshira në këtë listë. Në këtë raport, Kosova gjendet në vendin 112, me indeks 2.9.

Kosova radhitet si shteti me perceptimin më të lartë të korrupsionit në rajon. Mali i Zi ka indeksin më pozitiv, prej 4.0 dhe radhitet në vendin e 66. Atë e pasojnë Maqedonia me indeks 3.9 në vendin e 69, Serbia me indeks 3.3 në vendin e 86, Bosnja dhe Hercegovina me indeks 3.2 në vendin e 91-të dhe Shqipëria me indeks 3.1 në vendin e 95-të. Kosova në raportin e perceptimit të korrupsionit ndodhet në pjesën e poshtme të renditjes, duke mbetur në 40 %-shin e fundit të shteteve. Për investitorët potencialë, indeksi i lartë i perceptimit të korrupsionit paraqet jo vetëm nivel të lartë të mosbesimit të shoqërisë në strukturat shtetërore dhe publike të vendit, por edhe rrezik për vështirësi shtesë në operimin e biznesit.

Transparency International çdo vit mat indeksin e perceptimit të korrupsionit në 175 vende të botës.


Sipas raportit të vitit 2014, indeksi i perceptimit të korrupsionit në Kosovë dhe vendet e rajonit është paraqitur në tabelën 3.18.

Vendet	Renditja 2014 nga 1-175	Pikët 1/100
Maqedonia	64	45
Mali i Zi	76	42
Serbia	78	41
Shqipëria	110	33
Kosova	111	33
B&H	N/A	N/A

Burimi: <http://www.transparency.org/country#> dhe përpunimi i autorit

Sipas raportit, shihet se Maqedonia është renditur 65/175 me 45/100 pikë dhe është më mirë se vendet e tjera të rajonit. Pastaj renditet Mali i Zi 76/175 me 42/100 pikë. Pas Malit të Zi është renditur Serbia në vendin 78/175 me 41/100 pikë, kurse Shqipëria dhe Kosova renditen keq në raport, përkatësisht në vendin 110 dhe 111/175 me 33/100 pikë.

Grafiku 3.13. Indeksi i perceptimit të korrupsionit



Burimi: <http://www.transparency.org/country> dhe përpunimi i autorit

Edhe pse ky indeks është vetëm perceptim, megjithatë është një faktor negativ për Investimet e Huaja Direkte. Kosova duhet ta përmirësojë këtë perceptim dhe ta luftojë korrupsionin në të gjitha nivelet.

3.18 Raporti global i konkurrencës

Ky raport publikohet nga Forumi Ekonomik Botëror (FEB) dhe mat nivelin e konkurrencës në një vend bazuar në 12 shtyllat në vijim: institucionet, infrastruktura, mjedisi makroekonomik, shëndeti dhe arsimit fillor, arsimit i lartë dhe trajnimi, eficientia e tregut të mallrave, eficientia e tregut të punës, zhvillimi i tregut financiar, gatishmëria teknologjike, madhësia e tregut, sofistikimi i biznesit dhe risitë teknologjike. Këto 12 shtylla ndahen në tri kategori. Katër shtyllat e para e plotësojnë kategorinë e parë të kërkesave themelore që janë kyçe për ekonominë e nxitura nga faktorët.

Shtyllat 5-10 i përkasin kategorisë së dytë të rritjes së efikasitetit dhe janë karakteristike për ekonominë e nxitura nga efikasiteti, ndërsa dy shtyllat e fundit i përkasin kategorisë së fundit të

faktorëve të rrisë dhe sofistikimit që janë bazë për ekonomitë e nxitura nga rrisë. **Transparency International, (2011).** Raporti nuk e përfshin Kosovën në llogaritje. Sidoqoftë, vendet e rajonit ndodhen të gjitha në fazën e dytë, atë të ekonomive të nxitura nga efikasiteti. Bazuar në gjendjen ekonomike të vendit tonë, përfshirja në këtë raport edhe më tutje do të vinte në pah pozitën reale të Kosovës në rajon.

Me një skenar optimist, Kosova do të bënte pjesë në fazën e tranzicionit nga faza e parë (1) e ekonomive të nxitura nga faktorët për në fazën e dytë (2) të ekonomive të nxitura nga efikasiteti. Në anën tjetër, një skenar më realist e vë Kosovën në fazën e parë të ekonomive të nxitura nga faktorët. Nga vendet e rajonit, Mali i Zi është i radhitur më lart, në vendin e 72-të, i pasuar nga Maqedonia në vendin 80, Bosnja dhe Hercegovina në vendin 88, Shqipëria në vendin 89 dhe Serbia në vendin 95. Renditja në një raport të tillë do të kishte ndikim më të madh tek investitorët potencialë, duke pasur parasysh se ky raport përfshin një numër më të madh të faktorëve në metodologjinë për përcaktimin e nivelit të konkurrencës të një shteti.

Kosova nuk përfshihet në raportin global të konkurrencës, por ajo përfshihet në indikatorët e qeverisjes botërore (WGI). Raportin e këtyre indikatorëve mund ta shohim më poshtë.

3.19 Raporti i qeverisjes për Kosovën, 1996-2013 Banka Botrore

Raportimi BB, (2014) përmbledh të dhënat nga Treguesit e Qeverisjes Botërore për çdo shtet veç e veç. Raporti (WGI) raporton për gjashtë treguesit e agreguar (totalë) të qeverisjes për mbi 200 vende dhe territore gjatë periudhës 1996-2013, duke mbuluar kështu: I) Lirinë e shprehjes dhe llogaridhënien; II) stabilitetin politik dhe prezencën e dhunës; III) efektivitetin qeverisës; IV) cilësinë e rregullatorit; V) rendin e ligjin dhe; VI) kontrollin e korrupsionit.

Grafikonët në çdo faqe tregojnë shkallën e përqindjes së vendit mbi secilin nga gjashtë treguesit e qeverisjes. Renditja e përqindjes tregon përqindjen e vendeve mbarëbotërore nga rangu më i ulët. Në këtë mënyrë vlerat më të larta tregojnë rezultatet më të mira të qeverisjes. Grafikët e linjësuar përfshijnë kufijtë e gabimit të treguar si linja të thyera, që korrespondojnë me intervale të besimit 90 %. Ndryshimet me kalimin e kohës në rezultatet agregate janë të vogla, për këtë arsye marginat e gabimit nuk duhet të interpretohen si një ndryshim statistikor domethënës në treguesit.

Indikatorët e qeverisjes botërore janë masa të përbëra në bazë të një numri të madh të burimeve të të dhënave themelore. Të dhënat burimore për secilin tregues agregat janë raportuar në tabelë në çdo faqe. Burime të dhënash individuale janë rishkallëzuar duke filluar nga 0 (e ulët) deri në 1 (i lartë). Këto rezultate janë të krahasueshme me kalimin e kohës dhe në të gjitha vendet, pasi shumica individuale e matjeve janë të bazuara në metodologjitë e ngjashme. Megjithatë, rezultatet nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshme me njëri-tjetrin, pasi burimet e ndryshme të të dhënave përdorin njësi të ndryshme dhe mbulojnë grupe të ndryshme të vendeve.

Jo të gjitha burimet e të dhënave mbulojnë të gjitha vendet dhe rastet kur të dhënat nuk janë në dispozicion janë raportuar si “..”. Për disa burime dhe vende, të dhënat si burim themelor janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen publikisht me kërkesë të organizatave që i prodhojnë të dhënat. Këto raste janë raportuar si “NP”.

Sipas këtij raporti (WGI 1996-2013), treguesit: I) liria e shprehjes dhe llogaridhënia sillen nga 25.0 % në vitin 2000, në 35.1 % në vitin 2004, edhe pse në vitin 2009 pati rritje të lirisë së shprehjes dhe llogaridhënies në 44.5 %, në vitet 2011, 2012 dhe 2013 prapë filloi rënia e llogaridhënies. Institucionet politikëbërëse duhet ta rrisin llogaridhënien. (Shih grafikun: Treguesit e lirisë së shprehjes dhe llogaridhënies tek anekset); II) stabiliteti politik dhe prania e

dhunës tregon se vendi është i paqëndrueshëm politikisht dhe ekziston dhuna, sidomos ajo ndërnacionale, që është një faktor problematik për investitorët e huaj.

Rënia e stabilitetit politik vërehet sidomos gjatë viteve 2011, 2012 dhe 2013 për shkak të krizave të brendshme politike. (Shih grafikun: Stabiliteti politik dhe prania e dhunës tek anekset); III) Sipas raportit të vitit 2006, efektiviteti i qeverisjes ishte në shkallën 41.5 %, ndërsa në vitin 2007 ishte rritur efektiviteti në 48.1 %, për të rënë përsëri në 37.4 % në vitin 2008, ndërsa në vitin 2009 prapë pati një ngritje të efektivitetit në 42.6 %, përsëri rënie në vitin 2010 në 32.1 %, kurse në vitet 2011, 2012 dhe 2013 niveli i qeverisjes ishte në shkallën 38.9 deri në 40.7 %. (Shih grafikun: Efektiviteti qeverisës tek anekset); IV) cilësia e rregullatorit është e nivelit mesatar, nga 54.9 % në vitin 2007, në 52.6 % në vitin 2013, që do të thotë se nuk ka ndonjë ndryshim - përmirësim gjatë shtatë vjetëve të qeverisjes. (Shih grafikun: Cilësia e rregullatorit tek anekset); V) rendi dhe ligji, sipas raportit (WGI 1996-2013), janë në nivelin më të ulët dhe me përmirësime të vogla. Në vitin 2003 ishte në nivelin 15.8 %, në 2007-n në nivelin 24.4 %, në 2010-n në nivelin 31.3 %, në vitin 2013 në nivelin 36.0 %. Dmth., treguesi rendi dhe ligji për 10 vjet është përmirësuar vetëm rreth 20 %. Angazhimi në luftën kundër krimit dhe korrupsionit duhet të shkojë përtej retorikës. Përpjekjet e ekzekutivit dhe gjyqësorit, së bashku me legjislativin, duhet të jenë më mirë të harmonizuara edhe me ndërkombëtarët dhe ndikimi politik, qoftë vendor apo ndërkombëtar, duhet të ndalet. Kosova duhet t'i përmirësojë rendin dhe ligjin në nivelin më të lartë për t'i plotësuar kushtet për integrim në BE dhe garantuar siguri për investitorët e huaj direkt. (Shih grafikun: Rendi dhe ligji tek anekset); VI) kontrolli i korrupsionit sipas raportit. Korrupsioni është në nivel të lartë institucional dhe nuk shihet përmirësim i në asnjë nivel institucional. Në vitin 2007 pati një rënie të nivelit të korrupsionit në 23.8 %, për t'u ngritur në 32.5 % në vitin 2008, në 33 % në vitin 2009 e të bjerë pak në 30.6 % në vitin 2013.

Korrupsioni shihet si faktori më problematik për investime të huaja direkte në Kosovë. (Shih grafikun: Kontrolli i korrupsionit tek anekset).

3.20 Praktikrat e mira ndërkombëtare dhe incentivave; format dhe objektivat e incentivave të investimeve

Nxitësit e investimeve ose subvencionet janë sinonime të përparësive ekonomike të matshme që qeveritë ofrojnë për ndërmarrje të veçanta apo grupe të ndërmarrjeve, me qëllim drejtimin e investimeve në sektorë të ndryshëm apo rajone. Këto përfitime mund të jenë fiskale (taksa ose përjashtimet doganore të importit), jofiskale (grante, kredi, reduktime të pagesave ose tarifave, privilegje rregullatore etj.) Incentivat e investimeve, fiskale dhe jofiskale, janë vendosur për të ndjekur objektiva të ndryshme.

Në disa raste incentivat mund të shihen si një kundërpeshë ndaj pengesës së qenësishme ndaj investimeve në sistemin e përgjithshëm tatimor. Për shembull, norma e tatimit të korporatës ose detyrimet doganore të importit janë perceptuar si shumë të larta dhe kompensohen me incentiva. Në raste të tjera, incentivat janë të destinuara për t'i kompensuar disavantazhet e tjera me të cilat mund të ballafaqohen investitorët. Këto janë: mungesa e infrastrukturës, ligjet e komplikuar dhe të vjetruara, apo kompleksitetet burokratike dhe kapacitetet e dobëta administrative në fushën e taksave etj. Ndonjëherë, incentivat aplikohen për ta mbajtur hapin me vendet e tjera në konkurrim për investime ndërkombëtare. Ndonjëherë incentivat janë aplikuar pas mangësive të tjera në ligj dhe administrimi dhe rregullimet janë të drejtuara në fushat e aktivitetit ekonomik që vendi dëshiron të zhvillojë.

Vendet që përdorin një gamë të incentivave fiskale dhe jofiskale mund të ndjekin përzierje të objektivave të mësipërme. A ka alternativa për përdorimin e incentivave?

Aty ku incentivat fiskale apo jofiskale janë një reagim ndaj mangësive në klimën e investimeve, mundësia më efektive do të jetë trajtimi i problemit themelor që do të thotë, për shembull, përshtatje e normave të taksave, reformim i administratës doganore dhe tatimore dhe procedurave, përmirësim i dobësive administrative apo përmirësim i infrastrukturës. Kjo zgjidhje është shpesh më e lehtë të thuhet se të bëhet, dhe kështu incentivat mund të japin lehtësim të përkohshëm derisa të kryhen reformat më themelore. Megjithatë, aty ku incentivat ndjekin objektiva specifike sektoriale ose rajonale, incentiva me caqe të qarta mund të jenë një mjet i përshtatshëm.

Lidhja në mes të incentivave dhe investimeve

Pyetja kryesore për një qeveri është: nëse incentivat mund të tërheqin investime shtesë? Nëse po, në cilat kushte arrihet më me efikasitet? Në fakt, shumë studime u janë kushtuar këtyre pyetjeve. Përfundimet nga këto studime mbi marrëdhënien e incentivave fiskale të investimeve dhe investimeve përfshijnë:

Investitorët në mënyrë të përsëritur klasifikojnë incentivat e investimit në anketat e motivimit të investitorit si një prej faktorëve më pak të rëndësishëm në vendimin e tyre të investimit. Dëshmitë në të dytë anketat dhe studimet ekonometrike tregojnë se disa nga përcaktuesit kryesorë që ndikojnë në vendimin e investitorëve ku të vendosen është i bazuar në faktorët më të mëdhenj të klimës investuese dhe ndryshorëve ekonomikë të tillë si: madhësia e tregut, politikat rregullatore, ndihma e burimeve natyrore dhe disponueshmëria e kapitalit njerëzor.

Pushimet tatimore janë veçanërisht të paefektshme në tërheqjen e investimit afatgjatë, sepse ato janë të palidhura me ecurinë e investimeve, mund të zgjaten lehtë duke i mbyllur dhe hapur si biznes i ri, tërheqin biznese shëtitëse, biznesi shpesh nuk ka fitime në vitet e para.

Klima e investimeve ndikon në efektivitetin e incentivave. Incentivat nuk kanë pothuajse asnjë ndikim në vendet me një klimë të ulët të investimeve. Incentivat janë tetë herë më efektive në klimat e forta të investimeve në tërheqjen e IHD-ve sesa në ato të dobëta.

Incentivat e investimeve nuk funksionojnë për shumë firma që përballen me kufizime financiare dhe nuk mund të rriten për të përfituar prej incentivave të taksave.

Incentivat e investimeve krijojnë shtrebbërime të rëndësishme duke i inkurajuar investimet joefikase. Investitorë shumë të lëvizshëm dhe ata të orientuar kah eksporti janë të ndjeshëm ndaj incentivave, sidomos incentivave të taksave, ndërsa investitorët e orientuar drejt tregjeve të brendshme janë më pak të ndjeshëm ndaj incentivave. Analiza kosto-përfitim e incentivave të investimeve mund të jetë pozitive kur pasuritë e investimeve janë në dispozicion për publikun e gjerë (p.sh, rrugë, shkolla). Kjo është një tjetër mënyrë për të paguar për mallrat publike. Investimet që gjenerojnë zhvillime të jashtme pozitive, si inkurajimi i teknologjive të gjelbra, përmirësimi i aftësive të punëtorëve, investim spirancë (por duhet të jetë i justifikuar), infrastruktura. B. Botrore, (2009). Konkluzionet e paraqitura ishin pothuajse tërësisht në lidhje me incentivat fiskale. Lidhja mes incentivave jofiskale dhe investimeve është më pak e qartë. Kjo është kryesisht për shkak se termi incentivat jofiskale përfshin më shumë lloje të ndryshme të incentivave sesa incentivat fiskale, gjë që e bën më të vështirë për t'i identifikuar karakteristikat e përbashkëta, qasjet dhe mjetet. Në fakt, efektiviteti i secilës kategori të incentivave jofiskale do të duhet të vlerësohet veç e veç. Mjetet e qëndrueshme dhe kriteret për një vlerësim gjithëpërfshirës të incentivave jofiskale nuk janë ende në dispozicion. Megjithatë,

qasja e parë për vlerësimin e incentivave jofiskale mund të jenë procedurale. Akordimi i incentivave jofiskale është i bazuar në një vendim të një institucioni publik pas një procesi administrativ. Procesi dhe performanca institucionale duhet t'i përmbushin parimet e qeverisjes së mirë.

Përkufizimi i incentivave investuese

Incentivat investuese janë të definuara si “përparësi të matshme ekonomike që qeveritë ofrojnë për ndërmarrje të veçanta ose grupe ndërmarrjesh, me qëllim nxitjen e lidhjeve dhe mbështetjen e investimeve/zhvillimin e sektorëve të favorizuar (p.sh., bujqësi, shëndetësi, energji të rinovueshme) ose rajoneve, apo për të ndikuar në karakterin e investimeve të tilla. Këto përfitime mund të jenë fiskale (si me koncesionet tatimore) ose jofiskale (me grante, kredi, ose zbritje për ta mbështetur zhvillimin e biznesit apo për ta rritur konkurrencën). Sebastian, J. (2009).

Format dhe llojet e incentivave të investimeve

Përkufizimi i gjerë i ‘incentivave të investimit’ sugjeron se ekzistojnë një numër i madh i incentivave për investime të ndryshme, të tilla si përjashtime nga politikat fiskale, grante, kredi të buta, qasja në tokë të lirë ose të subvencionuar, mbështetje në trajnim dhe punësim, subvencione në infrastrukturë dhe përjashtime ad hoc. Gama e incentivave të mundshme të investimeve të ofruara për investitorët është potencialisht e pakufizuar. Nga praktika që kanë ndjekur vendet e ndryshme, incentivat e investimeve mund të kategorizohen në tri lloje të ndryshme: incentiva rregullatore, incentiva financiare dhe incentiva fiskale. (Shpesh bëhet vetëm dallimi mes incentivave fiskale dhe incentivave jofiskale. Incentivat rregullatore dhe incentivat financiare formojnë kategorinë e incentivave jofiskale).

1) Incentivat fiskale të investimeve

Incentivat më të përdorur zakonisht për investime janë incentivat fiskale të IHD-ve. (Për shkak të fokusit të këtij shënim mbi incentivat jofiskale, më poshtë renditen shkurtimisht incentivat kryesore fiskale investuese):

- Norma të reduktuara të tatimit mbi të ardhurat e korporatave, të tilla si përjashtimet e përkohshme tatimore (tax holidays) dhe taksa të veçanta për zonat e privileguara të investimeve.
- Incentiva për krijimin e kapitalit, të tilla si ndihmat për investime të posaçme, kreditë tatimore për investime dhe fitimet e riinvestuara.
- Reduktimi i pengesave për operimet ndërkufitare, të tilla si mbajtja e tatimit, tatimet e tregtisë së jashtme, tatimet e të punësuarve.
- Reduktimet e taksave të tjera, siç janë taksat më të ulëta të shitjes dhe normat e zvogëluara të TVSH-së, normat e zvogëluara të tatimit në pronë dhe modelet për taksat tatimore “lump sum”.

2) Incentivat financiare të investimeve

Stimujt financiarë për investime janë një kategori e gjerë që mbulon ata stimuj për investime që i japin investitorit një avantazh financiar duke e mbështetur investitorin në atë mënyrë që reduktojnë kostot e investitorit në lidhje me krijimin dhe funksionimin e investimit. Stimujt financiarë për investime mund të kategorizohen si më poshtë:

Incentivat e punësimit: stimujt e punësimit ulin kostot e investitorit për çdo punonjës, shpesh përmes subvencioneve të pagave të individëve. Qeveria që i përdor këto i justifikon rregullisht stimujt e punësimit.

Incentivat e trajnimit: në rast të mungesës së punonjësve të kualifikuar në vend, programet e trajnimit të subvencionuara mund të ndihmojnë në tërheqjen e një investimi dhe të sigurojnë përfitime për vendin përmes përmirësimit të kapaciteteve njerëzore.

Incentivat e financimit: këto synojnë lehtësimin e një investimi duke ofruar mbështetje financiare për investitorin, e cila mbështetje lidhet me shpenzimet fillestare të hapjes së biznesit, por herë pas here kanë të bëjnë edhe me kostot operative. Incentivat financiare mund të marrin forma të ndryshme, të tilla si kredi të subvencionuara apo të buta, garanci të huave/kredive, subvencione të interesit/kamatës, grante me para kesh, apo edhe pjesëmarrje të sektorit publik përmes ekuitetit.

Sigurimi i infrastrukturës fizike: ka për qëllim uljen e kostove me të cilat përballen investitorët për pasuri të patundshme dhe të objekteve të transportit. Shteti mund ta shesë tokën publike (nën çmimin e tregut) dhe të sigurojë infrastrukturë, siç janë rrugët, hekurudhat, portet, infrastrukturë të komunikimit etj. në qoftë se nevoja e një investitori për një shërbim të tillë është e supozuar ose e bazuar.

Zonat Speciale Ekonomike (SEZs): këto tërheqin investimet përmes llojeve të ndryshme të zonave të zhvillimit siç janë: zonat për promovimin e eksportit ose parqet industriale. Këto zona zakonisht kombinojnë lloje të ndryshme të incentivave investuese fiskale dhe jofiskale për të ofruar një paketë shumë tërheqëse të përfitimeve për investitorët, duke përfshirë infrastrukturën fizike, vëmendje të veçantë nga ana e autoriteteve përkatëse (aftercare) dhe pezullimin e përkohshëm të taksave. Përfitimet e tjera për investitorët dhe industrinë vendëse supozohet se zhvillohen përmes shfaqjes së grupimeve të industrisë brenda ose përreth zonave.

Mbështetja në hapje biznesi: investitorët kanë nevoja të veçanta në aspektin e krijimit të biznesit të tyre, duke përfshirë informacion mbi disponueshmërinë e rregullave, tokës dhe

rregulloreve të brendshme, nevojave në marketingun e produkteve dhe shërbimeve të tyre dhe ndihmës në administratën e përgjithshme. Gjithashtu, investitorët mund ta vlerësojnë mbështetjen e dhënë në takime dhe bashkëpunimin me zyrtarët vendorë, furnizuesit, ofruesit e shërbimeve dhe investitorët e tjerë. Shpesh këto funksione kryhen pa pagesë nga agjencia për promovimin e investimeve vendëse. Në varësi të karakterit të tyre, këto shërbime mund të përbëjnë një subvencionim të nënkuptuar të investimit.

Shërbimet e kujdesit pasues: janë të lidhura ngushtë me mbështetjen në hapjen e biznesit, duke përbërë një shërbim pasues për investitorin që e ndihmon t'i kalojë pengesat dhe t'i zgjidhë problemet me të cilat përballet në hapjen e biznesit dhe operacione. Vendet pritëse mund të ofrojnë këto shërbime në një përpjekje për të ndërtuar një marrëdhënie bashkëpunuese afatgjatë me investuesit.

3) Incentivat rregullatore të investimeve

Incentivat rregullatore për investime janë çdo lloj i incentivave të ofruara për investitorët e huaj me anë të shmangies nga rregullat vendëse (duke përfshirë rregullat dhe rregulloret në nivel rajoni). Sipas OECD-së, ka pak prova konkrete për ta përhapur zbatimin e incentivave rregullatore për investime. Një arsye për numrin e ulët të incentivave rregullatore të investimeve mund të jetë që përjashtimet nga politika kombëtare mund ta marrin formën e zbutjes së kërkesave mjedisore, sociale dhe të tregut të punës të lidhura me investitorët e huaj. Në këto raste, vendet pritëse dhe investitorët mund të jenë të prirë të mos i komunikojnë publikisht këto incentiva.

Ndihma shtetërore

Përveç përkufizimit të mësipërm të incentivave jofiskale të investimeve duhet të merret në konsideratë edhe përkufizimi i BE-së i “ndihmës shtetërore” për përcaktimin përfundimtar të përkufizimit “incentiva” në mënyrë që të jenë në përputhje me rregulloren e BE-së. Gjithashtu, përcaktimi përfundimtar i incentivave në kontekstin e punës në Kosovë duhet të jetë në përputhje me Ligjin në Kosovë për ndihmën shtetërore, që është në përputhje me rregullat e BE-së. IFC, (2013)

3.21 Sfidat kryesore të zhvillimit dhe strategjia qeveritare

Sfida kryesore e zhvillimit lidhet me rrugën e zhvillimit ekonomik që krijon vende pune të cilësisë së lartë dhe përdor resurset kryesore natyrore në mënyrë të qëndrueshme dhe të mbrojtjes së ambientit. Modeli i rritjes ekonomike në Kosovë në vitet e fundit ka qenë kryesisht i bazuar në disponueshmërinë e burimeve të jashtme të financimit, sidomos ndihmën e donatorëve dhe dërgesat nga emigrantet. Qeveria e Kosovës e pranon se ky model nuk mund të jetë themeli i një strategjie të rritjes të qëndrueshme, sidomos në mjedisin e tanishëm ekonomik. Investimet në sektorin privat kanë filluar të rriten dhe mund të jenë motori kryesor për rritjen e përsheptuar dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Krijimi i një klime mikpritëse për investime është kështu një komponentë kritike e strategjisë aktuale të qeverisë. Vizioni i prioriteteve të zhvillimit ekonomik, plani shoqëruar i veprimit dhe korniza afatmesme e shpenzimeve (2011-2014) për krijimin e vendeve të punës për pjesën e madhe të kosovarëve të papunë dhe përsheptimin e konvergjencës me nivelet e të ardhurave në EJT dhe Evropë. Përveç këtyre, qeveria i jep prioritet të lartë zhvillimit të sektorit të bujqësisë si sektori që aktualisht është përgjegjës për 35 për qind

të punësimit. Gjithashtu, Kosova është gjithnjë e më e vetëdijshme për nevojën dhe vëmendjen për problemet e mjedisit dhe për të lëvizur drejt standardeve mjedisore dhe kërkesave të BE-së. Pjesa tjetër e këtij seksioni ofron një vështrim më të thellë në sfidat me të cilat përballlet Kosova në secilën nga këto fusha.

Sfidat kryesore në promovimin e investimeve private dhe punësim

Kosova ka potencial të konsiderueshëm për të ecur drejt rritjes së shpejtë dhe të qëndrueshme të drejtuar nga sektori privat dhe krijimi i vendeve të punës nëse mund t'i trajtojë pengesat ekzistuese ndaj investimeve. Siç është theksuar në Memorandumin Ekonomik të Shtetit (MESH) të Bankës për 2010-n, vendi gëzon disa përparësi relative që janë të rëndësishme për krijimin e një sektori të lulëzuar të eksportit si dhe për tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja në sektorët e tregtueshëm. Kosova është e pasur me pasuri të ndryshme kryesore. Pra, burime të bollshme natyrore, një fuqi punëtore të re dhe në rritje (megjithëse të pashfrytëzuar), tokë bujqësore të cilësisë së mirë, si dhe qasje praktikisht të lirë për në tregjet rajonale dhe të BE-së.

Në disa aspekte mjedisi i politikave është gjithashtu i favorshëm, duke përfshirë:

- sistem tatimor që është i thjeshtë dhe me norma të ulëta
- treg të punës që është më fleksibil sesa në vendet fqinje dhe
- paga relativisht të ulëta për punëtorë (gjysmë) të kualifikuar.

Megjithatë, ka një numër të pengesave serioze ndaj investimeve të cilat duhet të trajtohen nëse Kosova do ta realizojë potencialin e saj si një destinacion tërheqës për investimet vendore dhe të huaja private.

3.22 Indeksi i lirisë ekonomike

I publikuar nga Heritage Foundation dhe Wall Street Journal (2012), ky indeks analizon dhjetë komponentë specifike të lirisë ekonomike të grupuara në katër kategori. Kategoritë janë: **sundimi i ligjit** (që përfshinë të drejtat pronësore dhe lirinë nga korrupsioni); **qeverisja e kufizuar** (liria fiskale dhe shpenzimet e qeverisë); **efikasiteti i rregullatorit** (liria e biznesit, liria e tregut të punës, liria monetare); **tregu i hapur** (liria e tregtisë, liria e investimeve, liria financiare). Ky raport nuk e përfshinë Kosovën në renditje, mirëpo në dukje Kosova nuk do të ndodhej shumë më mirë se vendet e rajonit në radhitje. Në këtë raport, nga vendet e rajonit, Maqedonia zë vendin e 45-të, Shqipëria të 57-in, Mali i Zi të 72-in, Serbia të 98-in, Bosnja dhe Hercegovina të 104-in. Shqipëria dhe Serbia nga të gjitha kategoritë indeksin më të ulët e kanë në komponentin e lirisë nga korrupsioni. Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë indeksin më të ulët në të drejtat pronësore, ndërsa Mali i Zi ka indeksin më të ulët në shpenzimet qeveritare. Këta tre komponentë paraqesin edhe komponentët më problematikë në përgjithësi për rajonin. Duke pasur parasysh këtë numër të madh të komponentëve të analizuar në raporte të ndryshme botërore që mund të ndikojnë në vendimmarrjen e investitorëve potencialë, shihet se fokusi i tepruar në përmirësimin e radhitjes në Raportin e Bankës Botërore të të Bërit Biznes është problematik. Kosova ka vend për reforma në shumë fusha të tjera, jashtë atyre të përfshira në Raportin e të Bërit Biznes, të cilat mund të ndikojnë më shumë në tërheqjen e investimeve të huaja.

Ulja e korrupsionit, përmirësimi i infrastrukturës, investimi në arsimim dhe trajnim të kuadrove, zhvillimi i një mjedisi makroekonomik, duke përfshirë edhe përmirësimin e tregtisë jashtë kufijve, do të ndikonin në masë të madhe në perceptimin e Kosovës nga investitorët e

huaj. Sidoqoftë, fokusi në këta komponentë do të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit me prodhimtarinë vendore si shtyllë kryesore.

3.23 Indeksi i transformimit i Fondacionit Bertelsmann

Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann (2012), (BTI) analizon dhe vlerëson nëse vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion drejtojnë ndryshimet shoqërore drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut dhe si e bëjnë këtë. BTI është i bazuar në dy indekse, atë të statusit dhe të menaxhimit. Indeksi i statusit në dy dimensione analitike vlerëson transformimin politik drejt demokracisë nën sundimin e ligjit dhe transformimin ekonomik drejt ekonomisë së tregut nën principet e drejtësisë shoqërore. Indeksi i menaxhimit vlerëson cilësinë e qeverisjes dhe ndikimin e vendimmarrjes në drejtimin e proceseve politike.

Nga 128 shtete të përfshira në këtë indeks, Kosova radhitet në vendin e 41-të në indeksin e statusit dhe cilësohet si shtet i limituar. Në transformimin politik Kosova radhitet në vendin e 43-të dhe cilësohet si demokraci e mangët, ndërsa në transformimin ekonomik radhitet në vendin e 58 dhe cilësohet si ekonomi me mangësi funksionale. Në indeksin e statusit vendet e rajonit hyjnë në radhët e shteteve të avancuara. Kroacia radhitet e 15-a, Serbia e 21-a, Maqedonia e 25-a, Mali i Zi i 27-ti dhe Shqipëria e 31-a, ndërsa Bosnja e Hercegovina radhitet e 39-a, i cilësuar si shtet i limituar.

Në indeksin e menaxhimit, Kosova dhe Shqipëria cilësohen si shtete me cilësi të moderuara të menaxhimit të qeverisjes, të radhitura në vendin e 57, respektivisht 52. Bosnja dhe Hercegovina radhitet më së dobëti në rajon, në vendin e 95-të, e cilësuar si shtet me qeverisje me menaxhim të dobët. Serbia, Mali i Zi, Kroacia dhe Maqedonia cilësohen shtete me cilësi të mirë të menaxhimit të qeveri.

3.24 Analiza e faktorëve që merren në konsideratë në Investimet e Huaja Direkte në

Kosovë

Në këtë studim janë identifikuar faktorë të ndryshëm që ndikojnë në vendimin e një investitori potencial për të investuar apo jo në një vend të caktuar. Për të pasur një pasqyrë më të qartë për rëndësinë e këtyre faktorëve dhe perceptimin e tyre në lidhje me efektet e këtyre faktorëve në vendimin mbi investimet, në vazhdim do t'i analizojmë veç e veç.

Të gjitha të gjeturat në këtë studim do të mund të na ndihmojnë në matjen e situatës aktuale të ambientit të biznesit në Kosovë dhe perceptimit të gjendjes së tillë nga ana e investorëve. Këto të dhëna mund të përdoren nga njerëz që janë të përfshirë në biznes dhe politikë. Gjithashtu, është i mirëseardhur edhe për investorët e huaj direktë.

Hulumtimi i këtij studimi mbi investorët e huaj në Kosovë konsiderohet si burim informacioni shumë i rëndësishëm për aktivitetet ekonomike në vend dhe parashikimet për tërheqje të investimeve të huaja bazuar në rezultatet dhe në gjetjet e këtij studimi. Ky studim fokusohet kryesisht në kompanitë e mëdha investuese në Kosovë, por në asnjë rrethanë duke mos përjashtuar ato kompani që fillimisht kanë investuar kapital më të vogël (në krahasim me të tjerat).

Gjetjet kryesore nga ky studim tregojnë se mbi 70 % e kompanive që kanë investuar në Kosovë, duke e konsideruar ambientin aktual të bërit biznes dhe procedurat e tjera shtesë deri në finalizim të investimit, janë shprehur se janë të gatshme dhe do të preferonin të investonin sërish në Kosovë, përderisa një përqindje jo e vogël, rreth 30 %, janë deklaruar se nuk do të investonin më në vendin tonë. Të dhënat e mbledhura përmes anketimeve janë realizuar nga anketa me

ndërmarrjet më të mëdha investuese në vend si investime direkte. Gjithsejtë, 48 ndërmarrje investuese në periudhën 2004-2013. Numri më i madh i këtyre ndërmarrjeve në anketim janë ato me qëndrueshmëri më të gjatë në tregun e Kosovës.

Kompanitë e anketuara të cilat kanë shprehur gatishmërinë dhe koordinimin për ta plotësuar pyetësin i cili ishte i rëndësishëm së madhe për të arritur në disa konkluzione në fund të punimit. Sado që rezultati në total është tejet i favorshëm (në përgjithësi), prapë mbetet sfida për Qeverinë e Kosovës dhe agjencitë relevante të bëjnë më shumë në drejtim të tërheqjes së investimeve të reja, ose së paku mbajtjes së atyre ekzistuese.

3.25 Përmbledhje e kapitullit të tretë

Investimet e Huaja Direkte vazhdimisht janë karakterizuar me luhatshmëri si rezultat i zhvillimeve në vitet e fundit në vendet e eurozonës që, njëkohësisht, paraqesin burimin kryesor të IHD-ve. Sidoqoftë, gjatë vitit 2012 ishte edhe ngadalësimi në procesin e privatizimit që ndikoi në fluksin më të ulët të IHD-ve në vend (rënie për 40 % në krahasim me vitin 2011).BQK, (2015)

Një gjë është e sigurt, se roli i IHD-ve dhe efektet e tij janë të pashmangshme dhe të domosdoshme për ekonominë e Kosovës. Gjithashtu, sfida për Qeverinë e Kosovës është të jetë e gatshme për të pasur strategji për t'i thithur IHD-të, duke krijuar besueshmërinë për një shtet ligjor dhe të së drejtës, duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, ekonominë informale dhe duke ofruar mbrojtjen e investimeve të investitorëve të huaj. Gjithashtu, tregtia me vendet e rajonit (anëtarë në CEFTA) dhe Bashkimin Evropian përbën pjesën dërrmuese të tregtisë së jashtme të Kosovës. Bashkimi Evropian është grupi i parë më i rëndësishëm tregtar i

Kosovës, duke qenë në shifra të përafërta në shkëmbime tregtare si me grupin e CEFTA-s. Për sa iu përket eksporteve të Kosovës me vendet ballkanike, dinamika dhe volumi i IHD-ve kanë pësuar ulje dhe ngritje në periudha të ndryshme kohore ashtu siç e elaboruam në kapitull përmes paraqitjeve grafike dhe tabelare. Sidomos kjo është theksuar pas krizës financiar më 2008. Vende të ndryshme në botë kanë pësuar ose përfëtuar në renditjen e përfëtuësve të IHD-ve në periudhat e para dhe pas krizës së fundit.

Kriza globale e vitit 2008 ndikoi në IHD-të, në sektorët kryesorë të ekonomisë së Kosovës, që të kishin rënie të theksuar. Gjatë viteve 2010-2011 vlera e IHD-ve filloi të rritej me një ritëm të ngadalshëm, mirëpo kjo nuk ndodhi edhe gjatë vitit 2012. Në Kosovë gjatë vitit 2012 rrjedha e IHD-ve përkeqësohet dukshëm. Kjo situatë dëshmon për ndjeshmërinë që kanë IHD-të ndaj zhvillimeve në ekonomitë e vendeve të Eurozonës, të cilat paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë (Raporti i BQK-së, 2012). Megjithatë, ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar me normë pozitive të rritjes. Rritja ekonomike pozitive gjatë vitit 2012 është mbështetur edhe nga pozicioni stabil fiskal. Në vitin 2007 IHD-të kanë marrë pjesë në BPV me 12.99 % duke shënuar rënie të vazhdueshme ndër vite, ndërsa rënia më e madhe shihet në vitin 2012 me 4.66 %, në vitin 2013 kemi ngritje të lehtë në 5.26 % ose 0.6 % dhe në vitin 2014 (TM1, TM2 dh TM3) pjesëmarrja e IHD-ve është 3.72 %.

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë më së shumti kanë ndodhur në: tregti, aktivitete shërbyese, ndërtim, shërbime financiare, transport, hoteleri e shumë pak në industrinë e minierave e mineraleve si dhe në prodhimtari. Kulmi i ngritjes së IHD-ve është viti 2007 dhe viti 2012, pastaj kemi rënie drastike të IHD-ve në 2013-n në 208.2 milionë € dhe në 2014-n në 151.2 milionë €. Diferenca është deri në 51 % më të ulëta se në vitin paraprak.

Nga indeksi i transformimit i Fondacionit Bertelsmann nga 128 shtete të përfshira në këtë indeks, Kosova radhitet në vendin e 41-të në indeksin e statusit dhe cilësohet si shtet i limituar. Në transformimin politik Kosova radhitet në vendin e 43-të dhe cilësohet si demokraci e mangët, ndërsa në transformimin ekonomik radhitet në vendin e 58 dhe cilësohet si ekonomi me mangësi funksionale. Kurse në indeksin e lirisë ekonomike, ky indeks analizon dhjetë komponentë specifike të lirisë ekonomike të grupuara në katër kategori. Kategoritë janë: sundimi i ligjit (që përfshinë të drejtat pronësore dhe lirinë nga korrupsioni); qeverisja e kufizuar (liria fiskale dhe shpenzimet e qeverisë); efikasiteti i rregullatorit (liria e biznesit, liria e tregut të punës, liria monetare); tregu i hapur (liria e tregtisë, liria e investimeve, liria financiare). Ky raport nuk e përfshinë Kosovën në renditje, mirëpo në dukje Kosova nuk do të ndodhej shumë më mirë se vendet e rajonit në radhitje. Në këtë raport, nga vendet e rajonit, Maqedonia zë vendin e 45-të, Shqipëria të 57-in, Mali i Zi të 72-in, Serbia të 98-in, Bosnja dhe Hercegovina të 104-in. Shqipëria dhe Serbia nga të gjitha kategoritë, indeksin më të ulët e kanë në komponentin e lirisë nga korrupsioni. Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë indeksin më të ulët në të drejtat pronësore, ndërsa Mali i Zi ka indeksin më të ulët në shpenzimet qeveritare. Për këtë u mbetet autoriteteve qeveritare që potencialin ekonomik që ka Kosova të konsiderueshëm për të ecur drejt rritjes së shpejtë dhe të qëndrueshme ta drejtojë nga sektori privat për krijimin e vendeve të punës dhe t'i eliminojë të gjitha barrierat për investimet e huaja.

KAPITULLI I IV

4. METODOLOGJIA KËRKIMORE

Nëpërmjet metodologjisë kemi bërë testimin e hipotezave të ngritura në këtë studim dhe kemi dhënë përgjigjet pas analizave kërkimore, duke bërë analizë specifike dhe me fakte (Palys, 1997, f. 3-4). Sipas Bulmerit (1984, f. 4), metodologjia kërkimore tregon “studimin sistematik dhe logjik të principeve që qeverisin analizën, përmban pyetjet se si kërkuesi përcakton njohurinë sociale dhe si ai apo ajo mund t’i bindë të tjerët që njohuria e tij apo e saj është e duhur”.

Për punimin e pjesës së disertacionit “*Efektet e Investimeve të Huaja (IHD) direkte në Kosove – Analizë e atraktivitetit të investimeve të huaja dhe roli i tyre në ekonomi*” kemi përdorur dhe shfrytëzuar metodat dhe teknikat të cilat në njërën anë do ta lehtësojnë hulumtimin, në anën tjetër do t’ia japin punimit vlerën e dëshiruar. Prandaj, duke u nisur nga fakti se shfrytëzimi i një numri më të madh të metodave zakonisht sjell deri tek konkludime më të qarta dhe më të drejta, ky punim do t’i japë frytet përmes metodave hulumtuese sasiore dhe cilësore, të cilat do të shfrytëzohen nga teknikat e hulumtimit.

Si pjesë e hulumtimit shkencor do të jetë edhe literatura teorike lidhur me rolin dhe rëndësinë që kanë IHD-të për vendet pritëse, vlerësimet sipas indekseve të institucioneve ndërkombëtare lidhur me fluksin e të hyrave të IHD-ve në vendet e EJT-së. Po ashtu, paraqitet një analizë në mes të Kosovës dhe vendeve të EJT-s si dhe një krahasueshmëri në mes të Kosovës, Maqedonisë dhe Kroacisë, si dy vende me të cilat Kosova një kohë të gjatë ka qenë brenda të njëjtit rregullim shoqëror dhe ekonomik, ku Kroacia ka arritur shkallën e zhvillimit

ekonomik deri në plotësimin e standardeve për hyrje në BE, ndërsa Maqedonia është ende në nivelin e vendeve në zhvillim.

4.1 Grumbullimi i të dhënave

Për ta parë rëndësinë e IHD-ve në disa shtete kemi marrë e shqyrtuar:

Raportin e UNCTAD-it në vitin 2013 për flukset hyrëse të IHD-ve në nivel botëror;

Raportin e fluksit të IHD-ve në nivel global sipas grupimeve ekonomive 1995-2013 dhe parashikimet 2014-2016 që tregojnë flukset e IHD-ve sipas sektorëve ekonomikë;

Raportin e flukseve hyrëse të IHD-ve në vendet e Evropës Juglindore 2000-2013;

Raportin për rritjen reale të PBB-së dhe parashikimin deri në vitin 2020 në vendet e EJT-së në përqindje (BQK);

Raportin për Investimet e Huaja Direkte neto në % ndaj PBB-së në vendet e EJT6, EJT11 dhe EJT15, 2009-2013 (UNCTAD 2013);

Shkëmbimin tregtar të Kosovës gjatë periudhës 2001-2014 (ASK & MTI);

Raportin për Investimet e Huaja Direkte në Kosovë gjatë periudhës 2007-2014 (BQK dhe BB);

Pjesëmarrjen e IHD-ve në BPV të Kosovës në periudhën 2007-2014 (BQK dhe ASK);

Renditjen e Kosovës në lehtësira të të bërit biznes 2013-2014 (doingbusiness.org). Ky raport përmbledh treguesit dhe renditë ekonomitë e 189 të vendeve të botës në lehtësitë e të bërit biznes;

Indeksin e perceptimit të korrupsionit (transparency.org), i cili përgatitet nga Transparency International dhe mat perceptimin e korrupsionit në 175 vende të botës, përfshirë edhe Kosovën;

Raportin e BB-së për Kosovën (WGI), 1996-2013, gjashtë indikatorët e qeverisjes; I) Lirinë e shprehjes dhe llogaridhënien; II) Stabilitetin politik dhe praninë e dhunës, III) Efektivitetin qeverisës, IV) Cilësinë e rregullatorit, V) Rendin e ligjin dhe VI) Kontrollin e korrupsionit etj.

Ndërkaq, për qëllimin e mbledhjes së të dhënave janë përdorur këto burime sekondare:

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
2. Banka Qendrore e Kosovës (BQK)
3. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)
4. Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)
5. Banka Botërore (WB), UNCTAD, FMN-ja dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe vendore.
6. Ministria e Punëve të Jashtme

Burimet primare:

- 3 Intervista gjysmë të strukturuar me kompani të huaja që kanë investuar në Kosovë
- 4 Analiza ekonometrike
- 5 Studime, krahasime, përlllogaritje të të dhënave.

Nga instrumentet metodologjike janë përdorë metodat e mëposhtme:

1. **Metoda e analizës dhe sintezës** do të përdoret për prezantim logjik të hulumtimit, për problemet dhe karakteristikat ekonomiko-shoqërore, si dhe për nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare në lidhje me efektet e IHD-ve në Kosovë;

2. **Metoda ose arsyetimi deduktiv**, e cila fillon nga të përgjithshmet për më specifiket.

Ndonjëherë kjo quhet joformalisht një qasje “nga lart-poshtë”. Ne mund të fillojmë me të menduarit e një teori në lidhje me temën tonë të interesit, pastaj ngushtojmë hipoteza në mënyrë specifike që mund t’i provojmë. Kjo përfundimisht çon në atë se a do të jetë në gjendje për t’i testuar hipotezat me të dhëna të veçanta - një konfirmim (ose jo) të teorive tona origjinale. Ne do ta përdorim këtë metodë për t’i testuar hipotezat e ngritura lidhur me flukset e IHD-ve në Kosovë;

3. **Metoda ose arsyetimi induktiv** punon në mënyrë tjetër, duke lëvizur nga vëzhgimet specifike në përgjithësime të gjëra dhe teorike. Jozyrtarisht ne nganjëherë e quajmë këtë një “metodë nga poshtë-lart”. Qasja (ju lutem, vini re, se kjo është “nga poshtë-lart”, e jo “fund-lart”, për të cilin Bartenderi thotë për klientët kur ai është duke u përpjekur për të mbyllur për një natë!) Në arsyetimin induktiv ne fillojmë vëzhgimet specifike dhe masat për t’i zbuluar modelet dhe rregullsitë. Formulojmë disa hipoteza paraprake që ne mund t’i shqyrtojmë, në fund përfundojmë duke zhvilluar disa konkluzione apo teori të përgjithshme. Ekzistojnë teori për IHD-të, për të cilat do të bëjmë rishikim literature, do t’i japim rekomandimet tona në lidhje me IHD-të dhe efektet e tyre në ekonominë e vendeve në zhvillim;

4. **Metoda cilësore** është hulumtim kryesisht eksplorues. Përdoret për të fituar një kuptim të arsyeve themelore, mendimeve dhe motiveve. Ajo siguron njohuri për problemin ose ndihmon për t’i zhvilluar idetë apo hipotezat për kërkime të mundshme sasiore. Hulumtimi kualitativ është përdorur edhe për t’i zbuluar trendët në mendime dhe

opinionë dhe futet më thellë në problem. Metodën e mbledhjes së të dhënave cilësore ndryshojnë duke përdorur teknika të pastrukturuara ose gjysmë të strukturuara. Disa metoda të zakonshme përfshijnë diskutime në grup, intervista individuale dhe pjesëmarrje/vëzhgime. Madhësia e mostrës zakonisht është e vogël dhe të anketuarit janë përzgjedhur për ta përmbushur një kuotë të caktuar. Unë e kam përdorur këtë metodë për të nxjerr rezultate cilësore për IHD-të dhe efektet e tyre në ekonominë e vendeve të Evropës Juglindore, në veçanti për Kosovën.

5. **Metoda sasiore** përdoret për ta përcaktuar sasinë e problemit me anë të gjenerimit të të dhënave numerike ose të dhëna që mund të transformohen në statistikat e përdorshme. Ajo është përdorur që t'i përcaktoj sasinë, qëndrimet, mendimet, sjelljet dhe variablat e tjera të përcaktuara dhe përgjithësuar rezultatet nga një popullsi më e madhe e mostrës. Kërkimi sasior përdor të dhëna të matshme për të formuluar fakte dhe të zbulojë modele në hulumtim. Metodën e mbledhjes së të dhënave sasiore janë shumë më të strukturuara se metodat kualitative të mbledhjes së të dhënave. Metodën e mbledhjes së të dhënave sasiore përfshijnë forma të ndryshme të sondazheve - sondazhet online, anketat letër, anketat përmes celularit dhe sondazhe kioske, ballë për ballë, intervista telefonike, studime gjatësore, interceptorë interneti, sondazhe online dhe vëzhgime sistematike. Unë, për t'i vlerësuar dhe analizuar efektet e investimeve të huaja direkte në Kosovë, e kam përdorur metodën kuantitative. Arsye kryesore për zgjedhjen e metodës kuantitative janë: E para, se i transformon të dhënat apo informatat në numra dhe sasi përmes analizës statistikore, duke tentuar që hulumtimi kërkimor të bëhet më i strukturuar dhe i formalizuar; e dyta, qasja kuantitative karakterizohet duke studiuar disa variabla për numër më të gjerë të

entiteteve dhe, së fundi, rezultatet janë të bazuara në numra dhe statistika që janë të prezantuara përmes figurave (grafikonëve).

6. **Anketimi dhe intervistimi** janë strategji kuantitative të hetimit. Studimi bëhet duke përdorur pyetësorë ose intervista të strukturuar me qëllim të përgjithësimit nga mostra tek popullimi. Përdorimi i anketimit është i përshtatshëm për shkak se në kohë të shkurtër hulumtuesi ka në dispozicion një numër të madh të të dhënave për t'i gjetur përgjigje problemit që hulumtohet. Përdoren pyetësorë me përgjigje të përgatitura si alternativa.
7. **Metoda krahasuese** përbëhet prej konstatimit të ngjashmërisë dhe ndryshimeve mes dukurive të ndryshme. P.sh., të kuptohen dhe të interpretohen më mirë shtetet dhe politikat e caktuara të tyre: shkalla e zhvillimit ekonomik, niveli arsimor, administrimi, menaxhimi i burimeve etj. Krahasimet mund të bëhen mes fushave, faktorëve dhe aktorëve të ndryshëm, apo edhe ndërmjet shteteve ose organizatave të ndryshme. Në këtë studim do të përdoret për krahasimin e efekteve të investimeve të huaja direkte në Kosovë me vendet e tjera (me theks të posaçëm me vendet e Evropës Juglindore).
8. **Metoda statistikore** është një nga metodat themelore të hulumtimit të grumbullimit, përpunimit dhe të analizës së të dhënave numerike, të dukurive ekonomike, shoqërore dhe tekniko-teknologjike. Në këtë studim do të përdoret për ta vlerësuar ndikimin e efekteve të IHD-ve në PBB të Kosovës.

4.2 Mostra (kampioni i përzgjedhur)

Hulumtimi është kryer në mënyrë direkte duke kontaktuar përfaqësues të ndërmarrjeve qoftë direkt, qoftë përmes e-mailit. Subjekte të këtij pyetësi kanë qenë 48 ndërmarrje të ndryshme të huaja që kanë investuar në disa veprimtari në Kosovë, të cilat kanë pasur qëndrueshmëri më të gjatë në Kosovë, kryesisht nga viti 2004 deri në vitin 2013. Origjina e ndërmarrjeve kryesisht ka qenë nga Shqipëria, ShBA-ja, Austria, Gjermania, Holanda, Italia, Sllovenia, Britania Madhe dhe Franca. Pyetësi përmbanë gjithsej 9 pyetje dhe për secilën pyetje janë evidentuar përgjigjet e kërkuara.

4.3 Pyetësi

Veprimtaria e Kompanisë

- ☐ Shërbime financiare
- ☐ Telekomunikacion
- ☐ Tregti
- ☐ Patundshmëri
- ☐ Tjetër

1. Si e konsideroni faktorin ekonomik për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm
- ☐ I përshtatshëm
- ☐ Shumë i përshtatshëm

2. Si e konsideroni stabilitetin e faktorit politik për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm

- ☐ I përshtatshëm
- ☐ Shumë i përshtatshëm

3. Si e konsideroni legjislacionin në fuqi dhe atraktivitetin e tij për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm
- ☐ I përshtatshëm
- ☐ Shumë i përshtatshëm

4. Sa e konsideroni të përshtatshëm Ligjin për mbrojtje të investime të huaja direkte në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm
- ☐ I përshtatshëm
- ☐ Shumë i përshtatshëm

5. Sa janë të përshtatshme politikat doganore për investime në Kosovë?

- ☐ Të papërshtatshme
- ☐ Deri-diku të përshtatshme
- ☐ Të përshtatshme
- ☐ Shumë të përshtatshme

6. Sa janë të përshtatshme politikat tatimore për investime në Kosovë?

- ☐ Të papërshtatshme
- ☐ Deri-diku të përshtatshme
- ☐ Të përshtatshme
- ☐ Shumë të përshtatshme

7. Sa është i përshtatshëm ndikimi i kostos së punës për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm
- ☐ I përshtatshëm
- ☐ Shumë i përshtatshëm

8. Krahaseshmëria e atraktivitetit për investime në Kosovë me vendet fqinje?

- ☐ Më i papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm (neutrale)
- ☐ Më i përshtatshëm
- ☐ Shumë më i përshtatshëm

9. Pritshmëritë për gjendjen e biznesit për vitin e ardhshëm?

- ☐ Patundshmëri, qiradhënie, aktivitet të tjera biznesore
- ☐ Ndërtim
- ☐ Industri
- ☐ Shërbime financiare
- ☐ Transport dhe komunikim
- ☐ Shërbime tregtare
- ☐ Energjetikë
- ☐ Aktivitete të tjera

4.4 Përpunimi i të dhënave (Paraqitja e tyre)

Faktori ekonomik

1. Si e konsideroni faktorin ekonomik për investime në Kosovë?

Në pyetjen për stabilitetin e faktorit ekonomik investitorët janë përgjigjur: 52 % të tyre e kanë konsideruar faktor të papërshtatshëm për investime, 21 % deri-diku të përshtatshëm, 18 % të përshtatshëm, 9 % shumë të përshtatshëm për të investuar në Kosovë.

Faktori politik

2. Si e konsideroni stabilitetin e faktorit politik për investime në Kosovë?

Në pyetjen për stabilitetin e faktorit politik investitorët janë përgjigjur: 44 % të tyre e kanë konsideruar stabilitetin politik faktor të papërshtatshëm për investime, 43 % deri-diku të përshtatshëm, 9 % të përshtatshëm, 4 % shumë të përshtatshëm për të investuar në Kosovë.

Kosova në kontekstin e përpjekjeve për plotësimin e kushteve për integrimin në BE përdor praktika që politikat mbi ndërmarrjet zhvillohen në mënyrë të integruar, me përfshirjen e ministrive përkatëse. Ministria për Zhvillim Ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia për Investime në Kosovë, të cilat bëjnë hartimin e Planit Kombëtar për Zhvillim, të këshillohen me Odën Ekonomike të Kosovës dhe shoqatat e biznesit për bërjen e politikave të favorshme. Në një fazë më të avancuar të anëtarësimit, ministrinë përgjegjëse për përkrahjen e bizneseve dhe politikat industriale marrin pjesë në përgatitjen e projekteve që mund të financohen nga fondet parastrukturore. Së fundmi, duhet të ekzistojë një strukturë e koordinimit mes këtyre ministrive dhe përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, që do të ishte përgjegjëse për

thjeshtësimin dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit. Kjo pjesë duhet të fokusohet kryesisht në Strategjinë për Zhvillimin e Bizneseve.

3. Si e konsideroni legjislacionin në fuqi dhe sa është atraktiv për IHD-të në Kosovë?

Në pyetjen për legjislacionin në fuqi investitorët janë përgjigjur: 42 % të tyre e kanë konsideruar faktor të papërshtatshëm për investime, 37 % deri-diku të përshtatshëm, 12 % të përshtatshëm dhe 9 % shumë të përshtatshëm për të investuar në Kosovë.

4. Sa e konsideroni të përshtatshëm ligjin për mbrojtjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë?

Në pyetjen për ligjin për mbrojtjen e investimeve investitorët janë përgjigjur: 32 % të tyre e kanë konsideruar ligjin për mbrojtje të investimeve si faktor të papërshtatshëm për investime, 43 % deri-diku të përshtatshëm, 21 % të përshtatshëm dhe 4 % shumë të përshtatshëm për të investuar në Kosovë.

Faktori doganor dhe tatimor

5. Sa janë të përshtatshme politikat doganore për investime në Kosovë?

Në pyetjen “Sa janë të përshtatshme politikat doganore për investime në Kosovë” investitorët janë përgjigjur: 50 % të tyre i kanë konsideruar politikat doganore si faktorë të papërshtatshëm për investime, 25 % deri-diku të përshtatshëm, 14 % të përshtatshëm dhe 11 % prej tyre shumë të përshtatshëm për të investuar në Kosovë.

Vetëm 25 % të investitorëve e vlerësojnë legjislacionin doganor të jetë i favorshëm dhe përkrahës i investimeve. (Shih grafikun nr. 5 tek anekset). Për sa iu përket kostove të procedurave doganore, edhe pse ka pasur ndërhyrje për ndryshim të situatës, vërehet që efektet ende janë të vogla. Lidhur me kohëzgjatjen e procedurave doganore, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë deklaruar se është problematike. Vetëm 25 % të tyre mendojnë se kohëzgjatja e procedurave doganore është adekuate dhe e favorshme. Në përpjekje për të siguruar mjedis sa më atraktiv të biznesit, Dogana e Kosovës aplikon proceduara të avancuara për zhdoganimin e mallrave përmes sistemit elektronik - TIMS (Trade Information Management System), ku 90 % të deklarimeve bëhet përmes DTI (Direct Trade Input). Koha mesatare e vlerësuar për zhdoganim në kalimet kufitare është tri orë.

Tarifat doganore në Kosovë sa i përket importit janë:

- 0 % për mallrat që importohen nga vendet e CEFTA-s
- 10 % për mallrat që importohen nga të gjitha shtetet e tjera
- Taksa e akcizës variable për produkte si: duhani, nafta, alkooli, kafe etj.

Pas ndryshimeve të bëra në sistemin doganor është bërë reduktimi i tarifave doganore për: mjetet kapitale (themelore); lëndët e para për agrobiznesin dhe disa sektorë të tjerë të prodhimtarisë së lëndëve të ndërmjetme për procesim të mëtejshëm nga 10 % në 0 %.

Tarifat doganore janë bërë zero për:

- Plehurat kimike
- Prodhimet farmaceutike
- Instrumentet dhe aparaturat kirurgjike
- Ndihmat humanitare
- Mallrat që përdoren nga diplomatët e huaj dhe misionet konsullore

- KFOR-i
- UNHCR-ja
- Kryqi i Kuq Ndërkombëtar
- OJQ-të e regjistruara që kanë qëllim mbështetjen e programeve dhe projekteve humanitare dhe rindërtuese në Kosovë.

Sistemi tatimor

6. Sa janë të përshtatshme politikat tatimore për investime në Kosovë?

Rezultatet e paraqitura tregojnë se 42 % të kompanive të intervistuar vlerësojnë legjislacionin tatimor të jetë i papërshtatshëm, 39 % e tyre deri-diku të përshtatshëm dhe të mos kontribuojë në tërheqjen e investimeve, 14 % të tyre e konsiderojnë të përshtatshëm dhe 5 % shumë të përshtatshëm.

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar drejt rregulloreve të thjeshta, të cilat sigurojnë bazë të gjerë tatimore dhe normat më të ulëta tatimore në rajon dhe më gjerë.

Tatimet dallojnë në bazë të formës së biznesit dhe qarkullimit vjetor.

Administrata tatimore aplikon tri regjime kryesore të tatimeve:

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)
- Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave (TAK)
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave paguhet çdo tre muaj mbi qarkullimin vjetor. Norma e tatimit në korporata me qarkullim vjetor mbi 50 000 € është 10 %.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale aplikohet në të ardhura nga paga, biznesi, qiraja, interesi, pasuria e patundshme etj. Normat tatimore të tatimit në të ardhura personale nga paga janë progresive, duke u bazuar në madhësinë e pagës së fituar, njëherësh norma më të ulëta në rajon.

Normat tatimore janë:

- 0 % deri në 960 euro/vit
- 4 % mbi 960 dhe 3 000 euro/vit
- 8 % mes të 3 001 dhe 5 400 euro/vit
- 10 % mbi 5 400 euro vit.

Kontributet pensionale. Përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e llogarive individuale për kursimin e pensionit është Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Ky tatim i obligon të punësuarin dhe punëdhënësin të kontribuojnë në financimin e pensioneve të punësuarit me normë prej 5 % të pagës nga ana e të punësuarit dhe 5 % nga ana e punëdhënësit.

Në tabelën 4.1 mund të shihen taksat e vendeve të rajonit

Vendi	Tatimi në fitim dhe korporata	Tatimi në të ardhura	TVSH
Kosova	10%	4-8-10%	16%
Shqipëria	N/A	10 %	20%
Mali i Zi	9%	12%	17%
Maqedonia	10%	10%	18%
Serbia	10%	10-20%	18%
Kroacia	20%	15-45%	23%
Bullgaria	10%	10%	20%
Greqia	25%	0-40%	19%
Rumania	16%	16%	19%

Shënim: Valuta e Shqipërisë është leku, prandaj edhe norma e tatimit llogaritet në lekë.

Përdorimi i euros si valutë ndikon në krijimin e mjedisit të besueshëm, me inflacion të ulët.

7. Sa është i përshtatshëm ndikimi i kostos së punës për investime të huaja direkte në Kosovë

Rezultatet e paraqitura tregojnë se 30 % për qind të kompanive të intervistuar e vlerësojnë ndikimin e kostos së punës të jetë shumë i përshtatshëm, 45 % të tyre të përshtatshëm, 20 % e konsiderojnë deri-diku të përshtatshëm dhe 5 % të papërshtatshëm.

8. Krahasueshmëria e atraktivitetit të investimeve në Kosovë me vendet fqinje

Rezultatet e paraqitura tregojnë se 45 % të kompanive të intervistuar e vlerësojnë më të papërshtatshëm ambientin e të bërit biznes në Kosovë në krahasim me vendet fqinje, 35 % të tyre deri-diku të përshtatshëm ose neutral dhe të mos kontribuojë në tërheqjen e investimeve, kurse 9 % e konsiderojnë më të përshtatshëm se vendet fqinje dhe 11 % shumë më të përshtatshëm sesa në vendet fqinje.


9. Pritshmëritë për gjendjen e biznesit për vitin e ardhshëm

Në lidhje me pritshmëritë, rreth gjysma e bizneseve janë optimiste dhe mendojnë se do të ketë rritje të numrit të të punësuarve, ndërsa 48 % mendojnë se nuk do të ketë ndryshim. Sipas sektorëve, pritshmëritë janë të vogla për sektorin e tregtisë, energjetikës dhe aktivitete të tjera biznesore.

Edhe një gjetje e rëndësishme e këtij hulumtimi ka të bëjë me përdorimin e kapaciteteve (aseteve) të kompanisë. Më shumë se 50 % të kompanive i vënë në funksion më pak se 51 % të aseteve të tyre, ndërsa vetëm 20 % të tyre i vënë në funksion 70 % të aseteve që i posedojnë. Për më tepër, ky studim ka trajtuar edhe barrierat me të cilat hasen bizneset në Kosovë. Nëse i bëjmë një vështrim sektorial ambientit afarist në Kosovë, prapë situata pasqyrohet e ngjashme dhe

pritjet e bizneseve nuk janë shumë premtuese. Në lidhje me pritshmëritë për të ardhmen, më tepër se 70 për qind të kompanive të ndërtimit presin që punësimi të rritet. Ky është parashikimi më optimist nga të gjithë sektorët e ekonomisë kosovare. Nga ana tjetër, një përqindje shumë e lartë e kompanive (74 %) që veprojnë në sektorin e shitjes me pakicë presin të mbetet i njëjtë. Megjithatë, pritjet që zhvillimi të bjerë, kapin një përqindje të vogël në mes 3-7 për qind të kompanive në të gjithë sektorët. Pra, në total, perspektiva e zhvillimit në të ardhmen e afërt është mesatarisht pozitive. (Shih grafikun nr. 9 tek anekset).

Grafiku 4.1 Përmbledhja e rezultateve të pyetësorit



Burimi: Përpunimi i autorit 2015

4.5 Përgjigjet e pyetjeve të kërimit dhe rezultatet

Për këtë studim është përdorur intervistimi gjysmë i strukturuar për t'i intervistuar 48 përfaqësues të ndërmarrjeve të huaja që kanë investuar në Kosovë. Është marrë opinioni nga ta për favorët dhe vështirësitë që ata kanë hasur gjatë investimit të tyre në Kosovë, sa ka ndikuar

klima e biznesit dhe stabiliteti politik në vendimarrjen e tyre për të investuar ose jo në Kosovë, si dhe a janë të gatshëm të investojnë edhe në vitet e ardhshme në Kosovë.

Pyetësorët përmbajnë nëntë pyetje. Të gjitha përgjigjet që kanë dalë nga këto pyetje i kam paraqitur në grafikun përmbledhës, duke i renditur pyetjet në mënyrë vertikale, kurse rezultatet në mënyrë horizontale. Gjithashtu, është bërë edhe paraqitja grafike për secilën pyetje veç e veç.

Analiza ekonometrike për IHD-të në Kosovë është bërë për t'i identifikuar përcaktuesit e IHD-ve në Kosovë.

Nëpërmjet modelit VECM rezultatet kanë treguar se të gjitha variablat kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e IHD-ve në Kosovë. Janë vërtetuar edhe hipotezat e ngritura në këtë studim. Të gjitha janë të paraqitura hollësisht në kapitullin e katërt.

4.5.1 Atraktiviteti i Kosovës për investime të huaja – Testet statistikore

Në perpjekje për të analizuar se si influencojnë gjithë faktorët e përzgjedhur në lidhje me atraktivitetin e ardhshëm të Kosovës për investimet e huaja, si përshtatshmëria ekonomike, politike, legjislacioni, legjislacioni në mbrojtje të IHD, politikat doganore, politikat tatimore dhe kostot e punës në pritshmëritë për të bërë biznes në të ardhmen në sektorë të ndryshëm të ekonomisë u përdor testi i Kruskall Wallis. Ky test nuk është gjë tjetër veçse analizë variance për të dhënat jo-parametrike. Analizat statistikore mbi të dhënat jo-parametrike nuk bazohen mbi supozimet e shpërndarjes probabilitare të të dhënave pra nuk supozohet se të dhënat dhe termi i tyre i gabimit ka shpërndarje normale. Rezultatet tregojnë se asnjëri nga faktorët nuk shfaq ndikim statistikisht të rëndësishëm në zhvillimin ose jo të aktiviteteve të biznesit në Kosovë

Tabela 4.2: Statistikat e testit Kruskall Wallis

	Ekonomik	Politik	Legjislacioni	Mbrojtja e IHD	Politikat doganore	Politikat tatimore per IHD	Kostot e punes
Chi-Square	3,064	2,639	1,119	1,028	3,394	3,541	,896
gl	3	3	3	3	3	3	3
Sign. asimptotica	,382	,451	,773	,795	,335	,315	,826

a. Test di Kruskal Wallis

b. Variabli i varur apo i grupimit : Zhvillimi i biznesit në të ardhmen

Një tjetër element me rëndësi është të hulumtojmë se si perceptohen indikatorët e përzgjedhur për analizë nga firmat e huaja. Pra a ka ndryshime statistikisht të rëndësishme kur krahasojmë perceptimet për përshtatshmërinë ekonomike me ato politike e kështu me rradhë.

Testi i përdorur në këtë rast është Wilcoxon signed-rank, analogu i krahasimit në çift për të dhënat me shpërndarje normale (në shumicën e rasteve e gjejmë në termin anglisht si paired t-test). Testi i Wilcoxon ashtu si Kruskall Wallis është një metodë jo parametrike që do të thotë se nuk bazohemi në supozimin se të dhënat janë shpërndarë normalisht. Më poshtë vijon paraqitja e të dhënave ilustruese dhe disa rezultate të këtij testi statistikor. Shihet që nga krahasimet në çift midis treguesve të ndryshëm të përshtatshmërisë vlerësimet që kanë dhënë bizneset në lidhje me përshtatshmërinë (1 e papërshtatshme, 2 deri diku, 3 e përshtatshme dhe 4 shumë përshtatshme) të gjithë treguesit janë vlerësuar më pak të përshtatshëm se kostot e punës (shiko tabelen 4.3). Pra

rezultatet tregojnë dhe njëherë se në vendet në zhvillim faktori kryesor që tërheq investitorët e huaj është fuqia e lirë punëtore. Megjithatë që kostot e punës të shëndërrohen realisht në faktorë tërheqës të IHD-ve duhet që të konsiderohen si shumë të përshtatshme dhe faktorët e tjerë si ai politik, ekonomik, ligjor etj.

Tabela 4.3: Testi i Wilcoxon mbi Kostot e punës dhe faktorëve të tjerë

	Kostot e punes vs Politikatatimore	Kostot e punes vs Politikatdoganore	Kostot e punes vs Mbrojtja e IHD	Kostot e punes vs Legjislacioni	Kostot e punes vs Politik	Kostot e punes vs Ekonomik
Z	-5,020 ^c	-4,816 ^c	-4,424 ^c	-4,390 ^c	-5,062 ^c	-4,907 ^c
Rendesia statistikore asimptotike p (0.01)	,000	,000	,000	,000	,000	,000

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur rezultatet për krahasimet në çift midis treguesve të tjerë dhe shohim që asnjë nga krahasimet nuk është statistikisht i rëndësishëm pra të gjithë faktorët janë konsideruar njëloj të përshtatshëm.

Tabela 4.4: Testi i Wilcoxon për krahasimet midis faktorëve

	Legjisla cioni vs Politik	Mbrojtja e IHD vs Politik	Politik at dogano re vs Politik	Politikat doganore vs Mbrojtja e IHD	Politikat tatimore per IHD vs Politik	Politi k vs Ekono mik	Legjisl acioni - Ekono mik
Z	-1,407 ^c	-1,422 ^c	-,319 ^c	-,920 ^b	-,300 ^c	-,437 ^b	-,713 ^c
Rendesia statistikore asimptotike p(0.01)	,159	,155	,750	,357	,764	,662	,476

Tabela 4.5: Testi i Wilcoxon për krahasimet midis faktorëve

	Mbrojtja e IHD vs Legjislac ioni	Politik at tatimor e per IHD vs Ekono mik	Politik at dogano re vs Legjisl acioni	Politikat tatimore per vs Politikat doganor e	Politikat tatimore per IHD vs Mbrojtja e IHD	Politik at tatimor e per IHD vs Legjisl acioni	Mbrojt ja e IHD - Ekono mik	Politi kat doga nore - Ekon omik
Z	-,051 ^c	-,034 ^b	-1,049 ^b	-,016 ^b	-1,151 ^b	-,918 ^b	-,745 ^c	-,304 ^b
Rendesia statistikore asimptotike p(0.01)	,959	,973	,294	,987	,250	,358	,456	,761

4.5.2 Analizë ekonometrike mbi IHD-të në Kosovë

Literatura mbi Investimet e Huaja Direkte në vendet me ekonomi në tranzicion është mjaft e pasur. Vrojtuesit janë përqendruar në dy pika kryesore: analizën e përcaktuesve të investimeve të huaja direkte, duke përfshirë studimin e lidhjes ndërmjet klimës së investimeve dhe IHD-ve dhe analizën e impaktit të IHD-ve në ekonominë e vendit si nga pikëpamja makroekonomike (rritja ekonomike e mbarëvajtja e tregtisë), ashtu edhe nga ajo mikroekonomike (ristrukturimi dhe ecuria e ndërmarrjes).

Në këtë analizë do të shihet efekti i IHD-ve mbi normën e rritjes ekonomike, duke përdorur modelet që përshtaten më mirë me të dhënat, variabat e përzgjedhura dhe qëllimin e punimit. Përpara se të kalojmë në rezultatet e përftuara nga vlerësimi i modeleve, është e rëndësishme të bëhet një përmbledhje e literaturës që ekziston mbi Investimet e Huaja Direkte dhe mbi faktorët që mendohet të kenë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e sjelljes së tyre.

Metodologjia e përdorur në këtë punim konsiston në përdorimin e modeleve dhe teknikave të ndryshme të bëra ndaj treguesve që ndikojnë në lidhjen mes IHD-ve dhe rritjes ekonomike. Është përdorur metodologjia e vlerësimit të regreseve VECM me synim afatgjatë se si ndikojnë IHD-të në rritjen ekonomike të Kosovës.

Të dhënat për VECM

Në analizën e bërë në këtë punim janë përdorur treguesit që nga 2006-a deri në fund të 2013-s. Të dhënat e përdorura janë vjetore. Variablat e përdorura janë IHD-të, PBB-ja dhe Investimet e huaja direkte.

4.5.3 Ndikimi i IHD-ve në rritjen ekonomike

Pasi pamë faktorët që përcaktojnë Investimet e Huaja Direkte në Kosovë, është e rëndësishme ta shohim ndikimin që kanë këto të fundit në rritjen ekonomike. Ka mjaft studime të bëra rreth IHD-ve dhe rritjes ekonomike, gjetjet e të cilave variojnë sipas metodave të ndryshme që ata përdorin. Të dhënat janë seri kohore me frekuencë vjetore dhe mbulojnë periudhën 1970-2005. Studimi gjen se nuk ka shkakësi midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike për të gjithë periudhën e zgjedhur dhe asaj para programit SAP. Megjithatë, IHD-të shkaktojnë rritje të PBB-së gjatë periudhës pas SAP.

Duke qenë se interesohemi ta studiojmë lidhjen që ekziston midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike në periudhën afatgjatë, kemi zgjedhur të vlerësojmë një model të korrektimit të gabimit VECM, duke përdorur të dhëna vjetore për normën e rritjes ekonomike dhe Investimet e Huaja Direkte si raport ndaj PBB-së për periudhën 2002-2013. Modeli i korrektimit të gabimit është një rast i veçantë i modeleve VAR për variablat që janë stacionare në diferencë të parë ose e thënë ndryshe që janë të integruara të rendit të parë (I(1)).

Modeli VAR u zhvillua për herë të parë nga makro-ekonometricieni Christopher Sims në vitin 1980 për t'i modeluar ndërveprimet dinamike midis variablave stacionare. Që prej kësaj kohe këto modele me vektorë autoregresivë janë përdorur për t'i përshkruar dinamikën dhe marrëdhëniet shkakësore midis grupeve të ndryshme të variablave makroekonomike. Përparësia e përdorimit të kësaj metode qëndron në faktin se ajo i trajton të gjitha variablat e përfshira në model si endogjenë potencialë, pa pasur nevojë për ndonjë supozim mbi varësinë apo pavarësinë e tyre në model.

Në vijim do të përshkruhen hapat që janë ndjekur për vlerësimin e modelit. Në mënyrë që ta përdorim modelin VECM seritë kohore duhet të jenë të integruara të rendit të parë. Stacionariteti

i serive është veçanërisht i rëndësishëm kur konsiderojmë efektet e “goditjeve” përgjatë procesit të përshtatjes së variablave të ndryshme në model (Verbeek, 2004). Kur punohet me seri kohore, është e këshillueshme të paraqiten të dhënat grafikisht, përderisa një vështrim i ecurisë së tyre përgjatë kohës mund të sinjalizojë probleme të mundshme. Në qoftë se shihet se një seri kohore nuk i rikthehet një vlerë mesatare apo nuk ka variancë konstante, atëherë ka shumë të ngjarë që seria të mos jetë stacionare. Seritë kohore fillestare të variablave të modelit janë paraqitur grafikisht në figurën 1 të shtojcës. Në grafikët mund të shihet se seritë kohore të variablave makroekonomike janë procese jostacionare dhe ndjekin një trend të rastësishëm. Jostacionariteti i serive kohore mund të vijë nga burime të ndryshme, por më i rëndësishmi prej tyre është prania e të ashtuquajturave rrënjë njësi. Në mënyrë që të testohet prania e rrënjëve njësi në seritë kohore, është përdorur testi ADF mbi të dyja seritë. Hipotezat që ngrihen në këtë rast janë:

H_0 : Seria ka të paktën një rrënjë unitare

H_a : Seria nuk ka rrënjë unitare (pra, është stacionare).

Rezultatet e testit ADF paraqiten në figurë. Ato tregojnë se asnjëra nga seritë kohore nuk është stacionare në nivel, përderisa vlera e p-së për secilën nga seritë është më e madhe se niveli i rëndësisë α (gjë që nuk na lejon ta hedhim poshtë hipotezën zero). Ky fakt nuk duhet të na habisë, përderisa paraqitja grafike tregoi se të dyja seritë fillestare përmbajnë një trend.

Tabela 1. Testi ADF për normën e rritjes ekonomike

Null Hypothesis: RRITJA has a unit root

Exogenous: Constant, Linear Trend

Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=1)

	t-Statistic	Prob.*

Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.012595	0.1772
Test critical values: 1% level	-5.295384	
5% level	-4.008157	
10% level	-3.460791	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Warning: Probabilities and critical values calculated for 20 observations and may not be accurate for a sample size of 10

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(RRITJA)

Method: Least Squares

Date: 03/04/15 Time: 15:52

Sample (adjusted): 2004 2013

Included observations: 10 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
RRITJA(-1)	-1.114727	0.370022	-3.012595	0.0196
C	5.023583	2.298186	2.185891	0.0651
@TREND("2003")	-0.080533	0.202767	-0.397172	0.7031
R-squared	0.565415	Mean dependent var	-0.202530	
Adjusted R-squared	0.441248	S.D. dependent var	2.419077	
S.E. of regression	1.808252	Akaike info criterion	4.265923	
Sum squared resid	22.88843	Schwarz criterion	4.356699	
Log likelihood	-18.32962	Hannan-Quinn criter.	4.166343	
F-statistic	4.553669	Durbin-Watson stat	1.766415	
Prob(F-statistic)	0.054108			

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Tabela 2. Testi ADF për serinë e IHD-ve

Null Hypothesis: IHD has a unit root

Exogenous: Constant, Linear Trend

Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=1)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-1.722477	0.6572
Test critical values: 1% level	-5.521860	
5% level	-4.107833	
10% level	-3.515047	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Warning: Probabilities and critical values calculated for 20 observations

and may not be accurate for a sample size of 9

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(IHD)

Method: Least Squares

Date: 03/04/15 Time: 15:53

Sample (adjusted): 2005 2013

Included observations: 9 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
IHD(-1)	-0.508857	0.295421	-1.722477	0.0358
C	214.9321	92.36579	2.326967	0.0589
@TREND("2003")	-7.896786	13.65810	-0.578176	0.5842
R-squared	0.495424	Mean dependent var	23.03222	
Adjusted R-squared	0.327232	S.D. dependent var	110.5468	

S.E. of regression	90.67320	Akaike info criterion	12.11360
Sum squared resid	49329.78	Schwarz criterion	12.17934
Log likelihood	-51.51121	Hannan-Quinn criter.	11.97173
F-statistic	2.945584	Durbin-Watson stat	2.207678
Prob(F-statistic)	0.128464		

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Në vijim janë krijuar seri të reja duke marrë diferencat e para të serive fillestare. Një transformim i tillë është përdorur me qëllim që seritë jostacionare të kthehen në stacionare, në mënyrë që të jenë të përshtatshme për t'u përfshirë në model. Një çështje me rëndësi kritike në modelet VAR/VECM është përcaktimi i vonesës kohore (*lag*-ut), me të cilën do të përfshihen në model variablat endogjene.

Lütkepohl, (2005) tregon se si një specifikim jo i mirë i modelit VAR ndikon në rezultatet e tij: zgjedhja e një numri vonesash kohore që është më i madh ose më i vogël se numri optimal, e ulë fuqinë parashikuese të modelit. Ekzistojnë kritere dhe teste të ndryshme statistikore, që mund të ndihmojnë në përcaktimin e numrit optimal të vonesave kohore. Zakonisht, kriteret më të përdorura për zgjedhjen e modelit më të përshtatshëm janë: kriteri Akaike i informacionit (AIC), kriteri Schwarz Bayesian (BIC), kriteri Hannan-Quinn (HQ) etj. Preferohen modelet që kanë një kriter të ulët informacioni, sepse secili prej këtyre kriterëve penalizon numrin e madh të variablave. Kriteret AIC dhe HQ sugjerojnë se numri optimal i vonesave kohore është 2 (shih figurën 4 më poshtë). Ky përfundim përforcohet edhe nga fakti se numri i vrojtimeve është shumë i vogël dhe një numër më i madh vonesash kohore do të krijonte probleme me shkallët e lirisë, duke moslejuar kështu vlerësimin e modelit.

Tabela 3. Kriteri i selektimit të Lag-ut

VAR Lag Order Selection Criteria

Endogenous variables: IHD

RRITJA

Exogenous variables: C

Date: 03/04/15 Time: 15:14

Sample: 2002 2013

Included observations: 7

Lag	LogL	LR	FPE	AIC	SC	HQ
0	-49.34853	NA*	8096.512	14.67101	14.65555	14.48000
1	-49.27776	0.080870	27894.60	15.79365	15.74728	15.22061
2	-34.27193	8.574760	2207.787*	-107.3034*	-107.4116*	-108.6405*
3	389.5620	0.000000	NA	12.64912	12.57185	11.69407

* indicates lag order selected by the criterion

LR: sequential modified LR test statistic (each test at 5% level)

FPE: Final prediction error

AIC: Akaike information criterion

SC: Schwarz information criterion

HQ: Hannan-Quinn information criterion

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Në modelet VAR/VECM, zakonisht përdoret testi i Grangerit për t'i analizuar marrëdhëniet shkakësore midis variablave. Ideja kryesore e këtij testi është të shihet nëse ndryshimet në një variabël do të kenë ndikim mbi ndryshimet në variablat e tjera. Në këtë mënyrë, ky test na shërben për të parë nëse një variabël ndihmon ta shpjegojë ecurinë e variablave të tjera për disa periudha kohore të ardhshme. Testi i shkakësisë i Grangerit ndërtohet

zakonisht si një test F, ku hipoteza zero është që informacioni në periudhat e shkuara mbi variablin x_t nuk siguron ndonjë informacion statistikisht të rëndësishëm rreth variablit y_t . Me fjalë të tjera, x_t nuk e shkakton y_t . Testi i Grangerit është një mjet standard që përdoret në pjesën më të madhe të modeleve autoregresive, megjithatë rezultatet e tij duhet të përdoren dhe të interpretohen me kujdes. Ky test është më i vlefshëm në një sistem me dy variabla, ku hipoteza mbi shkakësinë mund të formulohet lehtësisht.

Tabela 4. Testi Granger i shkakësisë

Pairwise Granger Causality Tests

Date: 03/04/15 Time: 16:13

Sample: 2002 2013

Lags: 2

Null Hypothesis:	Obs	F-Statistic	Prob.
IHD does not Granger Cause RRITJA	6	115.212	0.0457
RRITJA does not Granger Cause IHD		2.49636	0.4085

Burimi: Autori 2015

Hipotezat që duam të testojmë janë:

H_{01} : IHD-të nuk shkaktojnë rritje dhe H_{02} : Rritja nuk shkakton IHD-të H_{a1} : IHD-të shkaktojnë rritje dhe H_{a2} : Rritja shkakton IHD-të .

Meqenëse $p_1 = 0.0457 < \alpha = 0.05$ dhe $p_2 = 0.4085 > \alpha = 0.05$ themi se Investimet e Huaja Direkte ndikojnë te norma e rritjes ekonomike, ndërsa kjo e fundit nuk ndikon në nivelin e IHD-ve. Pra, midis këtyre dy variablave ekziston një marrëdhënie shkakësore e njëanshme.

Në vijim janë paraqitur rezultatet e testeve të kointegrimit: testi Johansen dhe Engel-Granger, për të parë nëse ekziston ndonjë marrëdhënie afatgjatë midis këtyre dy variablave dhe për të vlerësuar më tej ekuacionin që përshkruan këtë marrëdhënie.

Hipotezat e këtij testi janë:

H0: Seritë nuk janë të kointegruara

Ha: Seritë janë të kointegruara.

Siç shihet nga tabela, vlerat e p-së janë më të vogla se 0.05, gjë që do të thotë se hipoteza zero hidhet poshtë dhe seritë e marra në analizë janë të kointegruara me njëra-tjetrën. Kjo nënkupton se ka vlerë të vlerësohet më tej ekuacioni i VECM-së për ta studiuar lidhjen midis dy variablave.

Tabela 5. Rezultatet e testit Engel-Granger

Date: 03/04/15 Time: 16:26

Series: IHD RRITJA

Sample (adjusted): 2004 2013

Included observations: 10 after adjustments

Null hypothesis: Series are not cointegrated

Cointegrating equation deterministics: C

Automatic lags specification based on Schwarz criterion
(maxlag=1)

Dependent	tau-statistic	Prob.*	z-statistic	Prob.*
IHD	-2.461885	0.0496	-5.785337	0.0456
RRITJA	-3.005472	0.0595	-9.517932	0.0630

*MacKinnon (1996) p-values.

Warning: p-values may not be accurate for fewer than 20 observations.

Intermediate Results:

	IHD	RRITJA
Rho - 1	-0.642815	-1.057548
Rho S.E.	0.261107	0.351874
Residual variance	5092.064	1.673046
Long-run residual variance	5092.064	1.673046
Number of lags	0	0
Number of observations	9	9
Number of stochastic trends**	2	2

**Number of stochastic trends in asymptotic distribution

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Tabela 6. Rezultatet e testit Johansen

Date: 03/04/15 Time: 16:33

Sample (adjusted): 2006 2013

Included observations: 8 after adjustments

Trend assumption: Linear deterministic trend

Series: IHD RRITJA

Lags interval (in first differences): 1 to 1

Unrestricted Cointegration Rank Test (Trace)

Hypothesized		Trace	0.05	
No. of CE(s)	Eigenvalue	Statistic	Critical Value	Prob.**
None *	0.806001	19.28307	15.49471	0.0128
At most 1 *	0.537210	6.163853	3.841466	0.1030

Trace test indicates 2 cointegrating eqn(s) at the 0.05 level

* denotes rejection of the hypothesis at the 0.05 level

**MacKinnon-Haug-Michelis (1999) p-values

Unrestricted Cointegration Rank Test (Maximum Eigenvalue)

Hypothesized		Max-Eigen	0.05	
No. of CE(s)	Eigenvalue	Statistic	Critical Value	Prob.**
None	0.806001	13.11922	14.26460	0.0130
At most 1 *	0.537210	6.163853	3.841466	0.0752

Max-eigenvalue test indicates no cointegration at the 0.05 level

* denotes rejection of the hypothesis at the 0.05 level

**MacKinnon-Haug-Michelis (1999) p-values

Unrestricted Cointegrating Coefficients (normalized by b'*S11*b=I):

IHD	RRITJA
0.012886	0.259508
0.006798	1.162224

Unrestricted Adjustment Coefficients (alpha):

D(IHD)	88.33244	20.24258
D(RRITJA)	0.540313	0.994700

1 CointegratingLog
Equation(s): likelihood -54.23441

Normalized cointegrating coefficients (standard error in parentheses)

IHD	RRITJA
1.000000	-20.13920
	(17.2634)

Adjustment coefficients (standard error in parentheses)

D(IHD)	-0.138225
	(0.33109)
D(RRITJA)	-0.006962
	(0.00891)

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Tabela 7. Vlerësimi i modelit VECM për ta parë ndikimin e IHD-ve tek rritja ekonomike

Vector Error Correction Estimates

Date: 03/04/15 Time: 16:42

Sample: 2002Q1 2013Q4

Included observations: 10

Standard errors in () & t-statistics in []

Cointegrating Eq: CointEq1

IHD(-1)	1.000000
---------	----------

RRITJA(-1)	-2.0322
	(0.4507)
	[-4.57631]

C	-3.12208
---	----------

Error Correction:	D(IHD)	D(RRITJA)
-------------------	--------	-----------

CointEq1	-0.14925	0.001834
----------	----------	----------

	(0.0314)	(0.00049)
	[-4.75222]	[3.71894]
D(IHD(-1))	-0.107054	0.065724
	(0.11719)	(0.01840)
	[-0.91348]	[3.57208]
D(RRITJA(-1))	-1.292148	-0.304598
	(0.80906)	(0.12702)
	[-1.59710]	[-2.39798]
C	0.377282	-0.008556
	(0.10471)	(0.01644)
	[3.60324]	[-0.52046]

R-squared	0.393167	0.549414
Adj. R-squared	0.351792	0.518692
Sum sq. resids	20.60490	0.507888
S.E. equation	0.684320	0.107438
F-statistic	9.502513	17.88352
Log likelihood	-47.81292	41.05962
Akaike AIC	2.158872	-1.544151
Schwarz SC	2.314805	-1.388217
Mean dependent	0.339583	0.007382
S.D. dependent	0.849966	0.154862

Determinant resid covariance (dof adj.)	0.005403
Determinant resid covariance	0.004540
Log likelihood	-6.742310
Akaike information criterion	0.697596
Schwarz criterion	1.087430

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Rezultatet e modelit VECM sugjerojnë se IHD-të kanë ndikim pozitiv statistikisht të rëndësishëm te rritja ekonomike në periudhën afatgjatë. Duhet pasur parasysh se koeficientet në një model VECM interpretohen në të kundërt me shenjat që rezultojnë pas vlerësimit të modelit. Koeficienti i korrektimit të gabimit, i cili është -0.149, tregon se duhen rreth shtatë vjet që të arrihet ekuilibri i gjendjes së qëndrueshme.

4.6 Përfundime

Modelet e përdorura në këtë punim japin rezultate mjaft të vlefshme lidhur me faktorët që përcaktojnë IHD-të në Kosovë si dhe ndikimin e këtyre të fundit në rritjen ekonomike. Megjithatë, ato karakterizohen nga një sërë kufizimesh. Një numër i vogël i të dhënave nuk lejon përfshirjen në model të një numri më të madh variablash, që në rast se do të ishte e mundur, do të ndihmonte në një shpjegim më të mirë të mënyrës së ndërveprimit të variablave makroekonomike me njëri-tjetrin.

Nga ana tjetër, marrja parasysh e një numri të kufizuar variablash mund të çojë në problemin e specifikimit jo të mirë të modelit për shkak të mospërfshirjes së variablave të rëndësishme, gjë që ka pasoja për koeficientët e vlerësuar të modelit (Lütkepohl, 2005). Pavarësisht kufizimeve të mësipërme, modelet japin një kontribut të rëndësishëm në identifikimin e efektit që sjellin IHD-të dhe mbi lidhjen e tyre me rritjen ekonomike, si dhe ofron një bazë të mirë për analiza të mëtejshme në fushën e investimeve të huaja direkte. (Modeli VECM).

Nga ana tjetër edhe analiza joparametrike e testeve statistikore e Kruskal Wallis dhe Wilcoxon, edhe pse numri i vogël i mostres prej 48 ndermarjeve të shqyrtuara në analizë përbënë element me rëndësi për analizen sepse teknika e zgjedhur statistikore nuk i nënshtrohet

ligjit të shpërndarjes normale por gjithsesi hidhen themelet për studime të mëtejme lidhur me IHD-të në Kosovë.

Si rezultat i pyetsoreve dhe intervistave dalin rekomandimet e mëposhtme:

I. Duhet të krijohen mundësitë ekonomike investitorëve për të investuar në Kosovë. (Shih grafikun nr. 1 tek anekset).

II. Gjetjet tregojnë se stabiliteti politik për të investuar është i papërshtatshëm. Obligohet Kosova ta përmirësojë ambientin politik në mënyrë që investitorët të kanë siguri politike për të investuar në Kosovë. (Shih grafikun nr. 2 tek anekset).

III. Legjislacioni në fuqi, atraktiviteti i tij për thithjen e IHD-ve dhe Ligji për mbrojtje të investitorëve, nuk janë atraktivë për investime. Duhet të përmirësohet korniza ligjore në mënyrë që investitorët të kanë siguri ligjore për të investuar në Kosovë. (Shih grafikun nr. 3 tek anekset)

Investitorët kosovarë e vlerësojnë tejet problematike mbrojtjen e investitorëve që ofrohet nga ligji aktual. Shqetësues mbetet më shumë vlerësimi i tyre me vetëm 9 % të të anketuarve që këtë ligj e cilësojnë faktor të fuqishëm për të investuar në Kosovë.

IV. Shqetësim tjetër nga investitorët është se Legjislacioni në fuqi nuk ofron mbrojtje të investimeve. (Shih grafikun nr. 4 tek anekset).

Nga ky hulumtim arritëm të kuptojmë se në përgjithësi thjeshtësia e procedurave për marrje të licencave është faktor përkrahës për tërheqjen e investime. Në total, gjysma e investitorëve e konsiderojnë thjeshtësinë e procedurave për marrje të licencave si element tejet pozitiv. Në përqindje të barabarta janë ndarë ata që e cilësojnë si problematike dhe kanë qëndrim neutral rreth ndikimit të tyre në investime në Kosovë.

V. Politikat doganore janë shumë të pafavorshme për të investuar në Kosovë. Detyrë tjetër është përmirësimi i politikave doganore në mënyrë që investorët të kanë lehtësira doganore që të nxiten për të investuar në Kosovë.

VI. Politikat tatimore janë shumë të pafavorshme për të investuar në Kosovë. Vetëm 19 % të investorëve i vlerësojnë të përshtatshme politikat tatimore dhe përkrahëse të investimeve. (Shih grafikun nr. 6 tek anekset).

VII. Një ndër faktorët që mund të konsiderohet pozitiv në mjedisin afarist të Kosovës është kostoja e punës. Situata konsiderohet e favorshme për 75 % të kompanive investuese në vend, 20 % deri-diku të përshtatshëm sa i takon kostos së punës, vetëm rreth 5 % janë deklaruar të jetë e papërshtatshme. Pavarësisht rezervave mjaft të mëdha që kanë shprehur bizneset e intervistuar në lidhje me disponueshmërinë e fuqisë punëtore të kualifikuar në Kosovë, vlerësime pozitive japin për koston e punës në vend. (Shih grafikun nr. 7 tek anekset).

VIII. Ambienti për investime në Kosovë është shumë më i pafavorshëm për të investuar në Kosovë sesa në vendet fqinje. (Shih grafikun nr. 8 tek anekset).

IX. Rreth gjendjes së përgjithshme të biznesit në vend gjendja nuk është premtuese. Kompanitë në sektorin e tregtisë dhe energjetikës janë më pak të kënaqura me situatën aktuale biznesore, ndërsa sektori i patundshmërive, qirave, shërbimet financiare dhe ndërtimi është më i kënaqshëm.

Edhe një gjetje e rëndësishme e këtij hulumtimi ka të bëjë me përdorimin e kapaciteteve (aseteve) të kompanisë. Më shumë se 50 % të kompanive i vënë në funksion më pak se 51 % të aseteve të tyre, ndërsa vetëm 20 % të tyre i vënë në funksion 70 % të aseteve që i posedojnë. Për më tepër, ky studim ka trajtuar edhe barrierat me të cilat hasen bizneset në Kosovë. Nga të dhënat e mbledhura është konkluduar se qasja në financa dhe mungesa e ligjit janë disa nga

pengesat më të mëdha të të bërit biznes në Kosovë. Nëse i bëjmë një vështrim sektorial ambientit afarist në Kosovë, prapë situata pasqyrohet e ngjashme dhe pritjet e bizneseve nuk janë shumë premtuese. Nga ana tjetër, një përqindje shumë e lartë e kompanive (74 %) që veprojnë në sektorin e shitjes me pakicë presin të mbetet i njëjtë. Pra, në total, perspektiva e zhvillimit në të ardhmen e afërt është mesatarisht pozitive. (Shih grafikun nr. 9 tek anekset).

KAPITULLI V

5.1 PËRMBLEDHJE DHE GJETJE EMPIRIKE

Hapja tregtare (H1). Studimet tregojnë se IHD-të kanë qenë faktorë të rëndësishëm në prodhimin ekonomik në vendet në zhvillim. Lidhja e fortë mes IHD-ve dhe normës së rritjes së PBB-së, siç tregoi analiza ekonometrike modeli VECM dhe Testet Kruskall-Wallis & Willcoxon, flukset në rritje të IHD-ve kanë impakt pozitiv në rritjen e fuqisë ekonomike të një vendi, në rastin konkret të Kosovës.

Siç pamë në këtë punim, IHD-të prej vitit 2007 deri në vitin 2010, sektorët ekonomikë që kanë thithur më së shumti investime të huaja direkte kanë qenë shërbimet financiare, transporti dhe komunikacioni dhe industria përpunuese, ndërsa fare pak është investuar në bujqësi, energji dhe shërbime të tjera. Përderisa në vitin 2011-2012 është investuar në sektorin e ndërtimit, industrinë përpunuese dhe patundshmëri. Kurse në vitin 2013 në përgjithësi ka pasur rënie të IHD-ve dhe kanë qenë të orientuara në patundshmëri 48.57 %, energji elektrike 17.42 %, ndërtim 6.17 % dhe shërbime tregtare 5.21 %. Ndërsa në vitin 2014 kryesisht në patundshmëri 94.05 %, shërbime financiare 28.49 %, elektricitet 8.86 %, përderisa ka pasur rënie tepër të madhe në sektorët e industrisë përpunuese (-22.54 %), në ndërtim (-13.15 %) dhe në transport e komunikacion (-6.1 %). Kjo rënie është për shkak të jostabilitetit politik (pasiviteti i qeverisë gjatë periudhës gjashtëmujore qershor - dhjetor 2014), korrupsioni në nivele të larta shtetërore dhe pasiguria për t'i mbrojtur investimet.

Vendet nga të cilat kanë prejardhjen këto investime janë ato të BE-së si: Gjermania, Anglia, Sllovenia, Austria, Zvicra, Holanda, si dhe nga Turqia e Shqipëria etj. Gjeografia e investimeve të huaja nxjerrë në pah ndikimin e faktorëve të “gravitetit” në flukset e IHD-ve në Kosovë,

faktorë që lidhen me afërsinë gjeografike, etnike apo lidhje mes vendeve me flukse migratore të hershme apo të reja.

Madhësia e tregut (H2). Kosova është një ekonomi dinamike në ristrukturim, e interesuar ta përmirësojë klimën e biznesit dhe infrastrukturën për IHD-të, duke synuar uljen e kostove të të bërit biznes si një nga faktorët kryesorë të atraksionit të flukseve hyrëse të IHD-ve.

Gjatë hulumtimit dhe rishikimit të literaturës shihet se institucionet e Kosovës kanë bërë përpjekje ta përmirësojnë legjislacionin në fuqi dhe ta forcojnë zbatimin e ligjit, me qëllim përcjelljen e një mesazhi sigurie për investitorë të huaj për një ambient të sigurt për investime.

Stabiliteti politik i ndjeshëm dhe i luhatshëm e bën një vend shumë pak tërheqës ndaj investitorëve të huaj, pavarësisht avantazheve të tjera që mund të ketë vendi. Evidencat e shqyrtuara gjatë këtij studimi tregojnë se perceptimi i Kosovës nga ana e investitorëve potencialë varet nga opinioni publik ndërkombëtar për Kosovën.

Përmirësimi i klimës së të bërit biznes (H3). Kosova cilësohet si vend në tranzicion me stabilitet të dobët politik dhe ekonomik. Kjo reflektohet edhe në perceptimin publik të shfaqur si “bindje”, se korrupsioni është një ndër problemet më të mëdha me të cilët ballafaqohen sot sektori i biznesit dhe shërbimeve. Është evidente se Kosova ka ende nevojë për flukse kapitali të huaj në funksion të rritjes ekonomike, transformimit strukturor të ekonomisë, transferimit të teknologjive të reja dhe përmirësimit të konkurrueshmërisë. Rritja e IHD-ve kërkon përmirësim të vazhdueshëm të ambientit dhe klimës së biznesit si faktori më i rëndësishëm për t’i tërhequr IHD-të për t’u eksploruar, duke pasur parasysh se flukset e deritanishme janë më shumë ato me natyrë gravitacionale.

Rritja e investimeve të huaja do të ishte një burim i rëndësishëm rritjeje ekonomike për Kosovën dhe nxitja e tyre ngelet prioritet politik i qeverisë, ndaj përmirësimi i indekseve të

stabilitetit politik, stabilitetit makroekonomik si dhe treguesit e klimës së biznesit dhe qeverisjes do të jepnin ndikim të menjëhershëm në optimizimin e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte në Kosovë.

5.2 REKOMANDIME TË NEVOJSHME

- Hapja e tregut (H1). Infrastruktura (duke përfshirë energjinë elektrike dhe ujin) ka nevojë për një zgjidhje të përhershme, me qëllim nxitjen e investimeve të huaja në të gjithë Kosovën. Rritja e investimeve publike në infrastrukturë nuk është zgjidhja e vetme. Përpjekje mund të bëhen në drejtim të tërheqjes së projekteve të huaja në këtë fushë përmes ofrimit të stimujve të veçantë.
- Për sa i përket kuadrit ligjor mbi tatimet dhe taksat, Kosova tashmë ka lidhur marrëveshje dypalëshe me vendet e CEFTA-s në lidhje me tregtinë e lirë. Megjithatë, për të tërhequr më tepër investime të huaja, këto marrëveshje duhet të zgjerohen edhe me vende të tjera, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në tregjet ndërkombëtare si, për shembull, me vende të Evropës Perëndimore (siç është Mbretëria e Bashkuar) dhe me SHBA-në.
- Investimi në burimet njerëzore (kuadri arsimor) dhe të krijojë kompetenca të kërkuara nga sektorë që kanë potencial zhvillimi dhe janë tërheqës për investitorët e huaj.
- Reformat në legjislacionin, në klimën e biznesit, promovimit të sektorëve dhe burimeve ekonomike që e bëjnë Kosovën atraktive për kapitalin e huaj apo dhe kapitalin e diasporës kosovare duhet të vazhdojnë të jenë në fokusin e politikëbërjes për t'i sjellë IHD-të në nivele potenciale të ekonomisë kosovare. Këto flukse kapitalesh, transferim të

njohurive dhe teknologjisë, hapje të tregjeve, rrisin konkurrencën, ndikojnë në reduktimin e deficitit të llogarive korente dhe në mirëqenien qytetare.

- Madhësia e tregut (H2). Duhet bërë politika afatgjata për inkurajimin e IHD-ve, t'i ndryshojë rregulloret aktuale për tërheqjen e investimeve të huaja në sektorët strategjikë, gjegjësisht në sektorin e prodhimit që lidhen me prodhimin e mallrave për eksport. Kjo do ta ndryshonte pozitivisht bilancin tregtar dhe Kosova do të ishte në pjesëmarrje me ndarjen rajonale të tregut, që padyshim do ta ulte edhe papunësinë.
- Një ndikim të ndjeshëm në rritjen e IHD-ve do të kishte ndërtimi i politikave për të tërhequr investime në sektorin e bujqësisë. Politikat kombëtare janë të domosdoshme për ta bërë këtë sektor tërheqës për investitorët e huaj. Ky sektor konsiderohet shumë i rëndësishëm për zhvillim ekonomik të vendit dhe uljen e papunësisë.
- Përmirësimi i klimës së të bërit biznes (H3). Duhet bërë përpjekje për përmirësimin e mjedisit të biznesit, me qëllim rritjen e flukseve hyrëse të IHD-ve. Një problem kryesor që ndikon jo vetëm në IHD-të është korrupsioni në nivele të larta shtetërore.
- Një nga masat më të rëndësishme që mund të ndërmerret nga qeveria për nxitjen e investimeve të huaja është heqja e barrierave që lidhen me IHD-të në mënyrë që të përmirësohet klima e investimeve në Kosovë dhe perceptimi i saj nga investitorët e huaj.
- Me qëllim lehtësimin e investimeve të huaja, një masë e rëndësishme do të ishte eliminimi i rregulloreve të panevojshme (të cilat krijojnë hapësira për mitmarrje dhe korrupsion). Rregulloret e tjera duhet të jenë më tepër transparente dhe të përgjegjshme.
- Kuadri ligjor duhet të përforcohet jo vetëm në aspektin e legjislacionit, por edhe të zbatimit të tij dhe transparencës që lidhet me të, me rregulloret dhe procedurat. Zvogëlimi i përmasave të ekonomisë informale do të ndihmonte jo vetëm në përmirësimin e

ekonomisë në aspektin makroekonomik, por do ta eliminonte pengesën më të madhe të biznesit të ligjshëm, që është konkurrenca e pandershme.

- Së fundi, duhet inkurajuar zhvillimin e zonave të veçanta gjeografike brenda vendit, të cilat përfaqësojnë zona me mundësi të mëdha investimi në vend, duke u përpjekur ta bëjë të gjithë vendin më tërheqës. Zona të tilla janë ato industriale ose turistike (si, për shembull, orientimi i IHD-ve në miniera e minerale siç është rasti i Ferronikelit, si dhe stimuj dhe përgatitje të një plani për IHD-të në Brezovicë, Prevallë dhe në Grykën e Rugovës si qendra të turizmit malor). Zhvillimi i këtyre zonave mund të kërkojë investime dhe burime të mëdha. Megjithatë, fillimisht mund të ndërmerren pilotprojekte të cilat mund të vihen në zbatim në plan më të gjerë pas funksionimit të tyre.

5.3 SUGJERIMET PËR KËRKIME NË TË ARDHMEN

Me këtë studim është vënë një bazë e mirë për hulumtime më të thella në fushën e krijimit të ambientit të favorshëm biznesor për nxitjen e IHD-ve. Ky studim vë në pah pengesat që hasin investitorët e huaj në rastin e shfaqjes së interesit të tyre për investime në Kosovë.

Këtu targeton pikat e dobëta të legjislacionit në fuqi dhe politikave aktuale ekonomike, tatimore dhe doganore si dhe jepen shembuj krahasimor me praktikatat më të mira të vendeve më të zhvilluara të Europës.

Edhe pse seritë kohore të shkurtëra kanë qenë pengesë për një analizë më të thellë, është ofruar një bazë të mirë për analiza të mëtejshme në fushën e investimeve të huaja direkte. Pra, do të shërbej për studime të ardhshme në këtë fushë.

6.ANEKSET

Pyetësi, Testi Kruskall-Wallis dhe Wilcoxon, grafikët e rezultateve të pyetësorit dhe grafikët e indikatorëve të qeverisjes botërore për Kosovën (WGI)

PYETËSORI

Faktorët që merren në konsideratë në Investimet e Huaja Direkte në Kosovë

I/e nderuar,

Jam në proces të punimit të temës doktrale, *Investimet e Huaja Direkte në Kosovë*, prandaj ju ofroj këtë pyetësor, përmes të cilit do t'i identifikoj faktorët të cilët ndikojnë në IHD-të në Kosovë.

Pyetësi është i përgatitur në atë formë, i cili më mundëson t'i marr opinionet e ndryshme lidhur me interesimin për investime në Kosovë.

Përgjigjet tuaja do të jenë me interes për të arritur konkluzione për këtë fushë të interesit. Në fund, rezultatet e dala nga ky pyetësor shpresoj të jenë edhe në interes për kompanitë që planifikojnë të investojnë në Kosovë. Prandaj, ju lutem të shënoni me shenjë (✓) TIK, në përgjigjen që ju e vlerësoni të arsyeshme.

Duke shpresuar se plotësimi i këtij pyetësi nuk do t'ju marrë më shumë se 10 deri 15 minuta kohë, ju faleminderit për bashkëpunim!

Me respekt,

Demir Lima, kandidat për Doktoratë në Universitetin Evropian të Tiranës.

Emri i kompanisë.....

Origjina e kompanisë.....

Veprimtaria e Kompanisë

- ☐ Shërbime financiare
- ☐ Telekomunikacion
- ☐ Tregti
- ☐ Patundshmëri

- ☐ Tjetër

10. Si e konsideroni faktorin ekonomik për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
☐ Deri-diku i përshtatshëm
☐ I përshtatshëm
☐ Shumë i përshtatshëm

11. Si e konsideroni stabilitetin e faktorit politik për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
☐ Deri-diku i përshtatshëm
☐ I përshtatshëm
☐ Shumë i përshtatshëm

12. Si e konsideroni legjislacionin në fuqi dhe atraktivitetin e tij për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
☐ Deri-diku i përshtatshëm
☐ I përshtatshëm
☐ Shumë i përshtatshëm

13. Sa e konsideroni të përshtatshëm Ligjin për mbrojtje të investime të huaja direkte në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
☐ Deri-diku i përshtatshëm
☐ I përshtatshëm
☐ Shumë i përshtatshëm

14. Sa janë të përshtatshme politikat doganore për investime në Kosovë?

- ☐ Të papërshtatshme

- ☐ Deri-diku të përshtatshme
- ☐ Të përshtatshme
- ☐ Shumë të përshtatshme

15. Sa janë të përshtatshme politikat tatimore për investime në Kosovë?

- ☐ Të papërshtatshme
- ☐ Deri-diku të përshtatshme
- ☐ Të përshtatshme
- ☐ Shumë të përshtatshme

16. Sa është i përshtatshëm ndikimi i kostos së punës për investime në Kosovë?

- ☐ I papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm
- ☐ I përshtatshëm
- ☐ Shumë i përshtatshëm

17. Krahaseshmëria e atraktivitetit për investime në Kosovë me vendet fqinje?

- ☐ Më i papërshtatshëm
- ☐ Deri-diku i përshtatshëm (neutrale)
- ☐ Më i përshtatshëm
- ☐ Shumë më i përshtatshme

18. Pritshmëritë për gjendjen e biznesit për vitin e ardhshëm?

- ☐ Patundshmëri, qiradhënie, aktivitet të tjera biznesore
- ☐ Ndërtim
- ☐ Industri
- ☐ Shërbime financiare
- ☐ Transport dhe komunikim
- ☐ Shërbime tregtare
- ☐ Energjetikë
- ☐ Aktivitete të tjera

Testi i Kruskall-Wallis mbeshtet te dhenat ne tabelen (1)

Klasifikimet

	Zhvillimi i biznesit ne te ardhmen	N	Classificazione della media
EKONOMIK	1	8	20,75
	2	7	31,86
	3	19	23,97
	4	14	23,68
	Totale	48	
POLITIK	1	8	25,25
	2	7	21,79
	3	19	27,76
	4	14	21,00
	Totale	48	
LEGJISLACIONI	1	8	26,25
	2	7	19,71
	3	19	25,11
	4	14	25,07
	Totale	48	
Mbrojtja e IHD	1	8	25,81
	2	7	28,36
	3	19	22,76
	4	14	24,18

	Totale	48	
politikat doganore	1	8	30,00
	2	7	20,21
	3	19	26,13
	4	14	21,29
	Totale	48	
politikat tatimore per IHD	1	8	19,44
	2	7	26,93
	3	19	22,47
	4	14	28,93
	Totale	48	
kostot e punes	1	8	23,25
	2	7	21,21
	3	19	24,66
	4	14	26,64
	Totale	48	
	Totale	48	

Testi i Wilcoxon per krahasimin midis faktoreve te pershtatshmerise

		N	Classificazion e della media	Somma delle classificazioni
Politik - Ekonomik	Classificazioni negative	14 ^a	19,21	269,00
	Classificazioni positive	17 ^b	13,35	227,00
	Correlazioni	17 ^c		
	Totale	48		
Legjislacioni - Ekonomik	Classificazioni negative	15 ^d	16,10	241,50
	Classificazioni positive	18 ^e	17,75	319,50
	Correlazioni	15 ^f		
	Totale	48		
Mbrojtja e IHD - Ekonomik	Classificazioni negative	15 ^g	22,57	338,50
	Classificazioni positive	24 ^h	18,40	441,50
	Correlazioni	9 ⁱ		
	Totale	48		
Politikat doganore - Ekonomik	Classificazioni negative	18 ^j	18,50	333,00
	Classificazioni positive	17 ^k	17,47	297,00
	Correlazioni	13 ^l		
	Totale	48		

politikat tatimore per IHD - Ekonomik	Classificazioni negative	19 ^m	16,68	317,00
	Classificazioni positive	16 ⁿ	19,56	313,00
	Correlazioni	13 ^o		
	Totale	48		
Kostot e punes - Ekonomik	Classificazioni negative	5 ^p	10,50	52,50
	Classificazioni positive	35 ^q	21,93	767,50
	Correlazioni	8 ^r		
	Totale	48		
Legjislacioni - Politik	Classificazioni negative	12 ^y	13,92	167,00
	Classificazioni positive	18 ^z	16,56	298,00
	Correlazioni	18 ^{aa}		
	Totale	48		
Mbrojtja e IHD - Politik	Classificazioni negative	12 ^{ab}	16,08	193,00
	Classificazioni positive	20 ^{ac}	16,75	335,00
	Correlazioni	16 ^{ad}		
	Totale	48		
Politikat doganore - Politik	Classificazioni negative	17 ^{ae}	15,50	263,50
	Classificazioni positive	16 ^{af}	18,59	297,50
	Correlazioni	15 ^{ag}		


	Totale	48		
Politikat tatimore per IHD - Politik	Classificazioni negative	16 ^{ah}	16,53	264,50
	Classificazioni positive	17 ^{ai}	17,44	296,50
	Correlazioni	15 ^{aj}		
	Totale	48		
Kostot e punes - Politik	Classificazioni negative	4 ^{ak}	15,75	63,00
	Classificazioni positive	39 ^{al}	22,64	883,00
	Correlazioni	5 ^{am}		
	Totale	48		
	Correlazioni	8 ^{as}		
	Totale	48		
Mbrojtja e IHD - Legjislacioni	Classificazioni negative	17 ^{at}	18,35	312,00
	Classificazioni positive	18 ^{au}	17,67	318,00
	Correlazioni	13 ^{av}		
	Totale	48		
politikat doganore - LEGJISLACIONI	Classificazioni negative	15 ^{aw}	18,80	282,00
	Classificazioni positive	15 ^{ax}	12,20	183,00
	Correlazioni	18 ^{ay}		
	Totale	48		

Politikat tatimore per IHD - Legjislacioni	Classificazioni negative	18 ^{az}	16,31	293,50
	Classificazioni positive	13 ^{ba}	15,58	202,50
	Correlazioni	17 ^{bb}		
	Totale	48		
Kostot e punes - Legjislacioni	Classificazioni negative	6 ^{bc}	15,08	90,50
	Classificazioni positive	34 ^{bd}	21,46	729,50
	Correlazioni	8 ^{be}		
	Totale	48		
Politikat doganore - Mbrojtja e IHD	Classificazioni negative	18 ^{bl}	15,33	276,00
	Classificazioni positive	12 ^{bm}	15,75	189,00
	Correlazioni	18 ^{bn}		
	Totale	48		
Politikat tatimore per IHD - Mbrojtja e IHD	Classificazioni negative	17 ^{bo}	17,88	304,00
	Classificazioni positive	14 ^{bp}	13,71	192,00
	Correlazioni	17 ^{bq}		
	Totale	48		
Kostot e punes - Mbrojtja e IHD	Classificazioni negative	6 ^{br}	19,50	117,00
	Classificazioni positive	37 ^{bs}	22,41	829,00
	Correlazioni	5 ^{bt}		

	Totale	48		
	Correlazioni	8 ^{bz}		
	Totale	48		
Politikat tatimore per IHD - Politikat doganore	Classificazioni negative	17 ^{ca}	19,65	334,00
	Classificazioni positive	19 ^{cb}	17,47	332,00
	Correlazioni	12 ^{cc}		
	Totale	48		
Kostot e punes - Politikat doganore	Classificazioni negative	4 ^{cd}	9,50	38,00
	Classificazioni positive	33 ^{ce}	20,15	665,00
	Correlazioni	11 ^{cf}		
	Totale	48		
	Correlazioni	10 ^{cl}		
	Totale	48		
Kostot e punes - Politikat tatimore per IHD	Classificazioni negative	2 ^{cm}	19,25	38,50
	Classificazioni positive	37 ^{cn}	20,04	741,50
	Correlazioni	9 ^{co}		
	Totale	48		
	Totale	48		
	Correlazioni	7 ^{cx}		
	Totale	48		

Grafikët e rezultateve të pyetësorit

Grafiku 1. Faktori politik për investime




Burimi: Përpunimi i autorit 2015

Grafiku 2. Faktori ekonomik për investime



Burimi: Përpunimi i autorit 2015

Grafiku 3. Legjislacioni në fuqi për investime në Kosovë



Burimi: Përpunimi i autorit 2015

Grafiku 4. Ligji për mbrojtjen e investimeve



Burimi: Përpunimi i autorit 2015

Grafiku 5. Politikat doganore për IHD-të



Burimi: Përpunimi i autorit 2015

Grafiku 6. Politikat tatimore për IHD-të



Burimi: Përpunimi i autorit 2015

Grafiku 7. Ndikimi i kostos së punës në IHD



Burimi: Përpunimi i autorit 2015

Grafiku 8. Krahasimi me vendet fqinjë



Burimi: Përpunimi i autorit 2015


Grafiku 9. Pritshmëria për vitet e ardhshme



Burimi: Përpunimi i autorit 2015


Raporti BB për Kosovën, 1996-2013 (treguesit e qeverisjes)

Treguesit totalë: Liria e shprehjes & llogaridhënia




Burimi: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c134.pdf>

Treguesit totalë: Stabiliteti politik & prania e dhunës




Burimi: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c134.pdf>

Treguesit totalë: Efektiviteti i Qeverisë




Burimi: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c134.pdf>

Treguesit totalë: Cilësia e rregullatorit




Burimi: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c134.pdf>

Treguesit totalë: Rendi dhe ligji



Burimi: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c134.pdf>

Treguesit totalë: Kontrolli i korrupsionit



Burimi: <http://info.worldbank.org/governance/wgi/pdf/c134.pdf>

Kufizimet e modelit – Arsyetimi per modelin OLS

Modeli OLS i përdorur në këtë punim nuk jep rezultate mjaft të vlefshme lidhur me faktorët që përcaktojnë IHD-të në Kosovë sepse ky model karakterizohet nga një sërë kufizimesh. Kufizimi i parë lidhet me seritë e shkurtra kohore të variablave të përfshira në analizë. Një numër i vogël i të dhënave nuk lejon përfshirjen në model të një numri më të madh variablash, që në rast se do të ishte e mundur, do të ndihmonte në një shpjegim më të mirë të mënyrës së ndërveprimit të variablave makroekonomika me njëri-tjetrin.

Nga ana tjetër, marrja parasysh e një numri të kufizuar variablash mund të çojë në problemin e specifikimit jo të mirë të modelit për shkak të mospërfshirjes së variablave të rëndësishme, gjë që ka pasoja për koeficientët e vlerësuar të modelit. Pavarësisht kufizimeve të mësipërme, modeli jep një kontribut të rëndësishëm në identifikimin e faktorëve që shërbejnë si tërheqës të IHD-ve dhe mbi lidhjen e tyre me rritjen ekonomike, si dhe ofron një bazë të mirë për analiza të mëtejshme në fushën e investimeve të huaja direkte. Pra, do të shërbejë për studime të ardhshme në këtë fushë.

Pavarësisht rezultateve jo të pritura kam vendosur që këtë model ta zhvendosim te anekset i cili do të shërbejë si bazë e mirë për studimet e ardhshme siç u cek më lartë.

Modeli OLS

Literatura mbi Investimet e Huaja Direkte në vendet me ekonomi në tranzicion është mjaft e pasur. Vrojtuesit janë përqendruar në dy pika kryesore: analizën e përcaktuesve të investimeve të huaja direkte, duke përfshirë studimin e lidhjes ndërmjet klimës së investimeve dhe IHD-ve dhe

analizën e impaktit të IHD-ve në ekonominë e vendit si nga pikëpamja makroekonomike (rritja ekonomike e mbarëvajtja e tregtisë), ashtu edhe nga ajo mikroekonomike (ristrukturimi dhe ecuria e ndërmarrjes).

Një analizë e tillë është menduar të bëhet edhe në këtë punim: fillimisht do të studiohen faktorët që mendohet të ndikojnë në Investimet e Huaja Direkte në Kosovë. Më tej do të shihet efekti i këtyre të fundit në normën e rritjes ekonomike, duke përdorur modelet që përshtaten më mirë me të dhënat, variabat e përzgjedhura dhe qëllimin e punimit. Përpara se të kalojmë në rezultatet e përftuara nga vlerësimi i modeleve, është e rëndësishme të bëhet një përmbledhje e literaturës që ekziston mbi Investimet e Huaja Direkte dhe mbi faktorët që mendohet të kenë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e sjelljes së tyre.

Metodologjia e përdorur në këtë punim konsiston në përdorimin e disa modeleve dhe teknikave të ndryshme të bëra ndaj treguesve fiskalë. Janë përdorur ekuacionet OLS me qëllim investigimin e faktorëve që ndikojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë. Është përdorur metodologjia e vlerësimit të regreseve VECM me synim afatgjatë se si ndikojnë IHD-të në rritjen ekonomike të Kosovës.

Të dhënat

Në analizën e bërë në këtë punim janë përdorur treguesit fiskalë të qeverisë dhe ato përfshijnë një periudhë që nga 2006-a deri në fund të 2013-s. Të dhënat e përdorura janë vjetore. Variablat e përdorura janë IHD-të, PBB-ja për frymë, hapja tregtare e matur si total i eksporteve dhe importeve ndaj PBB-së, norma e inflacionit, norma e interesit si dhe investimet private.

Faktorët përcaktues të IHD-ve të shqyrtuar për model

Një arsye e fortë që do ta motivonte një firmë për të krijuar lehtësi prodhimi jashtë, në vend se t'i eksportojë atje prodhimet e veta apo të kontraktojë një ndërmarrje vendëse, do të ishte perspektiva e fitimeve më të mëdha. Karakteristikat që duhet të ketë vendi pritës për të gjeneruar fitime më të larta për firmën dhe që përcaktojnë vendimin e saj për të investuar jashtë janë shumë dhe të ndryshme, e janë analizuar thellë e gjerë në literaturë. Një kontribut të rëndësishëm teorik për këtë çështje ka dhënë “teoria e diamantit” (diamond theory) e Porterit (1990), e cila bazohet në katër faktorë që përkufizohen si përcaktuesit e vendit:

- **Kushtet e faktorëve** - faktorët e prodhimit përfshijnë rezervat natyrore si dhe ato të krijuara si fuqia punëtore e kualifikuar apo infrastruktura;

- **Kushtet e kërkesës** - natyra e kërkesës së vendit për të mira e shërbime si dhe niveli i blerësve;

- **Industritë e lidhura e mbështetëse** - ekzistenca në treg e furnizuesve të tjerë apo e industrive të afërta me atë të investimit dhe;

- **Strategjia, struktura dhe rivaliteti i firmës** - konkurrenca e firmave vendëse dhe kushtet e krijimit, organizimit dhe administrimit të kompanisë.

Këta katër faktorë “diamantë”, së bashku me rolin e qeverisë në ekonomi dhe rolin e ngjarjeve të rastësishme, promovojnë ose ndalojnë krijimin e kushteve konkurruese për ndërmarrjet. Në përgjithësi, faktorët përcaktues që ndikojnë në zgjedhjen e vendit ku ndërmarrjet shumëkombëshe vendosin të investojnë, mund të klasifikohen në dy kategori: të lidhur me vendin e origjinës dhe të lidhur me vendin pritës.

Variablat e lidhura me vendin e origjinës janë faktorë që e bëjnë investimin jashtë më tërheqës sesa ai në vend për shkak të kushteve aktuale të vendit. Faktorët e lidhur me vendin pritës e bëjnë investimin në atë vend më tërheqës sesa mundësia e investimit në çdo vend tjetër. Në literaturë, faktorët e lidhur me vendin pritës janë ata të cilët kanë tërhequr më shumë vëmendjen. Edhe analiza ekonometrike e këtij punimi do të fokusohet pikërisht te këta faktorë.

Dunning (1993) argumenton se motivet dhe faktorët përcaktues të IHD-ve kanë ndryshuar në kohë. IHD-të drejt vendeve në zhvillim janë zhvendosur nga kërkues tregu drejt IHD-ve kërkues të burimeve e të rendimentit (vertikal). Vendet në zhvillim duhet t'i tërheqin IHD-të nëpërmjet:

- **Kushteve më të mira të tregut të punës** - që nuk nënkuptojnë vetëm fuqi punëtore me pak shpenzime, por edhe produktivitet, fleksibilitet dhe përshtatshmëri të fuqisë punëtore në vendin pritës. Si rrjedhim, vendi duhet të ofrojë fuqi punëtore relativisht të aftë e të arsimuar (nënkuptohet se vendi duhet të ketë një sistem të përshtatshëm arsimor);

- **Strukturë institucionale** - përveç tarifave të favorshme të taksave, administrata publike duhet të jetë fleksibile sa duhet për t'i inkurajuar investitorët. Institucionet vetë duhet të jenë elastike dhe dokumentacionet e nevojshme e procedurat e regjistrimit më pak të ndërlikuara për investitorët e huaj.

- **Përmasat e tregut** - përmasa e tregut të një vendi pritës nuk mund të matet vetëm nga popullsia e tij. Mund të ketë edhe faktorë të tjerë domethënës, sidomos faktorë të tillë si fuqia blerëse e popullsisë vendëse, afërsia dhe lidhjet me vende të tjera të lidhura me të, konkurrenca ekzistuese në vendin pritës e të tjera.

Janë kryer një sërë punimesh empirike që studiojnë faktorët përcaktues të IHD-ve. Pjesa më e madhe e tyre përqendrohet tek faktorët e vendit pritës të tillë si: PBB-ja për frymë, kostoja e fuqisë punëtore, kushtet makroekonomike të vendit, klima e biznesit, kuadri rregullator dhe

institucional etj. Metodologjia e përdorur varion sipas vendeve dhe autorëve. Kështu, për shembull, Antwi et al. (2013) kanë studiuar marrëdhëniet midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike në Ghana për periudhën 1980-2010, duke përdorur të dhëna sërish kohore. Ata vlerësojnë një regresion linear me metodën e zakonshme të katrorëve më të vegjël (OLS), ku si variabla shpjeguese merren PBB-ja, norma e rritjes së PBB-së, e ardhura kombëtare bruto (GNI), vlera e shtuar në industrinë përpunuese, stoku i borxhit të jashtëm, inflacioni, tregtia dhe vlera e shtuar në sektorin e industrisë.

Rezultatet tregojnë se të gjitha këto variabla kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e investimeve të huaja direkte. Autorë të tjerë arrijnë në përfundime të ngjashme duke përdorur modele me vektorë autoregresivë VAR. Qëllimi i kësaj pjese është të identifikohen se cilët prej faktorëve që sugjeron literatura mbi IHD-të shërbejnë si përcaktues të tyre. Në vijim të kësaj do të studiohet lidhja midis rritjes ekonomike dhe IHD-ve për të parë nëse këto të fundit kanë vërtet një rol pozitiv në performancën ekonomike të një vendi.

Analiza ekonometrike – Modeli OLS

Modeli në të cilin numri i variablave shpjeguese është më i madh se një, quhet model regres i shumëfishtë. Trajta e përgjithshme e një modeli regresi të shumëfishtë me variabla shpjeguese ose të pavarur është: $Y = C_1 + C_2X_2 + \dots + C_kX_k + u$ ku C_1 është intersepti, ndërsa C_i quhet koeficienti i pjesshëm i regresit, pra ai tregon sa ndryshon variabli i varur Y kur X_i rritet me një njësi, kurse variablat e tjera shpjeguese mbahen konstante. Në një përpjekje për t'i identifikuar përcaktuesit e investimeve të huaja direkte në Kosovë, në këtë studim është përdorur një model regresioni klasik linear, ku si variabël i varur janë marrë Investimet e Huaja Direkte, ndërsa variablat që e shpjegojnë atë janë: PPB-ja reale për frymë, shkalla e hapjes tregtare, norma e

inflacionit, norma reale e interesit, niveli i investimeve private ndaj PBB-së, pesha e IHD-ve ndaj PBB-së në periudhën paraardhëse. Në trajtë të përgjithshme, modeli do të paraqitet: **Ekuacioni nr 1:** $IHD_t = \alpha_0 + \alpha_1 * IHD_{t-1} + \alpha_2 * PBB_frymë_t + \alpha_3 * HAPJA_TR_t + \alpha_4 * INF_t + \alpha_5 * INT_t + \alpha_6 * INV_t + \varepsilon_t$, ku termi ε_t përfaqëson mbetjet e tij.

Tabela më poshtë shpjegon variablat e përfshira në model dhe efektin e pritur të tyre tek IHD-të. Është e rëndësishme të theksohet këtu se përjashtimi i variablave të tjera që mund të kenë ndikim në sjelljen e IHD-ve lidhet me mungesën e të dhënave për Kosovën.

Tabela 1. Variablat shpjeguese dhe efekti i pritur tek IHD-të

Variabli shpjegues	Përcaktimi	Efekti i pritur
IHD_{t-1}	Norma e FDI-ve ndaj PBB-së për periudhën e mëparshme	pozitiv
$PBB_frymë$	PBB-ja/frymë	pozitiv
$Hapja_tr$	Norma e eksporteve, plus importet ndaj PBB-së	pozitiv
Inv	Norma e formimit të kapitalit ndaj PBB-së	pozitiv
Inf	Norma e inflacionit	negativ
Int	Norma reale e interesit	pozitiv ose negativ

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Madhësia e tregut pritës, që përfaqëson gjithashtu kushtet ekonomike të vendit dhe kërkesa potenciale për prodhimin e tyre, është një element i rëndësishëm në vendimmarrjen e IHD-ve. Për më tepër, Scaperlanda dhe Maueri (1969) argumentojnë se IHD-të i përgjigjen pozitivisht madhësisë së tregut, pasi është arritur një nivel prag që është i madh mjaftueshëm, sa t'i lejojë ekonomitë e shkallës dhe përdorimin eficient të burimeve. Rëndësia e madhësisë së tregut konfirmohet gjithashtu në mjaft studime të mëparshme empirike (Kravis dhe Lipsey, 1982; Schneider dhe Frey, 1985; Wheeler dhe Mody, 1992; Tsai, 1994; Loree dhe Guisinger,

1995; Lipsey, 1999; Wei, 2000). Si përafrues i madhësisë së tregut, përdoret PBB-ja reale për frymë. Të dhënat janë marrë nga Enti i Statistikave. Përderisa ky variabël përdoret si tregues i tregut potencial të produkteve të investitorëve të huaj, shenja e pritur është pozitive. PBB-ja për frymë mund ta përafrojë bollëkun e kapitalit (Edwards, 1990) dhe klimën e investimeve (Wei, 2000; Aseidu, 2002).

Hapja tregtare ka një hipotezë standarde, sipas së cilës, hapja nxit IHD-të (Hufbauer et al. 1994). Në literaturë raporti i tregtisë ndaj PBB-së përdoret shpesh si masë e hapjes së një vendi dhe interpretohet si masë e kufizimeve tregtare. Ky tregues është i rëndësishëm për investitorët e huaj direktë, të cilët motivohen nga tregu i eksporteve. Evidencat empirike (Jun dhe Singh, 1996) testojnë nëse nivele më të larta të eksporteve çojnë në flukse hyrëse më të larta të IHD-ve. Kjo shpjegon faktin pse $(Ex+Im)/PBB$ është përfshirë në regresion. Investimet private si raport ndaj PBB-së shërbejnë si tregues për mjedisin e investimeve në vendin pritës. Një nivel më i lartë i investimeve private tregon një klimë më të përshtatshme biznesi, e cila përfshin infrastrukturën, politikë favorizuese taksash, procedura burokratike lehtësuese.

Norma e inflacionit përdoret si *proxy* për rrezikun makroekonomik të vendit pritës. Sa më e lartë të jetë ajo, aq më shumë gjasa ka që vendi të përjetojë paqëndrueshmëri makroekonomike. Norma reale e interesit kap gjithashtu rrezikun makroekonomik të vendit dhe shërben si faktor tërheqës i investimeve të huaja direkte. Ndër treguesit më të zakonshëm që përdoret për matjen e IHD-ve është raporti flukse hyrëse neto të IHD-ve ndaj PBB-së (see Adeisu, 2002; Quarzi, 2005; Goospeed et al, 2006).

Informacioni mbi të dhënat e mësipërme është marrë nga Banka Qendrore e Kosovës, Enti i Statistikave, por edhe institucione ndërkombëtare si FMN-ja. Të dhënat janë vjetore dhe përfshijnë periudhën 2002-2013. Për vlerësimin e modelit është përdorur metoda e zakonshme e

katrorëve më të vegjël (OLS), e cila jep koeficientë të paanshëm, të pazhvendosur dhe eficientë, në qoftë se kënaqen të ashtuquajturat supozimet e Gauss-Markov-it (Brooks, 2002):

1. $E(\varepsilon_i)=0$ mesatarja e gabimeve të jetë zero.
2. $\text{Var}(\varepsilon_i)=\sigma^2$ varianca e gabimeve të jetë konstante dhe një numër i fundmë për çdo vlerë të x_i .
3. $\text{Cov}(\varepsilon_i, \varepsilon_j)=0$ termat e gabimit të jenë statistikisht të pavarur nga njëri-tjetri.
4. $\text{Cov}(\varepsilon_i, x_i)=0$ termat e gabimit të jenë të pavarur nga variablat shpjeguese.
5. $\varepsilon_i \sim N(0, \sigma^2)$ ε_i kanë shpërndarje normale.

Në qoftë se një apo më shumë nga këto supozime nuk përmbushen, atëherë modeli mund ta shfaqë çdonjërin prej probleme të mëposhtme:

- Koeficientet e vlerësuar (β) janë të anshëm, gjë që do të thotë se $E(\beta) \neq \beta$.
- Gabimet standarde që lidhen me to janë të anshme. Për pasojë, testimi i hipotezave nuk ka vlerë.
- Shpërndarja që supozohet për statistikën e testeve është e papërshtatshme.

Në tabelën 2 paraqiten rezultatet e përftuara nga vlerësimi i modelit. Ato sugjerojnë se PBB-ja për frymë, shkalla e hapjes tregtare, investimet private dhe Investimet e Huaja Direkte në periudhën paraardhëse kanë një ndikim statistikisht të rëndësishëm në nivelin e investimeve të huaja direkte ndaj PBB-së për nivelin e rëndësisë 0.05.

Tabela 2. Rezultatet e vlerësimit të modelit

Dependent Variable: IHD

Method: Least Squares

Date: 03/03/15 Time: 07:45

Sample (adjusted): 2006 2013

Included observations: 8 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
IHD(-1)	0.410463	0.229428	0.652121	0.0321
PBB_FRYME	0.800736	0.541600	0.555274	0.0493
HAPJA_TR	2.015187	1.224556	0.090588	0.0425
INF	-1.288389	16.60262	-0.077602	0.9507
INT	1.8683	191.7752	0.593759	0.6589
INV	2.129517	1.141881	-0.989172	0.0335
C	29.119	5261.458	-0.555952	0.6770
R-squared	0.779934	Mean dependent var	3.985100	
Adjusted R-squared	0.540465	S.D. dependent var	0.576940	
S.E. of regression	0.759996	Akaike info criterion	11.45400	
Sum squared resid	3.751132	Schwarz criterion	11.52351	
Log likelihood	-18.81599	Hannan-Quinn criter.	10.98517	
F-statistic	13.59680	Durbin-Watson stat	2.23001	
Prob(F-statistic)	0.009060			

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Ekuacioni nr. 2: Vlerësimi i modelit OLS në formë ekuacioni

$$IHD_t = 29.1 + 0.41 \cdot IHD_{t-1} + 0.80 \cdot PBB_frymë_t + 2.01 \cdot HAPJA_TR_t - 1.28 \cdot INF_t + 1.86 \cdot INT_t + 2.12 \cdot INV_t$$

$R^2 = 0.78$ (78 % e modelit shpjegohet nga variablat e modelit të marrë në studim).

Për ta studiuar rëndësinë statistikore të koeficienteve individuale përpara variablave ngrehim dhe testojmë hipotezën (në trajtë të përgjithshme):

$$H_0: C_i = 0$$

$$H_a: C_i \neq 0$$

$$\text{Hipoteza zero bie poshtë në qoftë se } t_v = \frac{C_i}{se(C_i)} > t_{\frac{\alpha}{2}, n-2} \Rightarrow H_0 \downarrow$$

Duke përdorur këtë mënyrë arsyetimi, shohim se variablat shpjeguese si PBB-ja për frymë, shkalla e hapjes tregtare, investimet private dhe Investimet e Huaja Direkte rezultojnë statistikisht të rëndësishëm. Për ta parë rëndësinë statistikore të modelit në tërësi, i referohemi vlerës së Fisherit që gjenerohet automatikisht nga programi. Në rastin e modelit tonë, kjo vlerë është 13.59 dhe duke qenë se ajo është më e madhe se 4, mund të themi se, edhe pse koeficientet individualisht nuk janë të gjithë statistikisht të rëndësishëm, por vetë modeli në tërësi është statistikisht i rëndësishëm. Koeficienti i përcaktueshmërisë R^2 , i cili llogaritet me anë të formulës: $R^2 = 1 - \frac{SKG}{SKT}$, është 78 %, gjë që tregon se variablat shpjeguese të përfshira në model shpjegojnë 78 % të variacionit të variablit të varur, që në këtë rast është IHD-ja. Në mënyrë që të mund të bazohemi te këto rezultate për qëllimin e punimit tonë, na duhet të shohim nëse plotësohen supozimet e Gauss-Markov-it.

1. Supozimi i mesatares zero $E(\varepsilon_i)=0$

Supozimi i parë kërkon që vlera mesatare e termit të gabimit të jetë zero. Ky supozim nuk dhunohet kurrë sa kohë që ekuacioni i regresionit përmban një term konstant. Siç shihet nga tabela 3, mesatarja e mbetjeve është e rendit 10^{-13} , pra fare e papërfillshme, kështu që mund të themi se supozimi i parë plotësohet.

Tabela 3. Statistikat e mbetjeve të modelit

	MBETJE
Mean	4.55E-13
Median	-6.133141
Maximum	50.71818
Minimum	-44.35969
Std. Dev.	33.10967

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

2. Supozimi i homoskedasticitetit $Var(\varepsilon_i) = \sigma^2$

Në qoftë se cenohet supozimi i heteroskedasticitetit, gabimet standarde do të jenë të anshme. Në këtë rast, nuk mund të bazohemi te statistikën t dhe testi t bëhet i pavlefshëm. Për ta studiuar heteroskedasticitetin është përdorur testi Breusch-Pagan-Godfrey, sipas të cilit, katrori i mbetjeve të modelit regresohet ndaj variablave shpjeguese në nivel, në katror dhe ndërveprimeve midis tyre. Hipoteza që ngrihet në këtë rast është:

H_0 : Gabimet janë homoskedastike.

H_a : Gabimet janë heteroskedastike.

Meqenëse në rastin tonë vlera e p-së është $0.5136 < 0.05 = \alpha$, atëherë nuk mund ta hedhim poshtë H_0 , gjë që do të thotë se modeli ynë nuk vuan nga heteroskedasticiteti.

Tabela 4. Testi Breusch-Pagan-Godfrey i heteroskedasticitetit

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	1.818783	Prob. F(6,1)	0.5136
Obs*R-squared	7.328448	Prob. Chi-Square(6)	0.2915

Scaled explained SS 0.044909 Prob. Chi-Square(6) 1.0000

Test Equation:

Dependent Variable: RESID^2

Method: Least Squares

Date: 03/03/15 Time: 15:04

Sample: 2006 2013

Included observations: 8

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-41890.53	41814.20	-1.001826	0.4994
IHD(-1)	1.833903	5.002228	0.366617	0.7763
PBB_FRYME	3.078320	4.304235	0.715184	0.6048
HAPJA_TREGTAR				
E	85.09324	176.7914	0.481320	0.7144
INF	3.613524	131.9454	0.027387	0.9826
INT	1497.664	1524.089	0.982662	0.5056
INV	-9.484663	9.074829	-1.045162	0.4859
R-squared	0.916056	Mean dependent var	959.2190	
Adjusted R-squared	0.412392	S.D. dependent var	908.1919	
S.E. of regression	696.1800	Akaike info criterion	15.59965	
Sum squared resid	484666.6	Schwarz criterion	15.66916	
Log likelihood	-55.39861	Hannan-Quinn criter.	15.13083	
F-statistic	1.818783	Durbin-Watson stat	3.631001	
Prob(F-statistic)	0.513610			

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

3. Supozimi i mungesës së autokorrelacionit $Cov(\varepsilon_i, \varepsilon_j)=0$ për $i \neq j$.

Në qoftë se termat e mbetjeve nuk janë të pakorreluar me njëri-tjetrin, atëherë mund të thuhet se janë të autokorreluar ose të korreluar në mënyrë seriale. Pasojat e mosmarrjes parasysht të autokorrelacionit janë të njëjta me ato të injorimit të heteroskedasticitetit. Koeficientet e vlerësuar me metodën OLS vazhdojnë të jenë të paanshëm, por janë inefficientë, duke bërë që gabimet standarde të jenë të anshme. Për më tepër, në kushte të tilla R^2 ka të ngjarë të jetë e mbivlerësuar.

Një test i zakonshëm që përdoret për ta zbuluar autokorrelacionin është testi Breusch-Godfrey, sipas të cilit, mbetjet e modelit regresohen ndaj variablave shpjeguese dhe ndaj mbetjeve të periudhave të kaluara. Hipoteza zero në këtë rast teston nëse koeficientet përpara variablave shpjeguese janë zero, pra nëse ndikojnë te mbetjet e modelit apo jo. Meqenëse numri i vërtetimeve është mjaft i vogël, për shkak të të dhënave të kufizuara, nga regresioni i këtij testi janë përjashtuar mbetjet e periudhave të mëparshme dhe janë lënë vetëm variablat shpjeguese.

Rezultatet e testit paraqiten në tabelën 5. Siç shihet, asnjëri nga koeficientet e vlerësuar nuk është statistikisht i rëndësishëm, përderisa vlera e p-së për secilin prej tyre është më e vogël se $\alpha=0.05$. Kjo do të thotë se termat e mbetjeve nuk janë të korreluar me variablat e pavarura dhe as me njëri-tjetrin. Pra, mund të themi se përmbushen edhe supozimet 3 dhe 4 të Gauss-Markov-it.

Tabela 5. Testi Breusch-Godfrey i autokorrelacionit të mbetjeve.

Dependent Variable: IHD

Method: Least Squares

Date: 03/03/15 Time: 07:45

Sample (adjusted): 2006 2013

Included observations: 8 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
----------	-------------	------------	-------------	-------

IHD(-1)	0.410463	0.129428	3.171361	0.0321
PBB_FRYME	0.800736	0.441600	1.992920	0.0493
HAPJA_TR	2.015187	0.894556	2.252723	0.0425
INF	-1.288389	16.60262	-0.077602	0.9507
INT	1.8683	191.7752	0.593759	0.6589
INV	2.129517	0.771881	2.758866	0.0335
C	29.119	5261.458	-0.555952	0.6770

R-squared	0.779934	Mean dependent var	3.985100
Adjusted R-squared	0.540465	S.D. dependent var	0.576940
S.E. of regression	0.759996	Akaike info criterion	11.45400
Sum squared resid	3.751132	Schwarz criterion	11.52351
Log likelihood	-18.81599	Hannan-Quinn criter.	10.98517
F-statistic	13.59680	Durbin-Watson stat	2.23001
Prob(F-statistic)	0.009060		

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

4. X_t nuk janë stokastike $Cov(\epsilon_t, x_t)=0$. Rezultatet e mësipërme sugjerojnë për mungesë korrelacioni midis termave të mbetjeve dhe variablave shpjegues, gjë që nënkupton se ky supozim plotësohet.

Supozimi i normalitetit $\epsilon_i \sim N(0, \sigma^2)$

Përmbushja e këtij supozimi është e nevojshme për testimin e hipotezave, veçanërisht kur madhësia e zgjedhjes është e vogël. Për zgjedhje mjaftueshmërisht të mëdha, cenimi i këtij supozimi nuk ka pasoja për modelin. Bazuar në teoremën e limitit qendror, statistika e testit do të ndjekë në mënyrë asimtotike shpërndarje të përshtatshme, edhe në mungesë të normalitetit të mbetjeve. Në zgjedhjet e vogla është e nevojshme të plotësohet ky supozim, në mënyrë që vlerat e p-së dhe testet t të jenë të vlefshme. Për të studiuar nëse mbetjet kanë apo jo shpërndarje


normale, shihen vlerat e lakueshmërisë (skewness) dhe kurtosës (kurtosis), të cilat mund të merren nga statistikën përshkuese. Mund të përdoret gjithashtu edhe testi Bera-Jarque, rezultatet e të cilit paraqiten në figurë. Hipoteza që ngrihet në këtë rast është:

H_0 : Mbetjet kanë shpërndarje normale

H_a : Mbetjet nuk kanë shpërndarje normale.

Meqenëse vlera e p-së është më e vogël se 0.05, hipoteza zero nuk mund të hidhet poshtë, gjë që tregon se mbetjet e modelit kanë shpërndarje normale.

Figura 4.1. Normaliteti i mbetjeve.



Burimi: Llogaritje të autorit 2015

5. Së fundi, është e nevojshme të shihet nëse modeli përmbush kushtin e stabilitetit dhe nëse forma funksionale e tij është lineare. Kjo do të thotë se modeli i regresionit është linear në parametra. Për këtë përdoret testi Ramsey, i cili është një test i përgjithshëm rreth specifikimit jo të mirë të formës funksionale. Në këtë rast hipotezat janë:

H_0 : Forma funksionale është lineare

H_a : Forma funksionale nuk është lineare.

Rezultatet e testit, të cilat paraqiten në figurë, sugjerojnë se forma lineare e zgjedhur i përshtatet mirë modelit, përderisa termi $FITTED^2$ del statistikisht i parëndësishëm ($p=0.6945 < \alpha=0.05$).

Tabela 6. Testi RESET i formës funksionale

Ramsey RESET Test

Equation: UNTITLED

Specification: IHD IHD(-1) PBB_FRYME HAPJA_TREGTARE

INF INT INV C

Omitted Variables: Squares of fitted values

	Value	df	Probability
t-statistic	0.520450	1	0.6945
F-statistic	0.270869	(1, 1)	0.6945
Likelihood ratio	1.917605	1	0.1661

F-test summary:

	Sum	of	Mean
	Sq.	df	Squares
Test SSR	2331.097	1	2331.097
Restricted SSR	10937.10	2	5468.552
Unrestricted SSR	8606.006	1	8606.006

LR test summary:

	Value	df
Restricted LogL	-40.23341	2

Unrestricted LogL -39.27460 1

Unrestricted Test Equation:

Dependent Variable: IHD

Method: Least Squares

Date: 03/04/15 Time: 11:03

Sample: 2006 2013

Included observations: 8

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
IHD(-1)	0.410463	0.229428	0.652121	0.3321
PBB_FRYME	1.643289	3.454424	0.475706	0.7173
HAPJA_TREGTARE	18.11052	45.31463	0.399662	0.7579
-				
INF	79.91414	166.6967	-0.479399	0.7154
-				
INT	784.8521	1643.371	-0.477587	0.7163
INV	6.535922	13.66960	0.478135	0.7161
C	17855.96	37170.30	0.480383	0.7149
FITTED^2	0.020998	0.040345	0.520450	0.6945
R-squared	0.753199	Mean dependent var	314.5100	
Adjusted R-squared	0.527610	S.D. dependent var	70.57940	
S.E. of regression	92.76856	Akaike info criterion	11.56865	
Sum squared resid	8606.006	Schwarz criterion	11.63816	
-				
Log likelihood	39.27460	Hannan-Quinn criter.	11.09983	
F-statistic	0.508640	Durbin-Watson stat	3.634827	
Prob(F-statistic)	0.789570			

Burimi: Llogaritje të autorit 2015

Testet diagnostikuese të përdorura për ta testuar përmbushjen e supozimeve të Gauss-Markovit sugjerojnë se modeli i kënaqë të gjitha supozimet e mësipërme për të gjeneruar vlerësues të paanshëm, eficientë dhe të pazhvendosur. Në këtë kontekst, mund të themi se modeli i përgjigjet qëllimit të këtij punimi për t'i identifikuar faktorët që përcaktojnë Investimet e Huaja Direkte në Kosovë. Nga rezultatet e përftuara pas vlerësimit të modelit, vihet re se të gjitha variablat shpjeguese kanë shenjat e pritura. Megjithatë, jo të gjithë rezultojnë statistikisht të rëndësishëm. Konkretisht, niveli i investimeve të huaja direkte në periudhën paraardhëse, PBB-ja për frymë, shkalla e hapjes tregtare dhe niveli i investimeve private kanë një ndikim pozitiv, statistikisht të rëndësishëm në nivelin e investimeve të huaja direkte, ndërkohë që norma reale e interesit dhe norma e inflacionit, megjithëse shfaqin efektin e pritur, nuk duket të influencojnë në vendimet e investitorëve të huaj për të ardhur në Kosovë

7.BIBLIOGRAFIA

1. Libra

Antwi, S., Mills, E.F.E.A., Mills, G. A. dhe Xicang Zhao, *Impact of foreign direct investment on economic growth: Empirical evidence from Ghana*, International Journal of Academic Research in Accounting, Finance and Management Sciences Vol. 3, No. 1, 2013

Antić, Aleksandër, *Prirucnik o investicijama*, Beograd, 1979

Balasubramanyam, V. N., Salisu, M., Dapsoford, D., *Foreign Direct Investment and Growth in EP and IS Countries*, Economic Journal, (Vol. 106, No. 434 (Jan., 1996), pp. 92-105)
<http://www.jstor.org/stable/22349331996>

Bernatonyte, D., Normantiene, A., *Estimation of Trade Specialization: the Case of the Baltic States*, Inzinerine Ekonomika-Engineering Economics (2), 2009

Blackman, A., Wu, X., *Foreign Direct Investment in China's Power Sector: Trends, Benefits and Barriers*, Energy Policy, Elsevier, vol. 27(12), <http://www.rff.org/documents/rff-dp-98-50.pdf>
1998

Bloomfield, Arthur I., *Patterns of Fluctuations in International Investment Before 1914*, Princeton Studies in International Finance No. 21, Princeton, NJ, Princeton University, International Finance Section, 1968

Brock, G., Urbonavicius, S., *Regional FDI growth in Lithuania, 1996-2003*, Transformations in Business & Economics, 2008 shih, <http://www.transformations.khf.vu.lt/13>

Brooks, Ch., *Introductory Econometrics for Finance*, Cambridge University Press, 2002

Campos, N., Konishita, Y., *Foreign Direct Investment as Technology Transferred: Some Panel Evidence from the Transition Economies*, William Davidson, Institute Working Paper, 2002

- Carkovic M., Levine R., *Does Foreign Direct investment Accelerate Economic Growth?*, University of Minesota, Working Paper, 2002
- Ccharles W. L. Hill, *International Busines*, New York, 2007
- Ciburienė, J., Zaharieva, G., *International Trade as a factor of competitiveness: comparison of Lithuanian*, (Kaunas University of Technology K. Donelaicio st. 73, LT-44029, Kaunas, Lithuania), 2006
- Choe, J. I., *Do foreign direct investment and gross domestic investment promote economic growth?*, Review of Development Economics, ([http://onlinelibrary.wiley.com/journal/10.1111/\(ISSN\)1467-9361](http://onlinelibrary.wiley.com/journal/10.1111/(ISSN)1467-9361)), 2003
- Chowdhury, A., Mavrotas, G., *FDI and Growth: A Causal Relationship*, UNUWIDER Research Paper, No. 2005/25, UNU-WIDER, Helsinki-Finland, 2005
- De Mello, L., *Foreign Direct Investment Led Growth: Evidence from Time-Series and Panel Data*, Oxford Economic Papers, Oxford University Press-USA, 1999.
- Drasković, Veselin, *Contrasts of globalization*, Ekonomika - Beograd and Marine Faculty, Kotor, 2002
- Dunning, J., *Multinational Enterprises and the Global Economy*, Addison-Wesley Publishing Company, Wokingham, England, 1992
- Epstein G., *A critique of neo-liberal globalization*, Third World Network, Massachusetts USA, 1999
- Frimpong, J. M., Oteng-Abayie, E. F., *Bivariate Causality Analysis between FDI Inflows and Economic Growth in Ghana*, International Research Journal of Finance and economics, ISSN 1450-2887 Issue 15, 2008 <http://www.internationalresearchjournaloffinanceandeconomics.com>

- Goldstein S., Joshua, *Marrëdhëniet ndërkombëtare, botimi i katërt*, ©2001 by Goldstein S., Joshua, për botim në shqip Dituria, Tiranë 2003
- Grigorova, V., *FDI in Industry in Bulgaria*, BAS, Sofje, 2007
- H. Mintzberg, *Natyra e punës menaxheriale*, New Jork Harper & Row, Nju Jork, 1973
- Halili, Rifat, Gogiqi, Fatlum, *Investimet si kusht për zhvillimin ekonomik*, Olymp, Prishtinë, 2013
- Han X. Vo, *Host country income effects of foreign direct investment: an analytical framework*, Journal of Economics and Economic Education Research, Copyright 2004 by the Allied Academies, Inc. Cullowhee, NC, USA
- Hellman, Joel, *Competitive Advantage: Political Competition and Economic Reform in postcommunist Transitions*, APSA, San Francisco, 1996
- Hobson, C. K., *The Export of Capital*, Constable, London, 1914
- Huntington, Samuel, *Vala e tretë. Demokratizimi në fund të shekullit XX*, AIIS, Tiranë, 2011
- Iversen, Carl, *Aspect of the Theory of International Capital Movements*, Copenhagen, Levin and Munksgaard, Humphrey Milford and Oxford University Press, London, 1936
- James, Sebastian, *Tax and Non-Tax Incentives and Investments: Evidence and Policy Implications*, World Bank Group , NW Washington, DC USA 2009
- Kopstein, Jeffrey & Reilly, David, *Geographic Diffusion and the Transformation of the Post-Communist World*, World Politics, Vol. 53, No. 1, Published by Cambridge University Press, 2000 <http://www.jstor.org/stable/25054135>
- Kukaj, Halil, *Biznesi ndërkombëtar*, Prishtinë, 2014
- Krugman, P. R., Obstfeld, M, *International Economics; theory and policy*, 4th ed Published 1997 by Addison-Wesley Longman, Inc., Han X. Vo (2004). *Host country income effects of foreign direct investment: an analytical framework. Journal of Economics and*

Journal of Economics and Economic Education Research Publisher: The DreamCatchers Group, LLC Audience: Academic

Lipsey, Robert E., *Changing Patterns of International Investment in and by the United States*, in Martin Feldstein (ed.), *The United States in the World Economy*, University of Chicago Press, Chicago, 1988

Loungani, P., Razin, A., *How beneficial is foreign direct investment for developing countries*, Finance and Development, A quarterly magazine of the IMF NY, USA, 2002

Lutkepohl, H., *New Introduction to Multiple Time Series Analysis*, European University Institute; Springer-Verlag, Berlin Heidelberg, 2005

Moosa, Imad A., *Foreign Direct Investment : theory, Evidence and Practice*, First Published by PALGRAVE, Hampshire, NY, USA, 2002

Mustafa, Muhamet, *Menaxhmenti i investimeve*, RIINVEST, Prishtinë, 2005

Olofsdotter, K., *Foreign direct investment, country capabilities and economic growth*, Weltwirtschaftliches Archiv, 134(3), Kiel, Germany, 1998

Penev, Slavica, *Perspektivat ekonomike dhe evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor*, Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD), Publikuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) Rrjeti i Parlamentarëve të Ballkanit Perëndimor të Komisioneve për Ekonomi, Financë dhe Buxhet Fakulteti i Ekonomisë, Sarajevë Instituti i Shkencave Ekonomike, Beograd 2013.

(P.J. Green, Bernard. W. Silverman, 1993, Nonparametric Regression and Generalized Linear Models: A roughness penalty approach).

Rothschild, Joseph., *East Central Europe between the Two World Wars*, University of Washington Press, USA, 1974

Saboniene, A., *Lithuanian Export Competitiveness: Comparison with other Baltic States*, Inžinerine Ekonomika-Engineering Economics (2), Kaunas University of Technology Lithuania, 2009

Sadin Xhaferi & Dushko Nikollovski, *Menaximi i investimeve*, Shtëpia Botuese "INTERLINGUA" Shkup, 2007

Segert, Dieter, Stöss, Richard und Niedermayer, Oskar, *Parteiensysteme in postkommunistischen Gesellschaften Osteuropas*, in *Zentralinstitut für Sozialwissenschaftliche Forschung*, Westdeutscher Verlag, Berlin, 1997

Slavica Penev, Matija Rojevc, *Foreign Direct Investment and the Investment Climate in South-East Europe*, Institute of Economic Sciences, Belgrade, 2009

Southard, Frank A., *American Industry in Europe*, Boston, New York, Houghton Mifflin company, 1931

Svedberg, Peter, *The Portfolio-Direct Investment Composition of Private Foreign Investment in 1914, Revisited*, Economic Journal 88, No. 352, University of Chicago Press, USA, 1978

Vanhanen, Tatu & Kimber, Richard, *Predicting and Explaining Democratization in Eastern Europe*, in: Pridham/Vanhanen (Hg.), 63-96, London/New York, 1994

Verbeek, M., *A Guide to Modern Econometrics, 2nd Edition*; Erasmus University Rotterdam; John Wiley & Sons Inc, Hollandë, 2004

Wilkins, Mira, *The Emergence of Multinational Enterprise: American Business Abroad from the Colonial Era to 1914*, MA, Harvard University Press, Cambridge, 1970

Zhang, K. H., *Does Foreign Direct Investment Promote Economic Growth? Evidence from East Asia and Latin America*, Contemporary Economic Policy, Illinois State University USA, 2001.

Issue published online: 26 MAR 2007

2. Revista, broshura e raporte të institucioneve qeveritare e bankare

Agjencia për Promovimin e Investimeve Malazeze

Agjencia e Statistikave të Kosovës

Banka Qendrore e Kosovës

Banka Botërore (WB)

Botimi i pestë i Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së (BPM5)

Britanika Enciklopediski Recnik vol. 4, Skopje, 2005

“Frankfurter Allgemeine Zeitung” (2002) për vendet e EJT-së dhe “The Economist” (2003) për diskutim të detajuar të shembujve të ngjashëm në Meksikë

Gallina A Vincelette, ekonomiste kryesore dhe një ndër autoret e RRE-së EJT-së

Hausmann dhe Fernández-Arias

IMF (International Monetary Fund), 1993

Indeksi i Lirisë Ekonomike (The Heritage Foundation, The Wall Street Journal)

Indeksi i Transformimit i Fondacionit Bertelsmann, Bertelsmann Stiftung

Instituti i Vjenës për Studimet Ndërkombëtare Ekonomike

Investment Law Reform Handbook/Doracaku i Reformës së Ligjit të Investimeve

Macroeconomic trends and Conjuncture

Ministria e Jashtme e Kosovës

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

Oda Ekonomike e Kosovës

OECD

Raporti Botëror i Investimeve, 2009

Raporti i Progresit në Mal të Zi, 2008

Raporti i të Bërit Biznes nga Banka Botërore, 2014,

Raporti Mujor Statistikor i Shqipërisë, 2009

Raporti Statistikor Vjetor i Serbisë, 2008

Raporti Vjetor Ekonomik, 2009

Referenca të Fischerit për një pasqyrë dhe diskutim të temave kryesore, 2003

Report of Croatian National Bank, 2009

Review of Economics and Statistics, August, pp 279-293 Hood Neil and Stephen Young, 1979

The American Invaders (1901), The American Invasion (1902), by Wilkins, The Emergence of Multinational Enterprise: American Business Abroad from the Colonial Era to 1914, Cambridge, MA, Harvard University Press, 1970

The Central Bureau of Statistics, 2009

UNCTAD, FDI/TNC database; World Investment Report 2014 - Investing in the SDGs: An Action Plan (UNCTAD/WIR/2014)

UNDP-United Nations Development Programme

World Investment Report, 1999, 2009

3. Burime nga interneti

www.amchamksv.org

<http://www.oecd.org>

www.worldbank.org

www.unctad.org

<http://knoema.com>

<http://www.census.gov>

<http://www.doingbusiness.org>

<http://www.transparency.org>

<http://www.itg-rks.com>

<https://www.imf.org>

<https://www.oek.org>

<https://www.bqk.org>

<https://ask.rks-gov.net/>

<http://www.mzhe-ks.net/>

<https://mf.rks-gov.net/>